

MANUAL ME VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (2023-2024)



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

**MANUAL
ME VENDIME TË PËRZGJEDHURA
TË GJYKATËS EVROPIANE PËR
TË DREJTAT E NJERIUT
(2023-2024)**

Tiranë, Nëntor 2024

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "© Këshilli i Evropës, 2024". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Directorate General Human Rights and Rule of Law /Southeast Europe and Turkey Unit, Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00 E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

@ Këshilli i Evropës, nëntor 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Kopertina: Foto nga FreePik

Shtypur në: Shtypshkronjën "Maluka"

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Shkurtime	7
I. Mbrojtja e të drejtave të pronës dhe banesës	9
A. Shembja e pronës	9
B. Dëbimi, konfiskimi dhe sanksione të tjera	18
C. Kthimi dhe kompensimi	25
II. Procese civile	31
A. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore	31
B. Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë	43
C. Të drejtat procedurale	48
D. Fokus i veçantë: Proceset gjyqësore që përfshijnë të drejtat e gjyqtarëve	60
III. Proceset penale	73
A. Hetimet	73
B. Arresti në burg	95
C. Procesi gjyqësor dhe Ekzekutimi	106
IV. Liria e Shprehjes dhe Informimit	116
V. Teknologjitë e reja	129
Lista e vendimeve sipas seksioneve	141
I. Mbrojtja e të drejtave pronësore dhe të strehimit	141
II. Procedurat civile	142
III. Procedurat penale	143
IV. Liria e shprehjes dhe informimit	144
V. Teknologjitë e reja	144
Lista e vendimeve sipas neneve të GJEDNJ-së	145
Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore amenduar me protokollin nr. 11	151

Hyrje

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) interpreton dhe zbaton të drejtat e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe protokollat e saj. Vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme dhe u kërkojnë Shteteve të korrigojnë shkeljet dhe të zbatojnë masa për të parandaluar çështjet e ardhshme. Përhapja e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është thelbësore për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut nga sistemet ligjore kombëtare. Vendimet e Gjykatës, të cilat evoluojnë me sfidat moderne, orientojnë Shtetet drejt mbrojtjes së këtyre të drejtave.

Ky Manual paraqet një përmbledhje të një numri të përzgjedhur çështjesh për të cilat GJEDNJ ka dalë me vendime në vitin 2023 dhe 2024. Manuali synon të shërbejë si një udhëzues praktik për profesionistët ligjorë shqiptarë (përfshirë avokatët e shtetit, gjyqtarët, avokatët dhe prokurorët) për të naviguar në peizazhin e pasur të jurisprudencës më të fundit të GJEDNJ-së. Qëllimi përfundimtar i këtij Manuali është të lehtësojë zbatimin e të drejtave të Konventës, të zhvilluara nga Gjykata, në nivel kombëtar dhe të fuqizojë profesionistët ligjorë për të kontribuar efektivisht në përafrimin e praktikave të brendshme gjyqësore me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për të arritur këtë qëllim, përzgjedhja dhe sistemimi i çështjeve të përfshira në këtë Manual u bë bazuar në vlerësimin e Avokatëve të Shtetit në Shqipëri.

Manuali është i ndarë në pesë pjesë tematike: Pjesa I trajton çështjet e mbrojtjes së pronës, të cilat shpesh janë të ndërlidhura me të drejtat për banesë; Pjesa II trajton çështjet që kanë të bëjnë me proceset civile, ku vëmendje e veçantë i kushtohet kërkesës për afatin e arsyeshëm dhe zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë; Pjesa III ka të bëjë me proceset penale, nga hetimet (duke marrë parasysh edhe detyrimet pozitive të Shteteve Anëtare që rrjedhin nga disa dispozita materiale të KEDNJ-së) dhe arresti në burg deri në gjykimin dhe ekzekutimin e vendimit përfundimtar; Pjesa IV raporton çështje për lirinë e shprehjes dhe ndarjen e informacionit; Pjesa V trajton çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut dhe teknologjitë e reja. Vendimet e GJEDNJ-së në lidhje me Shqipërinë mund të gjenden në fillim të çdo pjese/nënpjesë. Manuali përmban gjithashtu një

listë të shkurtimeve dhe dy lista të vendimeve gjyqësore të raportuara: njëra rendit vendimet gjyqësore sipas Pjesëve, tjetra rendit vendimet gjyqësore sipas neneve të KEDNJ-së.

Për çdo çështje do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të “mesazhit” që Gjykata i drejton palëve të interesuara kombëtare, një prezantim të shkurtër të fakteve (*Fakte*) të cilat janë thelbësore për të kuptuar arsyetimin ligjor dhe gjetjet kryesore të Gjykatës. (*Vendosi*). Një çështje mund të paraqitet në më shumë se një Pjesë, sipas çështjeve të ndryshme të shqyrtuara nga Gjykata.

Manuali është një nga rezultatet e projektit “Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në Shqipëri (D-REX III)”, i cili synon të mbështesë mbajtësit shqiptarë të të drejtave për të gëzuar më mirë të drejtat e njeriut përmes përmirësimit të kapacitetit të brendshëm për të zbatuar të drejtat e pronës dhe për të ekzekutuar vendimet përkatëse të GJEDNJ-së.

Ne ju inkurajojmë që ta përdorni këtë manual si një mjet praktik në punën tuaj të përditshme, për të përmirësuar të kuptuarit mbi çështjet e GJEDNJ-së me qëllim që të mbështesni në mënyrë efektive të drejtat dhe liritë themelore të GJEDNJ-së dhe të promovoni mbrojtjen e tyre në Shqipëri.

FRANCESCO DE SANTIS

GIULIA CILIBERTO

Shkurtime

Kër(at):	Kërkesa(t)
N.(et):	Neni(et)
ATP:	Agjencia e Trajtimit të Pronës
CCEJ:	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europeanë
Konventa+108:	Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale
KEDNJ/Konventa:	Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e njohur edhe si Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ/Gjykata:	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
DHM:	Dhoma e Madhe e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut
	Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, ose “GDPR”: Rregullore (BE) 2016/679 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, dhe që shfuqizon Direktivën 95/46/KE
GREVIO:	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KKGJ:	Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit
Nr(at):	Numri(at)
ZRPP:	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Prot:	Prot. i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
KPA:	Kolegji i Posaçëm i Apelit
SIA:	Instituti Shtetëror i Arteve

I. Mbrojtja e të drejtave të pronës dhe banesës

A. SHEMBJA E PRONËS

Zela kundër Shqipërisë , Kërkesa nr. 33164/11, Vendimi gjyqësor i datës 11 qershor 2024

Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të vendosin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të pronës së individëve në rastet që kanë të bëjnë me shembjen e objekteve pa leje. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të nenit 1 të Prot. nr.1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës).*

Fakte: Kërkuesi është shtetas shqiptar i cili ka ndërtuar një objekt trekatësh për qëllim banimi dhe biznesi në bregun e lumit Lana. Emri i kërkuesit nuk ishte përfshirë në një autorizim kolektiv që caktonte parcelat në atë zonë (10 dhjetor 1991), por ai kishte marrë leje ndërtimi për një ndërtesë banimi (19 maj 1992) e cila i referohej autorizimit kolektiv të mëparshëm dhe bazohej në një pjesë të legjislacionin kombëtar. Leja e ndërtimit u dha për një periudhë gjashtëmujore (1 qershor 1992 - 1 dhjetor 1992) dhe lejonte që objekti të ekzistonte për një vit pas përfundimit të ndërtimit; pas kësaj periudhe, kërkuesi nuk kishte kërkuar rinovimin e lejes. Pas përfundimit të objektit (28 mars 1993), Gjykata e Rrethit Tiranë e pranoi si fakt ligjor ekzistencën e objektit dhe kërkuesi e regjistroi atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe iu dha certifikata e pronësisë (16 gusht 1997).

Më pas, autoritetet administrative kombëtare, duke u mbështetur në një pjesë të legjislacionit kombëtar për urbanistikën, urdhëruan shembjen e të gjitha objekteve pa leje në një zonë mbi lumin Lana, pavarësisht nga viti i ndërtimit. Për sa i përket objektit të kërkuesit, dy inspektorë nga Policia Ndërtimore përpiluan një procesverbal ku përcaktonin se kërkuesi kishte kryer kundërvajtje administrative (16 shtator 2002). Në bazë të këtyre dy akteve, Policia Ndërtimore e Tiranës urdhëroi shembjen e objektit të kërkuesit (17 shtator 2002).

Kërkuesi denoncoi kreun e Policisë së Ndërtimit dhe kërkoi anulimin e urdhrin të shembjes. Ai gjithashtu paraqiti një padi civile kundër urdhrin, duke kërkuar shfuqizimin e tij, njohjen si pronar të objektit dhe pezullimin e vendimit për shembjen e objektit si masë sigurimi. Pavarësisht se gjykata kishte dhënë masën e sigurimit, objekti i kërkuesit u shemb (19 shtator 2002). Kështu, kërkuesi ndryshoi pretendimin e tij dhe kërkoi kompensim për shembjen e pronës së tij dhe për humbjen e tokës truall. Pas procedurave që zgjatën më shumë se tetë vjet në katër shkallët e juridiksionit, padia e ankuesit u rrëzua përfundimisht në vitin 2010 me arsyetimin se ndërtimi i objektit ishte i paligjshëm.

Vendosi: Gjykata vlerësoi se, edhe pse objekti i kërkuesit ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme, ai kishte një "pronë" sipas kuptimit të N.1, Prot. nr.1, meqenëse në një fazë të mëvonshme ka marrë lejen e ndërtimit për objektin, e ka regjistruar titullin e pronësisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe e ka poseduar objektin për më shumë se nëntë vjet. Prandaj, N.1, Prot. nr. 1 u zbatohet për këtë çështje. Gjykata gjeti se autoritetet shqiptare ndërhyjnë në të drejtën e pronës së kërkuesit, për shkak se privuan posedimin prej tij të objektit si pasojë e shembjes dhe shfuqizuan titullin e tij të pronësisë me urdhër gjykate. Ndërhyrja ishte e ligjshme sepse bazohej në shkaqe ligjore dhe ndiqte interesin legjitim publik për të garantuar respektimin e politikës dhe rregullave për urbanistikën.

Megjithatë, autoritetet shqiptare nuk arritën të kryenin një vlerësim proporcionaliteti ndërmjet qëllimit legjitim dhe mjeteve për ta arritur atë – në këtë rast, shembja e objektit, duke e privuar kështu kërkuesin nga posedimi i tij. Në veçanti, në fazën administrative, vendimet e autoritetit kombëtar nuk i referoheshin objektit të kërkuesit, por urdhëronin shembjen e të gjitha ndërtimeve pa leje përgjatë një segmenti të caktuar të bregut të lumit Lana. Pra, autoriteti administrativ nuk shpjegoi arsyen pse objekti i kërkuesit ishte konsideruar i paligjshëm. Për më tepër, kërkuesi nuk ishte i përfshirë në proceset që kishin çuar në këtë vendim. Përveç kësaj, as procesverbali i policisë dhe as urdhri i shembjes (16-17 shtator 2002) nuk dhanë arsye mbi atë që përbënte saktësisht kundërvajtje administrative dhe kërkuesi nuk ishte në gjendje të paraqiste ndonjë argument përpara se të bëhej procesverbali dhe të jepej urdhri i shembjes. Objekti u shemb në pritje të ankimimit të tij kundër urdhrin të prishjes dhe në kundërshtim me kërkesën e gjykatës për masë sigurimi.

Për sa i përket rezultatit të proceseve gjyqësore të nisura nga kërkuesi, Gjykata nuk vuri në dyshim konkluzionet e gjykatave kombëtare që gjetën se objekti ishte i paligjshëm, por theksoi se gjyqtarët e brendshëm nuk kishin marrë

parasysh që kërkuesi ishte shtyrë të besonte se pronësia e tij mbi objektin ishte legjitime për shkak të rrethanave të mëposhtme: (i) nxjerrja e lejes së ndërtimit (19 maj 1992) vlefshmëria e së cilës nuk ishte kontestuar kurrë; (ii) tolerimi për të përdorur objektin për shumë vite, edhe pse ndërtimi nuk ishte përfunduar brenda afatit të caktuar dhe ai nuk kishte kërkuar rinovimin e lejes; (iii) regjistrimi i pronësisë së kërkuesit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi Gjykata e Rrethit Tiranë e kishte pranuar si fakt ligjor ekzistencën e objektit.

Në këtë drejtim, Gjykata kujtoi rëndësinë e veçantë të parimit të qeverisjes së mirë: autoritetet mund të korrigjojnë gabimet e rastit, madje edhe ato që vijnë nga pakujdesia e tyre, por gabimet nuk duhet të korrigjohen në kurriz të individëve në fjalë. Në kontekstin e revokimit të pronësisë së një prone të fituar gabimisht, parimi i qeverisjes së mirë vendos ndaj autoriteteve detyrimin *për të vepruar menjëherë për të korrigjuar gabimin e tyre dhe për t'i paguar kompensimin e duhur (ose një lloj tjetër dëmshpërblimi të duhur) personit që ka vepruar në mirëbesim.*

Në çështjen në fjalë, Gjykata gjithashtu vuri në dukje se kërkuesi e kishte përdorur objektin si vend biznesi edhe pse e kishte marrë lejen e ndërtimit vetëm për objekt banimi dhe ai nuk kishte kërkuar rinovimin e lejes, siç kërkohej.

Në këtë kontekst, Gjykata doli në përfundimin se si autoritetet e brendshme ashtu edhe kërkuesi kanë kontribuar në krijimin e rrethanave që çuan në shembjen e objektit. Prandaj, për të siguruar proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës së kërkuesit që mbrohet nga N.1, Prot. nr.1, juridiksionet kombëtare duhej t'i kishin dhënë kërkuesit kompensim, të lidhur në mënyrë të arsyeshme me vlerën e tregut të objektit.

Kërkuesi gjithashtu pretendoi shkelje të N.6(1) KEDNJ– për këtë shihni Pjesën II.A

Simonova kundër Bullgarisë , Kërkesa nr. 30782/16, Vendimi gjyqësor i datës 11 prill 2023

Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të vendosin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtës së individit për respektimin e banesës në çështjet që kanë të bëjnë me shembjen e ndërtimeve pa leje, veçanërisht kur këto çështje kanë të bëjnë me familjet me fëmijë të mitur që rrezikojnë të mbeten të pastrehë si rezultat i shembjes. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të nenit 8 KEDNJ (E drejta për respektimin e banesës)

Fakte: Kërkuesja është shtetase bullgare dhe ka shtatë fëmijë (të lindur në 1996, 1997, 1999, 2003, 2006, 2008 dhe 2011). Në vitin 2007, ajo fitoi një tokë truall dhe tokë bujqësore dhe në vitin 2009 mori lejen për të ngritur një objekt për qëllime bujqësore; kërkuesja dhe fëmijët e saj filluan të jetonin në të pas ndërtimit të objektit. Ndërtesa nuk kishte instalime elektrike, furnizim me ujë apo kanalizime.

Pas gjetjeve të proceseve administrative dhe gjyqësore që rrjedhin nga një mosmarrëveshje për kufirin me pronarin e truallit kufitar, në mars 2015, autoritetet vendore lëshuan një urdhër për prishjen e objektit me arsyetimin se ishte ngritur pothuajse tërësisht në truallin kufitar dhe ishte i paligjshëm (p.sh. nuk kishte vërtetim të përputhshmërisë së tij me rregulloret e ndërtimit, përdorej për qëllime banimi dhe jo bujqësore). Pas diskutimeve për mundësitë e rivendosjes së kërkueses dhe fëmijëve të saj të mitur, ajo refuzoi ndihmën e shërbimeve sociale dhe deklaroi se ajo dhe fëmijët e saj do të transferoheshin te të afërmit e tyre. Ekzekutimi i urdhrit të shembjes u shty për në nëntor 2017, kur u rrëzua çatia dhe një nga muret e objektit. Në vitin 2018, kërkuesja rindërtoi objektin dhe vazhdoi të jetonte në të.

Vendosj: Gjykata vërejti se kërkuesja e përdori objektin për qëllime banimi dhe lidhjet e saj me objektin ishin të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, kështu që u cilësua si “banesë” e saj në kuptimin e N.8 KEDNJ. Gjithashtu, kërkuesja nuk kishte shtëpi tjetërkund.

Urdhri i shembjes përbënte ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e banesës së saj. Ishte në përputhje me ligjin sepse kishte një bazë ligjore dhe ndiqte qëllimin legjitim të parandalimit të prishjes së rendit publik, promovimin e mirëqenies ekonomike të vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve sipas N.8(2) të KEDNJ: në fakt, objektit i mungonin dokumentet e kërkuara të ndërtimit dhe ishte ngritur pothuajse tërësisht në truallin kufitar që i përkiste dikujt tjetër.

Megjithatë, Gjykata vendosi që shembja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe, rrjedhimisht, gjeti shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së, sepse autoritetet bullgare nuk morën parasysh rrethanat individuale të kërkueses dhe nuk kryen një vlerësim proporcionaliteti të ndërhyrjes në të drejtën e kërkueses për respektimin e banesës së saj (shihni *Ivanova dhe Cherkezoz kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr.46577/15, 21 prill 2016).

Në veçanti, autoritetet administrative dhe gjykatat kombëtare nuk morën parasysh të gjithë faktorët që mund të ndikonin në proporcionalitetin e ndërhyrjes dhe nuk u përpoqën të balanconin interesin e kërkueses për

të vazhduar jetesën në atë objekt me fëmijët e saj kundrejt konsideratave në favor të prishjes së tij. Autoritetet kombëtare duhej të kishin peshuar elementët që mbështesnin nevojën për të zbatuar urdhrin e shembjes (p.sh. mungesa e instalimeve elektrike, furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe pamundësia për ti bërë ato në përputhje me rregullat përkatëse të ndërtimit), nga njëra anë, me argumentet në favor të ndjekjes së shembjes me hapa që synonin të lehtësonin siç duhej vështirësitë e mëdha që pasonin nga shembja (konkretisht, rreziku që kërkuesja dhe katër fëmijët e saj të mitur të mbeteshin të pastrehë) nga ana tjetër. Për më tepër, përpjekjet e autoriteteve dhe shërbimeve sociale për të gjetur një zgjidhje për problemin e strehimit të kërkueses nuk u zhvilluan brenda një procedure formale që kërkonte një vlerësim gjithëpërfshirës të proporcionalitetit të ndërhyrjes duke pasur parasysh rrethanat e saj individuale. Gjithashtu, autoritetet nuk i ofruan kërkueses një zgjidhje të plotë, sepse propozimi i vetëm që u bë nënkuptonte vendosjen e përkohshme të fëmijëve të saj në strehim të menaxhuar nga shërbimet sociale. Vonesa në zbatimin e urdhrin të shembjes, ndonëse pa dyshim që i dha kërkueses një afat kohor të caktuar, nuk çoi drejt një zgjidhjeje të duhur të problemit me të cilin ajo po përballlej.

Alif Ahmadov dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit , Kërkesa nr. 22619/14, Vendimi gjyqësor i datës 4 maj 2023

Në rastin e një shtëpie të ndërtuar pa leje në kundërshtim me rregullat e ndërtimit dhe të ngritur në një zonë në pronësi të shtetit, autoritetet kombëtare duhet të vlerësojnë proporcionalitetin e urdhrave të dëbimit dhe shembjes duke marrë parasysh rrethanat specifike të personave në fjalë (p.sh. rrezikun që të mbeten pa strehë). Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.8 KEDNJ (E drejta për respektimin e banesës)*.

Në rastin e një shtëpie të ndërtuar pa leje në kundërshtim me rregullat e ndërtimit dhe të ngritur në një zonë në pronësi të shtetit, për të cilën personi i interesuar nuk ka dokumente për blerjen e banesës, ai person nuk ka pritshmëri legjitime për të fituar të drejtat e pronësisë. Prandaj, nuk zbatohet *N.1, Prot. nr.1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës)*.

Fakte: Kërkuesit janë një familje azerbajxhanase (bashkëshortët dhe fëmijët). Në vitin 1977 pretendohet që kërkuesi i parë bleu një shtëpi nga një person tjetër; megjithatë, në lidhje me atë shtëpi nuk ka një kontratë shitblerjeje.

Në korrik 1963, autoritetet kompetente vendase i kishin lëshuar ish-pronarit një pasaportë teknike që përmbante informacion mbi shtëpinë (p.sh. adresa, sipërfaqe e banueshme). Pjesa përkatëse e pasaportës teknike përmbante shënimin “pa dokumente” në lidhje me pronarin e shtëpisë.

Në qershor 1981 dhe korrik 1982, pasaportës teknike ju shtua planimetria e shtëpisë. Sipas kërkuesit të parë, ai kishte aplikuar te punëdhënësi i tij duke kërkuar që të përfshihej në listën për strehim në vitin 1982 dhe 1992, sipas një skeme strehimi të zhvilluar për punëtorët e naftës – siç ishte edhe kërkuesi. Kërkesa e tij u refuzua pas vizitave të autoriteteve lokale në shtëpinë e tij. Kërkuesi i parë nuk ka paraqitur kopje të dokumenteve përkatëse. Në vitin 2011 dhe 2017, kërkuesit nënshkruan kontratat për furnizimin me ujë dhe gaz.

Në vitin 2012, Azneft (një filial i shoqërisë shtetërore të naftës) kërkoi truallin ku ndodhej shtëpia e kërkuesit duke pretenduar se ajo ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme në truall shtet që i ishte caktuar Azneft-it dhe në zonën e mbrojtjes së një pusi naftë. Në të njëjtin vit, gjykata vendase vendosi që trualli në fjalë ishte në posedim të Azneft-it dhe se nuk kishte prova që konfirmonin të drejtat e kërkuesve mbi truallin dhe mbi shtëpinë. Prandaj, gjykata urdhëroi dëbimin e kërkuesve nga shtëpia dhe shembjen e saj me shpenzimet e tyre. Përsëri në vitin 2012, autoriteti kompetent i lëshoi një vërtetim kërkuesit të parë. Mes informacioneve të tjera, vërtetimi tregonte që shtëpia ishte ndërtim pa leje dhe që kërkuesi i parë ishte regjistruar aty që nga viti 1979, ndërsa kërkuesit e tjerë ishin regjistruar aty që nga viti 1984.

Deri në vitin 2018, shtëpia nuk ishte shembur ende dhe kërkuesit vazhdonin të jetonin atje.

Vendosi: Gjykata përsëriti se koncepti “banesë” sipas kuptimit të N.8 të Konventës nuk kufizohet vetëm në ambientet që janë të uzurpuara në mënyrë të ligjshme ose që janë krijuar ligjërisht. Nëse ambientet e veçanta përbëjnë ose jo një “banesë” kjo varet nga rrethanat faktike, përkatësisht ekzistenca e lidhjeve të mjaftueshme dhe të vazhdueshme me një vend të caktuar. Meqenëse humbja e banesës është forma më ekstreme e ndërhyrjes në të drejtën për respektimin e banesës, çdo person në rrezik në këtë drejtim duhet të jetë në gjendje që një gjykatë e pavarur të përcaktojë proporcionalitetin e masës, edhe kur bëhet fjalë për ndërtime pa leje (shihni *Ahmadova kundër Azerbajxhanit*. Kërkesa nr. 9437/12, 18 nëntor 2021).

Në çështjen në fjalë, kërkuessit ishin regjistruar në shtëpinë në fjalë në vitin 1979 (kërkuessi i parë) dhe 1984 (kërkuessit e tjerë) dhe që atëherë kishin jetuar atje. Prandaj, shtëpia ishte banesa e tyre në kuptimin e N.8 KEDNJ. Sipas vlerësimit të Gjykatës, urdhri i dëbimit nuk ishte ekzekutuar akoma. Megjithatë, ai u la në fuqi me një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe u bë i zbatueshëm. Kështu, ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuessve për respektimin e banesës së tyre.

Gjykata vlerësoi nëse ndërhyrja ishte në zbatim të N.8(2) KEDNJ, veçanërisht nëse ishte e ligjshme, bëhej për një qëllim legjitim të përmendur në të dhe ishte proporcionale. Kërkuessve nuk iu ofrua një procedurë që do t'u mundësonte atyre të kishin një vlerësim të duhur të proporcionalitetit të ndërhyrjes, nisur nga rrethanat e tyre personale – d.m.th. rreziku për t'u bërë të pastrehë. Veçanërisht, Gjykata vërejti se gjykatat e brendshme kur urdhëruan shembjen e shtëpisë dhe dëbimin e kërkuessve u përqendruan ekskluzivisht në faktin se ishte një ndërtim pa leje i ndërtuar në truall në pronësi të shtetit – d.m.th, gjykatat vendase nuk arritën të peshonin interesat konkurruese të kërkuessve, të cilat ata i parashtruan në ankimet e tyre. As mjetet juridike apo procedurat e tjera që kërkuessit mund të kishin përdorur për të siguruar ekzaminimin e duhur të proporcionalitetit të ndërhyrjes.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Azerbajxhani do të shkelte N.8 të Konventës nëse urdhri i dëbimit do të zbatohet pa kryer një vlerësim të proporcionalitetit të ndërhyrjes duke pasur parasysh rrethanat personale të kërkuessve.

Sa i përket N.1, Prot. nr.1 KEDNJ, Gjykata përsëriti se kërkuessi mund të pretendojë shkelje të kësaj dispozite vetëm për aq sa vendimi i kundërshtuar lidhet me “pronën” e tij/saj. Ky koncept, i përcaktuar në N.1 Prot. nr. 1 KEDNJ, mbulon gjithashtu pasuritë në lidhje me të cilat kërkuessi mund të pretendojë se ai ka të paktën një “pritsmëri legjitime” dhe të arsyeshme për të siguruar gëzimin efektiv të së drejtës së pronës. “Pritshmëria” është “legjitime” nëse bazohet ose në një dispozitë legjislative ose në një akt ligjor që ka ndikim në interesin për pronën në fjalë. Në çdo rast, çështja që duhet të shqyrtohet është nëse rrethanat e çështjes, të vlerësuara në tërësi, i kanë dhënë kërkuessit titullin për një interes thelbësor të mbrojtur nga N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ.

Në këtë çështje, sipas kërkuessve, shtëpia ishte blerë nga një person tjetër. Megjithatë, nuk ka asnjë dokument në lidhje me blerjen e shtëpisë. Gjykata

nuk gjeti elemente bindëse për të vënë në dyshim konkluzionet e arritura nga gjykatat e brendshme në lidhje me shtëpinë e ndërtuar pa ndonjë autorizim apo leje përkatëse dhe me vendndodhje brenda zonës së mbrojtjes së pusit të naftës. Për më tepër, nuk ka dispozita përkatëse të legjislacionit të brendshëm që i lejojnë kërkuesit të fitojnë të drejtat e pronësisë në lidhje me shtëpinë, pasi rregullat e përdorura nga kërkuesit nuk zbatohen për çështjen e tyre. Prandaj, ata nuk mund të kenë pasur ndonjë pritshmëri legjitime të bazuar në legjislacionin e brendshëm për qëllimin e përcaktimit të “pronës” sipas N.1, Prot. nr.1 KEDNJ.

Gjithashtu, rrethanat e çështjes, të vlerësuara në tërësi, nuk mund të konsideroheshin se u kishin dhënë kërkuesve titullin për një interes thelbësor të mbrojtur nga N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ. Së pari, nuk mund të vërtetohej se kërkuesit kanë paguar ndonjë taksë për shtëpinë në fjalë. Për sa i përket ofrimit të shërbimeve utilitare, duket se kontratat e para për furnizimin me ujë dhe gaz ishin nënshkruar në vitin 2011. Për më tepër, mungesa e reagimit nga shteti për një periudhë të caktuar kohore nuk duhej kuptuar si e tillë që tregonte se ndaj tyre nuk mund të fillonin procese për shembjen e shtëpisë. Në fund, vetëm kohëzgjatja e posedimit të shtëpisë nuk mjafton për të dalë në përfundimin se interesi pronësor i kërkuesve përbënte «pronë» sipas kuptimit të N. 1, Prot. nr.1. Përveç kësaj, përmirësimet që kërkuesit i kanë bërë shtëpisë nuk mund të ndryshonin gjetjet e Gjykatës për faktin se, - mes arsyeve të tjera, - kërkuesit kanë vepruar pa leje ndërtimi ose autorizim dhe duhej ta kishin ditur se duke bërë përmirësime në shtëpi, ata po investonin në pasuri të paluajtshme që nuk u përkiste atyre.

Nisur nga sa më sipër, kjo pjesë e kërkesës ishte e papajtueshme *ratione materiae* me N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ dhe, prandaj, duhej të shpallej e papranueshme sipas Nenit 35 KEDNJ.

Bagirova dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, Kërkesat nr. 37706/17 dhe të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 31 gusht 2023

Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të ndjekin çdo hap të procedurës së shpronësimit të krijuar me legjislacionin e brendshëm. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N.1 Prot. nr. 1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës)

Fakte: Kërkuesit janë gjashtë shtetas Azerbajxhanas që kishin prona (shtëpi private, pjesë të shtëpive ose apartamenteve) në një zonë ku

autoritetet kombëtare synonin të zbatonin një projekt për përmirësimin e infrastrukturës së qarkullimit rrugor. Për këtë qëllim, në vitin 2013, autoritetet kombëtare nxorën një urdhër për lirim dhe shembjen e pronave që ishin në atë zonë, të cilat duhej të bliheshin sipas kontratave të shitjes (të lidhura në baza vullnetare). Në vitin 2015, Kabineti i Ministrave miratoi një urdhër për shpronësimin e këtyre pronave për nevojat e shtetit, veçanërisht për qëllimin e ndërtimit të rrugëve dhe rrjeteve të tjera të komunikacionit. Pronat e kërkuarve u prishën në data të ndryshme në 2015-16. Në data të ndryshme dhe, në disa raste, pasi pronat e tyre ishin dëmtuar ose shembur pjesërisht, kërkuarve (përveç njërit) lidhën kontrata shitblerjeje dhe morën shumën të caktuar si kompensim, sipas përlllogaritjes së bërë nga një vlerësues privat i kontraktuar nga autoritetet shtetërore.

Në një seri procesesh gjyqësore (përfshirë disa të filluara nga kërkuarve që kishin lidhur kontrata shitblerjeje për të kërkuar shfuqizimin e tyre), gjykatat e brendshme urdhëruan shpronësimin e kërkuarve kundrejt kompensimit. Mes argumenteve të tjera, kërkuarve pretenduan se vendimi i Kabinetit të Ministrave nuk mund të ishte bazë për shpronësimin e pronave të tyre sepse kishte të bënte vetëm me fazën përgatitore të procedurës së shpronësimit për nevojat e shtetit, ndërsa legjislacioni i brendshëm kërkonte miratimin e një vendimi tjetër nga Kabineti i Ministrave për caktimin e një vlerësuesi të pavarur dhe për vetë shpronësimin. Gjykatat kombëtare hodhën poshtë të gjitha parashtrimet e kërkuarve.

Vendosji: Urdhri i shpronësimit dhe shembja e pronave të kërkuarve përbënte ndërhyrje në të drejtën e tyre për pronën sipas N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ.

Autoritetet kombëtare nuk ndoqën procedurën e brendshme për shpronësimin e pronës private për nevoja të Shtetit. Vendimi i Kabinetit të Ministrave i datës 11 nëntor 2015 kishte të bënte vetëm me fazën përgatitore të procedurës së shpronësimit dhe se nuk u ndërmor asnjë nga hapat e mëvonshëm procedurale të parashikuar nga legjislacioni kombëtar. Në veçanti, Kabineti i Ministrave nuk kishte nxjerrë asnjëherë një vendim për shpronësimin dhe për përfshirjen e një vlerësuesi të pavarur, i cili në fakt ishte përfshirë në procedurë pa një vendim të tillë.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se autoritetet e Azerbajxhanit kanë shkelur N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ, sepse mungonte baza ligjore për ndërhyrjen në gëzimin e qetë të kërkuarve mbi pronat e tyre.

S.C. Zorina International SRL kundër Rumanisë, Kërkesa nr. 15553/15, Vendimi gjyqësor i datës 27 qershor 2023

Vendosja e sanksioneve për veprat penale që lidhen me evazionin tatimor përbën ndërhyrje në të drejtën e pronës. Kjo ndërhyrje është legjitime nëse parashikohet në të drejtën kombëtare, bëhet për qëllim të goditjes së evazionit tatimor (sidomos kur paraqet një problem të përsëritur në nivel kombëtar), shoqërohet nga procese të drejta të rishikimit gjyqësor përpara gjykatave të brendshme, dhe nëse sanksioni është proporcional me rëndesën e veprës penale (p.sh., pezullimi i përkohshëm i veprimtarive tregtare). Në këto rrethana, *nuk ka shkelje të N.1, Prot., nr. 1 (Mbrojtja e pronës).*

Fakte: Kërkuesi S.C. Zorina International SRL, është një shoqëri tregtare me seli në Rumani. Në mars 2013, pas një inspektimi, autoriteti tatimor raportoi se shoqëria tregtare nuk kishte lëshuar fatura për shumën prej 179 RON (afërsisht 40 euro), dhe se përfaqësuesi i shoqërisë, i cili ishte i pranishëm gjatë inspektimit nuk kishte dhënë asnjë shpjegim për këtë rast. Shoqëria tregtare u dënua me gjobë në shumën 8.000 RON (afërsisht 1.900 euro) dhe shuma 179 RON (afërsisht 40 euro) u konfiskua; gjithashtu, aktivitetet e shoqërisë u pezulluan për një periudhë tre mujore.

Vendosi: Ndërhyrja në të drejtat e pronës së kërkuesit përfshihet në kuadër të masave për “kontrollin e përdorimit të pronës”, dhe më konkretisht, në lidhje me gjobën, masa “për sigurimin e pagesës së taksave apo kontributeve apo gjobave të tjera”, sipas objektivit të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ.

Sanksionet kumulative të vendosura ndaj kërkuesit ishin parashikuar me ligj dhe ndiqnin qëllimin legjitim për të luftuar evazionin fiskal dhe për të përmirësuar përgjegjësinë financiare mes tregtarëve. Gjykata, për të përcaktuar nëse sanksionet ishin proporcionale, solli në vëmendje se Shtetet kanë një kufi të gjerë vlerësimi në çështjet tatimore. Vepra penale e kryer nga kërkuesi përfaqësonte një pjesë të një problemi të përsëritur në nivel kombëtar, i cili, siç përcaktohet nga gjykatat kombëtare, pengonte funksionimin e duhur dhe efikas të ekonomisë. Sanksionet e vendosura ndaj kërkuesit lidheshin me politikën fiskale të Rumanisë, e cila u përpoq të inkurajonte më shumë disiplinë dhe përgjegjësi në fushën e biznesit dhe të kontabilitetit. Për më tepër, kërkuesi iu drejtua proceseve të drejta të rishikimit gjyqësor. Gjykatat e brendshme i lanë në fuqi sanksionet duke i konsideruar në proporcion me një qëllim të tillë. Vlerësimi i tyre u bë brenda

kufirit të vlerësimit të gjykatave të brendshme. Gjithashtu, ndikimi i pezullimit të veprimtarisë së kërkuarit ishte i përkohshëm dhe shoqëria nuk paraqiti asnjëherë kërkesë për shpallje falimentimi dhe arriti të ishte funksionale, edhe pse në rrethana më të vështira.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Rumania nuk ka shkëlur N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ, sepse autoritetet kombëtare kanë vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm, nga njëra anë, dhe respektimit të së drejtës së pronës së shoqërisë kërkuuese, nga ana tjetër – d.m.th., ndërhyrja në të drejtën e pronës së kërkuarit ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur.

Yordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, Kërkesat nr. 265/17 dhe 26473/18, Vendimi gjyqësor i datës 26 shtator 2023

Nëse legjislati i brendshëm autorizon sekuestrimin e pasurive “të fituara në mënyrë të paligjshme” (d.m.th, pasuri për të cilat nuk është përcaktuar origjina e ligjshme), gjykatat e brendshme duhet të përcaktojnë një lidhje ndërmjet veprës (penale ose administrative) që ka gjeneruar paratë për të blerë pasuritë, nga njëra anë dhe pasurive objekt sekuestrimi, nga ana tjetër. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N.1 të Prot. nr 1, KEDNJ (Mbrotja e pronës)

Fakte: Në vitin 2012, Bullgaria miratoi Ligjin për sekuestrimin e Pasurive të Përfituara në mënyrë të Paligjshme (Ligji 2012), i cili parashikonte sekuestrimin e pasurive “të paligjshme” (d.m.th. pasurive për të cilat nuk është përcaktuar origjina e ligjshme). Procedurat e sekuestrimit ishin të shkëputura nga çdo proces penal dhe rezultati i tyre: procedurat e sekuestrimit fillojnë nëse i pandehuri angazhohet në veprimtari të paspecifikuar kriminale ose të paligjshme. Ligji 2012 shfuqizoi ligjin e vitit 2005 për sekuestrimin e të ardhurave nga krimi (Ligji 2005), i cili u ndikua nga disa mangësi (shihni *Todorov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesat nr. 50705/11 dhe 6 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 13 korrik 2021). Ligji i vitit 2005 parashikonte sekuestrimin e të ardhurave të krimit pas një dënimi nga një gjykatë dhe, sipas praktikës gjyqësore të gjykatave kombëtare, një lidhje shkakësore ndërmjet veprës së kryer dhe pasurive që do të sekuestroheshin.

Kërkuarit janë tre shtetas bullgarë (dy prej tyre jetojnë në Bullgari, ndërsa njëri jeton në Belgjikë) dhe një shoqëri tregtare, selia e të cilës është

regjistruar në Bullgari. Të gjithë kërkuesit u dënuan për vepra të lidhura me taksat, si shmangia e pagesës së tatimit mbi të ardhurat dhe përdorimi i dokumenteve të falsifikuara. Gjykatat bullgare urdhëruan sekuestrimin e pasurive në pronësi të kërkuesve. Urdhrat u miratuan sipas Ligjit 2012 dhe arritën në përfundimin se të gjitha pasuritë që ishin objekt i kërkesës për sekuestrim ishin blerë në mënyrë të paligjshme (d.m.th. kërkuesit nuk arritën të provonin origjinën e ligjshme të parave). Lidhja ndërmjet veprës penale të kryer dhe pasurive që do të konfiskoheshin nuk u provua: sipas gjykatave bullgare kjo lidhje nuk kërkohet sipas Ligjit 2012, pasi kjo pjesë e legjislacionit kishte të bënte me të gjitha pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme dhe jo domosdoshmërisht me të ardhurat nga krimi. Pas përfundimit të procedurës së sekuestrimit, një pjesë e pasurive të sekuestruara u nxorën në shitje publike dhe iu shitën të tretëve. Kërkuesit nuk kanë mbledhur asnjë pjesë të shumave që u detyrohen atyre.

Vendosj: Sekuestrimi i pasurive të kërkuesve përbënte ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ. Ndërhyrja e kishte një bazë në të drejtën e brendshme (Ligji 2012) dhe ndiqte një qëllim legjitim në interesin publik, *pra* parandalimin e fitimit të paligjshëm të pronës përmes veprave penale ose administrative.

Gjykata, në kryerjen e vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, gjeti se Ligji 2012 ruajti një numër të konsiderueshëm mangësish që kishte Ligji 2005, duke përfshirë fushën e tij shumë të gjerë të zbatimit (p.sh., një listë të gjerë veprash që mund të nxisin procedurat e sekuestrimit) dhe zbatimin e tij me fuqi prapavepruese (Ligji 2012 zbatohet për veprat penale të kryera vite përpara hyrjes në fuqi, siç ka ndodhur në lidhje me një nga kërkesat). Këto mangësi e bënë të vështirë për kërkuesit detyrën për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave ose origjinës së çdo pasurie.

Për më tepër, nisur nga ngjashmëritë ndërmjet Ligjit 2005 dhe Ligjit 2012, Gjykata miratoi një qasje të ngjashme me atë të vendosur në jurisprudencën e saj të mëparshme (*Todorov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, e cituar më lart). Në veçanti, Gjykata përsëriti se një sekuestrim sipas Ligjit 2012 do të kishte qenë në përputhje me N.1, Prot. nr.1 KEDNJ vetëm nëse gjykatat kombëtare do të kishin vendosur një lidhje ndërmjet veprimtarisë kriminale (ose veprës administrative) nga e cila mund të ishin gjeneruar paratë e përdorura për të blerë pasuritë, nga njëra anë, dhe pasurive objekt i sekuestrimit. Kjo lidhje ishte kundërpesha thelbësore ndaj mangësive të Ligjit 2012 dhe avantazhit të Shtetit në procedurat e sekuestrimit. Në çështjen në fjalë, gjykatat

bullgare nuk gjetën ekzistencën e një lidhjeje ndërmjet veprave (penale ose administrative) dhe pasurive në fjalë. Për rrjedhojë, standardet e kërkuara të mbrojtjes nuk ishin përmbushur dhe ndërhyrja në të drejtat e kërkuarve ishte joproporcionale.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Bullgaria ka shkelur N.1, Prot. nr.1 KEDNJ, sepse gjykatat e brendshme nuk arritën të vendosnin një lidhje ndërmjet veprave (administrative ose penale) dhe pasurive objekt i sekuestrimit, duke kufizuar kështu në mënyrë disproporcionale të drejtën e pronës.

Naforiça kundër Republikës së Moldavisë, Kërkesa nr. 49066/12, Vendimi gjyqësor i datës 16 janar 2024

Në çështjet që kanë të bëjnë me dëbimin nga një apartament në pronësi shtetërore të personave që kanë jetuar në të për shumë vite, autoritetet kombëtare kanë detyrimin të peshojnë interesat konkurruese të banorëve me ato të Shtetit. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.8 KEDNJ (E drejta për respektimin e banesës)*

Fakte: Kërkuesit janë shtetas moldavë që jetonin në apartamente të menaxhuara nga Akademia e Muzikës, Teatrit dhe Arteve Plastike ("Akademia"), ish Instituti Shtetëror i Arteve ("SIA"). Akademia është një institucion shtetëror, i cili administron ndërtesën në emër të shtetit. Veçanërisht, të dy kërkuesit nënshkruan kontratë me drejtuesin e SIA-s, përkatësisht si mjek (1995) dhe si pastruese (2001). Në këmbim të punës së tyre, kërkuesit siguruan përdorimin e dy apartamenteve në ndërtesë; ata paguanin faturat e shërbimeve utilitare. SIA i kërkoi autoritetit vendor t'i jepte kërkuesit të parë regjistrimin e vendbanimit të tij të përhershëm në godinën e tij; SIA i lëshoi gjithashtu kërkuesve kupon banimi, i cili është baza ligjore për t'u vendosur në këtë lloj apartamenti. Megjithatë, SIA nuk i kishte kërkuar autoritetit kompetent lëshimin e kuponave të banimit për apartamentet në fjalë. Me kalimin e viteve, ndërtesa filloi të shfaqë disa probleme të rënda mirëmbajtjeje, të cilat u riparuan nga banorët e apartamenteve të ndërtesës (përfshirë edhe kërkuesit) me shpenzimet e tyre.

Në vitin 2006, kërkuesit paraqitën një kërkesë në gjykatë ku kërkonin një urdhër që Akademia t'i kërkonte autoritetit kompetent të rrethit të

lëshonte kupona banimi për apartamentet në bujtinën ku ata jetonin. Pas proceseve gjyqësore (2006-2011), gjykata përkatëse lejoi kërkesën e kërkuesve dhe e urdhëroi SIA-n/Akademisë të kërkonte një kupon banimi nga autoriteti kompetent i rrethit. Në vitin 2012, Gjykata e Lartë veproi kundër praktikës së saj gjyqësore të mëparshme dhe e prishi vendimin për shkak të mungesës së marrëdhënieve të punës mes kërkuesve dhe Akademisë, kështu që ata i kishin marrë apartamentet përkohësisht (dhe jo si "staf" i Akademisë): meqë ata thjesht i kishin marrë apartamentet me qira, kërkuesit duhej t'i lironin ato me kërkesë të Akademisë. Gjykata e Lartë e Drejtësisë urdhëroi dëbimin e kërkuesve, pa ofruar ndonjë strehim alternativ. Pas një procedure dëbimi që filloi në nëntor 2012, kërkuesit i lanë apartamentet përfundimisht.

Vendosj: Gjykata fillimisht solli në vëmendje se humbja e shtëpisë është forma më ekstreme e ndërhyrjes në të drejtën për respektimin e banesës sipas N. 8 KEDNJ.

Nuk është e qartë nëse dëbimi me gjyq është kryer në përputhje me ligjin, pasi Gjykata e Lartë nuk specifikoi se cilat rregulla kombëtare të përmendura në vendimin e saj zbatoheshin në rastin e kërkuesve. Për shkak të fuqisë së saj të kufizuar për të rishikuar përputhshmërinë me ligjin e brendshëm, Gjykata nuk pati një pikëpamje përfundimtare në këtë aspekt. Gjykata pranoi se ndërhyrja u bë për qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve (përkatësisht, atyre të Akademisë dhe anëtarëve të stafit të saj që kishin të drejtën për akomodim).

Megjithatë, dëbimi nuk ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur. Veçanërisht, vendimi i Gjykatës së Lartë të Drejtësisë urdhëroi dëbimin e kërkuesve në bazë të një dispozite që i referohej zënies pa leje të një banese, si dhe referencës konfuze që i bëhej dispozitave që kanë të bëjnë me lloje të ndryshme strehimi, pa specifikuar se cila dispozitë zbatohet në rastin konkret. Megjithatë, asnjë nga gjykatat e brendshme nuk gjeti të kërkuarit i kishin zënë apartamentet pa titull ligjor: në veçanti, ata të dy kishin një kontratë pune me SIA/Apartamenti dhe një kupon banimi, i cili nuk ishte shpallur asnjëherë i pavlefshëm. Vendimi i Gjykatës së Lartë të Drejtësisë u shmang nga jurisprudenca e saj e mëparshme, që kishte qenë në favor të personave që kishin pasur pretendime praktikisht identike me ato të kërkuesve. Konkretisht, në praktikën e mëparshme gjyqësore, ekzistenca e një marrëdhënieje pune me Akademinë nuk kishte ndikuar te Gjykata e Lartë të Drejtësisë. Gjykata e Lartë e Drejtësisë nuk e dalloi atë çështje nga kjo në

fjalë, por doli në zgjidhjen e kundërt. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e Drejtësisë nuk mori në konsideratë faktin që kërkuesit nuk kishin strehim alternativ dhe rrezikuan të mbeteshin të pastrehë pas më shumë se njëmbëdhjetë vjetësh që kishin jetuar në mënyrë të ligjshme në apartamente, duke paguar faturat e shërbimeve utilitare dhe të riparimeve të konsiderueshme. Gjykata e Lartë e Drejtësisë nuk vlerësoi nëse Akademia kishte nevojë për apartamente për stafin e saj dhe nëse stafi tjetër kishte strehim alternativ. Në përfundim, Gjykata e Lartë e Drejtësisë nuk peshoi interesat konkurruese në diskutim (ato të kërkuesve, nga njëra anë dhe të Akademisë, nga ana tjetër): ajo vetëm u shpreh që administratori i ndërtesës ju kishte kërkuar kërkuesve që të largoheshin.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Moldavia ka shkelur N.8 të Konventës për shkak se autoritetet vendore nuk kanë vlerësuar proporcionalitetin e dëbimit të kërkuesve nga apartamentet ku ata jetonin ligjërisht prej vitesh.

Yasaroglu kundër Turqisë, Kërkesa. Nr.78661/11, Vendimi gjyqësor i datës 12 shtator 2023

Në çështjet e konfiskimit të sendeve me vlerë mjaft të lartë pa dënim për një vepër penale, autoritetet vendore duhet të vlerësojnë proporcionalitetin e konfiskimit me qëllim që të shmangin vendosjen e një barre të tepruar mbi pronarin e sendeve. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës)*

Fakte: Kërkuesi është një shtetas turk që ka në pronësi një shoqëri tregtare bizhuterish. Në vitin 2003, kërkuesi u kthye në Turqi nga SHBA-të në posedim të më shumë se 25 kg ar në formën e bizhuterive të ndryshme. Kërkuesi fillimisht ia kishte shitur të gjitha këto artikuj një shoqëri tregtare amerikane, e cila ishte ankuar se disa prej tyre kishin defekte në prodhim. Kështu, kërkuesi shkoi në SHBA për të ekzaminuar mallin dhe disa prej tyre i ktheu me vete në bagazhin e tij. Policia në një aeroport turk e kapi kërkuesin në posedim të bizhuterive, të cilat ai nuk i kishte deklaruar në doganë, dhe sekuestroi të gjitha sendet e arit. Kërkuesi deklaroi se kishte paguar taksat në momentin e eksportit dhe faturat e kthimit i kishte klienti amerikan. Ai gjithashtu pretendoi se kur policia e kishte pyetur se çfarë mbante në çantë, ai u kishte thënë se kishte bizhuteri ari dhe u kishte treguar dokumentet.

Kërkuesi u ndoq penalisht nga prokurori për veprën penale të kontrabandës. Gjykata e rrethit e shpalli të pafajshëm me arsyetimin që importi i bizhuterive prej ari nuk ishte objekt i ndonjë autorizimi, licence apo kufizimi tjetër dhe se mungesa e një deklarate ishte çështje e autoriteteve doganore. Prandaj, ajo urdhëroi kthimin e mallrave pasi vendimi të kishte marrë formë të prerë. Në vitin 2005, Gjykata e Kasacionit e prishi vendimin, me gjetjen që kërkuesi kishte tentuar të sillte mallin në Turqi pa kryer formalitetet e nevojshme doganore. Në vitin 2007, gjykata më e ulët e shpalli kërkuesin fajtor për kontrabandë dhe e dënoi atë me gjobë. Në vitin 2011, Gjykata e Kasacionit e rrëzoi atë vendim gjyqësor me arsyetimin se procesi ishte parashkruar. Megjithatë, ajo urdhëroi konfiskimin e sendeve.

Vendosi: Gjykata vendosi që konfiskimi i më shumë se 25 kg ari në formën e sendeve të ndryshme të bizhuterive përbënte ndërhyrje në të drejtën e pronës sipas N.1, Prot. nr.1 KEDNJ.

Ndërhyrja kishte një bazë ligjore, sepse legjislacioni doganor turk vendoste detyrimin për të deklaruar mallrat e kthyer nga eksporti dhe që importimi i mallrave pa kryerjen e formaliteteve doganore konsiderohej vepër penale e kontrabandimit. Për më tepër, ligji kombëtar lejon konfiskimin e mallrave që konsiderohen të kontrabanduara edhe nëse nuk ka një dënim përfundimtar. Ndërhyrja ndoqi një qëllim legjitim, pikërisht atë të garantimit të respektimit të regjimit doganor.

Ndërhyrja nuk ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur. Elementët e mëposhtëm duhet të merren parasysh për të vlerësuar nëse autoritetet kombëtare kanë vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese: i) origjina e ligjshme e mallrave të sekuestruara; ii) mungesa e qëllimit mashtrues; iii) natyra e masave të konfiskimit; iv) nëse konfiskimi është pasojë automatike e mosbërjes së një deklarate sipas rregullave doganore (shihni *Karapetyan kundër Gjeorgjisë*, Kërkesa nr. 61233/12, 15 tetor 2020).

Në çështjen në fjalë, vlera e të gjitha bizhuterive të arit të padeklaruara të konfiskuara ishte një shumë të madhe. Për më tepër, shkelja e pretenduar nga kërkuesi kishte të bënte vetëm me mosdeklarimin e bizhuterive kur u kthye në Turqi. Përsa i përket elementeve që duhen marrë parasysh, nuk ka asnjë dyshim për ligjshmërinë e origjinës së arit të sekuestruar (i) dhe nuk ka asnjë provë të qëllimit mashtrues nga ana e kërkuesit (ii). Përveç kësaj, konfiskimi kishte natyrë ndëshkuese (iii), sepse nuk kishte për qëllim kompensimin e ndonjë humbjeje të pësuar nga Shteti si rezultat i mosdeklarimit: në këtë

çështje, kërkuesi nuk gëzonte përparësi (p.sh., përjashtime nga taksat) duke pasur parasysh se ai ka paguar taksat përpara eksportimit të bizhuterive. Në përfundim, konfiskimi vendosi një barrë të tepërt mbi kërkuesin dhe rezultoi në shkelje të N.1 Prot. nr. 1 KEDNJ.

C. KTHIMI DHE KOMPENSIMI

Osmani kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 8706/18, Vendimi gjyqësor i datës 5 dhjetor 2023 [Komiteti]

Në rastin e shpronësimit, autoritetet kombëtare duhet të japin arsye për shumën e kompensimit dhe të japin dëmshpërblimin e duhur monetar. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6 (1) KEDNJ* (E drejta për proces të rregullt – E drejta për vendim të arsyetuar) dhe *N.1 Prot nr. 1 KEDNJ (Mbrotjtja e pronës)*.

Fakte: Në vitin 2010, autoritetet kombëtare i kërkuan kërkuesit (shtetas shqiptar) të lironte pronën e tij për qëllim të ndërtimit të një rruge të re. Në vitin 2010, autoritetet prishën disa nga ndërtimet e kërkuesit për këtë qëllim. Në atë kohë, procedura e shpronësimit nuk kishte përfunduar, pasi ajo përfundoi në vitin 2015. Kërkuesi paraqiti një kërkesë para gjykatave kombëtare për të marrë kompensim për dëmin e pësuar dhe shpronësimin *de facto* të një pjese të truallit të tij. Autoriteti kombëtar i përfshirë në ndërtimin e rrugës deklaroi se shuma e kompensimit ishte 20 euro për m². Një ekspert i caktuar nga Gjykata konstaton se çmimi i tregut për metër katror të tokës së kërkuesit ishte 160 euro. Më vonë, eksperti e plotësoi vlerësimin duke iu referuar një pjese të legjislacionit kombëtar, i cili fiksonte çmimin e referencës së truallit për metër katror në kuadër të procedurave të kompensimit për tokat e shpronësuara gjatë regjimit komunist. Sipas këtij legjislacioni, trualli i kërkuesit vlerësohej me 86 euro/m². Kërkuesi e kundërshtoi këtë vlerësim dhe kërkoi kompensim prej 200 euro/m². Në vitin 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë konkludoi se trualli ishte shpronësuar siç duhej dhe i dha kompensim prej rreth 20 euro për m². Kërkuesi e kundërshtoi këtë gjetje, duke pretenduar se Gjykata e Rrethit Tiranë nuk kishte dhënë arsye në lidhje me shumën e kompensimit. Ankesa e kërkuesit theksoi gjithashtu se mungesa e arsyeve nga gjykatat më të ulëta kishte të bënte me një shkelje të mundshme të të drejtave të tij të garantuara nga KEDNJ. Gjykatat kombëtare hodhën poshtë të gjitha pretendimet e tij. Në pritje të këtyre proceseve, në vitin 2015, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë miratoi një vendim me të cilin

shpronësoi një pjesë tjetër të truallit të kërkuesit me 22 euro për m2.

Vendosi: Gjykata solli në kujtesë se është kompetente për të vlerësuar nëse kompensimi është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm sipas kuptimit të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ.

Ajo vërejtë se, në vitin 2010, autoritetet kombëtare morën pronën e kërkuesit përmes një procedure shpronësimi *de facto* dhe në këtë çështje nuk u zbatua asnjë konsideratë e "interesit publik". Prandaj, nuk ishte e paarsyeshme që kërkuesi të priste kompensim të plotë për dëmin e shkaktuar.

Gjykatat kombëtare u mbështetën në shifrën e dhënë nga autoriteti kombëtar i përfshirë në ndërtimin e rrugës (d.m.th. 20 euro për m2). Gjykatat kombëtare nuk dhanë asnjë arsye mbi elementet që i çuan ato në mbajtjen e atij qëndrimi dhe në rrëzimin e parashtrimeve të tjera, veçanërisht propozimet e ekspertit. Prandaj, gjykatat kombëtare nuk arritën të angazhoheshin siç duhej ose të jepnin një përgjigje specifike dhe të qartë ndaj pretendimit kryesor të kërkuesit.

Gjykatat kombëtare kanë detyrimin të shqyrtojnë me rigorozitet dhe kujdes të veçantë pretendimet në lidhje me një shkelje të mundshme të të drejtave të KEDNJ-së. Në çështjen në fjalë, gjykatat më të larta shqiptare rrëzuan pretendimet e kërkuesit pa adresuar pretendimin e tij për shkeljen e mundshme të të drejtave të tij në KEDNJ për shkak të mungesës së arsyeve për llogaritjen e shumës së kompensimit. Si përfundim, gjykatat kombëtare nuk dhanë arsye në lidhje me shumën e kompensimit dhe ato nuk dhanë kompensimin e duhur për pronën që autoritetet vendore i kishin shpronësuar kërkuesit.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur edhe N.6(1) të Konventës edhe N.1, Prot. nr. 1 të Konventës për shkak se gjykatat kombëtare nuk kishin dhënë një vendim të arsyetuar dhe kompensim të duhur.

***Jella dhe të tjerët kundër Shqipërisë* Kërkesa nr. 7564/07, Vendimi gjyqësor i datës 5 mars 2024 [Komiteti]**

Autoritetet kombëtare duhet të marrin masat e duhura për zbatimin e vendimeve që përcaktojnë kthimin e tokës dhe rivendosjen e të drejtave të pronës. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës)*

Fakte: Kërkuesit janë shtetas shqiptarë, toka e të parëve të të cilëve u shtetëzua nga regjimi i mëparshëm komunist. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ("Komisioni") nxori një vendim që i njihte kërkuesve titullin e pronësisë mbi një truall ("parcela A"). Megjithatë, kjo parcelë nuk ishte në pronësinë e kërkuesve dhe as nuk ishte regjistruar në emër të tyre. Përkundrazi, Komisioni regjistroi pronësinë e kërkuesit mbi dy parcela të tjera të ndryshme ("parcela B dhe C").

Kërkuesit ngritën një padi në gjykatë kundër autoriteteve administrative përgjegjëse për procesin, duke kërkuar sqarim të vendimeve të tyre. Në vitin 2005, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi padinë, me arsyetimin se çështja ishte nën juridiksionin administrativ.

Në vitin 2005 dhe në vitin 2007, kërkuesit paraqitën kërkesa në lidhje me parcelën A tek pasardhësi i Komisionit, Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ("Agjencia"). Në vitin 2007 Agjencia i udhëzoi kërkuesit që të depozitonin një kërkesë të re në zyrën e saj vendore. Në vitin 2009, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi në favor të kërkuesve, duke deklaruar se Agjencia kishte për detyrë të jepte një vendim. Në vitin 2011, Agjencia hodhi poshtë kërkesën e kërkuesit për ekzekutimin e këtij vendimi.

Në vitin 2015, Gjykata e Rrethit Tiranë rrëzoi pretendimin e kërkuesve për shkak të mungesës së provave në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë mbi parcelën A. Në vitin 2017, Gjykata e Apelit Tiranë e prishi atë vendim dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Rrethit, duke u shprehur se analiza e provave përkatëse ishte e paplotë dhe se Agjencia nuk kishte vënë në pikëpyetje pronësinë e kërkuesve mbi parcelën A. Në vitin 2023, çështja mbeti në pritje në Gjykatën e Lartë pas ankimimit nga Agjencia për çështje të ligjit. Në vitin 2018, kërkesa e re e kërkuesve për regjistrimin e pronësisë së tyre mbi parcelën A u refuzua.

Vendosi: Gjykata përsëriti parimin sipas praktikës gjyqësore së saj të konsoliduar, sipas të cilit rreziku i çdo gabimi të bërë nga një autoritet shtetëror duhet të përballohet nga Shteti dhe gabimet nuk duhet të korrigjohen në kurriz të individit të prekur (shihni p.sh. *Lelas kundër Kroacisë*, Kërkesa nr. 55555/08, 20 maj 2010).

Gjykata gjithashtu theksoi se, duke pasur parasysh N.1 Prot. nr. 1 KEDNJ, autoritetet kombëtare kanë detyrimin të ndërmarrin hapa praktike për të siguruar që vendimi i tyre në lidhje me kthimin e pronësisë të jetë i zbatueshëm. Në çështjen në fjalë, autoritetet kombëtare nuk i ndërmorën

këto hapa, pavarësisht që kërkuesit kishin filluar disa procese për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e tyre të pronës (shihni p.sh. *Nuri kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 12306/04, 3 shkurt 2009). Në veçanti, autoritetet kombëtare nuk respektuan vendimin e Komisionit të vitit 1994 pa ndonjë arsye bindëse. Për rrjedhojë, kërkuesit jetuan në një gjendje pasigurie për të drejtat e tyre të pronës për njëzet e nëntë vitet e mëvonshme. Për më tepër, nuk është se kërkuesit nuk kishin marrë masa sipas legjislacionit kombëtar në lidhje me të drejtat e tyre të pronës, (përkundrazi shihni *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (vendim), Kërkesa nr. 29026/06 dhe 11 kërkesa të tjera, 17 mars 2020).

Prandaj, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.1, Prot. nr. 1 të Konventës, sepse kërkuesit duhej të mbanin një barrë joproporcionale dhe të tepruar.

Associations de copropriété forestière Porceni Pleșa et Piciorul Bătrân Banciu (Shoqata Pyjore ‘Porceni Pleșa dhe Kompozitorët Piciorul Bătrân Banciu’) kundër Rumanisë, kërkesat nr. 46201/16 dhe të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 28 nëntor 2023

Kompensimi monetar si formë e dëmshpërblimi mund të cilësohet si pronë sipas KEDNJ-së. Nëse legjislacioni kombëtar lejon qeverinë të paguajë kompensim dhe të miratojë rregulla metodologjike për këtë qëllim, mosmiratimi i zgjatur në kohë i këtyre rregullave metodologjike (dhe mospagimi vijues i kompensimit) mund të përbëjë *shkelje të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ*.

Fakte: Kërkuesit janë dy shoqata, të regjistruara sipas ligjit rumun, të pronarëve të pyjeve malore në pronësi të përbashkët. Shoqata kërkuese e parë dhe e dytë kanë tituj pronësie për dy pyje. Një pjesë e të dy pyjeve u përcaktua si zonë e mbrojtur natyrore (në vitin 2005, për kërkuesin e parë dhe në vitin 2005 dhe 2008, për kërkuesin e dytë) për qëllime të Rrjetit të Bashkimit Europian “Natura 2000”. Ky program i BE-së bashkon vende që janë të rëndësishme për trashëgiminë natyrore, për shkak të faunës dhe florës së jashtëzakonshme që ndodhet në to. Sipas dispozitave në fuqi, pronarët e pyjeve të klasifikuara si zona të mbrojtura natyrore kishin detyrimin t’i mirëmbanin pyjet, por nuk mund t’i përdornin në asnjë mënyrë. Pas përcaktimit si zona të mbrojtura natyrore, shoqata kërkuese lidhi kontrata mirëmbajtjeje, me shpenzimet e tyre, me departamentet rajonale të pyjeve për pyjet e tyre përkatëse.

Sipas Kodit të Pyjeve të vitit 2008, pronari kishte të drejtën e kompensimit

si formë dëmshpërblimi për pamundësinë e prerjes së pyjeve të tyre dhe koston e krijuar për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Një ligj i vitit 2010 autorizonte Shtetin të jepte ndihmë shtetërore për të ofruar kompensim në lidhje me programin “Natura 2000”. I njëjti ligj specifikonte se Qeveria duhej të miratonte një metodologji që do të rregullonte procedurën për zbatimin e kësaj dispozite për kompensimin. Në vitin 2009, Qeveria miratoi një projektvendim që përcakton këto rregulla metodologjike. Projektvendimi ishte paraqitur dhe vërtetuar nga Komisioni Europian në vitin 2012. Megjithatë, projektvendimi nuk u publikua.

Në vitin 2013, shoqata kërkuese e parë mori një vendim gjykatë në favor të saj, duke i dhënë kompensimin e pagueshëm nga Shteti për vitin 2012. Shoqata kërkuese e parë u informua gjithashtu për të drejtën e saj për të marrë kompensim për vitin 2013 dhe filloi procesin gjyqësor për këtë qëllim; megjithatë, gjykatat kombëtare rrëzuan kërkesën e kërkuesit të parë me arsyetimin se Qeveria nuk kishte miratuar ende rregullat metodologjike për kompensimin. Prandaj, asnjë pagesë nuk i ishte bërë shoqatës së parë kërkuese për vitin 2013.

Në një grup tjetër procesesh, gjykatat kombëtare mohuan gjithashtu kompensimin për shoqatën e dytë kërkuese në lidhje me periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2014, me arsyetimin se Qeveria nuk kishte miratuar ende rregullat metodologjike për kompensimin. Prandaj, shoqatës së dytë kërkuese nuk i ishte bërë asnjë pagesë për periudhën 2010-2014.

Vendosj: E drejta e shoqatave kërkuese për kompensim mund të cilësohet si pronë sipas kuptimit të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ, dhe duke qenë se ishte objekt i një pretendimi të caktuar me ligj, shuma e tij u përcaktua nga organet kompetente administrative dhe nuk u kontestua as për ekzistencën e as për nga shtrirja e saj në proceset gjyqësore të brendshme që kishin lidhje me çështjen (shihni p.sh., *Văleanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesat nr. 59012/17 dhe 27 të tjera, 8 nëntor 2022). Për më tepër, sipas dispozitave kombëtare për kompensimin, shoqatat ankuese kishin të paktën një pritshmëri legjitime për të marrë një formë të tillë dëmshpërblimi. Prandaj, në këtë çështje zbatohet N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ.

E drejta e pronës kërkon që Shtetet të mos ndërhyjnë dhe të miratojnë masa pozitive, veçanërisht kur ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet masave që një kërkues mund të presë në mënyrë legjitime që të merren nga autoritetet dhe gëzimit efektiv të pronës nga kërkuesi (shihni *Öneryıldız kundër Turqisë* [DHM], Kërkesa nr. 48939/99, 30 nëntor 2004).

Në këtë çështje, nuk kishte asnjë dyshim për ekzistencën e një lidhjeje shkakësore ndërmjet vonesës në miratimin e legjislacionit, që mund t'i atribuohet Shtetit, dhe mospagesës së kompensimit për shoqatat kërkuese për faktin se ato nuk mund të përdorin pyjet e tyre, të cilat ishin klasifikuar si zona të mbrojtura nga Natura 2000. Prandaj, mosmiratimi i rregullave metodologjike nga Qeveria përbën ndërhyrje në të drejtën e shoqatave kërkuese sipas N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ.

Ndërhyrja nuk është kryer sipas “kushteve të parashikuara në ligj”, siç kërkohet nga N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ. Mosmiratimi i rregullave metodologjike i zgjatur në kohë pengoi zbatimin edhe të Kodit Pyjor të vitit 2008, edhe të ligjit të vitit 2010 për kompensimin nëpërmjet ndihmës shtetërore.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Rumania ka shkelur N.1, Prot. nr. 1 të Konventës për shkak të mosmiratimit nga Qeveria të rregullave metodologjike për kompensimin.

II. Procese civile

A. KOHËZGJATJA E PROCESIVE GJYQËSORE

Kokolari kundër Shqipërisë , Kërkesa nr. 22493/12, Vendimi gjyqësor i datës 30 janar 2024 [Komiteti]

Autoritetet kombëtare administrative kanë detyrimin të shqyrtojnë pa vonesë pretendimet për kompensimin/kthimin e pronës së konfiskuar. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 6 (1) KEDNJ* (E drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm).

Fakte: Kërkuesit, dy shtetas shqiptarë, janë trashëgimtarët e ligjshëm të personave, tokat e të cilëve u konfiskuan në vitet 1940. Ata ndoqën kërkesat drejtuar autoriteteve kombëtare të paraqitura nga të afërmit e tyre në vitin 1994 për të marrë kompensim ose kthimin e pronës së tyre të konfiskuar. Këto kërkesa u bashkuan në një dosje të vetme në vitin 2012 dhe, që nga ajo datë, kërkuesit kanë vepruar si kërkues (dhe jo thjesht si përfaqësues të trashëgimtarëve të tyre). Në të njëjtin vit, kërkuesit depozituan kërkesën e tyre në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut me pretendimin për zgjatjen e tepruar të proceseve administrative. Sipas ligjit nr. 133/2015, Agjencia e Trajtitimit të Pronave (“ATP”) kishte për detyrë të vendoste për kërkesat e patrajuara të paraqitura para hyrjes në fuqi të atij ligji. Sipas ligjit nr. 133/2015, nëse ATP-ja nuk do të shqyrtonte këto kërkesa deri në shkurt 2019, kërkuesit mund t’i kishin kërkuar një gjykatë kombëtare që të vendoste mbi themelin e pretendimit të tyre për kthim/kompensim. Në dhjetor 2022, afati i ATP-së për të shqyrtuar kërkesat në pritje u zëvendësua me 31 dhjetor 2024.

Vendosj: Për pranueshmërinë e kërkesës sipas nenit 6 (1) KEDNJ, Gjykata vuri në dukje se procedurat për kthim/kompensim kanë të bëjnë me një të drejtë që njihet sipas ligjit shqiptar dhe kërkuesit kanë një interes të qartë në lidhje me objektin e këtyre procedurave dhe rezultatit e tyre. Procesi administrativ ka qenë në pritje që nga viti 2012 (kur kërkuesit paraqitën kërkesën e tyre para Gjykatës) deri në vitin 2023 (kur kërkuesit rivendosën pretendimet e

tyre), kështu që Gjykata mund të vlerësojë edhe faktet që kanë ndodhur në periudhën pas vitit 2012 (shihni p.sh. *Denis dhe Irvine kundër Belgjikës* [DHM], Kërkesat nr.62819/17 dhe 63921/17, 1 qershor 2021). N. 6(1) KEDNJ zbatohet nëse ekziston një mosmarrëveshje për një të drejtë civile. Kjo kërkesë përfshin situatën kur individët kundërshtojnë një vendim administrativ për pretendimin e tyre përpara një autoriteti tjetër administrativ ose një gjykate. Kërkesa për “afat të arsyeshem” sipas N.6(1) KEDNJ vlen për kohëzgjatjen e këtyre proceseve.

Për çështjen në fjalë, proceset kanë qenë në pritje pranë ATP-së. Sipas ligjit shqiptar, ky autoritet administrativ ka kompetencën (e veçantë, nëse jo ekskluzive) e vendimmarrjes për pretendimin e kërkuarit mbi të drejtat e tyre pronësore, të cilat janë me natyrë civile (shihni p.sh. *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 38222/02, 13 nëntor 2017). Në veçanti, proceset në pritje përpara ATP-së kishin të bënin me ekzistencën dhe shtrirjen e pretendimeve të kërkuarve për pronën, të cilat nuk kishin gjetur zgjidhje për shumë vite. Që nga shkurti i vitit 2019, nuk ka pasur asnjë autoritet apo gjykatë tjetër administrative që mund të përcaktonte të drejtën e kërkuarve. Nga shkurti 2019, kërkuarit kishin mundësinë të kundërshtonin mosveprimin e ATP-së përpara një gjykate kombëtare, e cila do të përbente një “mosmarrëveshje” sipas kuptimit të N.6(1) KEDNJ. Në përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa përfshihet në objektin e N. 6(1) KEDNJ për periudhën ndërmjet 2012 dhe 2019 (shihni p.sh. , *Bici kundër Shqipërisë*, nr.5250/07, 3 dhjetor 2015).

Për themelin, Gjykata iu referua parimeve të përmbledhura në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore. Sipas këtyre parimeve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve duhet të ketë parasysh: i) rrethanat e veçanta të çështjes; ii) kompleksitetin e çështjes; iii) sjelljen e kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse; iv) atë që është në rrezik për kërkuarin në mosmarrëveshje (shihni p.sh. , *Bici kundër Shqipërisë* , nr.5250/07, 3 dhjetor 2015).

Në këtë çështje, problemi administrativ ishte relativisht kompleks. Gjithashtu, shkaqet e vonësës përfshijnë numrin e madh të parashtrimeve për kompensim/kthim përpara autoriteteve administrative kombëtare dhe vendimin e Shtetit për të zbatuar një skemë gjithëpërfshirëse legjislative për kthimin/kompensimin në lidhje me pronat e konfiskuara. Megjithatë, Shtetet kanë detyrimin të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që ato autoritete të përmbushin kërkesat e N.6 KEDNJ (shihni p.sh., *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* , Kërkesat Nr.43391/18 dhe 17766/19, 12 tetor 2021). Për më tepër, ndërmjet viteve 2012 dhe 2019, kërkuarit nuk kanë kontribuar në

krijimin e vonesave (p.sh., duke mos dorëzuar dokumente).

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.6(1) të Konventës në lidhje me periudhën ndërmjet 2012 dhe 2019 për shkak të kohëzgjatjes së tepërt të proceseve administrative për kompensimin/kthimin e pronës së konfiskuar.

Vjola SH.PK . dhe DE SH.PK . kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 18076/12, Vendimi gjyqësor i datës 30 janar 2024

Në rastet e pretendimeve që kërkojnë përgjigje të shpejtë nga gjykatat (p.sh., shqetësim i posedimit dhe ushtrimit të të drejtave të tyre që rrjedhin nga një kontratë qiraje të lidhur me organet kombëtare), gjykatat e brendshme kanë detyrimin t'i japin individëve të drejtën për një seancë dëgjimore brenda një afati kohor të arsyeshëm. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 6 (1) KEDNJ* (E drejta për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm)

Fakte: Në vitin 2000, kërkuessit, dy shoqëri tregtare shqiptare, lidhën dy kontrata qiraje me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Kavajë (“Shërbimi Pyjor”) që u jepnin të drejtën e përdorimit të dy pyjeve për një periudhë 25-vjeçare. Të dyja kontratat ishin regjistruar në regjistrin e tokave. Në vitin 2004, një palë e tretë lidhi dy marrëveshje me Ministrinë e Planifikimit të Territorit dhe Turizmit (“Ministria”) për zhvillimin dhe marrjen me qira të një pylli në një parcelë toke që mbivendosej pjesërisht me parcelat e marra me qira nga shoqëritë kërkuese. Në të njëjtin vit, pas prishjes së gardhit rrethues dhe fillimit të punimeve të ndërtimit, shoqëritë kërkuese depozituan një padi civile kundër palës së tretë duke kërkuar: i) ndërprerjen e ndërhyrjes në zotërimin e tyre të ligjshëm dhe pezullimin e punimeve të ndërtimit; ii) rikthimin e tokës në gjendjen e mëparshme, iii) pagesën e dëmeve. Ato kërkuan gjithashtu një masë sigurimi, e cila nuk u vlerësua nga gjykata kombëtare.

Pas një sërë fazash përpara gjykatave kombëtare, në vitin 2006 Gjykata e Rrethit Kavajë (“Gjykata e Rrethit”) rrëzoi pretendimin e shoqërive kërkuese me arsyetimin se, meqenëse pala e tretë përfundoi punimet e ndërtimit, nuk ishte më e mundur të kërkohej rikthimi i tokës në gjendjen e mëparshme. Gjykata e Rrethit konstatoi gjithashtu se shoqëritë kërkuese duhej të kishin paraqitur një padi tjetër civile, afati për të cilin ishte tashmë ishte parashkuar. Megjithatë, Gjykata e Rrethit sugjeroi që, nisur nga rrethanat e reja, shoqëritë kërkuese të mund të depozitonin një padi kundër Shërbimit Pyjor dhe

Ministrisë për pagesën e dëmit. Në kontekstin e proceseve të apelimit që vijuan, gjykatat kombëtare konfirmuan gjetjet e Gjykatës së Rrethit. Në këtë kontekst, proceset në Gjykatën e Lartë zgjatën më shumë se tre vjet.

Vendosi: Gjykata iu referua parimeve të përmbledhura në praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm (shihni p.sh., *Frydlender kundër Francës* [DHM], Kërkesa nr. 30979/96, 27 qershor 2000).

Në çështjen në fjalë, proceset gjyqësore zgjatën më shumë se shtatë vjet, nga të cilat më shumë se tre vjet përpara Gjykatës së Lartë. Për sa i përket asaj që ishte në rrezik për shoqëritë kërkuese, pretendimet e tyre kishin të bënin me shqetësimin e zotërimit të parcelave objekt kontestimi nga ana e tyre, që ndikonte në të drejtat e tyre që lindnin nga një kontratë qiraje. Kështu, pretendimet e tyre kërkonin një përgjigje të shpejtë nga gjykatat. Sa i përket sjelljes së shoqërive kërkuese, sjellja e tyre nuk kontribuoi në zgjatjen e procedurave. Sa i përket sjelljes së gjykatave kombëtare, Gjykata e Rrethit nuk e adresoi asnjëherë kërkesën e kërkuesit për masë sigurimi dhe proceset para Gjykatës së Lartë zgjatën tepër në kohë, veçanërisht duke pasur parasysh që nuk kishte hapa procedurale ndërmjet paraqitjes së ankimit dhe miratimit të vendimit të saj. Kjo kontribuoi në kohëzgjatjen e proceseve. Në përfundim, gjykatat shqiptare shkelën të drejtën e shoqërive kërkuese për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm sipas N.6(1) KEDNJ.

Për sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës së pronës të shoqërive kërkuese, Gjykata pranoi se qiraja mund të konsiderohet interes pronësor sipas N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ. Në çështjen në fjalë, ndërhyrja në të drejtat e shoqërive kërkuese rezultoi nga fakti që autoritetet shtetërore dhanë të njëjtën parcelë toke për shfrytëzim nga shoqëritë kërkuese dhe një shoqëri e tretë. Megjithatë, shoqëritë kërkuese ngritën padi civile vetëm kundër një pale private dhe jo kundër organeve shtetërore. Për më tepër, pretendimet kishin të bënin vetëm me posedimin faktik të tokës dhe jo me shkeljen e kontratës së qirasë nga organet shtetërore.

Në përfundim, ankimi në lidhje me të drejtën e pronës sipas N.1, Prot. nr. 1 të Konventës ishte haptazi i pabazuar dhe u rrëzua në përputhje me nenin 35(3) (a) dhe (4) të KEDNJ-së.

Zela kundër Shqipërisë , Kërkesa nr. 33164/11, Vendimi gjyqësor i datës 11 qershor 2024

Proceset nuk tejkalojnë kërkesën për kohëzgjatje të arsyeshme nëse kanë lidhje me probleme komplekse (p.sh., vlefshmëria e titujve të pronësisë dhe planifikimi urban) dhe personi i përfshirë kontribuon në kohëzgjatjen e proceseve (p.sh., duke depozituar një ankim jashtë afatit përpara një gjykate kombëtare) – *Nuk ka shkelje të N.6(1) KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm)*

Fakte: Kërkuesi ngriti padi civile kundër urdhrit të prishjes së një ndërtese, pronësia e të cilit dhe pajtueshmëria me legjislacionin urbanistik u kundërshtua nga autoritetet; ai kërkoi të anulohet urdhri. Meqë ndërtesa e kërkuesit u prish pavarësisht masës së sigurimit të miratuar nga gjykata, ai ndryshoi pretendimin e tij dhe kërkoi kompensim për prishjen e pronës së tij dhe për humbjen e tokës. Këto procese zgjatën më shumë se tetë vjet në katër shkallë të gjyqësorit (përkatësisht, përpara një gjykatë rrethi, një gjykatë apeli, gjykatës së lartë, përsëri një gjykate apeli pas rikthimit të çështjes nga Gjykata e Lartë dhe, në fund, Gjykata Kushtetuese).

Për më shumë detaje, shihni Pjesën I.A.

Vendosi: Gjykata iu referua parimeve të përmbledhura në praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm (shihni p.sh., *Frydlander kundër Francës* [DHM], Kërkesa nr. 30979/96, 27 qershor 2000).

Në çështjen në fjalë, Gjykata konstaton se kohëzgjatja e përgjithshme e procesit nuk e kalonte atë që mund të konsiderohej e arsyeshme në rrethanat e çështjes, e cila ishte mjaft komplekse dhe përfshinte probleme të vështira në lidhje me vlefshmërinë e titullit të pronësisë së kërkuesit dhe planifikimin urban. Për më tepër, kërkuesi kontribuoi në zgjatjen e proceseve (ai paraqiti ankimin kushtetues rreth dhjetë muaj pas një prej vendimeve të kontestuara). Kështu, Gjykata u shpreh se nuk gjeti shkelje të N.6(1) KEDNJ.

Kërkuesi pretendoi gjithashtu shkelje të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës) – për këtë aspekt shihni Pjesën I.A.

Papakostandini kundër Shqipërisë Kërkesë nr. 7568/08, Vendimi gjyqësor i datës 18 korrik 2024 [Komiteti]

Menaxhimi i duhur i disa proceseve për të njëjtin problem kontribuon në kohëzgjatje të arsyeshme. Prandaj, në çështje që kanë të bëjnë me probleme jo komplekse (p.sh., kompensimi) të cilat çojnë në procese të shumëfishta, gjykatat kombëtare kanë detyrimin të menaxhojnë si duhet shumëfishimin e proceseve për të njëjtin problem (p.sh., identifikimi i proceseve paralele dhe bashkimi i tyre; refuzimi i fillimit të mëtejshëm të proceseve të reja). Mosveprimi në këtë mënyrë mund të rezultojë në *shkelje të N. 6 KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm)*.

Fakte: Në vitin 1995, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Durrës (“Komisioni”) pranoi se kërkuesi dhe familjarët e tij kishin të drejtën e trashëguar të pronësisë mbi një truall dhe urdhëroi kthimin e tij. Po në të njëjtin vit, kërkuesi regjistroi titullin e tij në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (“ZRPP”). Trualli ndodhej brenda një zone që administrohej nga Shtëpia e Pushimit të Ushtrisë Durrës (shoqëri publike nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes), e cila vazhdoi administrimin e truallit dhe e dha atë me qira te një pale të tretë në vitin 1999. Në vitin 2000, Gjykata e Rrethit Durrës ndryshoi vendimin e Komisionit të vitit 1995; gjykata e rrethit pranoi se kërkuesi dhe bashkëpronarët e tjerë kishin trashëguar titullin e pronësisë mbi një parcele tjetër toke dhe urdhëroi kthimin e saj.

I. Proceset për kompensimin për qiranë e parcelës së tokës

Në vitin 2000, kërkuesi dhe bashkëpronarët e tjerë filluan procesin kundër Shtëpisë së Pushimit të Ushtrisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes duke pretenduar shumat e parave që pala e tretë u kishte paguar të dy të paditurve sipas kontratës së qirasë të vitit 1999.

Në vitin 2001, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, përkatësisht, vendosën në favor të kërkuesit. Në vitin 2002, Gjykata e Lartë i rrëzoi këto vendime me arsyetimin se gjykatat më të ulëta duhej të kishin ftuar qiramarrësin në këtë proces. Prandaj, Gjykata e Lartë e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim.

Para gjykatës së shkallës së parë, proceset u pezulluan dhe rifilluan disa herë mes viteve 2002 dhe 2012, dhe seancat dëgjimore u ri-caktuan shpesh. Në vitin 2002, gjykata e shkallës së parë pezulloi proceset deri në vendimin e gjykatës së brendshme për një grup procesesh paralele ku Shtëpia e Pushimit të Ushtrisë (shih këtu më poshtë) kishte kundërshtuar titullin e pronësisë së kërkuarit mbi parcelën e tokës. Proceset ri-filluan në vitin 2008, por disa seanca dëgjimore u shtynë për shkak të mosdorëzimit të fletëthirrjes. Proceset u pezulluan më tej dhe rifilluan në vitin 2009, por seancat dëgjimore u ri-caktuan për shkak të mungesës së gjyqtarit përkatës. Në vitin 2010, gjykata pranoi kërkesën për të pezulluar proceset gjyqësore për shkak të riorganizimit të brendshëm të Shtëpisë së Pushimit të Ushtrisë dhe proceset gjyqësore rifilluan në vitin 2012. Në vitin 2013, proceset përfundimisht u ndërprejnë sepse kërkuari nuk ishte paraqitur para gjykatës.

II. Proceset në lidhje me anulimin e pronësisë së kërkuarit

Në vitin 2001 Shtëpia e Pushimit të Ushtrisë paditi kërkuarin duke kërkuar prishjen e vendimit të Komisionit të vitit 1995. Në vitin 2002, Gjykata e Rrethit Durrës pezulloi procesin sepse vlerësoi që paditësi kishte nisur një proces të ngjashëm dhe të ndërlidhur pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në vitin 2004, Gjykata e Lartë prishi këtë vendim dhe e ktheu çështjen në gjykatën më të ulët për rishqyrtim.

Në vitin 2006, Gjykata e Rrethit Durrës prishi pjesërisht vendimin e Komisionit të vitit 1995 dhe vendosi që Shtëpia e Pushimit të Ushtrisë kishte të drejtën e kompensimit monetar. Në vitin 2008, vendimi u la në fuqi nga gjykata e apelit. Në vitin 2012, Gjykata e Lartë i prishi të dy vendimet dhe e rrëzoi padinë kundër kërkuarit si të pabazuar, sepse vendimi i Komisionit të vitit 1995 ishte i ligjshëm dhe i vlefshëm.

Vendosi: Gjykata iu referua parimeve të përmbledhura në praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm (shihni p.sh., *Frydender kundër Francës* [DHM], Kërkesa nr. 30979/96, 27 qershor 2000). Gjithashtu Gjykata solli në vëmendje që gjeti shkelje të N.6(1) KEDNJ në lidhje me probleme të ngjashme me ato në çështjen në shqyrtim (shihni *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Kërkesat nr. 64480/09 dhe 5 të tjera, 1 prill 2014; *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Për t'u kthyer te rrethanat specifike të çështjes, ajo vuri në dukje se procesi mbi pretendimin e kërkuarit për kompensim zgjati më shumë se dymbëdhjetë vjet (2000-2013) përpara tre shkallëve të gjyqësorit ku çështja u shqyrtua në katër runde të proceseve gjyqësore. Çështja para gjykatave kombëtare nuk ishte veçanërisht komplekse. Vonesa ishte rezultat i sjelljes së gjykatave kombëtare dhe nuk i atribuohet kërkuarit. Vonesa e parë u shkaktua nga kthimi për rishqyrtim në gjykatën më të ulët, që i atribuohet autoriteteve gjyqësore. Vonesa e dytë prej gati gjashtë vitesh u shkaktua nga pezullimi i proceseve për shkak se titulli i pronësisë së kërkuarit u kundërshtua në procese paralele. Në këtë drejtim, Gjykata kishte shpallur tashmë se menaxhimi i duhur i proceseve paralele të ndërlidhura kontribuon në kohëzgjatjen e arsyeshme të tyre dhe, kështu, sipas N.6 KEDNJ, Shtetet kanë detyrimin të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të lejojnë gjykatat të menaxhojnë siç duhet shumëfishimin e proceseve mbi të njëjtën çështje (p.sh., t'i identifikojnë ato dhe, kur është e nevojshme, t'i bashkojnë, t'i pezullojnë ose të refuzojnë fillimin e mëtejshëm të proceseve të reja) (shihni *Gjonbocari dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr.10508/02, 23 tetor 2007). Vonesa e tretë prej një viti e gjysmë rezultoi nga pezullimi i dytë i procesit për të lejuar të paditurin që të kryente një riorganizim të brendshëm.

Proceset lidhur me kundërshtimin e titullit të pronësisë së kërkuarit zgjatën njëmbëdhjetë vjet (2011 - 2012), përpara tre shkallëve të gjyqësorit. Çështja nuk ishte komplekse dhe vonesa ishte rezultat i sjelljes së gjykatave kombëtare (Gjykata e Lartë prishi dy vendime dhe ktheu çështjen për rishqyrtim; disa muaj për marrjen e vendimeve nga të tre shkallët e gjyqësorit).

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 6(1) të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së tepruar të dy grupeve të proceseve civile lidhur me (i.) pretendimin e kërkuarit për kompensim të qirasë të parcelës nga i padituri te një palë e tretë. dhe (ii.) kundërshtimin e titullit të pronësisë së kërkuarit mbi një truall toke.

Van den Kerkhof kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 13630/19 , 5 shtator 2023

Një mjet kompensimi për kohëzgjatjen e tepërt të proceseve gjyqësore nuk mund të konsiderohet «mjet i juridik efektiv i brendshëm» që duhet shteruar, në përputhje me N.35(1) KEDNJ, nëse nuk ka mundësi reale që një pretendim i tillë të trajtohet më shpejt se procesi gjyqësor kryesor.

Shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që t'u mundësojnë gjykatave t'i garantojnë të gjithëve të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet për të drejtat dhe detyrimet civile brenda një afati të arsyeshëm. Nëse vonesat (në çështjen në fund: më shumë se tetë vjet për dy shkallë gjykimi, pavarësisht përpjekjes së kërkuesit) janë rezultat i problemeve strukturore në administrimin e sistemit të drejtësisë, Shteti duhet të marrë masa të përgjithshme për të bërë të mundur që gjykatat të shqyrtojnë çështjen brenda një afati kohor të arsyeshëm – *Shkelje e N. 6(1) KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm); masa e përgjithshme të nevojshme (N. 46 KEDNJ)*

Fakte: Në vitin 2015, kërkuesi ngriti një padi në gjykatën e rrethit të Brukselit, ku kërkonte pavlefshmërinë e shitjes së një apartamenti ose, përndryshe, masa të tjera (p.sh., dëmshpërblimi i dëmit) që të merreshin nga të paditurit (shitësit dhe agjencia e pasurive të paluajtshme që vepronte si ndërmjetëse). Ai gjithashtu kërkoi caktimin e një eksperti për të vlerësuar vlerën e pronës dhe koston e punës së ndërmarrë tashmë dhe ende për t'u kryer.

Në vitin 2017, gjykata e rrethit të Brukselit rrëzoi kërkesën për të anuluar shitjen, por, me një vendim të ndërmjetëm, caktoi një ekspert (i cili paraqiti një raport vitin pasues) dhe e shtyu çështjen për vendimin e formës së prerë.

Të pandehurit ankimuan vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë; në vitin 2018 çështja ishte gati për seancë në apel. Në atë kohë, zyra e regjistrimit e gjykatës së apelit informoi kërkuesin se çështja ishte në listë pritjeje dhe se një datë ndoshta do të caktohej pas marsit 2026.

Kërkuesi ndërmori disa hapa për rishikimin e datës së seancës (p.sh., ai kontaktoi kryetarin e gjykatës së apelit dhe paraqiti një kërkesë zyrtare në Ministrinë e Drejtësisë), por pa sukses. Ndër të tjera, ai depozitoi një ankesë pranë Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, i cili në vitin 2019 konstatoi se vonesat në çështjen e kërkuesit reflektonin një “mosfunksionim të gjyqësorit”. Në të njëjtin vit, paraqiti një kërkesë në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në vitin 2021, gjykata e apelit e rrëzoi ankimin dhe e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Seanca në këtë gjykatë fillimisht ishte caktuar për në mars 2022, por më pas u shty për në nëntor 2023, për shkak të mungesës

së gjyqtarëve. Në datën e miratimit të vendimit nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, proceset gjyqësore të kërkuetit ishin ende në pritje.

Vendosji: Gjykata rrëzoi kundërshtimin e Qeverisë për pranueshmërinë e kërkesës për shkak të mosshërimit të mjeteve juridike të brendshme në dispozicion, veçanërisht në lidhje me mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim kundër Shtetit belg për shkeljen e së drejtës për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshem. Qeveria nuk arriti të tregonte ekzistencën e një mundësie reale që kjo kërkesë do të trajtohej më shpejt se proceset gjyqësore kryesore. Gjykata gjithashtu vuri në dukje mungesën në ligjin belg të një mjeti juridik specifik për kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore. Nisur nga sa më sipër, Qeveria nuk arriti të tregonte se kërkesa për dëmshpërblim sipas ligjit kombëtar përmbushte kërkesat e një “mjeti efektiv të brendshëm” në përputhje me N. 35(1) KEDNJ dhe, prandaj, e shpalli kërkesën të pranueshme.

Për themelin, Gjykata solli në kujtesë praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, duke u shprehur se Shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që t’u mundësojnë gjykatave t’i garantojnë të gjithëve të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile brenda një afati të arsyeshem.

Në çështjen në fjalë, tashmë kishin kaluar shtatë vjet e tetë muaj për dy shkallë gjykimi (2015-2022) dhe proceset ishin ende në pritje. Proceset kishin një lloj kompleksiteti të caktuar që kërkonte caktimin e një eksperti. Kërkueti ushtroi kujdesin e duhur. Gjykatës së apelit iu desh një kohë tepër e gjatë për të vendosur për çështjen (pothuajse katër vjet) dhe çështja ishte ende në pritje në gjykatën e shkallës së parë. Këto vonesa reflektonin sipas Gjykatës, një “mosfunksionim të gjyqësorit”, për të cilin Qeveria nuk dha asnjë shpjegim të pranueshem.

Në fakt, një mbingarkesë kronike nuk mund të justifikojë kohëzgjatjen e tepruar të proceseve dhe mungesa e vendimarrjes për një mosmarrëveshje në gjykatë mund të çojë në mohim të drejtësisë, në shkelje të N.6 KEDNJ. Vonesat e tepruara në administrimin e drejtësisë ndikuan në besimin e publikut te sistemi gjyqësor dhe rrezikuan seriozisht sundimin e ligjit ku bazohet KEDNJ. Për më tepër, sistemi i Konventës bazohet në parimin e subsidiaritetit, kështu që para së gjithash i takon gjykatave kombëtare të sigurojnë respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa. Sistemi i Konventës nuk mund të funksionojë siç duhet nëse gjykatat e brendshme

nuk arrijnë të administrojnë drejtësinë brenda një afati të arsyeshëm për qëllimet e N. 6(1) KEDNJ.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Belgjika ka shkelur N.6(1) të Konventës për shkak se gjykatat kombëtare nuk e kishin shqyrtuar çështjen e kërkuarit brenda një afati të arsyeshëm. Meqenëse problemi ishte me natyrë strukturore në gjykatën e rrethit të Brukselit, siç konfirmohet, ndër të tjera, nga vendimet e mëparshme të Gjykatës, Belgjika duhej të merrte masa të përgjithshme për të respektuar të drejtën për një seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm.

Altius Insurance LTD kundër Qipros, Kërkesa Nr. 41151/20, Vendimi gjyqësor i datës 24 tetor 2023

Gjykatat kombëtare kanë detyrimin të shqyrtojnë çështje relativisht të lehta brenda një afati të arsyeshëm. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6(1) KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm)*

Në lidhje me të drejtën për proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, mjete juridik kombëtar për kompensimin që detyron kërkuarin të ndajë kërkesat e tij për kompensim sipas shkallëve të gjyqësorit (i) pengon vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve gjyqësore dhe (ii) mund të ndikojë në masën e kompensimit të dhënë. Kjo përbën *shkelje të N.13 KEDNJ (E drejta për zgjidhje efektive) (në lidhje me N.6 KEDNJ)*

Fakte: Kërkuari është një shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit qipriot, e cila ka vepruar si e paditur në proceset civile për shkelje të një kontrate. Ankimi u depozitua në vitin 2004 dhe gjykata e shkallës së parë e rrëzoi kërkesëpadinë në vitin 2010, pas disa hapave procedurale të ndërmarra nga të dyja palët, disa shtyrjeve të seancave (si me kërkesë të palëve ashtu edhe *ex officio*, për shkaqe të panjohura) dhe kërkesës për shtyrje për të paraqitur parashtrimet përfundimtare. Pas ankimit, në vitin 2017 Gjykata e Lartë e përmbysi vendimin duke vendosur kundër shoqërisë kërkuare dhe duke e urdhëruar atë të paguajë pothuajse 2 milionë euro dëmshpërblim, plus kostot dhe shpenzimet ligjore.

Në vitin 2018, kërkuari ngriti padi civile për t'u ankuar për kohëzgjatjen e përgjithshme të proceseve të brendshme gjyqësore. Padia u ngrit bazuar në një ligj kombëtar të vitit 2010 që parashikonte mjete juridike efektive për tejkalimin e afatit të arsyeshëm. Me një vendim të vitit 2020, Gjykata e Lartë rrëzoi pretendimin e kërkuarit në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve në shkallë të parë për shkak se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit (një vit nga

marrja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë). Për sa i përket pretendimit të shoqërisë kërkuese në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në apel, Gjykata e Lartë vuri në dukje se proceset e përgjithshme zgjatën pothuajse shtatë vjet, duke tejkaluar kështu kërkesën për afat të arsyeshëm; kështu, kërkuesi kishte të drejtë për dëmshpërbim dhe iu dhanë 5.000 euro.

Vendosj: Gjykata solli në vëmendje praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Në çështjen në shqyrtim, proceset para gjykatave kombëtare zgjatën mbi trembëdhjetë vjet (2004-2017). Çështja në lidhje me shkëljen e kontratës nuk ngriti pyetje jashtëzakonisht komplekse të ligjit. Vonesat e pakta që i atribuohen shoqërisë kërkuese për shkak të kërkesave për shtyrjen e proceseve gjyqësore të shkallës së parë nuk mund të konsiderohen si faktor i rëndësishëm që justifikon kohëzgjatjen e tyre. Për më tepër, nuk kishte rrethana të jashtëzakonshme që të justifikonin kohëzgjatjen e tyre të përgjithshme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Qipro ka shkelur N. 6(1) të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së tepruar të pajustificuar të proceseve të shoqërisë kërkuese.

Sa i përket N. 13 KEDNJ, Gjykata theksoi se një mjet kombëtar për t'u ankuar për kohëzgjatjen e proceseve është "efektiv" sipas kuptimit të kësaj dispozite nëse individët mund ta përdorin atë për të përshpejtuar proceset përpara gjykatave kombëtare ose për të marrë kompensimin e duhur për vonesat që kanë ndodhur tashmë. Nëse një sistem ligjor i brendshëm ka parashikuar ngritjen e padisë kundër Shtetit, ky veprim duhet të mbetet një mjet juridik efektiv, i mjaftueshëm dhe i aksesueshëm në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore. Vonesat e tepërta dhe masa e kompensimit janë elementë që duhen marrë parasysh kur vlerësohet nëse mjeti juridik është i mjaftueshëm në këtë drejtim (shihni *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, Kërkesat nr. 43391/18 dhe 17766/19, 12 tetor 2021).

Në çështjen në fjalë, mjeti sipas ligjit të vitit 2010 nuk ofronte një mjet efektiv për të përshpejtuar proceset ose për të shmangur zgjatjen e tyre të tepërt, sepse nuk kishte asnjë provë që metodat e përcaktuara sipas atij ligji do të jepnin rezultat *de facto*. Gjithashtu, ndarja e kërkesave për kompensim sipas shkallëve të gjyqësorit (shkallës së parë dhe apelit) ishte në kundërshtim me qasjen e Gjykatës për shqyrtimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve. Një mjet juridik i brendshëm për kohëzgjatjen e tepërt të proceseve është "efektiv" sipas kuptimit të N.13 KEDNJ dhe N. 35(1)

KEDNJ vetëm nëse është në gjendje të mbulojë të gjitha fazat e proceseve për të cilat është bërë ankimi dhe kështu të marrë parasysh kohëzgjatjen e tyre të përgjithshme. Gjithashtu, ndarja e proceseve gjyqësore sipas shkallëve të gjyqësorit ndikoi në llogaritjen e dëmshpërblimit, pasi Gjykata e Lartë vlerësoi dëmin vetëm në lidhje me proceset gjyqësore të apelit. Meqenëse kompensimi prej 5.000 euro ishte dukshëm më i ulët se shumata e dhëna për vonesa të krahasueshme në çështje të tjera, Gjykata doli në përfundimin se shoqëria kërkuese nuk vlerësoi dëmshpërblimin e duhur, i cili në çdo rast do të kërkonte një llogaritje bazuar në të gjithë kohëzgjatjen e procesit.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Qipro ka shkelur N. 13 të Konventës, në lidhje me N. 6 (1) të Konventës, për shkak të mosfrimit të mjeteve juridike të brendshme efektive për të dhënë dëmshpërblim në rast të kohëzgjatjes së tepërt të proceseve.

B. ZBATIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Maçi kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 21051/10, Vendimi gjyqësor i datës 4 korrik 2024 [Komiteti]

E drejta për një proces gjyqësor të drejtë përfshin ekzekutimin në kohë të vendimeve të formës së prerë, vendimeve detyruese në favor të paditësve për çështjet e të drejtave të pronësisë dhe përcaktimin e kufijve të një trualli toke. Kështu, autoritetet kombëtare kanë detyrimin t'i zbatojnë këto vendime gjyqësore plotësisht dhe brenda një afati të arsyeshëm. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N. 6 KEDNJ (E drejta për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës) dhe të N.1, Prot. nr. 1 KEDNJ (Mbrojtja e pronës).

Fakte: Kërkuesit janë trashëgimtarë të një personi në favor të të cilit, në vitin 1996, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë ka nxjerrë një vendim që urdhëron kthimin e një trualli, regjistrimin e tij në hipotekë dhe kompensimin e tij. Mbi atë truall është ngritur një objekt banimi dhe personat kanë fituar pronësinë e banesës në atë objekt duke i blerë apartamentet nga autoritetet shtetërore. Pas një padie nga i afërmi i kërkuesve, në vitin 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi zyrën e regjistrimit të regjistronte titullin e tij të pronësisë, siç përcaktohej në një raport ekspertize të paraqitur gjatë procesit. Sipas këtij raporti, trualli kufizohej me një pronë publike. Autoritetet vendore ishin palë në këto procese. Vendimi gjyqësor mori formë të prerë.

Pas vdekjes së të afërmit të tyre, zyra e regjistrimit informoi kërkuesit se kishte regjistruar titullin e tyre të pronësisë vetëm për një pjesë të truallit të përcaktuar në vendimin e vitit 2004: eksperti i caktuar nga gjykata bëri një gabim gjatë matjes së truallit dhe, pas ri-matjes shtesë, pjesa tjetër ju caktua pronës publike. Gjithashtu, zyra e regjistrimit u përpoq të fillonte procesin gjyqësor për të shpallur të pavlefshëm titullin e pronësisë së kërkuesve për pjesën që mbulonte pronën publike.

Vendosi: N. 6(1) KEDNJ siguron për të gjithë të drejtën për proces gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë. Kështu Shtetet kanë detyrimin të krijojnë një sistem gjyqësor që siguron zbatimin e një vendimi përfundimtar të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (shihni psh *Hornsby kundër Greqisë*, Kërkesa nr. 18357/91, 19 mars 1997). Gjithashtu, në dy çështje të mëparshme kundër Shqipërisë, Gjykata kishte gjetur tashmë shkelje të N. 6(1) KEDNJ në lidhje me probleme të ngjashme me ato të çështjes në fjalë (shihni *Qufaj Co. Sh.pk. kundër Shqipërisë* Kërkesa nr. 54268/00, 18 nëntor 2004; *Gjyli kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 32907/07, 29 shtator 2009). Çështja në fjalë kishte të bënte me mosekzekutimin e vendimit të vitit 1996 dhe vendimit të vitit 2004.

Për sa i përket vendimit të vitit 1996, Qeveria kundërshtoi faktin që kërkuesit nuk i kishin shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme, sepse titulli i tyre i pronësisë do të binte ndesh me të drejtat e pronësisë së banorëve të objektit të ngritur mbi atë truall. Sipas Gjykatës, nuk kishte asnjë provë që ekzistonte një mosmarrëveshje ndërmjet kërkuesve dhe banorëve që kishin në pronësi apartamentet e objektit të ngritur në truallin e kontestuar. Për më tepër, nuk i takon Gjykatës të balancojë të drejtat e kërkuesve me ato të banorëve të ndërtesës, sepse ky detyrim bie mbi gjykatën e brendshme. Edhe nëse supozohej se ekzistonte një mosmarrëveshje e tillë, kjo do të ishte rezultat i transferimit të gabuar të pronës nga autoritetet vendore mbi të njëjtin objekt te persona të ndryshëm privatë, pa marrë parasysh të drejtat konfliktuale. Prandaj, Shqipëria nuk mund të përdorte dhënien e vendimeve të tilla kontradiktore si një rrethanë që përjashton përgjegjësinë e zbatimit të urdhrit të kthimit sipas vendimit të vitit 1996. Sa i përket urdhrit të kompensimit sipas vendimit të vitit 1996, Ligji për Pronat i vitit 2015 prezantoi një mjet të ri juridik: veçanërisht, kërkuesit duhej të aplikonin në Agjencinë e Trajtimit të Pronave për të marrë kompensimin e tyre. Ky mjet juridik ishte efektiv (shihni *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (vendim), Kërkesat Nr. 29026/06 dhe 11 të tjera, 17 mars 2020). Në përfundim, Shqipëria nuk i ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për

të zbatuar plotësisht dhe brenda afatit të arsyeshëm urdhrin e kthimit sipas vendimit të vitit 1996.

Sa i përket vendimit të vitit 2004, kërkuessit nuk kanë detyrimin të fillojnë procese të njëjta me atë të filluar nga paraardhësi i tyre dhe të përfunduar me vendimin e formës së prerë të vitit 2004, i cili njohu paraardhësin e tyre si pronar të të gjithë truallit objekt kontestimi (dhe jo vetëm të një pjese të tij). Për më tepër, pas miratimit të vendimit të vitit 2004 në procesin ku ishin palë autoritetet vendore dhe që zgjidhi çështjen e përcaktimit të kufijve të truallit, autoritetet nuk ishin më në gjendje të kundërshtonin matjet e ekspertëve për atë truall. Si përfundim, autoritetet kombëtare nuk arritën të bënin të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zbatuar vendimet përfundimtare të brendshme të vitit 2004.

Në përfundim, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.6 (1) të Konventës dhe N. 1, Prot nr. 1 të Konventës për shkak të moszbatimit të plotë dhe në kohë nga autoritetet e brendshme të një vendim kombëtar dhe një vendimi gjyqësor mbi çështjen e të drejtave të pronësisë dhe përcaktimin e kufijve të një trualli.

Tona kundër Shqipërisë , Kërkesa nr. 78957/11, Vendimi gjyqësor i datës 4 korrik 2024 [Komiteti]

Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për zbatimin e një vendimi gjyqësor që njeh të drejtën e individit për të poseduar dhe disponuar tokë truall, në veçanti autoritetet kombëtare duhet të regjistrojnë parcelën dhe t'ia kalojnë personit në fjalë. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N.6 KEDNJ (E drejta për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës).

Fakte: Në vitin 2006, Komisioni i Pronave Korçë pranoi që babai i kërkuessit kishte në pronësi një parcelë pyjore (të shpronësuar gjatë regjimit komunist) dhe urdhëroi kthimin e saj te kërkuessi. Komisioni rrëzoi pretendimin e kërkuessit për dy parcelat shtesë, të cilat i atribuoheshin N.GJ.. Kërkuessi e kundërshtoi këtë pjesë të vendimit dhe në vitin 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec shfuqizoi vendimin e Komisionit që njihte titullin e pronësisë së N.Gj .mbi parcelat, ndryshoi vendimin e vitit 2006 dhe urdhëroi që autoritetet kombëtare të njihnin babanë e kërkuessit si ish-pronar të dy parcelave shtesë. Zyra e regjistrimit ishte palë në këtë proces gjithashtu. Vendimi gjyqësor mori formë të prerë në vitin 2009.

Në vitin 2010, zyra e regjistrimit u mbështet në rregulloren e saj të brendshme dhe refuzoi regjistrimin e parcelave nën emrin e kërkuesit për shkak të mungesës së procesverbalit të kalimit të pronësisë së pronës, i cili duhej të hartohej nga një përbarues. Në të njëjtin vit, Gjykata e Rrethit Pogradec lëshoi një urdhër ekzekutimi dhe vuri në dukje se pa regjistrim, kërkuesi nuk mund të dispononte parcelat mbi të cilat ai kishte fituar të drejtat reale të pronësisë. Me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit, Zyra e Avokatit të Shtetit këshilloi që autoritetet të mos i dorëzonin parcelat kërkuesit, sepse nuk ishte e qartë nëse vendimi i vitit 2006 (i ndryshuar me vendimin e 2008) përmbante një urdhër për kthimin e atyre parcelave te kërkuesi. Në vitin 2011, zyra përbarimore urdhëroi hipotekën të regjistronte parcelat në emër të kërkuesit, pa paraqitur një procesverbal për transferimin e pronësisë, sepse vendimi i vitit 2006 (i ndryshuar me vendimin e vitit 2008) nuk i referohej kalimit fizik të parcelave. Edhe një herë zyra e regjistrimit refuzoi për shkak të mungesës së procesverbalit të kalimit në pronësi të pronës. Përbaruesi e konsideroi të kryer procedurën përbarimore dhe e ndërpreu procedurën.

Vendosj: Gjykata solli në vëmendje praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe detyruese. Gjithashtu, në dy çështje të mëparshme kundër Shqipërisë, Gjykata kishte gjetur tashmë shkelje të N. 6(1) KEDNJ në lidhje me probleme të ngjashme me ato të çështjes në fjalë (shihni *Qufaj Co. Sh.pk. kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 54268/00, 18 nëntor 2004; *Gjyli kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 32907/07, 29 shtator 2009).

Në çështjen në fjalë, urdhri i ekzekutimit i vitit 2010 i referohej të drejtës së kërkuesit për të poseduar dhe disponuar parcelat në fjalë. Megjithatë, autoritetet vendore nuk i regjistruan parcelat në emrin e kërkuesit dhe nuk siguruan fizikisht transferimin e parcelave te kërkuesi. Në veçanti, zyra e regjistrimit u mbështet në rregulloren e saj të brendshme për të justifikuar refuzimin e regjistrimit të titullit të pronësisë së kërkuesit, duke mos përmbushur kështu vendimin e gjykatës vendase të dhënë në proces ku ishte palë edhe zyra e regjistrimit. Në këtë kuadër, kërkuesi nuk krijoi asnjë pengesë në fazën e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë. Si përfundim, autoritetet kombëtare nuk arritën të bënin të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zbatuar vendimet e brendshme të formës së prerë në favor të kërkuesit.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 6(1) të Konventës për shkak të moszbatimit nga autoritetet vendore të një vendimi

kombëtar të formës së prerë në lidhje me regjistrimin dhe transferimin e parcelave.

Spahiu kundër Shqipërisë, Kërkesat nr. 79452/17 dhe 2 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 18 korrik 2024 [Komiteti]

E drejta për proces të drejtë përfshin ekzekutimin në kohë të vendimeve të formës së prerë dhe detyruese të dhëna kundër Administratës Publike. Kështu, autoritetet kombëtare kanë detyrimin, i cili vlen në rastet e punësimit, që të ekzekutojnë këto vendime në mënyrë të plotë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6 KEDNJ (E drejta për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës)*

Fakte: Kërkuesit u ankuan për moszbatimin ose zbatimin me vonesë të vendimeve gjyqësore, të dhëna kundër Administratës Publike në çështjet e punësimit. Kërkuesja e parë u ankua për ekzekutimin me vonesë pothuajse katër vjeçare të një vendimi të një gjykate të brendshme të vitit 2014 për anulimin e transferimit të saj në një pozicion dhe qytet tjetër (zbatuar në vitin 2018). Kërkuesja e dytë u ankua për ekzekutimin me vonesë gati dy vjeçare të një vendimi të gjykatës të vitit 2015 për rikthimin e saj dhe pagesën e pagave të prapambetura deri në momentin e rikthimit (zbatuar në vitin 2018). Kërkuesja e tretë u ankua për ekzekutimin me vonesë prej gati katër vitesh të vendimit të një gjykate të vitit 2015 për rikthimin e saj (në të njëjtin pozicion ose në pozicion të ngjashëm) dhe pagesën e pagave të prapambetura deri në momentin e rikthimit.

Vendosi: Gjykata solli në vëmendje praktikën e saj gjyqësore të mirë-konsoliduar mbi të drejtën për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe detyruese. Gjithashtu, në dy çështje të mëparshme kundër Shqipërisë, Gjykata kishte gjetur tashmë shkelje të N. 6(1) KEDNJ në lidhje me probleme të ngjashme me ato të çështjes në fjalë (shihni *Qufaj Co. Sh.pk. kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 54268/00, 18 nëntor 2004; *Gjyli kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 32907/07, 29 shtator 2009). Këto parime zbatohen edhe për vendimet për çështjet e punës (shihni *Elgakoti Sh.pk dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Kërkesat nr. 63986/10 dhe 5 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 6 korrik 2023; *Alsula dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Kërkesat nr. 63975/10 dhe 3 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 30 nëntor 2023).

Në çështjen në fjalë, Gjykata pranoi se dy nga tre vendime të brendshme ishin ekzekutuar në vitin 2018 dhe se procedurat përmbarimore në lidhje me vendimin në favor të kërkueses së tretë përfunduan në vitin 2022. Gjykata

vlerësoi se faktet e çështjes tregojnë ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme dhe se autoritetet vendore nuk bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zbatuar në kohë të arsyeshme vendimet në favor të kërkueseve.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 6(1) të Konventës për shkak të ekzekutimit me vonesë nga autoritetet kombëtare të vendimeve të formës së prerë, detyruese, në favor të kërkueseve.

C. TË DREJTAT PROCEDURALE

Supergrav Albania Shpk kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 20702/18, 9 maj 2023

Afatet kohore për depozitimin e një ankimi duhet të llogariten nga data kur individët vihen në dijeni ose mund ta dinë si pjesën e dispozitivit të vendimit të ankimuar, ashtu edhe shkaqet e tij. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6 KEDNJ* (E drejta për t'ju drejtuar një gjykate).

Fakte: Kërkuesi është një shoqëri shqiptare e cila ka depozituar padi civile për dëmshpërblim. Kërkesa u rrëzua nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit në vitin 2013. Kërkuesi paraqiti më tej ankimin në Gjykatën e Lartë, e cila, në vitin 2016, pa praninë e palëve, miratoi dispozitivin e një vendimi refuzues. Njoftimi paraprak për seancat e mbajtura nga Gjykata e Lartë duhej të publikohej në ambientet e saj dhe në faqen e saj të internetit; palëve nuk u është dhënë asnjë njoftim personal. Nuk ka asnjë të dhënë për datën në të cilën vendimi i plotë i arsyetuar i Gjykatës së Lartë është marrë apo publikuar në faqen e saj të internetit.

Një ligj kombëtar i vitit 2016 shkurtoi afatin kohor për paraqitjen e një ankimi kushtetues nga dy vjet në katër muaj “nga momenti i marrjes dijeni për ndërhyrjen” në një të drejtë ose liri kushtetuese. Afati i ri kohor u bë i zbatueshëm që nga 1 marsi 2017. Pas një kërkesë zyrtare nga kërkuesi, vendimi i Gjykatës së Lartë iu dorëzua shoqërisë më 26 shtator 2017. Shoqëria depozitoi ankim kushtetues në tetor 2017. Gjykata Kushtetuese, në muajin pasues, e shpalli ankimin të papranueshëm sepse ishte depozituar jashtë afatit kohor prej katër muajsh, duke filluar nga miratimi i vendimit të Gjykatës së Lartë (2016), dhe jo nga data kur i ishte njoftuar shoqërisë kërkuese (26 shtator 2017).

Vendosji: Shtetet mund të kufizojnë të drejtën e aksesit në gjykatë sipas N.6(1), por këto kufizime nuk duhet të cenojnë vetë thelbin e kësaj të drejte. Kufizimi është në përputhje me N.6(1) KEDNJ nëse bëhet për një qëllim legjitim dhe nëse ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shihni *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], Kërkesa nr. 40160/12, 5 prill 2018). E drejta për akses në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale përbëjnë një pengesë për palën ndërgjyqëse që çështja e saj të shqyrtohet në themel nga gjykata kompetente (shihni p.sh. *Arrozpide Sarasola dhe të tjerët kundër Spanjës*, Kërkesat nr. 65101/16 dhe 2 të tjera, 23 tetor 2018).

Në çështjen në fjalë, akses i individëve në Gjykatën Kushtetuese ishte i kufizuar, *ndër të tjera*, me afate kohore. Rregullat që caktojnë afatet kohore për akses në gjykatat e larta janë përgjithësisht të lejueshme, pasi ato synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike. Një vendim i Gjykatës Kushtetuese mund të prishë vendimet gjyqësore të formës së prerë që janë objekt ankimi kushtetues. Shkurtimi i afatit për paraqitjen e një ankimi kushtetues ka për qëllim forcimin e sigurisë juridike, pasi shmang periudhat e gjata përpara se të arrihet rezultati përfundimtar në një çështje të caktuar (shihni *Çela kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 73274/17, 29 nëntor 2022). Kështu, shkurtimi i afatit bëhet për një qëllim legjitim sipas N. 6(1) KEDNJ.

Mënyra e zbatimit të afateve mund të cenojë N.6(1) KEDNJ nëse, ndër të tjera, afati fillon të llogaritet në një moment kur pala nuk ka dijeni dhe nuk mund ta dinte në mënyrë efektive përmbajtjen e vendimit të ankimuar të gjykatës më të ulët (shihni *Jensen kundër Danimarkës*, Kërkesa nr.8693/11, 13 dhjetor 2016).

Në çështjen në fjalë, njoftimi paraprak i seancave të mbajtura nga Gjykata e Lartë duhej të ishte publikuar në ambientet e saj dhe në faqen e saj të internetit; palëve nuk u është dhënë asnjë njoftim personal. Për më tepër, në legjislationin e brendshëm nuk kishte dispozita që të parashikonin qartë njoftimin e palëve për vendimet e arsyetuara të Gjykatës së Lartë dhe në praktikë nuk bëhet ky njoftim. Për më tepër, në rastin në fjalë nuk ka pasur seancë, pasi Gjykata e Lartë ka marrë një vendim me dyer të mbyllura. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk kishte dijeni për vendimin: shoqëria u njoh me ekzistencën dhe arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë më 26 shtator 2017, pas kërkesës së saj me shkrim. Gjykata përsëriti se palët duhet të jenë në gjendje të paraqesin ankimin që nga momenti që ata mund të

informohen efektimisht për vendimet e gjykatës. Njoftimi i vendimeve të gjykatës u mundëson palëve në proces të dinë dispozitat dhe shkaqet dhe, kështu, atyre u mundësohet depozitimi i ankimit.

Për sa i përket Shqipërisë, Gjykata kishte vendosur tashmë se afati kohor për paraqitjen e ankimit kushtetues duhej të ishte llogaritur që nga data që kërkuesi kishte marrë dënimin për vendimin që do të ankimohej (shihni *Shkalla kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 26866/05, 10 maj 2011, në lidhje me proceset *in absentia*). Deri më 26 shtator 2017, kërkuesi nuk ishte njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe arsyetimin e tij dhe, për rrjedhojë, nuk kishte të drejtën efektive për ankim kushtetues përpara kësaj date.

Përveç kësaj, në atë kohë kishte një vonesë të konsiderueshme në kohë ndërmjet miratimit të dispozitivit dhe arsyetimit të plotë të vendimeve të Gjykatës së Lartë. Para 1 marsit 2017, afati kohor për paraqitjen e ankimit kushtetues kishte qenë dy vjet. Prandaj, ishte e arsyeshme që kërkuesi të mësonte për vendimin e Gjykatës së Lartë nga faqja e saj e internetit (pa njoftim personal), sepse shoqëria kishte mjaft kohë për të paraqitur një ankim kushtetues. Megjithatë, shkurtimi i afatit ndryshoi rrethanat e çështjes, pasi kërkuesi nuk kishte kohë të mjaftueshme për t'u njohur me arsyetimin e vendimit përmes faqes së internetit të Gjykatës së Lartë. Në përfundim, afati katër mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues duhej të llogaritej nga data 26 shtator 2017 (kur kërkuesit i ishte dorëzuar vendimi).

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 6(1) të Konventës sepse kërkuesit i është privuar e drejta për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkak të llogaritjes së gabuar të datës së fillimit për zbatimin e kërkesës së afatit për të paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Lazaris kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 48806/06, Vendimi gjyqësor i datës 20 qershor 2023 [Komiteti]

Rregullat procedurale kombëtare për njoftimin e seancave para gjykatës duhet të jenë në përputhje me parimet e barazisë së armëve dhe një seancë të drejtë, në mënyrë që të sigurohet që palët ndërgjyqëse të kenë mundësinë të bëjnë parashtrimet në çështjet e tyre (sidomos duke komentuar parashtrimet e palës kundërshtare). Gjykatat e brendshme duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur për të ruajtur respektimin e këtyre parimeve. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6 KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor të drejtë)*

Fakte: Kërkuesit vazhduan procesin gjyqësor në vend të paraardhësve të tyre, të cilët ishin shtetas amerikanë që jetonin jashtë Shqipërisë. Babai i tyre kishte një truall dhe një shtëpi njëkatëshe, të cilat u shtetëzuan nga ish-regjimi komunist. Një fabrikë vaji, e cila u ndërtua në atë truall, u shit në vitin 1994 te V.R si rezultat i privatizimit. Në vitin 1995, pas kërkesës së kërkuesve drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Vlorës (“Komisioni”), ky i fundit u njohu të drejtën e pronës mbi tokën dhe urdhëroi kthimin e një pjese të truallit dhe shtëpisë të kërkuesit, dhe kompensimin me bono thesari për pjesën tjetër të truallit që ishte akoma e zënë nga fabrika e vajit.

Kërkuesit filluan procesin civil kundër V.R-së, Komisionit dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit për të kërkuar shfuqizimin e kontratës së privatizimit dhe kthimin e pjesës së mbetur të truallit. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit vendosën në favor të kërkuesit në vitin 2004.

Të paditurit bënë ankim pranë Gjykatës së Lartë, i cili iu njoftua avokatit që përfaqësonte kërkuesit. Kërkuesve apo përfaqësuesve të tyre nuk ju dërgua asnjë njoftim personal për seancën, e cila u mbajt në korrik 2005. Në atë kohë, njoftimet për seancat publikoheshin në ambientet e Gjykatës së Lartë dhe në faqen e saj. Në seancë mungonin kërkuesit dhe avokatët e tyre. Avokatët e të paditurve ishin të pranishëm në seancë dhe bënë parashtrime me gojë. Në vitin 2005, Gjykata e Lartë prishi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe hodhi poshtë pretendimet e kërkuesve, duke gjetur se privatizimi kishte qenë i ligjshëm. Ajo nuk e trajtoi çështjen e mungesës së kërkuesve.

Në vitin 2006, Gjykata Kushtetuese shpalli të papranueshëm, pa asnjë arsye, ankimin kushtetues të paraqitur nga kërkuesit.

Vendosi: Sipas N. 6(1) KEDNJ, e drejta për një seancë dëgjimore të drejtë përfshin të drejtën e palëve për të qenë të pranishëm në seancë dhe për të paraqitur parashtrimet e tyre. Secilës palë duhet t’i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të konsiderueshëm *kundrejt* kundërshtarit të saj, duke përfshirë mundësinë për të komentuar të gjitha parashtrimet e paraqitura. Këto garanci vlejné për proceset gjyqësore para gjykatave të apelit dhe gjykatës së lartë. N.6 KEDNJ nuk parashikon një formë specifike të njoftimit me postë nga gjykata, megjithatë Gjykata mund të konstatojë nëse zbatimi i rregullave të brendshme procedurale për komunikimet me palët ndërgjyqëse është në përputhje me Konventën.

Në këtë çështje, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk u shpreh për çështjen e mungesës së kërkuesve në seancën dëgjimore (p.sh., nuk thotë arsyen pse seanca nuk duhej të shtyhej) dhe Gjykata Kushtetuese nuk dha arsye për vendimin e saj të vitit 2006. Kjo heshtje në vetvete nuk përputhet me përgjegjësitë e gjykatave të brendshme sipas N.6 KEDNJ.

Në mungesë të njoftimit personal, kërkuesit dhe avokatët e tyre mund të mësonin për seancën vetëm duke vizituar gjykatën ose duke u konsultuar me faqen e saj në internet. Nuk mund të pritej në mënyrë të arsyeshme që kërkuesit ta bënin këtë për çdo njoftim të seancave dëgjimore të botuar nga Gjykata e Lartë gjatë rreth gjysmë viti që ka kaluar pasi ata morën dijeni për ankimin. Edhe nëse palët tregojnë mungesë kujdesi, pasojat që i atribuohen sjelljes së tyre nga gjykatat e brendshme duhet të jenë në përpjesëtim me masën e dështimeve të tyre, duke pasur parasysh edhe parimin e përgjithshëm të seancës dëgjimore të drejtë. Gjithashtu, në çështjen në fjalë, nuk u bë asnjë përpjekje për të njoftuar kërkuesin dhe avokatin e tyre për seancën përpara Gjykatës së Lartë, edhe pse dihejshin identiteti dhe adresat e tyre (p.sh., nuk kishte pasur vështirësi për njoftimin e tij për ankimin e paraqitur para Gjykatës së Lartë). Kështu, Gjykata e Lartë kishte mundësinë të njoftonte në mënyrë efektive kërkuesit dhe/ose avokatët e tyre për seancën, duke përfshirë edhe shtyrjen e seancës në pritje të njoftimit të rregullt. Autoritetet vendore kishin detyrimin të ushtronin kujdesin e duhur për të siguruar respektimin e garancive sipas N.6 KEDNJ, duke konsideruar se procedura kishte të bënte me vendimmarrjen për padinë civile të kërkuesve në lidhje me pronësinë e truallit, si dhe me pasojat monetare. Si përfundim, Gjykata e Lartë ua hoqi mundësinë kërkuesve për të paraqitur në mënyrë efektive çështjen e tyre dhe për të gëzuar barazinë e armëve me palën kundërshtarë. Kjo mangësi nuk u korrigjua pasi kërkuesit mësuan për vendimin e Gjykatës së Lartë.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 6 të Konventës për shkak të mosrespektimit të detyrimit të Gjykatës së Lartë për respektimin e parimit të një seance dëgjimore të drejtë.

Meli dhe Swinkels Family Brewers N.V kundër Shqipërisë, Kërkesat Nr. 41373/21 dhe 48801/21, Vendimi gjyqësor i datës 16 korrik 2024

Një ligj që parashikon shumicë të cilësuar dhe vota të barabarta për vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk cenon të drejtën për një proces gjyqësor të drejtë, nëse ligji saktëson që pasojat e votave të barabarta për rezultatin e konfliktit janë mjaftueshëm të qarta dhe të sigurta sipas legjislacionit kombëtar – *Nuk ka shkelje të së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës (N.6 KEDNJ)*

Gjykatat kombëtare duhet të shprehin në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato bazohen. Përmbyshja e këtij detyrimi bën të mundur që palët në proces të kuptojnë vendimin e gjykatës. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 6 KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor të drejtë – E drejta për një vendim të arsyetuar)*

Fakte: Në vitin 2008, kërkuesi i parë depozitoi një padi civile ku kërkonte titullin e pronësisë mbi një truall që tashmë i ishte kthyer palëve të treta në procedurat e kthimit. Pasi dëgjoi pretendimet e palëve dhe raportin e një eksperti, në vitin 2010 gjykata e shkallës së parë rrëzoi pretendimin e kërkuesit për shkak të mungesës së dokumentacionit të pamjaftueshëm mbështetës (veçanërisht, një hartë që tregon vendndodhjen e pronës së paraardhësve të tij). Ajo pranoi kërkesën e të paditurve për pronësinë në bazë të dokumenteve provuese. Në vitin 2012, gjykata e apelit refuzoi ankimimin e kërkuesit, duke lënë në fuqi arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Në vitin 2017, Gjykata e Lartë rrëzoi ankimimin e kërkuesit.

Pas një ankimi kushtetues nga kërkuesi, në vitin 2021 kolegji i Gjykatës Kushtetuese (i mbledhur si kolegji me gjashtë gjyqtarë për shkak të tre vendeve vakante) u nda tre me tre mbi ankimin e kërkuesit për një shkelje të pretenduar të barazisë së armëve, dhe katër me dy për ankimin për shkelje të së drejtës për vendim gjyqësor të arsyetuar. Si rezultat, ankimet u rrëzuan sepse gjykata nuk arriti shumicën prej pesë gjyqtarësh për themelin e tyre të kërkuar me ligj. Arsyetimi i vendimit përbëhej vetëm nga një përskrim i shkurtër i parimeve ligjore përkatëse dhe rezultatet e votimit dhe rezultatit e tij. Ai vendim ishte përfundimtar.

Për sa i përket kërkesës së dytë, të paraqitur nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me seli në Holandë) e cila prodhon pije alkoolike dhe joalkoolike, në vitin 2009, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale zgjeroi markën tregtare të shoqërisë së pijen e saj energjike B-52 në Shqipëri. Një shoqëri shqiptare pretendoi se ajo tashmë e kishte atë markë tregtare në Shqipëri dhe nisi procesin civil kundër kërkuesit për të kërkuar anulimin e markës së tij

tregtare në Shqipëri. Në vitin 2012, gjykata e shkallës së parë vendosi në favor të shoqërisë shqiptare. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë e lanë në fuqi vendimin përkatësisht në vitin 2013 dhe 2016. Pas një grupi tjetër procesesh civile, kërkuesi paraqiti ankim kushtetues lidhur me mungesën e pretenduar të arsytimit të duhur në vendimet e gjykatave më të ulëta. Në vitin 2021, kolegji i Gjykatës Kushtetuese (i mbledhur si kolegji me shtatë gjyqtarë për shkak të dy vendeve vakante) vendosi kundër kërkuesit me votim katër me tre. Arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese u kufizua në deklarinimin e faktit se ajo nuk mund të arrinte shumicën e kërkuar me ligj prej pesë gjyqtarësh për çështjen e ngritur. Ai vendim ishte përfundimtar.

Faktet e çështjes qëndrojnë kundër reformave të gjera të sistemit të drejtësisë në Shqipëri të vitit 2016, të cilat çuan në ndryshime në Kushtetutë dhe miratimin e një sërë ligjesh thelbësore që lidhen, ndër të tjera, me rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, duke ulur numrin e gjyqtarëve të disponueshëm për të dëgjuar çështjet në Gjykatën Kushtetuese (shihni *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 15227/19, 9 shkurt 2021).

Vendosi: Kërkesat nën shqyrtim përfshinin rrëzimet e ankimeve kushtetuese përkatëse të kërkuesve si rezultat ose i votave të barabartë ose i mungesës së shumicës së kërkuar prej pesë gjyqtarësh për gjetjen e shkëlqes kushtetuese. Një votë e barabartë nuk cenon N.6(1) KEDNJ nëse pasojat e votës së barabartë për rezultatin e konfliktit janë mjaftueshëm të qarta dhe të sigurta sipas legjislacionit kombëtar (shihni *Loizides kundër Qipros*, Kërkesa nr. 31029/15, 5 korrik 2022). Shqipëria iu nënshtrua një reforme kushtetuese dhe ligjore për të adresuar çështjen e ngritur në një vendim të mëparshëm përpara Gjykatës (*Marini kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 3738/02, 18 dhjetor 2007 në lidhje me rrëzimin e një ankimi kushtetues që e kishte lënë kërkuesin pa një vendim përfundimtar për padinë e tij civile dhe, kështu, ngriti pyetjen mbi sigurinë juridike). Si rezultat i kësaj reforme, ligji shqiptar sqaroi pasojat e votimit të barabartë, që shkaktojnë rrëzimin përfundimtar të ankimit kushtetues. Prandaj, çështja në fjalë nuk solli pyetje të sigurisë juridike që rrjedhin nga mungesa e një vendimi përfundimtar mbi pretendimin e ankuesve. Për më tepër, kërkesa për shumicë të cilësuar prej pesë gjyqtarësh për vendimin e Gjykatës Kushtetuese, *per se*, nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë sipas N.6(1) KEDNJ. Në çështjen në fjalë, ligji shqiptar parashikonte shumicën prej pesë gjyqtarësh, votat në çështjet e kërkuesve ishin në përputhje me ligjin dhe praktikën e zakonshme të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet tregonin rezultatin dhe pasojat e rrëzimit përfundimtar të pretendimeve të tyre.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria nuk ka shkelur të drejtën e kërkuësve për t'ju drejtuar një gjykate dhe për vendimmarrjen mbi themelin e pretendimeve të tyre sipas N. 6(1) të Konventës.

Sipas N. 6(1) KEDNJ, vendimet e gjykatave duhet të shprehin në mënyrë adekuate arsytet në të cilat ato bazohen. Ky detyrim nënkupton që palët në procese gjyqësore mund të presin që të marrin një përgjigje specifike dhe të qartë për argumentet që janë vendimtare për rezultatin e atyre proceseve. Parimi i arsytimit të drejtë të vendimeve është i lidhur ngushtë me të drejtën për proces gjyqësor të drejtë, i cili kërkon që palët në proces dhe publiku të jenë në gjendje të kuptojnë vendimin e gjykatës. Kjo kërkesë është një garanci thelbësore kundër arbitraritetit dhe nxit besimin e publikut në një sistem drejtësie objektiv dhe transparent, një nga themelet e një shoqërie demokratike.

Në çështjen në fjalë, ligji i Gjykatës Kushtetuese parashikon që vendimet e gjykatës të "publikohen me arsytim". Në praktikën e saj të fundit, Gjykata Kushtetuese kishte dhënë të paktën arsye të përmbledhura për qëndrimet e shumicës dhe pakicës efektive në këtë çështje. Megjithatë, vendimet për çështjet e kërkuësve ishin të kufizuara me vënien në pah të rezultateve të votimit dhe rezultatit të tij (duke përfshirë një përshkrim të shkurtër se si kishte votuar secili gjyqtar). Gjykata Kushtetuese nuk dha asnjë argument mbi themelin e ankimeve dhe një arsytim të përmbledhur të qëndrimeve të shumicës dhe të pakicës. Kështu, kërkuësit kishin siguri për rrëzimin përfundimtar të ankimeve të tyre, por jo për arsytet thelbësore dhe shkaqet bazë të vendimeve. Për më tepër, nuk mund të konsiderohet se Gjykata Kushtetuese ka miratuar në mënyrë të nënkuptuar arsytimin e gjykatave më të ulëta, sepse ankimet e kërkuësve kishin të bënin pikërisht me cilësinë e arsytimit të gjykatave të zakonshme ose respektimin e tyre me garancitë e procesit gjyqësor të drejtë.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 6(1) të Konventës për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk ka dhënë arsytimin e duhur për vendimet e saj, duke shkelur të drejtën për një proces gjyqësor të drejtë.

Ben Amamou kundër Italisë, Kërkesa nr. 49058/20, Vendimi gjyqësor i datës 29 qershor 2023

Në çështjen e të provuarit *ex officio* të shkakut vendimtar që mbështet refuzimin e një ankimi (p.sh. në vendimin për rrëzimin e kërkesës), gjykata e brendshme duhet të informojë personin për këto shkaqe ligjore të parashtuara rishtazi në mënyrë që t'i japë atij mundësi për të paraqitur argumente dhe për t'i kundërshtuar ato, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 6(1) KEDNJ (Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit)*.

Fakte: Kërkuesi është një shtetas tunizian që jetonte në Itali. Në vitin 2010, drejtuesi i një mjeti ku ndodhej kërkuesi manovroi papritur për të shmangur përplasjen me një automjet që nuk u identifikua. Si rezultat, kërkuesi pësoi lëndime trupore që u vlerësuan të rënda në masën 85% dhe paaftësi të përhershme për punë.

Kërkuesi filloi proces gjyqësor për kompensim kundër siguruesit të automjetit me të cilin ai kishte udhëtuar. Ai kërkoi kompensim si “pasagjer i thjeshtë”. Në prill 2015, gjykata kompetente e hodhi poshtë kërkesën e tij, duke konstatuar se një nga “dy kushtet” e përcaktuara në legjislacionin vendas, përkatësisht që “të paktën dy automjete [të përfshihen] dhe [që] të dyja automjetet të jenë të siguruar”, nuk plotësohej pasi aksidenti ishte shkaktuar nga një automjet i cili nuk ishte identifikuar.

Kërkuesi paraqiti një ankim në Gjykatën e Kasacionit ku kërkoi zbatueshmërinë e ligjit të brendshëm për rastet e aksidenteve automobilistike ku një nga automjetet e përfshira, pavarësisht nga përplasia, është e pasiguruar ose e paidentifikuar. Në vitin 2019, Gjykata e Kasacionit rrëzoi ankimin e kërkuesit duke u shprehur se, në raste të tilla si të kërkuesit, i dëmtuari duhet të kontaktojë ekskluzivisht shoqërinë e caktuar nga Fondi i Garancisë për viktimat e aksidenteve rrugore¹. Gjithashtu, Gjykata e Kasacionit vërejti se “pasagjeri i thjeshtë” mund të vepronte drejtpërdrejt kundër siguruesit të transportuesit të tij vetëm nëse është e mundur të përcaktohet (ose të supozohet) përgjegjësia e përbashkët e drejtuesit të mjetit në të cilin “pasagjeri i thjeshtë” ishte duke udhëtuar – kusht që nuk plotësohej në rastin në fjalë.

¹ Fondi u krijua me ligj për të paguar kompensimin për dëmet e shkaktuara nga aksidentet rrugore të shkaktuara, ndër të tjera, nga automjete të paidentifikuara dhe automjete të pasiguruar. Hetimi dhe shlyerja e pretendimeve kryhen nga shoqëritë e sigurimit.

Vendosi: Gjykata solli në kujtesë se koncepti i një seance dëgjimore të drejtë në N. 6 KEDNJ përfshin gjithashtu të drejtën për procese kundërshtare. Prandaj, faktori vendimtar është nëse njëra nga palët është “kapur në befasi”. Parimi i procesit kundërshtar kërkon që gjykatat të mos i bazojnë vendimet e tyre në elemente të faktit ose të ligjit që nuk janë diskutuar gjatë procesit dhe që i japin mosmarrëveshjes një rezultat që as një palë e kujdesshme nuk do të kishte qenë në gjendje ta parashikonte (shihni *Vegotex International SA kundër Belgjikës* [DH], Kërkesa nr. 49812/09, 3 nëntor 2022).

Çështja përpara Gjykatës ishte nëse mosveprimi i mundshëm nga Gjykata e Kasacionit për të informuar kërkuesin për qëllimin e saj për të ngritur arsyetimin në fjalë me nismën e saj ishte në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit. Për të adresuar këtë çështje, Gjykata vlerësoi nëse: (a) arsyeja në fjalë ishte ngritur tashmë në procese gjyqësore; (b) arsyeja e ngritur *ex officio* mund të jetë e diskutueshme; (c) ndikimi i saj në rezultatin e çështjes dhe në çështjet në fjalë ishte i papërfillshëm.

Për elementin e parë (a), GJEDNJ konstatoi se arsyeja në fjalë nuk ishte ngritur tashmë në procese gjyqësore me terma të qartë. Përveç kësaj, edhe duke supozuar që përgjegjësia e përbashkët u përdor disi në proces gjyqësor, Gjykata e Kasacionit kishte për detyrë të informonte palët për interpretimin e ri të ligjit të brendshëm, duke qenë se ai kishte ndryshuar gjatë procesit dhe, prandaj, kërkuesi nuk supozohej të kishte dijeni për këtë interpretim të ri.

Lidhur me elementin e dytë (b), Gjykata vlerësoi se arsyeja e ngritur *ex officio* nga Gjykata e Kasacionit ishte e re dhe e diskutueshme, pasi ajo ishte ende objekt i mendimit të ndryshëm doktrinor dhe konflikt jurisprudence, i cili vazhdonte ende pas vendimit të Gjykatës së Kasacionit për çështjen e kërkuesit.

Në lidhje me elementin e tretë (c), mungesa e përgjegjësisë së përbashkët përcaktoi rezultatin e çështjes dhe ishte vendimtare për refuzimin e ankimit të kërkuesit. Për më tepër, çështjet në fjalë nuk ishin të papërfillshme, sepse kërkuesi nuk ishte kompensuar pavarësisht dëmit të rëndë të pësuar prej tij dhe pasojave të tij. Në këtë drejtim, pas vendimit të Gjykatës së Kasacionit, kërkuesi nuk mund të mbështetej më në fondin e garancisë për viktimat e aksidenteve rrugore, sepse padia përkatëse ishte parashkruar.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata doli në përfundimin se Italia ka shkelur N. 6(1) KEDNJ për shkak se Gjykata e Kasacionit nuk ka informuar kërkuesin (dhe palët e tjera) mbi zëvendësimin *ex officio* të shkaqeve, duke konsideruar

se kërkuesi ishte “kapur në befasi” dhe nuk kishte mundësi të paraqiste argumentet e tij mbi një pyetje e cila ishte vendimtare për rezultatin e procesit. Kështu, ai përfitoi nga e drejta për një proces gjyqësor të drejtë për shkak të shkeljes së parimit të kontradiktoritetit.

Poklikayew kundër Polonisë, Kërkesa nr. 1103/16, Vendimi gjyqësor i datës 22 qershor 2023

Nëse një i huaj me qëndrim të ligjshëm kundërshton një urdhër dëbimi bazuar në shkaqe të sigurisë kombëtare të cilat nuk i janë treguar atij, urdhri i dëbimit nuk mund të bazohet në arsye të përgjithshme (p.sh., bashkëpunimi me shërbimet sekrete të një vendi të huaj). Për më tepër, autoritetet kombëtare duhet të sigurojnë që i huaji të gëzojë ndihmën efektive të një avokati (p.sh., duke i dhënë të huajit listën e avokatëve që kanë certifikatën e sigurisë për t'u njohur me dokumentet e pazbuluara në dosjen e tij). Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N.1, Prot. nr. 7 KEDNJ (Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve).

Fakte: Kërkuesi ishte shtetas bjellorus, i cili u transferua në Poloni në vitin 2006, ku mori leje qëndrimi të përhershme për shkak të origjinës së tij polake. Ai u vendos aty, gjeti punë dhe bleu një apartament. Në janar 2012, inteligjenca polake kërkoi dëbimin e kërkuesit për arsye të sigurisë kombëtare. Autoritetet polake pretenduan se ai kishte bashkëpunuar me shërbimet sekrete bjelloruse që nga viti 2000 dhe se në atë cilësi kishte kryer detyra në territorin polak. Kërkuesi u njoftua për fillimin e procedurës për heqjen e lejes së qëndrimit të përhershëm dhe për dëbimin. Në shkurt, autoritetet polake klasifikuan disa dokumente në dosje si dokumente sekrete. Në mars iu hoq leja e qëndrimit dhe u mor vendimi për dëbimin e tij. Kërkuesi u dëbua disa ditë më vonë dhe iu ndalua hyrja në zonën Shengen për pesë vjet.

Në prill, ai paraqiti një ankim dhe avokati i tij pa sukses kërkoi të njihet me pjesën e klasifikuar të dosjes së tij. Të gjitha vendimet e mëvonshme lënë në fuqi urdhrin e dëbimit për shkak të çështjeve të sigurisë kombëtare. Veçanërisht, një nga këto vendime konstatoi gjithashtu se kërkuesi mund të kishte marrë pjesë në proces, sepse ai ishte njoftuar dhe i ishte dhënë mundësia për të paraqitur argumente dhe prova. Për më tepër, ai kishte konsultuar dosjen e çështjes në shkurt 2012 (fakt për të cilin kërkuesi nuk ishte dakord) dhe kishte marrë informacion mbi natyrën e dyshimeve të ngritura kundër tij.

Vendosji: Gjykata solli në kujtesë parimet e përgjithshme për dëbimin e të huajve sipas N. 1, Prot. nr. 7 (*Muhammad dhe Muhammed kundër Rumanisë*[DHM], Kërkesa nr. 80982/12, 15 tetor 2020). Veçanërisht, i huaji duhet të informohet për elementet përkatëse faktike dhe të njihet me dokumentet dhe informacionet e dosjes së çështjes. Edhe në rast të kufizimeve të së drejtës sipas N. 1, Prot. nr. 7, Gjykata duhet të vlerësojë nëse këto kufizime janë gjetur të justifikuar plotësisht nga autoriteti kompetent i pavarur dhe nëse vështirësitë që rezultojnë nga këto kufizime për të huajin në fjalë janë kompensuar mjaftueshëm nga faktorë kundërpeshues, në mënyrë që të shmanget dëmtimi i thelbit të garancive procedurale sipas N.1, Prot nr. 7.

Në çështjen në fjalë, vendimi për klasifikimin e dokumenteve të caktuara si sekrete dhe pamundësia e kërkuarit dhe avokatit të tij për t'u njohur me ato, përbëjnë kufizim domethënës të së drejtës sipas N. 1, Prot. nr. 7. Për më tepër, palët nuk ranë dakord nëse kërkuari kishte konsultuar dosjen e çështjes në shkurt 2012.

Gjykata vlerësoi nëse ekzistonin faktorët kundërpeshues për të zbutur në mënyrë efektive këto kufizime. Së pari, kërkuari u njoftua për fillimin e procesit përkatës, por sjellja e tij u përshkrua në terma shumë të përgjithshme (bashkëpunim me shërbimet sekrete bjelloruse) pa përmendur asnjë aktivitet specifik që pretendohet të ishte kryer dhe që mund të kërcënonte sigurinë kombëtare.

Së dyti, dëbimi i menjëhershëm i kërkuarit pati ndikim në aftësinë e tij për të marrë pjesë efektivisht në proces, duke marrë gjithashtu parasysh refuzimin për t'i dhënë avokatit të tij të drejtën për t'u njohur me dokumentet në dosjen e çështjes me arsyetimin se avokatit i mungonte certifikata e kërkuar e sigurisë. Për më tepër, kërkuarit nuk iu dha asnjë informacion i mëtejshëm se si të njihet me dokumentet në dosje ose një listë me emrat e avokatëve që kishin certifikatën përkatëse të sigurisë. Prandaj, përfaqësimi ligjor i kërkuarit nuk ishte mjaftueshëm efektiv për kundërpeshë, në një mënyrë të konsiderueshme, të kufizimeve që preknin kërkuarin në ushtrimin e të drejtave të tij procedurale.

Së treti, edhe nëse urdhri i dëbimit do t'i nënshtrohej rishikimit gjyqësor, kjo nuk mjaftonte për të kundërpeshuar kufizimet që kërkuari kishte në ushtrimin e të drejtave të tij procedurale. Kjo ishte për shkak të informacionit të pakët dhe jospecifik në dispozicion të kërkuarit në ato procese gjyqësore, krahas arsyeve shumë të përgjithshme për përfundimet e gjykatave të brendshme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Polonia ka shkelur N. 1, Prot. nr. 7, meqenëse kufizimet e vendosura për gëzimin e të drejtave të kërkuesit nuk ishin kundërpeshuar në proceset gjyqësore të brendshme për të ruajtur vetë thelbin e tyre.

D. FOKUS I VEÇANTË: PROCESET GJYQËSORE QË PËRFSHIJNË TË DREJTAT E GJYQARËVE

Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë, Kërkesa nr.29943/18, Vendimi gjyqësor i datës 4 prill 2023

Një periudhë e gjatë pezullimi nga detyra mund të ketë ndikim negativ të rëndë në të drejtën e personit për jetë private dhe mund të përbëjë ndërhyrje në këto të drejta. Pezullimi i vazhduar pa bazë ligjore përbën *shkelje të nenit 8 KEDNJ (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)*.

Fakte: Kërkuesit janë dy shtetas shqiptarë, të cilët në atë kohë ishin të martuar dhe punonin si prokurorë. Në vitin 2013, kërkuesja e parë u promovua në pozicionin e Shefes së Njësisë së Dekriminalizimit dhe punoi, ndër të tjera, për çështje të profilit të lartë që përfshinin politikanë. Nga janari 2018, kërkuesi i dytë punonte si prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në përputhje me legjislacionin kombëtar, kërkuesit dorëzuan në zyrën kompetente deklaratat vjetore të pasurisë.

Në vitin 2016, Shqipëria filloi një reformë gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë rivlerësimin e të gjithë prokurorëve në detyrë ("procesi i vetingut"). Në janar 2017, në kuadër të procesit të vetingut, kërkuesja e parë dorëzoi një deklaratë të re dhe të plotë të pasurisë, e cila përfshinte pasurinë e kërkuesit të dytë dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Pas një vlerësimi negativ të deklaratës së saj të pasurisë, kërkuesja e parë iu përgjigj një pyetësori vijues. Në vitin 2018, kërkuesja e parë u pushua nga detyra dhe u pezullua *ex lege* nga detyrat e saj në pritje të vendimit në apel, i cili konfirmoi vendimin e shkarkimit në vitin 2019. Kërkuesi i dytë iu nënshtrua procesit të vetingut në vitin 2020 dhe 2021.

Në maj 2018, pas akuzave të bëra në disa media online, kërkuesit u akuzuan për veprat penale të refuzimit të dhënies, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimit të rremë të pasurisë në lidhje me deklaratimet periodike të pasurisë dhe në kuadër të procesit të verifikimit në lidhje me kërkuesen e parë. Për rrjedhojë, kërkuesit u pezulluan nga detyra e tyre si prokurorë në pritje të procedimit penal kundër tyre. Urdhrat e pezullimit bazoheshin në cilësimin

e veprës për të cilën ata akuzoheshin si “krim i rëndë” sipas kuptimit të ligjit kombëtar të vitit 2016, i cili përshkruan kushtet e pezullimit të detyrueshëm. Pas ankimit nga kërkuesit kundër urdhrave të pezullimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit (“KPA”) i informoi se nuk mund të merre një vendim në këtë drejtim, sepse një anëtar (I.R.) ishte tërhequr për shkak të konfliktit të interesit dhe, për shkak të mungesës së një rregulloreje specifike në atë kohë, ai nuk mund të zëvendësohej. Në qershor 2018, trupi gjyqësor i KPA-së (përfshirë I.R.) nuk e shqyrtoi ankesën dhe u shpreh se Gjykata Administrative e Apelit ishte organi përgjegjës për shqyrtimin e urdhrave të pezullimit. Në qershor 2018, kërkuesit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut.

Pas ankimit nga kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit rrëzoi kërkesën e kërkuesve për të pezulluar ekzekutimin e këtyre urdhrave me një vendim të ndërmjetëm.

Në nëntor 2018, e njëjta gjykatë i shpalli të paligjshme urdhrat e pezullimit dhe i prishi ato, për shkak të cilësimit të gabuar të veprave përkatëse si “krime të rënda” sipas legjislacionit të brendshëm të vitit 2016. Ky vendim nuk specifikoi nëse bëhej menjëherë i ekzekutueshëm, dhe, për rrjedhojë, kërkuesit nuk u rikthyen menjëherë në detyrë. Sipas kërkuesve, vendimi ishte menjëherë i ekzekutueshëm, edhe pse ishte i ankimueshëm në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë. Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm kërkoi rishikim për çështjet ligjore në Gjykatën e Lartë. Ankimi ishte ende në pritje në datën e miratimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në vitin 2019, një zyrë tjetër mori përsipër hetimin penal ndaj kërkuesve dhe kërkoi ndërprerjen e hetimit, i cili u lejua me një vendim gjyqësor të formës së prerë në të njëjtin vit. Vendimi i ndërprerjes u bazua në pamundësinë e përdorimit të vlerësimit të deklaratës për veting të kërkueses së parë si provë në çdo proces gjyqësor tjetër ndaj saj në pritje të procesit të vetingut.

Kërkuesi i dytë u rikthye në detyrë vetëm në janar 2020, me kërkesë të tij dhe pas disa hapave procedurale. Si kërkuesja e parë ashtu edhe kërkuesi i dyti vazhduan të paguheshin gjatë gjithë periudhës së pezullimit të tyre.

Nga marsi 2018, duke filluar me Alpenews (një portal lajmesh online), u publikuan disa artikuj mbi çështjen e kërkuesve. Kërkuesit u ankuar se artikujt bazoheshin në dokumente të nxjerra pa pëlqimin e tyre dhe të cilat i ishin dhënë kërkueses së parë në kuadër të proceseve të vetingut. Akuza u hodh poshtë nga organet e vetingut gjatë hetimit pasues.

Vendosj: Ankesat e kërkuesve në lidhje me të drejtën për proces gjyqësor të drejtë sipas N. 6(1) KEDNJ ishin të papranueshme. Konkretisht, për sa i përket mungesës së pretenduar të paanshmërisë dhe pavarësisë së KPA-së si institucion, Gjykata iu referua parimeve të përcaktuara në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore (shihni *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 15227/19, 9 shkurt 2021) dhe doli në përfundimin se ankesa ishte qartazi e pabazuar dhe duhej të refuzohej në përputhje me N.35(3) (a) dhe (4) KEDNJ.

Sa i përket mungesës së paanshmërisë dhe pavarësisë së përbërjes së trupit gjykues të KPA-së në çështjen e kërkuesve, proceset kishin të bënin vetëm me një çështje juridiksioni dhe kërkuesit nuk kishin pësuar dëm të konsiderueshëm (pasi ata morën një vendim të favorshëm para Gjykatës Administrative të Apelit). Kështu, kjo ankesë u refuzua në përputhje me N. 35(3) (b) dhe (4) KEDNJ.

Në lidhje me ankesat e kërkuesve për të drejtën e jetës private sipas N.8 KEDNJ për shkak të pezullimit të tyre nga detyra, Gjykata theksoi se çështjet për mosmarrëveshjet e punës përfshihen nën N. 8 KEDNJ në aspektin e tij të “jetës private” kur masat e pafavorshme kanë një ndikim negativ të rëndë në jetën private (shihni *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], Kërkesa nr. 76639/11, 25 shtator 2018).

Në çështjen në fjalë, Gjykata vuri në dukje se urdhrat e pezullimit të vitit 2018 në lidhje me kërkuesit i penguan menjëherë nga ushtrimi i funksioneve të tyre zyrtare. Në të njëjtin vit, Gjykata Administrative e Apelit prishi urdhrat e pezullimit. Sa i përket kërkueses së parë, ajo u ndalua të ushtronte detyrën e saj si prokurore për dy muaj e gjysmë; ajo vazhdoi të paguhej gjatë kësaj periudhe. Kërkuesja e parë nuk tregoi që pasojat e këtij pezullimi kaq të shkurtër në kohë kishin qenë aq të rënda sa të përfshiheshin në objektin e N. 8 KEDNJ. Çdo ndikim tjetër negativ (p.sh., në reputacion) ishte kryesisht për shkak të akuzave penale dhe jo për shkak të pezullimit *ex lege*.

Nisur nga sa më sipër, ankesa e kërkueses së parë është e papajtueshme *ratione materiae* me N. 8 KEDNJ dhe duhet të refuzohet në përputhje me N.35(4) KEDNJ.

Sa i përket kërkuesit të dytë, pezullimi i tij zgjati gati dy vjet: pavarësisht vendimit favorizues të nëntorit 2018, ai u rikthye në detyrë në fund të janarit 2020. Gjatë kësaj periudhe, atij i ishte hequr mundësia për të rifilluar punën e tij dhe për të jetuar në një mjedis profesional ku mund të ndiqte qëllimet e tij të zhvillimit profesional dhe personal. Vonesa e zgjatur në zbatimin e vendimit në favor të tij duhet të ketë shtuar pasigurinë e pozicionit të tij. Ai ka treguar se ka pësuar pasoja negative të rënda dhe ankimi i tij përfshihet në N. 8 KEDNJ.

Pezellimi i kërkuesit të dytë nga detyrat e tij përbën ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private sipas N.8 KEDNJ. Nga vendimi i pushimit në prill 2019 deri në rikthimin e tij në detyrë në janar 2020, pezullimi i vazhdueshëm i kërkuesit të dytë nuk kishte bazë ligjore, sepse ndaj tij nuk kishte më hetim penal në proces. Pra, ndërhyrja në të drejtën e tij për jetën private nuk ishte në përputhje me ligjin dhe përbënte shkelje të N. 8 KEDNJ.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 8 të Konventës për shkak të pezullimit të vazhdueshëm të kërkuesit të dytë pa bazë ligjore.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të N.8 KEDNJ për nxjerrjen e dokumenteve në media, Gjykata vërejtë se artikulli i Alpenews nuk përmbante asnjë nxjerrje dokumenti ose materiali në lidhje me kërkuesen e parë, as ndonjë informacion sensitiv në lidhje me atë ose pasuritë e saj. Prandaj, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje nga Shteti për aksesin të paautorizuar – dhe/ose nxjerrje ose transmetim të paligjshëm të – ndonjë dokumenti konfidencial specifik të paraqitur ose marrë gjatë procesit të vetingut. Prandaj, ankesa e kërkueses të parë ishte e papajtueshme *ratione personae* me N.8 KEDNJ dhe duhet të refuzohej në përputhje me nenin 35(4) KEDNJ. Për sa i përket nxjerrjes së çdo dokumenti shtesë në media dhe një fushate mediatike ndërmjet marsit dhe korrikut 2018, kërkuesit nuk detajuan apo provuan pretendimet e tyre, të cilat gjithashtu ishin paraqitur jashtë afatit dhe, për rrjedhojë, kjo ankesë u refuzua në përputhje me nenin 35(1) dhe (4) KEDNJ.

Ovcharenko dhe Kolos kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 27276/15 dhe 33692/15, Vendimi gjyqësor i datës 12 janar 2023

Vendimi i Parlamentit për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues për “shkelje të betimit” ka ndikim në jetën e tyre private (p.sh., humbje monetare dhe pasoja negative për reputacionin e tyre). Për të qenë legjitim, ai duhet të bazohet në shkaqe ligjore të parashikueshme, duke përfshirë një interpretim të qartë të “shkeljes së betimit” sipas legjislacionit kombëtar, krahas një përkufizimi të qartë të fushës së zbatimit të imunitetit funksional të gjyqtarëve. Mosrespektimi i këtyre kushteve përbën *shkelje të N. 8 KEDNJ (E drejta për respektimin e jetës private)*.

Gjykatat kombëtare duhet të japin arsye të mjaftueshme që mbështesin pajtueshmërinë e vendimit të Parlamentit për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues për “shkelje të betimit” me garancitë kushtetuese të pavarësisë së gjyqësorit. Mosdhënia e arsyeve të mjaftueshme përbën *shkelje të N. 6(1) KEDNJ (E drejta për t’ju drejtuar gjykatës, E drejta për një vendim të arsyetuar)*.

Fakte: Në vitin 2006, kërkuesit u emëruan gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në vitin 2010, Yanukovych u bë President i Ukrainës. Në të njëjtin vit, kërkuesit morën pjesë në një vendim gjyqësor që riktheu një version të mëparshëm të Kushtetutës, që rezultoi në mënyrë thelbësore në një rritje të kompetencave të Presidentit të Ukrainës. Pas protestave masive të vitit 2014 (të njohura si Revolucioni Ukrainas i Dinjitetit) dhe rrëzimit të z.Yanukovych, sistemi politik i Ukrainës përjetoi një sërë ndryshimesh.

Në shkurt të vitit 2014, Kuvendi miratoi një rezolutë për shkarkimin, për "shkelje të betimit", e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese që ishin emëruar nga kuota e Kuvendit, përfshirë edhe kërkuesit. Veçanërisht, sipas Kuvendit, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese që kishin miratuar vendimin gjyqësor të vitit 2010 kishin dështuar në përbushjen e detyrimit të tyre për të garantuar supremacinë e Kushtetutës dhe për të mbrojtur sistemin kushtetues dhe të drejtat kushtetuese të qytetarëve, dhe këto dështime nuk kishin qenë në pajtim me betimin gjyqësor dhe përbushjen e detyrave me ndershmëri e rigorozitet nga një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Në mars të të njëjtit vit, kërkuesit dorëzuan deklaratat e dorëheqjes, me dëshirën për të ndërprerë detyrën me vullnet të lirë dhe jo me sanksion të vendosur nga Parlamenti. Ata gjithashtu kundërshtuan pa sukses rezolutën përkatëse parlamentare para gjykatave të brendshme. Gjykata e Lartë u shpreh, veçanërisht, se, me vendimin gjyqësor të kundërshtuar të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese kishte ndryshuar Kushtetutën, ndërsa kompetenca për ta bërë këtë i ishte dhënë Parlamentit; kishte shkelur kështu parimet themelore të demokracisë, ndarjes së pushteteve dhe legjitimitetit të institucioneve vepruese të pushtetit të Shtetit.

Vendosi: Për çështjen sipas N. 8 KEDNJ, Gjykata vlerësoi se shkarkimi i kërkuesve kishte një ndikim të rëndë në rrethin e tyre të ngushtë, duke pasur parasysh humbjet monetare që pasuan, dhe në reputacionin e tyre, duke pasur parasysh se arsyet e shkarkimit – "shkelja e betimit" – kishin të bënin drejtpërdrejt me integritetin e tyre personal dhe kompetencën profesionale. Kështu, masa e kundërshtuar ndikoi në një shkallë shumë të konsiderueshme jetën private të kërkuesve, duke u përfshirë kështu në objektin e N. 8 KEDNJ dhe shkarkimi i tyre përbënte ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur sipas kësaj dispozite.

Gjykata vendosi se kjo ndërhyrje ishte e pajustificuar, pasi ishte e paligjshme për shkak të mungesës së parashikueshmërisë (shihni gjithashtu *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 21722/11, 9 janar 2013, për çështjen e

shkarkimit të gjyqtarëve për “shkelje e betimit”). Vendimi për shkarkimin e kërkuesve për “shkelje të betimit” bazohej në shkaqe ligjore shumë të përgjithshme që, nëse nuk kufizoheshin nga dispozita të tjera në fuqi dhe praktika gjyqësore, u jepnin diskrecion të gjerë autoriteteve vendore. Për më tepër, ligji i Ukrainës përcakton imunitetin funksional për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duke deklaruar, në veçanti, se ata nuk do të mbahen ligjërisht përgjegjës për rezultatet e votave të tyre në atë gjykatë. Megjithatë, në çështjen në fjalë, kërkuesit u shkarkuan pikërisht për rezultatet e votave të tyre të shprehura në vendimin e vitit 2010. Për më tepër, standardet ndërkombëtare dhe anketa e së drejtës krahasuese treguan një prirje të qartë drejt një kuptimi të përbashkët që shkaqet për sanksionimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë veçanërisht të rrepta dhe të ngushta për të shmangur pengimin e pavarësisë së gjyqësorit (shihni p.sh., Komisioni i Venecias, përmbledhja Amicus Curiae për përgjegjësinë penale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Opinioni 967/2019, 22 nëntor 2019).

Përveç kësaj, vendimi i vitit 2010 kishte të bënte me një çështje ligjore komplekse që kishte qenë një çështje debati serioz brenda dhe jashtë Ukrainës: në këtë kontekst, Parlamenti duhej të bënte kujdes të veçantë dhe të jepte argumente të forta nëse konsiderohet se vota e kërkuesve në miratimin e vendimit të vitit 2010 përbënte “shkelje të betimit”. Në fund, nuk është treguar që Parlamenti duhej të vepronte me urgjencë ekstreme në lidhje me shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues (përfshirë kërkuesit) për “shkelje të betimit”.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Ukraina ka shkelur N. 8 KEDNJ për shkak të mungesës së qartësisë në pyetjen se çfarë përbën “shkelje të betimit” dhe mungesës së arsyeve të detajuara në lidhje me shkarkimin e kërkuesit. Këto elementë çuan në një situatë pasigurie juridike, e cila është në kundërshtim me kërkesën e parashikueshmërisë dhe rrjedhimisht, të ligjshmërisë për qëllimin e kufizimeve legjitime të së drejtës për jetën private.

Për çështjen sipas N. 6(1) KEDNJ, Gjykata vuri në dukje se ajo çështje kishte të bënte me përgjegjësinë e dy gjyqtarëve para një organi politik që ushtronte fuqi vendimmarrëse përfundimtare. Në këtë kontekst, shqyrtimi i mëvonshëm nga një organ gjyqësor që dha garancitë e nenit 6(1) të KEDNJ-së ishte me rëndësi vendimtare për vlerësimin e pajtueshmërisë së procedurave të brendshme me atë dispozitë. Në rastin në fjalë, gjykatat e brendshme nuk arritën të kryenin një vlerësim të tillë. Veçanërisht, gjykatat e brendshme nuk dhanë një përgjigje të detajuar për pyetjen nëse shkarkimi

i kërkuessve ishte në përputhje me garancitë kushtetuese të pavarësisë së gjyqësorit, duke përfshirë pyetjen e imunitetit funksional.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Ukraina ka shkelur N. 6(1) KEDNJ sepse vendimet e nxjerra nga gjykatat kombëtare nuk ishin mjaftueshëm të arsyetuara.

Sarisu Pehlivan kundër Turqisë, Kërkesa nr. 63029/19, Vendimi gjyqësor i datës 6 qershor 2023

Sanksionet disiplinore ndaj gjyqtarëve që shprehin mendimin e tyre për reformat kushtetuese (p.sh., në një intervistë në gazetë) që prekin gjyqësorin, përbëjnë ndërhyrje në lirinë e tyre të shprehjes. Autoritetet kombëtare nuk mund të vendosin sanksione të tilla disiplinore kur gjyqtarët veprojnë në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm të sindikatës së gjyqtarëve, nëse deklaratat e tyre theksojnë rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit dhe nëse nuk ka garanci procedurale për të kundërshtuar sanksionet disiplinore. Një sjellje e ndryshme përbën *shkelje të N. 10 KEDNJ (Liria e shprehjes)*.

Fakte: Kërkuessa ishte shtetase turke e cili, në kohën përkatëse, ishte gjyqtare dhe gjithashtu sekretare e përgjithshme e një sindikate gjyqtarësh, një organizatë e themeluar në vitin 2016 dhe që synonte të promovonte sundimin e ligjit dhe të mbështeste pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Në janar 2017, Kushtetuta turke u ndryshua. Veçanërisht, u bënë ndryshime të rëndësishme në organizimin e gjyqësorit. Në shkurt 2017, një gazetë e përditshme kombëtare publikoi një intervistë me kërkuessen, në botimin e saj në shtyp dhe në faqen e saj të internetit, në lidhje me reformën kushtetuese të gjyqësorit.

Pak ditë më vonë, Këshilli i Lartë i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dërgoi te një inspektor për shqyrtim një letër ankese në lidhje me intervistën. Në qershor 2017, në përputhje me rekomandimin e inspektorit, Këshilli i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (KGJP), siç u bë e ditur pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese në prill 2017, lëshoi autorizimin për të hetuar në lidhje me kërkuessen. Në shtator 2018, KGJP-ja nxori një vërejtje ndaj kërkuesses dhe, më pas, vendosi të ulë masën dhe vendosi heqje të pagës për dy ditë pune. Në vitin 2019, KGJP refuzoi kërkesat e kërkuesses për rishikim, të cilat bazoheshin veçanërisht në lirinë e organizimit dhe të shprehjes që gëzonin gjyqtarët.

Vendosji: Ankesa e kërkueses sipas N. 10 KEDNJ ngre pyetje me rëndësi të përgjithshme, dhe në veçanti nëse një anëtar i gjyqësorit që përfaqëson kolegët e tij mund të mbështetet në të drejtën e lirisë së shprehjes për të kritikuar publikisht ndryshimet kushtetuese, të cilat kanë implikime gjyqësore dhe politike, dhe në çfarë kushtesh sanksionet e vendosura në përgjigje të këtij veprimi mund të konsiderohen si të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Në rastin në fjalë, vendosja e një sanksioni disiplinor përbënte ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes së kërkueses. Ndërhyrja kishte bazë ligjore në të drejtën e brendshme, pra ishte “e parashikuar me ligj”, dhe masa ndiqte qëllimin legjitim të garantimit të autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Në vlerësimin nëse masa ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata mori parasysh dy elementë.

Së pari, ajo vuri në dukje se, kur ajo i kishte bërë deklaratat në fjalë, kërkuesja kishte qenë gjyqtare dhe sekretare e përgjithshme e një sindikate gjyqtarësh dhe se ajo ishte intervistuar në këtë cilësi. Prandaj, duke pasur parasysh rolin e asaj sindikate dhe të kërkueses në të, ajo kishte të drejtën dhe detyrën të shprehte një opinion mbi pyetjet në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë (shihni gjithashtu p.sh., CCEJ, Opinioni 25 mbi lirinë e shprehjes së gjyqtarëve, 2 dhjetor 2022).

Së dyti, Gjykata shqyrtoi përmbajtjen e komentit të kërkueses. Deklaratat e saj kishin të bënin me ndikimin e reformës kushtetuese në pavarësinë e gjyqësorit *vis-à-vis* ekzekutivit dhe kishin theksuar – *inter alia* – rëndësinë e ruajtjes së kësaj pavarësie (për çështje të ngjashme, shihni gjithashtu Komisionin e Venecias, Turqi - Opinion mbi ndryshimet në Kushtetutë të miratuara nga Asambleja e Madhe Kombëtare më 21 janar 2017 dhe që do t'i nënshtrohen Referendumit Kombëtar më 16 prill 2017, mars 2017, CDL-AD(2017)005-e). Prandaj, komentet e saj ishin pjesë e një debati mbi çështjet me interes publik dhe garantonin një nivel të lartë mbrojtjeje sipas N.10 KEDNJ. Në këtë drejtim, Gjykata pranoi se implikimet politike të deklaratave të kërkueses nuk ishin të mjaftueshme në vetvete për të justifikuar kufizimin e lirisë së saj të shprehjes si sekretare e përgjithshme e sindikatës së gjyqtarëve në një fushë që prek thelbin e profesionit të saj. Për më tepër, edhe nëse sanksioni i vendosur ndaj kërkueses mund të konsiderohej si relativisht i lehtë, vendosja e tij kishte një efekt frenues mbi kërkuesen dhe anëtarët e tjerë të gjyqësorit.

Për sa i përket aspektit procedural, asnjë nga vendimet e miratuara nga KGJP nuk tregoi që e drejta e kërkueses për lirinë e shprehjes kishte më shumë

peshe se detyra e saj për diskrecion dhe kufizim si gjyqtare, dhe këto vendime as nuk kishin specifikuar se cilat pjesë ose shprehje specifike në intervistën e diskutuar konsideroheshin se dëmtonin imazhin e gjyqësorit dhe ish-in politikisht të njëanshme. Prandaj, Gjykata vlerësoi se autoritetet kombëtare nuk kishin dhënë arsye të mjaftueshme për të justifikuar sanksionin e kundërshtuar. Në fund, çdo gjyqtar i cili është subjekt i procedimeve disiplinore ka të drejtën e mbrojtjes kundër arbitraritetit, dhe veçanërisht një mundësi që masa në fjalë të shqyrtohet nga një organ i pavarur dhe i paanshëm, kompetent për të censuruar çdo abuzim nga autoritetet. Kjo nuk kishte qenë situata në fjalë, sepse KGJP-ja kishte vepruar edhe si autoritet procedues edhe si autoritet vendimmarrës përfundimtar në një çështje në lidhje me komentimin e deklaratave mbi përbërjen, funksionimin, pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Për më tepër, kërkesja nuk kishte pasur asnjë mjet juridik në lidhje me masën e marrë ndaj saj nga KGJP-ja.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Turqia ka shkelur N. 10 KEDNJ, sepse masa disiplinore e vendosur ndaj kërkuesses nuk kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Pajqk dhe të tjerët kundër Polonisë, Kërkesat Nr. 25226/18 dhe 3 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 24 tetor 2023

Nëse ekzekutivi ka kompetencë të nxjerrë vendime të njëanshme për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të gjyqtarëve, personat në fjalë duhet të kenë akses në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme për të shqyrtuar këto vendime të njëanshme. Mungesa e mjeteve gjyqësore për të kundërshtuar vendime të ngjashme të njëanshme përbën ndërhyrje arbitrare dhe të parregullt në sferën e pavarësisë dhe të palëvizshmërisë së gjyqtarëve, duke sjellë *shkelje të N. 6(1) KEDNJ (E drejta për t'ju drejtuar një gjykate)*.

Autoritetet kombëtare nuk mund të autorizojnë daljen në pension të gjyqtareve femra pesë vjet më herët se gjyqtarët meshkuj në të njëjtën situatë, sepse profesioni është me natyrë intelektuale dhe dallimet biologjike mes burrave dhe grave, ose çdo konsideratë e mundshme për rolin e gruas në shoqëri, janë të parëndësishme. për aftësinë e secilit seks për t'u angazhuar në profesione të kësaj natyre. Për më tepër, pensioni i detyrueshëm i gjyqtareve femra ka një ndikim të rëndë në gjendjen e mëparshme financiare, karrierën, mundësitë për zhvillim personal dhe profesional, reputacionin profesional dhe social – *Shkelje e N. 14 (+ N.8) KEDNJ (Ndalimi i diskriminimit për shkak të seksit dhe gjinisë vis-à-vis të drejtës për respektimin e jetës private)*.

Fakte: Në vitin 2017 dhe 2018, një sërë ndryshimesh legislative ulën moshën e pensionit për gjyqtarët nga 67 në 60 për gratë dhe në 65 për burrat dhe e kushtëzuan vazhdimin e detyrës së gjyqarit pas arritjes së moshës së pensionit me autorizimin e ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit ("KKGJ").

Në kohën përkatëse, kërkueset, të cilat ishin gjyqtare, kishin mbushur të gjitha moshën 60 vjeç. Duke dashur të vazhdonin të mbanin funksionet e tyre deri në moshën 70 vjeç, ato kërkuan autorizimin për këtë qëllim. Tre kërkuese i bashkëngjitën gjithashtu certifikatat mjekësore që vërtetonin se gjendja e tyre shëndetësore i lejonte të kryenin detyrën; kërkuesja e katërt refuzoi të dorëzonte një certifikatë të tillë mjekësore me arsyetimin se gjyqtarët meshkuj nuk ishin të detyruar ta bënin këtë në rrethana të ngjashme dhe se ky detyrim ishte për rrjedhojë diskriminues. Ministri i Drejtësisë refuzoi të gjitha kërkesat e tyre. Një nga kërkueset paraqiti kërkesë në KKGJ, por pa sukses. E njëjta kërkuese kundërshtoi vendimin e ministrit përpara Gjykatës së Lartë duke argumentuar – *inter alia* – se legjislacioni në fjalë ishte diskriminues për shkak të seksit dhe moshës. Gjykata e Lartë e shpalli kërkesën e saj të papranueshme.

Vendosi: Gjykata duhej të vlerësonte: (a) nëse N. 6(1) KEDNJ ishte i zbatueshëm për rastin; (b) nëse Polonia kishte shkelur një dispozitë të tillë.

Sa i përket çështjes së parë (a), supozohet se N.6 zbatohet për mosmarrëveshjet e zakonshme të punës (p.sh. ato mbi pagat, shtesat ose të drejtat e ngjashme) në lidhje me shërbimin publik (*Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* [DHM], Kërkesa nr. 63235/00, 19 prill 2007). Ky supozim vlen për mosmarrëveshjet në lidhje me gjyqtarët: megjithëse gjyqësori nuk është pjesë e shërbimit civil të zakonshëm, ai konsiderohet pjesë e shërbimit publik në kuptimin e gjerë (*Baka kundër Hungarisë* [DHM], Kërkesa nr. 20261/12, 23 qershor 2016).

Në çështjen në fjalë, Gjykata doli në përfundimin se kërkueset kishin një "të drejtë civile" sipas kuptimit të N.6(1) KEDNJ sepse – *inter alia* – mosmarrëveshjet në themel të çështjes përbëjnë shembuj të mosmarrëveshjeve të zakonshme të punës. Gjykata vlerësoi se gjyqtarët duhet të jenë në gjendje të gëzojnë mbrojtje kundër arbitraritetit të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv dhe se vetëm një kontroll i ligjshmërisë së masës së kundërshtuar, të marrë nga një organ i pavarur gjyqësor, mund të sigurojë efektivitetin e kësaj mbrojtjeje. Qasja në gjykatë duhet të garantohet, si parim i përgjithshëm, kur ndërprerja e funksioneve të gjyqtarëve rezulton nga miratimi i rregullave të reja (shihni

gjithashtu p.sh., Komiteti i Ministrave, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 mbi pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, 2012 CCEJ, Magna Carta e Gjyqtarëve Europianë, 2010).

Nisur nga sa më sipër, N. 6(1) KEDNJ është i zbatueshëm për çështjen në fjalë dhe kërkueset kishin të drejtë që çështja e tyre të shqyrtohej nga “një gjykatë”, sipas kuptimit të kësaj dispozite.

Për sa i përket pikës së dytë (b), Gjykata konstaton se e drejta e kërkueseve për akses në gjykatë ishte kufizuar në mënyrë të paligjshme. Gjykata analizoi regjimin që rregullon vendimet e marra nga Ministri i Drejtësisë dhe KKGJ. Për sa i përket të parit, Gjykata vërejti se legjislacioni përkatës në fuqi në kohën konkrete nuk specifikonte nëse vendimi i ministrit ishte objekt ankimi dhe se në atë kohë nuk kishte ekzistuar një praktikë e brendshme që do t'i lejonte kërkueseve të kishin akses në gjykatë – siç tregohet nga përpjekjet e pasuksesshme të kërkueseve (shihni gjithashtu Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, *Komisioni kundër Polonisë*, Çështja C-619/18, 24 qershor 2019)

Në lidhje me vendimet e KKGJ-së, Gjykata vuri në dukje se ishte e paqartë nëse kërkueset mund të kishin bërë ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë, që, në çdo rast, nuk plotësonte kushtet e një “gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj” sipas N. 6(1) KEDNJ dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet si një “gjykatë” sipas kuptimit të kësaj dispozite.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se Polonia ka ndërhyri në të drejtën e kërkueseve për akses në gjykatë sipas N. 6(1) KEDNJ.

Gjykata trajtoi nëse kjo ndërhyrje ishte legjitime, veçanërisht nëse ajo ndiqte një qëllim legjitim dhe ishte proporcionale. Ndërsa Gjykata nuk e kundërshtoi qëllimin e pretenduar të ndjekur nga Qeveria (domethënë përmirësimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor), ajo konsideroi se dalja në pension e kërkueseve me detyrim nuk kishte përmbushur asnjë kërkesë themelore të drejtësisë procedurale – të tilla si p.sh., linja e arsyetimit të shkurtër dhe të gatshëm dhe mungesa e pavarësisë (shihni gjithashtu Komisioni i Venecias, Poloni - Opinion mbi Projekt-aktin që ndryshon Aktin për Këshillin Kombëtar të Gjyqësorit; për Projekt-aktin për ndryshimin e Ligjit për Gjykatën e Lartë, propozuar nga Presidenti i Polonisë, dhe për Ligjin për Organizimin e Gjykatave të Zakonshme, dhjetor 2017).

Vendimet e ministrit dhe të KKGJ-së përbënin ndërhyrje arbitrare dhe të parregullt në sferën e pavarësisë dhe të palëvizshmërisë së gjyqtarëve nga

përfaqësuesi i autoritetit ekzekutiv dhe organi në varësi të tij. Për më tepër, kuadri ligjor kombëtar nuk arriti t'i mbronte kërkueset nga kjo ndërhyrje e paligjshme. Në përfundim, Qeveria nuk dha arsye serioze për të justifikuar mungesën e jashtëzakonshme të shqyrtimit gjyqësor të një vendimi të njëanshëm në lidhje me përfundimin e parakohshëm të mandatit të gjyqtarëve nga përfaqësuesi i ekzekutivit dhe organi në varësi të tij.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Polonia ka shkelur N. 6(1) të Konventës sepse kishte cenuar të drejtën e kërkueseve për t'ju drejtuar gjykatës në thelbin e saj.

Gjykata vuri në dukje se rastet në lidhje me mosmarrëveshjet e punës përfshihen në N. 8 KEDNJ në aspektin e tij për "jetën private" kur humbja e vendit të punës ka ndikim negativ të rëndë në jetën private (shihni *Denisov kundër Ukrainës* [DHM], Kërkesa nr. 76639/11, 25 shtator 2018). Në çështjen në fjalë, Gjykata vendosi se masat e kundërshtuara kishin ndikim negativ të rëndë në jetën private të kërkueseve si rezultat: i) i humbjes së të ardhurave; ii) i pasojave në karrierën e tyre dhe mundësisë për zhvillim personal dhe profesional; iii) i pasojave në reputacionin e tyre profesional dhe social (p.sh. për shkak të mungesës së mundësive për të gjetur punë kur janë në pension), krahas ndjenjës së thellë të zhgënjimit për shkak të pamundësisë për të arritur një përmbushje të kënaqshme profesionale.

Gjykata vuri në dukje se legjislacioni kombëtar i kundërshtuar prezantonte qartë një dallim të pajustificuar në trajtim, për shkak të seksit, për sa i përket moshës së daljes në pension të gjyqtarëve, pra anëtarëve të të njëjtit profesion. Profesionet e kërkueseve kishin natyrë intelektuale dhe dallimet biologjike mes burrave dhe grave, dhe çdo konsideratë e mundshme për rolin e gruas në shoqëri, ishte e parëndësishme për aftësinë e secilit seks për t'u angazhuar në profesione të kësaj natyre; as Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë provë në lidhje me këtë. Për më tepër, është veçanërisht shqetësuese që vetëm gjyqtaret femra duhej të dëshmonin me anë të një certifikate mjekësore se ato ishin akoma të afta në aspektin intelektual për të vijuar detyrën. Gjykata konstaton se dallimi në trajtimin ndërmjet gjyqtarëve femra dhe gjyqtarëve meshkuj nuk mund të konsiderohej i justifikuar objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme në lidhje me N.14 KEDNJ.

Si rezultat i kombinimit të legjislacionit kombëtar dhe vendimeve të ministrisë dhe të KKGJ-së, jeta e punës aktive të kërkueseve kishte ndaluar pesë vjet më parë se ajo e gjyqtarëve meshkuj në situata të ngjashme; Kjo situatë rezultoi gjithashtu në humbjen e të ardhurave të kërkueseve në

krahasim me gjyqtarët meshkuj. Këto faktorë vunë në dukje se kërkueset pësuan një trajtim diskriminues në krahasim me gjyqtarët meshkuj, i cili kishte një ndikim të rëndë në jetën e tyre private sipas kuptimit të N.8 KEDNJ.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Polonia ka shkelur N. 14 KEDNJ, në lidhje me N. 8 KEDNJ, për shkak të diskriminimit të pajustificuar që pësoi kërkuesja në krahasim me gjyqtarët meshkuj në lidhje me jetën e saj private.

III. Proceset penale

A. HETIMET

Durdaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 63543/09 dhe 3 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 7 nëntor 2023

Në rastin e shpërthimi të një objekti të çmontimit të armëve që rezultoi me vdekje dhe lëndime të rënda trupore, autoritetet kombëtare duhet të kryejnë hetim adekuat për incidentin dhe të identifikojnë menjëherë përgjegjësit e tij (përfshirë deputetët, veprimet e të cilëve nuk mbulohen nga imuniteti). Për më tepër, viktimat dhe të afërmit duhet të kenë mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proceset penale (si në fazën e hetimit ashtu edhe në fazën e gjyqimit). *Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N. 2 KEDNJ (E drejta për jetën).*

Fakte: Në mars 2007, qeveria shqiptare miratoi një vendim që përcaktonte procedurën për çmontimin e armëve, makinerive dhe pajisjeve të çmilitarizuara dhe të vjetruara të forcave të armatosura. Ministria e Mbrojtjes nxori leje për eksportin e këtyre armëve të çmilitarizuara me qëllim shitjen e tyre për përdorim civil (si p.sh. për qëllime grumbullimi). Shoqërisë së Eksport-Importit Ushtarak ("MEICO", shoqëri e krijuar nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes) iu besua kryerja e procedurës së shitjes dhe lidhja e kontratave përkatëse.

Në prill, autoritetet shtetërore ndërtuan objektin e Gërdecit për procesin e çmontimit. Objekti i Gërdecit ndodhej në një pronë nën administrimin e MEICO-s, i cili më pas e vuri në dispozicion të Albademil shpk, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri, pa kontratë qiraje. MEICO u urdhërua të lidhë kontratë me Southern Ammunition Company (SAC), një shoqëri e themeluar në SHBA, dhe ndër të tjera, të respektojë zbatimin e procedurave standarde të sigurisë dhe masave të mbrojtjes nga zjarri të kontraktorit.

Më 15 mars 2008, në objektin e Gërdecit ndodhi një shpërthim masiv ("ngjarja e Gërdecit"). Njëzet e gjashtë njerëz vdiqën dhe rreth 300 u plagosën rëndë ose lehtë. Djali shtatë vjeçar i kërkuesve (Kërkesat nr. 3543/09 dhe 12720/14)

vdiq dhe kërkuesit e tjerë pësuan lëndime të rënda kërcënuese për jetën. Kështu filluan proceset penale, administrative dhe civile.

Gjatë hetimit penal janë kryer tri ekspertiza. Të tre raportet kanë përcaktuar shkakun më të mundshëm të aksidentit dhe kanë vënë në dukje disa dështime në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e objektit të Gërdecit dhe mungesën e masave adekuate të sigurisë (si p.sh. procedura të pasigurta; punëtorë të patrajnuar që përdorin automjete të cilat nuk ishin në përputhje me standardet e sigurisë). Një raport ekspertize mjekësore u kërkua gjithashtu në lidhje me lëndimet që kishin pësuar viktimat e incidentit. Hetimi në tërësi kishte rezultuar në ngritjen e akuzave kundër tridhjetë personave, duke përfshirë edhe ish-ministrin e mbrojtjes, z. F.M. Raportet e lartpërmendura kishin shërbyer si bazë për akuzat dhe ishin përdorur si provë në gjykimin kundër të akuzuarit.

Gjykata e Lartë kishte veçuar proceset penale kundër z. F.M nga ato kundër të bashkë-akuzuarve të tjerë, duke pasur parasysh natyrën e ndryshme të akuzave ndaj këtij të fundit dhe natyrën e marrëveshjes së fshehtë mes tyre. Një nga kërkueset u ankua në Gjykatën Kushtetuese që ky veçim e kishte penguar atë të merrte pjesë në procesin penal. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin e saj, duke konstatuar se Gjykata e Lartë kishte vepruar në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Përfundimisht, në vitin 2009, imuniteti parlamentar i F.M. e pengoi ndjekjen penale kundër tij. Edhe pse që prej datës 26 tetor 2012, në vazhden e një ndryshimi në Kushtetutë, imuniteti parlamentar nuk ishte pengesë për institucionin apo vazhdimin e një hetimi penal ndaj një deputeti, prokurori nuk kishte ndjekur rihapjen e procesit penal kundër F.M deri në maj 2021.

Vendosi: Gjykata vlerësoi nëse gjykatat kombëtare kryen një hetim efektiv sipas kuptimit të N. 2 KEDNJ (aspekti procedural), në lidhje me fazën e hetimit (a) dhe fazën e gjykimin (b), dhe nëse kërkuesin morën pjesë në mënyrë efektive në të dyja fazat. Gjithashtu, Gjykata kishte për detyrë të shqyrtonte nëse (dhe në çfarë mase) gjykatat e brendshme, në arritjen e përfundimit të tyre, mund të konsideroheshin se ia kishin nënshtruar çështjen një shqyrtimi të kujdesshëm, në përputhje me efektin parandalues të sistemit gjyqësor *vis-a-vis* parandalimin e shkeljeve të së drejtës për jetën.

Gjykata kujtoi se një hetim penal efektiv është i nevojshëm për të përmbushur detyrimin procedural të vendosur nga N. 2 KEDNJ ku – ndër rrethana të tjera

– pati humbje jete ose vënie jete në rrezik për shkak të neglizhencës që i atribuohet zyrtarëve ose organeve shtetërore dhe për rrjedhojë shkon përtej një gabimi në gjykim ose pakujdesie. Në këto situata, fakti që ata që janë përgjegjës për vënien në rrezik të jetës nuk janë akuzuar për një vepër penale ose nuk janë ndjekur penalisht, mund të përbëjë shkelje të N. 2 KEDNJ. Në kontekstin e veçantë të aktiviteteve të rrezikshme, një hetim penal zyrtar është i domosdoshëm kur ka humbje jete si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur nën përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore (shihni *Öneryıldız kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 48939/99, 30 nëntor 2004, mbi vdekjet që rezultojnë nga një shpërthim aksidental në një vend mbeturinash pranë një lagjeje të varfër plot me banesa rudimentare të ndërtuara pa asnjë autorizim).

Për sa i përket fazës së hetimit në çështjen në shqyrtim (a), Gjykata vuri në dukje se Prokurori filloi hetimin *ex officio* në ditën e aksidentit dhe se ishin përgatitur tre raporte ekspertimi dhe një raport mjeko-ligjor. Hetimi në tërësi rezultoi me ngritjen e akuzave kundër njëzet e nëntë personave, përfshirë një ish-ministër të Mbrojtjes. Prandaj, hetimi ishte adekuat në faktin që përgjithësisht arriti të përcaktojë rrethanat e incidentit dhe identifikoi ata që ishin përgjegjës (shihni *Öneryıldız kundër Turqisë*, cituar më lart). Për sa i përket pjesëmarrjes efektive të kërkuesve, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit morën një kopje të dosjes së çështjes hetimore në fund të hetimit, i cili përfundoi brenda një viti nga ngjarja, dhe që kërkuesit nuk kanë theksuar ndonjë gabim apo mosveprim të veçantë nga ana e autoriteteve hetimore. Prandaj, hetimi ishte i shpejtë dhe kërkuesve iu dha akses në hetim në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime.

Për sa i përket fazës së gjykimit (b), Gjykata vuri në dukje se ndaj njëzet e nëntë të akuzuarve u shprehën akuzat në lidhje me ngjarjen e Gërdecit dhe se ata u gjykuan në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Njëzet e katër të akuzuar u shpallën fajtorë. Të gjitha dënimet e tyre i referoheshin në mënyrë specifike shkaktimit të vdekjes dhe plagosjes së disa personave. Kështu, dënimet e tyre kanë të bëjnë me akte të rrezikshme për jetën dhe me mbrojtjen e të drejtës për jetë sipas kuptimit të N. 2 KEDNJ (shihni *Öneryıldız kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 48939/99, 30 nëntor 2004, ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së edhe për shkak se dënimet nuk njihnin përgjegjësinë e organeve të Shtetit që nuk mbrojtën të drejtën për jetën). Dënimet me burg ndaj të akuzuarve kryesorë dhe koha që ata kishin kaluar në burg nuk ishin haptazi dhe në mënyrë disproporcionale të zbutura sa i përket rëndesës së veprave të kryera. Kështu, sistemi i së drejtës penale, siç u zbatua në çështjen në fjalë, kishte pasur një efekt mjaftueshëm frenues që arriti të siguronte

parandalimin efektiv të akteve të paligjshme siç janë ato për të cilat ankohen kërkuessit.

Për sa i përket pjesëmarrjes aktive të kërkuessve, Gjykata vëren se në vitin 2009 Gjykata e Lartë veçoi padinë civile të kërkuessve nga procesi penal që kishte filluar përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë. Që nga ai moment, ata nuk ishin më në dijeni për asnjë nga hapat e ndërmarrë në procesin penal. Sipas ligjit shqiptar të asaj kohe, një palë e dëmtuar që nuk kishte paraqitur padi civile gjatë procesit penal nuk kishte të drejtë të merrte pjesë aktive në një gjykim kundër të akuzuarit (p.sh., duke paraqitur prova, duke marrë në pyetje dëshmitarët ose të pandehurit, ose duke bërë komente mbi provat e mbledhura). Kështu, kërkuessit kishin mundësi ta ndiqnin gjykimin vetëm si anëtarë të publikut të gjerë (pasi seancat ishin të hapura për publikun), por ata nuk kishin një mundësi reale për të marrë pjesë aktive në gjykim. Gjithashtu, vendimet dhe vendimet përfundimtare të marra gjatë procesit penal nuk iu njoftuan kërkuessve dhe ata nuk kishin të drejtë ankimi kundër tyre. Prandaj, gjatë procesit penal, kërkuessit nuk kishin të drejta procedurale.

Mundësia e paraqitjes së një padie civile për dëmshpërblim nuk mund të kompensojë mungesën e mundësisë për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procesin penal (sidomos në fazën e gjykimit). Këto procese nuk shqyrtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit. Prandaj, Gjykata gjeti se kërkuessve nuk iu ishte dhënë mundësia e duhur për të marrë pjesë në gjykimin kundër të akuzuarve.

Gjykata trajtoi gjithashtu rrethanat që shoqëruan procesin penal kundër ish-ministrit të Mbrojtjes, z. F.M, që rezultuan në një boshllëk nëntëvjeçar për ndjekjen e tij penale. Autoritetet kombëtare të ndjekjes penale nuk kishin dhënë shpjegime bindëse. Prandaj, ndjekja e tij penale është ndikuar nga vonesa të konsiderueshme, inercia e organeve të ndjekjes penale dhe shumë përpjekje të kota të kërkuessve për ta vënë atë para drejtësisë. Procedimi penal ndaj tij për shpërdorim detyre (hetimi ndaj tij për akuzat e tjera ishte mbyllur) ishte ende në pritje, duke i lënë kërkuessit pa një konkluzion mbi përgjegjësinë e tij më shumë se katërbëdhjetë vjet pas ngjarjes së Gërdecit. Kërkuessit si dhe publiku i gjerë kishin të drejtë të dinin të vërtetën për rrethanat ku kishte ndodhur tragjedia e Gërdecit dhe rolin e saktë që kishte luajtur në të ish-ministri i Mbrojtjes.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 2 KEDNJ (aspekti procedural) për mospërfshirjen e kërkuessve në fazat e hetimit dhe gjykimin të procesit penal ndaj njëzet e nëntë të akuzuarve, si dhe për

mënyrën se si autoritetet kombëtare e kishin trajtuar ndjekjen penale të z. F.M.

Çupi kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 14 ,08/27187 nëntor 2023 [Komiteti]

Autoritetet kombëtare duhet të informojnë të dyshuarit për krime mbi të drejtën e tyre për avokat, të drejtën e tyre për të heshtur dhe privilegjin e tyre kundër vetë-fajësimit. Vetëm në këtë rrethanë, i dyshuari mund të konsiderohet se ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e tij për ndihmë juridike. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur i dyshuari është i ri, me arsim të kufizuar dhe pa përvojë profesionale. Çdo kufizim tjetër i të drejtës së të dyshuarit për avokat duhet të arsyetohet duke pasur parasysh rrethana bindëse. Dënimi i një të dyshuari kryesisht për shkak të deklaratave të bëra pa avokat gjatë fazës së hetimit/paraburgimit pengon drejtësinë e përgjithshme të procesit penal – *shkelje e N.6 (1) KEDNJ dhe N.6(3)(c) KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor të drejtë - E drejta për avokat).*

Fakte: Kërkuesi është shtetas shqiptar i lindur në vitin 1986. Në kohën e ngjarjes, ai kishte vetëm arsim të kufizuar dhe nuk kishte përvojë profesionale. Më 27 qershor 2004, ai u dorëzua, u mbajt në burg dhe deklaroi në polici si person i akuzuar për vrasje në rrethana rënduese të një të mituri dhe një punonjësi policie (të cilën dyshohet se e ka kryer me kushëririn e tij). Kërkuesi i bëri këto deklaratat në mungesë të avokatit. Ai u informua për të drejtën e tij për të mos dëshmuar kundër një personi me të cilin ishte i lidhur dhe për të drejtën e tij “për të dhënë ose jo shpjegime”. Në përgjigje, kërkuesi deklaroi se ai nuk kishte avokat dhe do t’i kërkonte babait të tij që të siguronte avokat më vonë. Disa ditë më vonë, edhe dy dëshmitarë të mitur dhanë deklaratimet në polici.

Pas akuzave formale për armëmbajtje pa leje dhe vrasje në rrethana rënduese të një të mituri dhe një punonjësi policie, gjykata penale dëgjoi dëshmitarët dhe përfshiu deklaratimet e dy dëshmitarëve të mitur në dosjen e çështjes. Kërkuesi i kërkoi gjykatës të përjashtonte nga dosja e çështjes deklaratimet e tij të datës 27 qershor 2004 të bëra në mungesë të avokatit. Gjykata e refuzoi kërkesën, duke konstatuar se ai kishte hequr dorë nga e drejta për avokat dhe e përfshiu deklaratimin e tij në dosjen e çështjes. Gjykata më tej pranoi një deklaratim nga kushëririn e kërkuesit. Kërkuesi mohoi akuzën e vrasjes dhe u shpreh që ajo duhej të ricilësohej në «moskallëzim krimi» dhe «mbështetje e autorit të krimit”. Në tetor 2005, gjykata penale e shpalli kërkuesin fajtor për bashkëpunim me kushëririn e tij (dhe jo për pjesëmarrje në vrasje) dhe e dënoi atë me njëzet e pesë vite burg.

Kërkuesi e ankimoi me pretendimin, ndër të tjera, se më 27 qershor 2004 ai ishte marrë në pyetje pa praninë e avokatit. Ankimi i tij u rrëzua me arsyetimin se ai kishte hequr dorë nga e drejta për avokat dhe se deklarimet e tij ishin shqyrtuar duke marrë parasysh edhe provat të tjera në dosjen e çështjes. Gjykata e Lartë konfirmoi vendimet e gjykatave më të ulëta. Kërkuesi paraqiti një ankim kushtetues, duke shtuar se, ai nuk kishte mjete të pamjaftueshme për të përballuar avokat dhe autoritetet duhet të kishin caktuar një avokat të financuar nga shteti për ta përfaqësuar atë. Në vitin 2007, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin, duke konstatuar se më 27 qershor 2004 kërkuesi nuk kishte kërkuar ndihmë juridike dhe se ai kishte pranuar të jepte shpjegime në mungesë të avokatit, duke hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike.

Vendosi: Sipas N. 6 KEDNJ, i dyshuari mund të heqë dorë nga e drejta e tij për avokat mbrojtës. Megjithatë, heqja dorë duhet të jetë në përputhje me standardin “e informimit dhe të të kuptuarit”: sipas këtij standardi, i dyshuari duhet të jetë i vetëdijshëm për të drejtën e tij për avokat, të drejtën e tij për të heshtur dhe privilegjin e tij kundër vetë-fajësimit (shihni *Simeonovi kundër Bullgarisë*. [DHM], Kërkesa nr.21980/04, 12 maj 2017).

Në këtë çështje, autoritetet kombëtare nuk i dhanë kërkuesit “letrën e të drejtave” (që përmban informacion në lidhje me të drejtën për të heshtur dhe për avokat) përpara marrjes së parë në pyetje. Kërkuesi ishte i informuar për të drejtat e tij, por ka dyshime nëse formulimi i deklarimeve (mbi të drejtat e tij “për të dhënë ose jo shpjegime”) ishte mjaftueshëm i qartë për të kuptuar se ai kishte të drejtë të heshtte në lidhje me akuzat ndaj tij. Kërkuesi u informua shkurtimisht për “të drejtën e tij për avokat” dhe ishte e paqartë nëse kjo i referohej një avokati të zgjedhur prej tij apo një avokati të ofruar nga autoritetet pa pagesë. Është e diskutueshme nëse përgjigja e kërkuesit tregonte zgjedhjen e tij të informuar për të hequr dorë nga e drejta për avokat apo pasqyrore faktin se në praktikë ishte e pamundur që ai të merrte ndihmë juridike të zgjedhur prej tij në atë kohë të caktuar. Në kohën e deklarimeve, kërkuesi sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç dhe kishte vetëm shkollim të kufizuar dhe nuk kishte përvojë profesionale. Është e diskutueshme nëse ai mund të parashikonte pasojat e heqjes dorë të supozuar nga e drejta e tij për ndihmë juridike (d.m.th., dënim me më shumë se njëzet vjet burgim). Asnjë nga gjykatat e përfshira në proces nuk u angazhua për asnjë nga këto pyetje, pavarësisht sfidave specifike të kërkuesve (shihni *Rodionov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 9106/09, 11 dhjetor 2018, për detyrimin e gjykatës të brendshme për të shqyrtuar rrethanat

që lidhen me heqjen dorë nga e drejta e të pandehurit për t'u mbrojtur). Në përfundim, Gjykata nuk mund të konkludojë se gjykatat e brendshme kanë provuar në mënyrë bindëse nëse heqja dorë nga ndihma juridike e kërkuarit ka qenë apo jo me dëshirë.

Prandaj, e drejta e kërkuarit për ndihmë juridike sipas N. 6(3)(c) KEDNJ ishte e kufizuar.

Kufizimet mbi të drejtën për avokat në fazën e paraburgimit lejohen vetëm për arsye bindëse në rrethanat të jashtëzakonshme. Në këtë çështje, nuk ekzistonin këto rrethanat.

Kufizimi i të drejtës për avokat krijon një supozim se procesi ka qenë i padrejtë dhe, rrjedhimisht, në kundërshtim me N. 6(1) KEDNJ. Për të hedhur poshtë një supozim të tillë, Qeveria duhet të demonstrojë bindshëm se drejtësia e përgjithshme e procesit gjyqësor nuk është cenuar në mënyrë të pakthyeshme nga kufizimi i të drejtës për këshilla juridike.

Në këtë çështje, Qeveria nuk bëri asnjë parashtrim në lidhje me këtë aspekt. Kërkuari sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, kishte vetëm shkollim të kufizuar dhe aspak përvojë profesionale dhe ai nuk ishte informuar siç duhej për të drejtat e tij për ndihmë juridike dhe për të heshtur. Për më tepër, deklarimi i kërkuarit në datën 27 qershor 2004 u pranua si provë para gjykatave të brendshme dhe u konsiderua prej tyre si i rëndësishëm për çështjen, pavarësisht nga kërkesat e përsëritura të kërkuarit për të përjashtuar deklarinë e tij nga dosja e çështjes.

E drejta për të mos u dënuar në bazë të deklaramëve të dhëna pa ndihmë juridike nuk kufizohet në rrethimet aktuale apo në komentet që janë drejtpërdrejt fajësuese; që deklaratat të konsiderohen si vetë-fajësuese, mjafton që ato të kenë ndikuar në mënyrë thelbësore në pozitën e të akuzuarit (shihni, *mutatis mutandis*, *Bjarki H. Diego kundër Islandës*, Kërkesa nr. 30965/17, 15 mars 2022). Në rastin konkret, deklarinët e kërkuarit përbënin një pjesë të pandarë të provave mbi të cilat bazohej dënimi.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.6(1) të Konventës për shkak të mungesës së drejtësisë së përgjithshme të procesit, e cila u ndikua nga deklarimi i kërkuarit pa praninë e avokatit, dhe N. 6(3)(c) të Konventës për shkak të kufizimit të së drejtës së kërkuarit për avokat në mungesë të rrethanave bindëse.

Nika kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 1049/17, Vendimi gjyqësor i datës 14 nëntor 2023

Në rastin e pretendimeve për privim të paligjshëm të jetës, autoritetet shtetërore duhet të kryejnë një hetim efektiv që mund të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e përgjegjësve për ngjarjet dhe për të zbuluar të vërtetën, sidomos përgjegjësinë e mundshme të komandantëve të policisë në terren; familjarët e viktimës duhet të përfshihen në këtë hetim, në funksion të mbrojtjes së interesave të tyre legjitime. Mangësitë në një hetim të tillë mund të përbëjnë *shkelje të N.2 KEDNJ (E drejta për jetën) në aspektin procedural të tij*.

E drejta për jetën përfshin disa detyrime për Shtetet Anëtare në lidhje me operacionet e kontrollit të turmës nga forcat e sigurisë kombëtare: një kuadër ligjor adekuat duhet të rregullojë përdorimin e armëve potencialisht vdekjeprurëse në këtë kontekst, duke e konsideruar atë absolutisht të jashtëzakonshëm; këto operacione duhet të planifikohen dhe të kontrollohen në mënyrë që të minimizohet rreziku për jetën e demonstruesve; përdorimi i forcës vdekjeprurëse duhet të jetë absolutisht i nevojshëm duke pasur parasysh rrethanat dhe nuk justifikohet kurrë me qëllimin e mbrojtjes së pronës private ose publike. Shkelja e këtyre detyrimeve përbën *shkelje të N. 2 KEDNJ në aspektin e tij material*.

Fakte: Kërkuesit janë tre shtetas shqiptarë, përkatësisht bashkëshortja dhe vajzat e një burri, i cili vdiq si pasojë e një plage me armë zjarri në kokë, gjatë një proteste para ndërtesës ku ndodhet zyra e kryeministrit të Shqipërisë më 21 janar 2011. Para protestës, autoritetet kombëtare përgatitën plane për vendosjen e rendit para, gjatë dhe pas protestës. Në datën e protestës situata degjeneroi dhe rezultoi në përplasje të dhunshme mes demonstruesve dhe punonjësve të policisë. Një grup oficerësh të pajisur me mburoja dhe shkopinj larguan shumicën e protestuesve që depërtuan në perimetrin e sigurisë. Pas një paralajmërimi me gojë dhe përdorimit të gazit lotsjellës dhe ujit, policia filloi të përdorë armë zjarri, duke qëlluar me plumba manovre dhe të vërtetë kundër një grupi të vogël protestuesish që sulmuan Kryeministrinë, me pretekstin për t'i penguar ata të vazhdonin sulmin ndaj ndërtesës. Të shtënat shkaktuan katër viktima (përfshirë të afërmin e kërkuesve), të gjithë të ndodhur jashtë oborrit të Kryeministrisë dhe të pa përfshirë në akte të dhunshme. Si pasojë e përplasjeve janë plagosur disa protestues dhe policë.

Në janar 2011, Prokuroria e Tiranës filloi hetimin për ngjarjet. Hetuesit e policisë ekzaminuan zonën e protestave dhe mblodhën prova (përfshirë deklaratimet e protestuesve, mjekëve dhe gazetarëve, si dhe kopjet e video-regjistrimeve). Në të njëjtin muaj, prokuroria urdhëroi: i) një raport mjekoligjor të trupave të të gjitha viktimave, përveç të afërmit të kërkuesve dhe

të disa prej protestuesve të plagosur; ii) sekuestrimin për këqyrje të një sërë armësh të përdorura nga punonjësit e policisë; iii) t'i jepeshin të gjitha audio-regjistrimet e radio-komunikimeve ndërmjet oficerëve, të cilat nuk u dhanë sepse komunikimet nuk ishin regjistruar. Raporti mjeko-ligjor konkludoi se viktimat dhe protestuesit nuk kishin përdorur armë zjarri gjatë protestave.

Brenda pak orësh nga ngjarja, prokurorët nxorën urdhër-arresti ndaj gjashtë punonjësve të lartë të policisë. Urdhrat e arrestit nuk u ekzekutuan për shkak të gabimeve të pretenduara teknike dhe administrative. Pak ditë më pas, Kryeministri kritikoi ashpër linjën e hetimit të prokurorit. Një komision parlamentar hetimor u krijua menjëherë për të hetuar mbi abuzimet e supozuara të kryera nga prokurorët që hetuan ngjarjet; Prokurori i Përgjithshëm u thirr dhe iu nënshtrua kritikave të ashpra publike nga anëtarët e atij komisioni. Me kërkesë të prokurorëve, Kryeministria dorëzoi vetëm një video regjistrim në lidhje me ngjarjen. Më pas prokurori sekuestroi harddiskun e sistemit të kamerave të Kryeministrisë. Sipas një raport ekspertimi të mëvonshëm, përmbajtja e tij ishte kopjuar dhe fshirë. Proceset e mëvonshme të brendshme nuk përcaktuan rrethanat e sakta dhe identitetin e personit(personave) që kishin urdhëruar dhe kishin kryer fshirjen e regjistrimeve. Kryeministria i ka përcjellë prokurorëve edhe një video-regjistrim tjetër. Megjithatë, kjo video ishte edituar shumë dhe kishte regjistrim vetëm për disa minuta.

Në shkurt të vitit 2011, në kuadër të marrjes në pyetje nga prokurori, disa oficerë policie deklaruan se: i) para ngjarjeve ishin informuar për përdorimin e armëve të zjarrit, por nuk kishin marrë ndonjë urdhër konkret për përdorimin e armëve (atyre u është thënë vetëm të qëllojnë në ajër në rast të një përshkallëzimi serioz të situatës); ii) gjatë protestave urdhrat jepeshin me gojë, me radio komunikim ose me telefon. Në të njëjtin muaj, gjashtë oficerët e lartë ndaj të cilëve ishin lëshuar urdhër arrestet u dorëzuan dhe u morën në pyetje nga prokurorët. Komandanti i Përgjithshëm mohoi që oficerët kishin marrë urdhrin për të hapur zjarr dhe vuri në dukje se shumë oficerë të policisë u plagosën gjatë protestave.

Në maj të vitit 2011, një raport ekspertimi për plumbin e gjetur në kokën e të afërmit të kërkuesve lexonte se për shkak se plumbi kishte humbur formën e tij origjinale nga deformimi dhe dëmtimi, ishte e pamundur të përcaktohej se nga cila armë ishte qëlluar. Dy raporte të tjera të ekspertimi dolën në përfundimin se plumbat që ishin gjetur te dy viktimat e tjera ishin shkrepur nga armë që ishin si ato që kishin përdorur dy nëpunës të lartë, të cilët në prill 2012 u akuzuan për vdekjen e tre protestuesve. Në të njëjtën

datë, prokurorët veçuan çështjen e kërkuesve nga pjesa tjetër e hetimit me arsyetimin se ishin të nevojshme veprime të mëtejshme hetimore në lidhje me çështjen e tij. Procesi penal për vdekjen e të afërmit të kërkuesve është ende në pritje.

Në shkurt 2013, gjykata e shkallës së parë i shpalli dy oficerët të pafajshëm. Vendimi gjyqësor u shfuqizua nga gjykata e apelit, e cila, në shtator të vitit 2013, i shpalli dy oficerët fajtorë për vrasje nga pakujdesia dhe i dënoi me një dhe tre vjet burgim përkatësisht. Gjykata e apelit gjeti – ndër të tjera – se: i) oficerët përdorën armët e tyre të zjarrit pothuajse në të njëjtën kohë për të qëlluar në ajër me plumba të vërtetë për të penguar një turmë të dhunshme; ii) përdorimi i forcës vdekjeprurëse ka qenë joproporcional, pasi dy viktimat nuk ishin të përfshira në akte dhune; iii) të pandehurit duhet të kishin parashikuar pasojat e mundshme të vendimit të tyre për të qëlluar në ajër me plumba të vërtetë. Në prill 2016, Gjykata e Lartë rrëzoi ankimet e ngritura për çështje ligjore.

Në shtator 2016, kërkuesit depozituan një padi për dëmshpërblim kundër policisë dhe Ministrisë së Brendshme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila gjeti se dy oficerët përdorën armët e tyre në kundërshtim me dispozitat përkatëse të brendshme dhe se autoritetet shtetërore ishin përgjegjëse për vdekjen e të afërmit të tyre. Gjykata dha kompensim monetar.

Vendosji: Faktet e çështjes ngrenë pyetje si në aspektin procedural ashtu edhe atë material të N.2 KEDNJ.

Sa i përket pjesës procedurale, N. 2 KEDNJ vendos detyrimin për të kryer një hetim efektiv për shkeljet e pretenduara të aspektit të tij material (d.m.th. në rast të privimit të paligjshëm arbitrar të jetës). Në rastin në fjalë, reagimi i Prokurorisë së Tiranës ka qenë i shpejtë, por kritikata e ashpra të Kryeministrit ndaj linjës së hetimit të prokurorit, shoqëruar me krijimin e komisionit hetimor parlamentar dhe sjelljen e anëtarëve të tij, kanë ndikuar negativisht mbi efektivitetin e hetimit (p.sh., frenimi i dëshmitarëve të mundshëm nga bashkëpunimi me hetimin në vazhdim). Sa i përket urdhër arresteve, autoritetet kombëtare nuk bashkëpunuan për të adresuar mangësitë e pretenduara që penguan ekzekutimin e tyre. Për më tepër, ekzekutimi i urdhrave të arrestit ndaj oficerëve të lartë të policisë rezultoi në humbjen e kohës së çmuar dhe të mundësisë për të marrë në pyetje të dyshuarit menjëherë pas ngjarjes (që rezultoi në rrezikun e marrëveshjes së fshehtë dhe shtrembërimit të së vërtetës). Gjithashtu, autoriteti nuk ka vepruar me shpejtësi dhe nuk

ka ushtruar kujdesin e duhur në sigurimin e video-regjistrimeve që kishte Kryeministria në lidhje me incidentin. Fshirja e një pjese të madhe të video-regjistrimeve ngre shqetësime serioze nëse ka qenë e qëllimshme dhe një përpjekje për të fshehur të vërtetën. Këto dyshime nuk u shuan nga proceset e brendshme gjyqësore, edhe pse ky regjistrim supozohej se ishte nën kujdesin e autoriteteve kombëtare, të cilat kishin detyrimin t'i mbanin të paprekura dhe të sigurta nga çdo ndërhyrje nga palët e treta (shihni *Lovpyginy kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 22323/08, 23 qershor 2016).

Hetimi u fokusua ekskluzivisht në identifikimin e personit që ishte drejtpërdrejt përgjegjës për vdekjen e të afërmit të kërkuesit dhe nuk trajtoi në mënyrë adekuate përgjegjësinë e mundshme nga ana e komandantëve në terren, as mundësinë që demonstruesit të ishin direkt në shënjestër të oficerëve të armatosur. Autoritetet kombëtare nuk hetuan një sërë rrethanash dhe indiciesh që mund të kishin hedhur më shumë dritë mbi këto aspekte (p.sh. fakti që oficerët e policisë kishin qëlluar në ajër pothuajse në të njëjtën kohë, mosrindërtimi i vendndodhjeve ku qëndronin viktimat në momentin që u qëlluan).

Hetimi për vdekjen e të afërmit të kërkuesve u karakterizua nga disa mangësi, sidomos: i) mosrindërtimi i kronologjisë të saktë të ngjarjeve; ii) moskryerja e ekspertizës mjeko-ligjore të trupit të tij; iii) mospërfshirja e kërkuesve në hetim (p.sh., duke i informuar ata për zhvillimet kryesore), në mënyrë që t'u jepet mundësia për të mbrojtur interesat e tyre legjitime.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur aspektin procedural të N. 2 të Konventës për shkak të moskryerjes së hetimit efektiv për ngjarjet dhe për vdekjen e të afërmit të kërkuesve.

Aspekti material i N. 2 KEDNJ ndalon privimin e paligjshëm dhe arbitrar të jetës. Dhënia e kompensimit monetar për kërkuesit nuk i privon ata nga statusi i viktimës para Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut: në fushën e përdorimit të paligjshëm të forcës nga punonjësit e shtetit, proceset civile ose administrative që synojnë vetëm dhënien e dëmshpërblimit nuk përbëjnë mjete të përshtatshme dhe efektive që mund të ofrojnë korrigjim për ankesat bazuar në aspektin material të N. 2 KEDNJ.

Në rastin në fjalë, legjislacioni kombëtar për përdorimin e armëve të zjarrit, siç ishte në fuqi në kohën e ngjarjeve, lejonte përdorimin e armëve të zjarrit për mbrojtjen e pronës (përfshirë në vende publike ku ka tubime njerëzish), pa dhënë ndonjë detaj të mëtejshëm në lidhje me llojin e

rrethanave të jashtëzakonshme ku mund të justifikohet përdorimi i armëve të zjarrit. Dispozitat përkatëse nuk parashikojnë detyrimin për të dhënë një paralajmërim me gojë përpara se të qëllohet me armë zjarri direkt mbi njerëzit.

Sa i përket përdorimit të forcës gjatë protestave, Gjykata Administrative e Tiranës konstatoi se dy oficerët përdorën armët e tyre në kundërshtim me dispozitat përkatëse të brendshme dhe se autoritetet shtetërore ishin përgjegjëse për vdekjen e të afërmit të kërkuesve. Përdorimi i forcës vdekjeprurëse nuk ishte as proporcional dhe as legjitim: në kohën kur u qëlluan me plumba të vërtetë, grupi relativisht i vogël i protestuesve të dhunshëm nuk përbënte rrezik serioz dhe të atyshëm ndaj asnjë personi. Për më tepër, i afërmi i kërkuesve nuk paraqiste ndonjë kërcënim serioz sepse ai nuk ishte i përfshirë në akte të dhunshme. Edhe pse ai u vra nga të shtënat në ajër, punonjësit e policisë nuk morën masa për të minimizuar në masën më të madhe të mundshme çdo rrezik ndaj jetës së kalimtarëve jo të dhunshëm, deri në atë pikë sa të përbënte pakujdesi të rëndë.

Mangësi ka pasur edhe organizimi edhe planifikimi i operacioneve policore gjatë ngjarjeve. Në ditën e protestës, u dhanë vetëm udhëzime shumë të pakta në lidhje me mundësinë e përdorimit të forcës vdekjeprurëse, sidomos munguan udhëzime të qarta dhe të sakta se kush do të jepte urdhër për përdorimin e forcës vdekjeprurëse dhe kush do të bënte vlerësimin nëse përdorimi i armëve të zjarrit do të ishte absolutisht i nevojshëm. Gjithashtu, kishte një sasi qartazi të pamjaftueshme të masave jo-vdekjeprurëse për kontrollin e turmës, veçanërisht një top uji dhe një sasi e caktuar gazi lotsjellës. Përdorimi si fillim i këtij të fundit preku oficerët e policisë, të cilët nuk kishin vendosur maska gazi lotsjellës. Për më tepër, paralajmërimet me gojë përpara të shtënave ishin të paqarta dhe të pasakta dhe nuk mund të konsideroheshin se përbënin një paralajmërim të duhur përpara përdorimit të armëve potencialisht vdekjeprurëse.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur aspektin material të N. 2 të Konventës për shkak të mangësive në kuadrin ligjor që rregullon përdorimin e armëve potencialisht vdekjeprurëse, defekteve të rënda në planifikimin dhe kontrollin e ngjarjes në shqyrtim dhe dështimin për të treguar se përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte absolutisht i nevojshëm, duke pasur parasysh rrethanat.

Repeşco dhe Repeşcu kundër Republikës së Moldavisë, Kërkesa nr. 39272/15, Vendimi gjyqësor i datës 3 tetor 2023

Nëse një person paraqet pretendime të besueshme se dënimi i tij bazohet në deklarin e dhënë nën presion dhe, mbi këto baza, kërkon rishikimin e këtij dënimi, juridiksionet kombëtare duhet të kryejnë një shqyrtim rigoroz dhe gjithëpërfshirës të këtyre pretendimeve dhe ai person duhet të ketë mundësi efektive për të kundërshtuar pranueshmërinë e deklaramëve si edhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 6(1) KEDNJ* (E drejta për proces gjyqësor të drejtë). Kjo është edhe më e vërtetë nëse, në kuadrin e një çështjeje të mëparshëm përpara KEDNJ-së, Qeveria ka pranuar se i njëjti person ka pësuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga neni 3 KEDNJ, ndër të tjera, për shkak të keqtrajtimit të shkaktuar në paraburgim policor.

Fakte: Në vitin 2013, kërkuesit u dënuan përkatësisht me katërmbëdhjetë dhe shtatë vjet burgim për vrasje në rrethana rënduese dhe vjedhje me dhunë bazuar në deklarinet fajësuese që kishte nxjerrë policia duke përdorur metoda të paligjshme. Në vendimin e saj, gjykata kompetente hodhi poshtë argumentin e kërkuesve se deklarinet në fjalë ishin marrë me detyrim. Ajo shtoi më tej se, nëse keqtrajtimi i tyre do të ishte vërtetuar më pas me një vendim gjyqësor të formës së prerë, kërkuesit do të kishin të drejtë të kërkonin rishikim të proceseve të tyre penale në mënyrë që të përfitonin anulimin e dënimit të tyre.

Kërkuesit paraqitën një kërkesë në Gjykatë, ku u ankuan për një keqtrajtim të tillë sipas N. 3 KEDNJ. Qeveria paraqiti një deklaratë të njëanshme, ku pranoi se kërkuesit vuajtën shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara nga N.3 dhe 13 KEDNJ. Meqë kushtet e deklaratës së njëanshme u pranuan nga kërkuesit, Gjykata e fshiu çështjen nga lista e saj në përputhje me nenin 39 të KEDNJ-së, duke u shprehur se palët arritën një marrëveshje miqësore *de facto* (*Adrian Repesco dhe Constantin Repescu kundër Republikës së Moldavisë*, Kërkesa nr. 64785/11, vendim i datës 25 nëntor 2014).

Në bazë të vendimit të Gjykatës, në shkurt të vitit 2015 kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për rihapjen e procesit penal. Në maj 2015, Gjykata e Lartë e Drejtësisë e hodhi poshtë këtë kërkesë si të pabazuar – *inter alia* – për arsyet e mëposhtme: i) kërkuesit nuk ishin ankuar në çështjen e tyre të mëparshme përpara Gjykatës për një shkelje të N.6 KEDNJ, dhe asnjë shkelje e tillë nuk ishte pranuar nga Qeveria apo gjetur nga Gjykata; ii) në vendimin e saj, Gjykata nuk kishte përdorur termin “torturë”, as nuk kishte konstatuar

se keqtrajtimi i ushtruar ndaj kërkuesve e kishte bërë të padrejtë procesin e tyre penal; iii) deklaratimet e kërkuesve nuk ishin e vetmja provë vendimtare në këtë çështja.

Vendosi: Gjykata solli në kujtesë që N.6(1) KEDNJ mund të zbatohet për çështjet në lidhje me rihapjen e proceseve penale (shihni *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr.[DHM], Kërkesa nr. 19867/12, 11 korrik 2017). Ligji moldav i lejon individët të sigurojnë rishikimin e një vendimi penal të formës së prerë pas gjetjes së një shkeljeje nga Gjykata ose pas një zgjidhjeje miqësore të një çështjeje përpara Gjykatës, me kusht që rishikimi të jetë i vetmi mjet i mundshëm për shkeljet e rënda të Konventës. Gjykata vuri në dukje se ky mjet juridik mund të kishte qenë vendimtar për një akuzë penale dhe se shqyrtimi i kryer nga Gjykata e Lartë e Drejtësisë kishte të bënte me themelin e procesit penal të ngritur kundër kërkuesve, duke rezultuar në dënimin e tyre. Prandaj, doli në përfundimin se N. 6(1) KEDNJ zbatohet për proceset e rishikimit në çështjen në fjalë.

Në lidhje me themelin e ankimeve të kërkuesve, Gjykata përsëriti se përdorimi në procesin penal i deklaratimeve të marra në kundërshtim me N.3 GJEDNJ automatikisht e privon procesin në tërësi nga drejtësia e tij, edhe nëse fakti që ato u pranuan si prova nuk ishte vendimtar për marrjen e një vendimi fajësie.

Në rastin në fjalë, në deklaratën e saj të njëanshme në çështjen e mëparshëm të kërkuesve, Qeveria pranoi se kërkuesit i ishin nënshtruar keqtrajtimit kur ishin nën kontrollin e policisë, gjatë hetimit penal kundër tyre me qëllim marrjen e rrëfimeve. Deklarimet e tyre u përdorën nga gjykatat e brendshme si provë kundër tyre. Gjatë procesit të rishikimit, Gjykata e Lartë nuk kreu një shqyrtim rigoroz dhe gjithëpërfshirës të pretendimeve të kërkuesve që deklaratimet e tyre ishte marrë nën presion në kundërshtim me N.3 KEDNJ, pavarësisht se parashtronin argumente bindëse bazuar në deklaratën e Qeverisë dhe vendimin e Gjykatës. Gjithashtu, kërkuesit nuk patën mundësi efektive për të kundërshtuar pranueshmërinë e këtyre deklaratimeve dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre.

Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit kanë të drejtë të presin që autoritetet kombëtare, përfshirë gjykatat e brendshme, të marrin parasysh në mirëbesim pasojat e një deklaratë të njëanshme nga Qeveria që pranon shkeljen e N. 3 KEDNJ dhe që çon në një vendim nga Gjykata e cila e mori atë parasysh. Në rastin në fjalë, Gjykata e Lartë e Drejtësisë tregoi formalizëm të tepruar dhe nuk nxori përfundimet e duhura nga deklaratat e njëanshme i

qeverisë për shkeljen e N.3 të Konventës.

Nisur nga sa më sipër Gjykata konkludoi që Moldavia ka shkelur N.6(1) KEDNJ për mos-rihapjen nga gjykata e brendshme të procesit penal të kërkuesve, pavarësisht pretendimeve të tyre të besueshme se deklarimet e përdorura kundër tyre si provë ishin marrë me anë të keqtrajtimit në kundërshtim me N.3 KEDNJ, siç konfirmohet nga deklarata e njëanshme e Qeverisë dhe vendimi i Gjykatës për çështjen e tyre të mëparshme.

Plechlo kundër Sllovakisë, Kërkesa nr. 18593/19, Vendimi gjyqësor i datës 26 tetor 2023

Duhet të ekzistojë një kuadër ligjor i cili siguron mbrojtje adekuate dhe efektive kundër abuzimit në rast të përgjimit të thirrjeve telefonike në kontekstin e hetimeve penale që prekin njerëz të rastësishëm (d.m.th., njerëz që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në hetimin penal dhe që nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i urdhrave të përgjimit të telefonit) – *Shkelje e N.8 KEDNJ (E drejta për jetën private)*

Fakte: Në vitin 2006, gjykatat sllovae nxorën një urdhër për përgjimin e thirrjeve telefonike në kuadër të një hetimi (hetimi i vitit 2006) mbi një dyshim për korrupsion brenda Fondit Kombëtar të Pronës (NPF). Kërkuesi (një zyrtar i nivelit të lartë të NPF) nuk ishte objektivi i operacionit, i cili e preku atë vetëm sepse ai ishte në kontakt me personin që ishte objektivi i tij. Materiali i përgjimit u mbajt nga policia dhe u përfshi në dosjen e një hetimi të veçantë që u hap në vitin 2012, pas regjistrimeve anonime të postuara në internet që pretendonin se e kishin origjinën nga një operacion vëzhgimi i kryer nga shërbimet sekrete sllovae në vitet 2005-2006 (“Operacioni Gorilla”). Hetimi i vitit 2012 kishte të bënte me NPF-në. Kërkuesi nuk ishte i përfshirë drejtpërdrejt.

Në bazë të informacioneve të marra nga operacioni Gorilla, në vitin 2016 u hap një tjetër hetim për keqmenaxhimin e pasurive dhe korrupsion të dyshimtë të nivelit të lartë në NPF. Kërkuesi ishte një nga të dyshuarit kryesorë. Disa nga materialet e përgjimit u përfshinë në dosje dhe kërkuesi u akuzua. Kërkuesi vdiq në vitin 2022 dhe në emër të tij vepruan të afërmit e tij.

Vendosi: Bisedat telefonike të kërkuesit në fjalë u përfshinë në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe të korrespondencës sipas N.8 KEDNJ, dhe regjistrimi, ruajtja dhe mbajtja e materialit të përgjuar përbënte ndërhyrje në këtë të drejtë.

Gjykata kujtoi se, që një ndërhyrje të jetë në përputhje me N.8 KEDNJ, ajo duhet të parashikohet me ligj dhe, në kontekstin e vëzhgimit sekret, duhet të shoqërohet me garanci adekuate dhe efektive (shih *Dragojević kundër Kroacisë*, Kërkesa nr. 68955/11, 15 janar 2015). Fakti që kërkuesi nuk kishte qenë në gjendje të njihej me urdhrin e përgjimit të telefonit, kishte kufizuar mjetet e kërkuetit për të kundërshtuar zbatimin e tij. Ky zbatim rezultoi në krijimin e materialit të përgjuar. Për më tepër, nuk ka asnjë mekanizëm për të mbrojtur të drejtat e personave të prekur rastësisht nga urdhër-përgjimet telefonike. Në fakt, legjislacioni kombëtar për urdhrat e përgjimit të telefonit siguron vetëm mbrojtje për të drejtat e njerëzve të prekur drejtpërdrejt nga urdhra të ngjashme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Sllovakia ka shkelur N. 8 KEDNJ, sepse ndërhyrja në të drejtën e kërkuetit për respektimin e jetës së tij private dhe korrespondencës nuk ishte në përputhje me ligjin për qëllimin e N.8(2) KEDNJ, sepse nuk shoqërohej me garanci adekuate dhe efektive kundër abuzimit.

X kundër Greqisë, Kërkesa nr. 38588/21, Vendimi gjyqësor i datës 13 shkurt 2024

Në rastet e përdhunimit, autoritetet kombëtare duhet të kryejnë një hetim efektiv, të informojnë viktimat për të drejtat e tyre dhe të marrin të gjitha masat e duhura për të shmangur traumatizimin e mëtejshëm dhe për të zbutur atë që është qartazi një situatë shqetësuese (p.sh., shmangia e kontakteve mes viktimës dhe të akuzuarit). Gjykatat e brendshme duhet të marrin parasysh rrethanat specifike të çështjes (p.sh., mosha e re e viktimës), të kryejnë një vlerësim që është i ndjeshëm ndaj kontekstit për besueshmërinë e versioneve të ndryshme të ngjarjes, të marrin parasysh rezultatit e ekzaminimit mjekësor. Si autoritetet hetimore ashtu edhe ato gjyqësore duhet të ndjekin një perspektivë të bazuar në gjini – *shkelje e N.3 KEDNJ (Ndalimi i trajtimit poshtëruës) dhe N. 8 KEDNJ (E drejta për respektimin e jetës private)*

Fakte: Kërkuësja, znj. X, është një shtetase britanike e lindur në vitin 2000, e cila pretendon se ka qenë viktimë e përdhunimit nga një banakier hoteli në Greqi në shtator 2019, ku shkoi për pushime me mamanë e saj. Ajo bëri një kallëzim penal gjatë natës dhe pretendimi i saj u trajtua më së shumti nga policë meshkuj. U dërgua në komisariat ku ndodhej edhe autori. E identifikoi atë, pa u ndjekur asnjë procedurë zyrtare. Pas kërkesës për një përkthyes zyrtar që të jepte deklarinimin e saj, oficeri i policisë e informoi se nuk ishte në dispozicion asnjë përkthyes dhe e ndihmoi një përkthyes jozyrtar. Kërkuësja

dha deklarimin e saj para një hetuesi mashkull dhe një oficerije policie si pjesë e hetimit paraparak të kryer nga policia. Në fund ajo u shpreh: “Unë dua që ai të ndiqet penalisht dhe të dënohet”. Mamaja e kërkueses gjithashtu bëri deklarimin e saj si dëshmitare.

Kërkuesja dhe mamaja e saj u dërguan në spital nga oficerët e policisë. Asaj iu morën mostra gjaku. Në spital, një mjek mashkull kreu ekzaminim fizik, i cili zbuloi mavijosje dhe lëndime të shkaktuara së fundmi (përfshirë himenin e perforuar). Kërkueses nuk ju dha asnjë shpjegim gjatë dhe pas ekzaminimeve në spital, as nuk mori dokumente për ekzaminimet apo mjekimin. Për më tepër, nuk u morën masa për ta mbajtur atë në distancë nga i akuzuari (p.sh. ai ishte ulur përballë saj në spital). Të nesërmen, policia e çoi atë në komisariat ku i thanë se duhej të firmoste dokumentet në greqisht edhe pse nuk i ishte dhënë një përkthim zyrtar. Ajo i nënshkroi ato nga frika e pasojave të refuzimit prej saj.

I akuzuari akuzohej për veprën penale të përdhunimit. Pasi dha deklarimin e tij mbrojtës, ai u la i lirë në pritje të gjyqimit. Në përputhje me konkluzionin e prokurorit, në vitin 2021 gjykata penale e shpalli të pafajshëm të akuzuarin me arsyetimin se provat e mbledhura gjatë hetimit (deklarimet e dëshmitarëve, raporti mjeko-ligjor, dokumentet dhe deklarimi i të akuzuarit) nuk përbënin indicie të mjaftueshme për të ngritur akuzë penale. Në të njëjtën kohë, vendimi nuk ngarkonte shpenzime ndaj znj. X, sepse nuk ishte provuar që ankesa e saj ishte tërësisht e rreme, tepër e pakujdesshme ose e shtrembëruar.

Kërkuesja nuk mori informacion gjatë gjithë kohës. Pas një përpjekjeje të pasuksesshme për të marrë informacion mbi çështjen përmes ambasadës britanike në Athinë, në janar 2021 konsulli më në fund informoi përfaqësuesin e kërkueses se i akuzuari ishte shpallur i pafajshëm. Konsulli i sugjeroi gjithashtu familjes së kërkueses të caktonte një avokat vendas. Kërkuesja dhe përfaqësuesi i saj i dërguan email gjykatës dhe prokurorisë, ku i kërkuan informacion mbi çështjen, si dhe akses në të gjitha dosjet policore dhe spitalore, si dhe informacion mbi procedurën. Prokuroria refuzoi kërkesën e tyre për arsye se kërkuesja nuk ishte palë civile në çështje (ajo nuk e kishte deklaruar këtë në deklarimin e saj dhe kishte paguar tarifën përkatëse) dhe se afati përkatës kishte mbaruar. Megjithatë, prokuroria e njoftoi atë për vendimin për lirin e të akuzuarit. Prokuroria përsëriti deklaratën e saj në një email drejtuar ambasadës britanike në Athinë dhe shtoi se kërkuesja nuk ishte paraqitur për të dëshmuar para gjyqtarit hetues një ditë pas incidentit

ose nuk kishte caktuar një avokat për ta përfaqësuar atë dhe se një kopje e vendimit mund t'i jepej çdo avokati të caktuar nga ambasada.

Vendosji: Përdhunimi dhe dhuna e rëndë seksuale përfshihen në objektin e N.3 KEDNJ dhe të N.8 KEDNJ. Sipas N.3 KEDNJ, Shtetet duhet të miratojnë dispozita të ligjit penal që ndëshkojnë në mënyrë efektive përdhunimin dhe t'i zbatojnë ato në praktikë përmes hetimit dhe ndjekjes penale efektive. Sipas N. 8 KEDNJ, shteti duhet të miratojë masa efektive frenuese kundër akteve të rënda si përdhunimi, i cili kërkon dispozita efikase të ligjit penal. Detyrimet pozitive sipas N.3 dhe 8 KEDNJ kërkojnë gjithashtu që Shtetet të marrin masa për të shmangur viktimizimin dytësor në proceset penale, si dhe për të vazhduar penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual pa pëlqim, sidomos në mungesë të kundërshtimit fizik nga viktimja. Për të qenë efektiv, hetimi duhet të jetë mjaftueshëm i plotë dhe objektiv. Autoritetet duhet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të marrë prova në lidhje me veprën në fjalë. Procesi penal duhet të organizohet në mënyrë që të mos rrezikojë në mënyrë të pajustificueshme interesat e mbuluara nga N.8 KEDNJ. Veçanërisht, në rastet që përfshijnë vepra seksuale, proceset penale shpesh konceptohen si një sprovë nga viktimja, veçanërisht kur kjo e fundit ballafaqohet pa dëshirë me të pandehurin.

Në rastin konkret, gjatë fazës së hetimit, autoritetet kombëtare nuk respektuan rregullat e brendshme për caktimin e përkthyesve, sidomos mosinformimin e kërkueses për të drejtat e saj për të paraqitur kundërshtime në lidhje me cilësinë e përkthimit. Autoritetet nuk morën masa për të zbutur atë që ishte qartësisht një situatë shqetësuese për viktimën, duke përfshirë shmangien e kontaktit mes saj dhe të akuzuarit, dhe për të siguruar privatësinë e kërkueses duke përdorur metoda identifikimi që do të shmangnin frikësimin dhe shqetësimin. Autoritetet nuk respektuan ligjin e brendshëm që kërkon që intervistat me viktimat e dhunës seksuale të kryhen nga një person i së njëjtës gjini me viktimën. Autoritetet e brendshme nuk e informuan kërkuesen për të drejtat e saj (për ndihmë juridike, për këshillim, për mbështetje psikologjike, për të marrë informacion, për të marrë një kopje të përkthyer të ankesës së saj, për të kundërshtuar interpretimin), as nuk trajtuan një kopje të përkthyer të ankimit ndaj saj. Në fazën e gjyqimit, prokurori dhe gjykata: i) nuk iu referuan deklaramentit të mamasë së viktimës dhe të një kolegu të të akuzuarit, të cilët u morën në pyetje si dëshmitarë; ii) nuk trajtuan në çfarëdo mënyre gjendjen psikologjike të kërkueses pas incidentit; iii) nuk bënë një vlerësim

të ndjeshëm të kontekstit për besueshmërinë e versioneve të ndryshme të ngjarjeve; iv) nuk morën parasysh raportin mjeko-ligjor; v) nuk vlerësuan gjendjen mendore të kërkueses pas tre pijeve ose nuk ju referuan rezultateve të analizave të gjakut dhe urinës; vi) nuk morën parasysh rrethanat personale të kërkueses (p.sh., mosha e saj e re dhe mungesa e përvojës seksuale); vii) nuk analizuan rrethanat e çështjes nga perspektiva e dhunës me bazë gjinore.

Edhe pse Greqia kishte një kuadër ligjor dhe rregullator të përshtatshëm për t'u marrë me rastet e përdhunimeve, autoritetet kombëtare nuk e zbatuan atë në praktikë. Autoritetet nuk adoptuan një qasje të ndjeshme, e cila kërkohet për shkak të natyrës intime të çështjes, moshës së re të kërkueses si dhe faktit që ajo pretendonte se ishte përdhunuar gjatë pushimeve në një vend të huaj. Autoritetet e brendshme nuk kryen një hetim efektiv, ato shpërfillën të drejtat dhe nevojat e viktimës, krahas rrezikut të viktimizimit dytësor dhe traumatizimit të mëtejshëm.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Greqia ka shkelur nenet 3 dhe 8 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së përgjigjes adekuate nga autoritetet hetimore dhe gjyqësore ndaj pretendimeve të kërkueses për përdhunim.

Matyushonok kundër Ukrainës , Kërkesa nr.34590/06, Vendimi gjyqësor i datës 11 korrik 2024 [Komiteti]

Autoritetet kombëtare kanë detyrimin të mos i nënshtrojnë të burgosurit ndaj keqtrajtimit në burg dhe të hetojnë akuzat në këtë drejtim. Mosveprimi në këtë mënyrë mund të përbëjë *shkelje të N.3 KEDNJ (Ndalimi i torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor apo poshtëruës)*.

Fakte: Kërkuesi është shtetas ukrainas, aktualisht në burg në Gubnik, pas një dënimi në vitin 2005 për vrasje me paramendim të kryer si pjesë e një grupi dhe për një vepër penale të ngjashme. Kërkuesit dhe të akuzuarit e tjerë u dënuan me burgim të përjetshëm, u konfiskua e gjithë pasuria dhe u urdhëruan bashkërisht të paguajnë dëmshpërbim për viktimat.

Kërkuesit dhe bashkë të pandehurit e tij paraqitën ankimim për të kundërshtuar ashpërsinë e dënimit dhe për të kërkuar që të merret parasysh pendimi i sinqertë i kërkuesit, mosha e tij dhe rrethanat e tjera dhe që dënimi i tij i përjetshëm të zëvendësohet me një afat të caktuar burgimi. Prokurori kërkoi gjithashtu që Gjykata e Lartë të ulë dënimin e përjetshëm të të gjithë të pandehurve në dënime me afat të caktuar.

Në shkurt 2006, Gjykata e Lartë shqyrtoi çështjen në mungesë të avokatit të kërkuesit dhe la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët, duke konfirmuar kështu dënimin e kërkuesit me burgim të përjetshëm.

Që nga tetori 2003, kërkuesi ka qenë subjekt i keqtrajtimit sistematik në burg nga oficerët, sidomos i rrahjes dhe mbytjes. Ai është ankuar te shefi i ambienteve të burgimit dhe ka kërkuar ndihmë mjekësore, por kërkesat e tij nuk janë marrë parasysh. Për më tepër, kushtet e paraburgimit ishin të papërshtatshme (p.sh., kushtet e këqija të higjienës dhe pastrimit; mungesa e ujit të pijshëm; kequshqyerja) dhe autoritetet monitoruan korrespondencën e kërkuesit dhe nuk i dhanë atij dokumentet që i nevojiteshin për të provuar pretendimin e tij përpara Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendosi: Juridiksioni i Gjykatës nuk mbulon përcaktimin e kushteve të përshtatshme të burgimit për një vepër të caktuar, por kufizohet në shqyrtimin nëse kërkuesit i është dhënë garancia e proceseve të drejta në tërësi sipas N. 6 KEDNJ (shihni, *Cani kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr.11006/06, 6 mars 2012).

Në rastin në fjalë, dënimi i dhënë ndaj kërkuesit ishte brenda gamës së dënimeve të parashikuara për krimin e kryer. Për më tepër, ai kishte përfaqësim ligjor gjatë hetimit dhe gjykimit para gjykatave kombëtare. Mungesa e informacionit dhe dokumenteve përkatëse (edhe për shkak të mungesës së aksesit në dosjen e çështjes penale të kërkuesit, e cila kishte mbetur në Krime pas pushtimit të paligjshëm të saj nga Federata Ruse në 2014) nuk e lejon Gjykatën të përcaktojë arsyen e mungesës së avokatit në Gjykatën e Lartë. Megjithatë, avokati paraqiti argumente në emër të kërkuesit në ankimin e tij me shkrim të paraqitur në Gjykatën e Lartë. Rrjedhimisht, interesat e kërkuesit u përfaqësuan në proceset penale përpara Gjykatës së Lartë dhe mungesa e një avokati në seancë nuk cenoi në mënyrë të pakthyeshme të drejtat e kërkuesit për mbrojtje ose drejtësinë e gjykimit. Nisur nga sa më sipër, procesi gjyqësor në këtë çështje, i marrë në tërësi, nuk mund të konsiderohet se ka qenë i padrejtë dhe, për rrjedhojë, në shkelje të N. 6 KEDNJ. Prandaj, kjo pjesë e kërkesës ishte qartazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me N. 35(3) dhe (4) KEDNJ.

Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës mbulon pjesën e ankimit të kërkuesit në lidhje me keqtrajtimin në burg dhe mungesën e ndihmës mjekësore dhe të një hetimi efektiv në këtë drejtim (shihni *Iglin kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 39908/05, 12 janar 2012; *Gorbatenko kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 25206/06, 28 nëntor 2013). Duke pasur parasysh materialin e çështjes në fjalë dhe gjetjet

e saj në çështjet e mëparshme, Gjykata doli në përfundimin se ankimet e kërkuarit tregojnë shkelje të N.3 KEDNJ.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Ukraina ka shkelur N.3 të Konventës për shkak të keqtrajtimit të kërkuarit në burg dhe mungesës së hetimit në këtë drejtim.

Hanovs kundër Letonisë, Kërkesa nr. 40861/22, Vendimi gjyqësor i datës 18 korrik 2024

Krimet e urrejtjes përbëjnë fyerje të dinjitetit të njeriut dhe ndikojnë në jetën private të viktimave. Në këto raste, autoritetet kombëtare kanë detyrimin të kryejnë një hetim të paanshëm, i cili merr parasysh motivin diskriminues pas agresionit. Autoritetet e brendshme duhet ta akuzojnë agresorin për vepra të motivuara nga urrejtja (dhe jo për vepra të zakonshme) dhe sanksionet e vendosura duhet të jenë në përpjesëtim me rëndesën e veprës penale. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N.3 KEDNJ (Ndalimi i trajtimit poshtëruës) dhe të N.8 KEDNJ (Respektimi i jetës private), në lidhje me N.14 KEDNJ (Ndalimi i diskriminimit).

Fakte: Në vitin 2020, kërkuari u bë viktimë e një sulmi homofobik kur kishte dalë shëtitje me partnerin e tij. Gjatë sulmit, dy agresorët ju bëritën atyre (duke përdorur gjuhë fyese dhe sharje kundër homoseksualëve) dhe njëri prej tyre tentoi të godiste kërkuarin, i cili arriti të fshihej në një dyqan ndërsa partneri i tij thirri policinë. Oficerët e policisë mbërritën dhe identifikuan një nga agresorët, i cili akuzohej për veprën penale të "huliganizmit". Agresori konfirmoi se ishte konfrontuar me gojë dhe fizikisht me çiftin për t'i bërë ata të ndalonin atë që ai e konsideronte një shfaqje të papranueshme dashurie (d.m.th., duke e mbajtur njëri-tjetrin nga beli gjatë ecjes). Në vitin 2021, hetuesi mbylli ndjekjen penale për mungesë elementesh për të proceduar me veprën e "huliganizmit".

Në maj 2022, autoritetet refuzuan përfundimisht ankimin e kërkuarit për të ndjekur penalisht sulmin si një vepër e motivuar nga urrejtja sipas ligjit penal të Letonisë. Ata gjetën që veprimet e agresorit ishin të motivuara nga paragjykimi ndaj personave homoseksualë, por përcaktuan se ato drejtoheshin vetëm kundër vetë kërkuarit (dhe jo kundër partnerit të tij gjithashtu) dhe nuk nxisnin të tjerët për urrejtje (që është një nga kërkesat për krimin e urrejtjes sipas ligjit kombëtar). Ndërkohë, në qershor 2021 agresori u shpall fajtor për "huliganizëm të lehtë" në proces për kundërvajtje administrative dhe u gjobit me 70 euro.

Vendosj: Detyrimi për të hetuar sulmet e motivuara nga urrejtja mund të lindë sipas N.3 dhe 8 KEDNJ, në lidhje me N.13 dhe 14 KEDNJ. Dispozita e zbatueshme duhet të përcaktohet në çdo rast duke pasur parasysh faktet dhe natyrën së pretendimeve të ngritura.

Në këtë çështje, zbatohen të dyja nenet 3 dhe 8 KEDNJ. Për sa i përket të parit, kërkuesi nuk pësoi ndonjë lëndim aktual, por ai ishte viktimë e sulmeve verbale dhe fizike, të cilat kishin për qëllim të frikësonin kërkuesin dhe partnerin e tij që t'i bënin ata të ndalonin shfaqjen publike të dashurisë. Kjo sjellje përbën fyerje të dinjitetit njerëzor, një koncept që përfshin të drejtën për të shprehur identitetin dhe dashurinë pa frikë nga ndëshkimi ose dhuna. Sulmet si ky në rastin konkret jo vetëm që minojnë sigurinë fizike të viktimave, krahas mirëqenies së tyre emocionale dhe psikologjike, por edhe poshtërojnë viktimat. Prandaj, agresioni në këtë çështje përfshihet në fushën e veprimit të N.3 KEDNJ. Këto sulme ndikojnë gjithashtu në jetën private të viktimave dhe, për rrjedhojë, mund të kufizojnë të drejtën e njohur sipas N.8 KEDNJ.

Në kuadër të sulmeve nga individë privatë, të dyja nenet 3 dhe 8 KEDNJ vendosin ndaj Shtetit detyrimin për të mbrojtur integritetin fizik dhe psikologjik të një personi, krahas detyrimit për të ofruar mbrojtje në përgjigje të sulmeve mjaft serioze (shihni p.sh. *Tërshana kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr.48756/14, 4 gusht 2020). Shtetet kanë detyrimin të kryejnë një hetim efektiv për të vërtetuar faktet, për të identifikuar dhe, nëse është e përshtatshme, për të ndëshkuar personat përgjegjës. Në rastin e sulmeve diskriminuese, autoritetet kombëtare duhet t'i hetojnë faktet me energji dhe paanshmëri dhe të shmangin trajtimin e krimeve të motivuara nga urrejtja njësoj si krimet e zakonshme.

Në çështjen në fjalë, sulmi ndaj kërkuesit ishte mjaft serioz për të kërkuar një përgjigje nga autoritetet e brendshme dhe ishte i motivuar nga orientimi seksual i kërkuesit (pra, ishte diskriminues). Megjithatë, policia dhe prokurori nuk morën parasysh nuancat homofobike që çuan te sulmi dhe refuzuan ta ndiqnin atë si një krim të motivuar nga urrejtja sipas dispozitave përkatëse të brendshme. Gjoha e vendosur ndaj agresorit në procesin për shkelje administrative nuk ishte në përputhje me detyrimin për të siguruar që sulmet homofobike të trajtohen në mënyrë adekuate dhe të parandalohen në mënyrë efektive për dy arsye: i) procesi për shkelje administrative nuk trajtoi elementin e urrejtjes që kishte ky sulm; ii) lehtësia e sanksionit ishte në shpërpjestim të dukshëm me rëndësinë e aktit. Autoritetet e brendshme

e trajtuan sulmin e motivuar nga urrejtja njësoj si trazira të vogla të rendit publik dhe, për rrjedhojë, ato nuk arritën t'i japin përgjigje të fortë dhe nxitën një ndjenjë mosndëshkimi për veprat e motivuara nga urrejtja. Mostrajtimi i krimeve të urrejtjes rrezikon të normalizojë armiqësinë ndaj personave LGBTI, duke vijuar kështu me kulturën e intolerancës dhe diskriminimit dhe duke inkurajuar akte të mëtejshme të një natyre të ngjashme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Letonia ka shkelur N.3 dhe 8 KEDNJ, në lidhje me N.14 KEDNJ, për shkak se autoritetet e brendshme nuk arritën të siguronin mbrojtjen e duhur për dinjitetin dhe jetën private të kërkuarit me anë të sigurimit të ndjekjes penale efektive të sulmit kundër tij, duke marrë parasysh motivin e urrejtjes pas sulmit.

B. ARRESTI NË BURG

Hysa kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 52048/16, Vendimi gjyqësor i datës 21 shkurt 2023

Vendimet që urdhërojnë arrestin në burg duhet të japin arsye relevante dhe të mjaftueshme. Personat e akuzuar kanë interesa legjitime për të kërkuar rishikimin e ankimit kushtetues të mangësive që prekin këto vendime, me anë të ankimit kushtetues. Interesat legjitime ekzistojnë edhe nëse arresti në burg është zëvendësuar me një masë më të butë dhe, për rrjedhojë, gjykatat kushtetuese nuk mund ta rrezikojnë këtë ankesë si të papranueshme për shkak të mungesës së interesit legjitim. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 5(3) KEDNJ* (Arsyeshmëria e arrestit në burg).

Fakte: Kërkuesi është shtetas shqiptar i cili mbante detyrën e drejtorit të Departamentit të Inspeksionit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Në vitin 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi masën e arrestit në burg të kërkuarës me dyshimin se ajo kishte kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Gjykata përshkroi me detaje shkeljen e dyshuar të rregullave përkatëse tatimore dhe iu referua “rrethanave të kryerjes së veprës dhe rrezikut të largimit së të dyshuarit” për të justifikuar arrestin në burg. Kërkuarja ju dorëzua gjykatës dhe apeloj kundër vendimit, duke argumentuar se vendimi për arrest në burg nuk jepte arsyet e duhura, duke kundërshtuar rrezikun e largimit dhe duke pohuar se nuk kishte rrezik për të kryer sërish veprën penale pasi ajo ishte pezulluar nga detyra. Masa e arrestit në burg u konfirmua nga gjykata e apelit, e cila arriti në përfundimin se ekzistonte

rreziku që kërkuesja, nëse lirohej, do të kryente sërish veprën penale. Ankimi i kërkueses pranë Gjykatës së Lartë u rrëzua si i papranueshëm.

Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë si të papranueshëm ankimin e kërkueses për mungesë legjitimimi, duke pasur parasysh se arresti i saj në burg ishte zëvendësuar ndërkohë me arrest shtëpie në qershor 2014. Në mendimin e tij të pakicës, një gjyqtar deklaroi se individët duhet të lejohen të kundërshtojnë kushtetutshmërinë e heqjes së lirisë së tyre edhe nëse në momentin e shqyrtimit të kundërshtimit, masa e arrestit në burg ndaj tyre ishte zëvendësuar me një masë më të lehtë. Kërkuesi përfundimisht u shpall fajtor për vjedhje duke shpërdoruar detyrën në bashkëpunim me të tjerët.

Vendosi: N.5(1)(c) KEDNJ përcakton shkaqet mbi të cilat mund të lejohet arresti në burg, ndërsa N.5(3) parashtron disa garanci procedurale, duke përfshirë rregullin që arresti në burg në pritje të gjykimit nuk duhet të kalojë një afat të arsyeshëm. Sipas N.5(3) KEDNJ, vazhdimi i dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, por pas një periudhe të caktuar ai nuk mjafton më, kështu që autoritetet e brendshme duhet të bazojnë vendimet e arrestit në burg në shkaqe të tjera të mjaftueshme dhe relevante (p.sh. rreziku i arratisjes, rreziku i përsëritjes së veprës penale) dhe duhet të tregojnë “kujdes të veçantë” në zhvillimin e procesit gjyqësor. Vlerësimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së periudhave të paraburgimit varet nga faktet e çështjes dhe veçoritë e tij specifike. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet vetëm bazuar në një kërkesë të vërtetë të interesave publike që tejkalon të drejtën për respektimin e lirisë individuale sipas N.5 KEDNJ. Autoritetet gjyqësore kombëtare kanë detyrimin të sigurojnë që periudha e paraburgimit të mos kalojë një afat të arsyeshëm. Vendimi i gjykatave kombëtare për arrestin në burg duhet të japë arsyet e duhura, bazuar në faktet dhe rrethanat personale të të akuzuarës.

Në rastin konkret, për sa i përket procesit para gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, të dyja gjykatat iu referuan shkaqeve legjitime të arrestit në burg (përkatësisht rreziku i arratisjes dhe rreziku i përsëritjes), pa dhënë asnjë arsye pse konsideroi se kërkuesja përbënte këto rreziqe. Gjithashtu, gjykata e apelit nuk iu përgjigj argumentit të kërkueses se ajo nuk do të mund të kryente sërish veprën penale, pas pezullimit të saj nga detyra. Të dyja vendimet bazoheshin në një masë të madhe në pasojat e rënda financiare të veprës në fjalë dhe në faktin që kërkuesja dyshohej se e kishte kryer atë duke shpërdoruar detyrën e saj publike. Megjithatë, rëndesa e veprës penale ose pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë arrestin në burg dhe nuk mund të justifikojnë, në vetvete, heqjen e lirisë së një të dyshuari. Të

dyja vendimet refuzuan zbatimin e masave alternative ndaj arrestit në burg të kërkueses, pa i kushtuar këtij aspekti vëmendjen e duhur.

Për sa i përket procesit gjyqësor para Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, të dyja gjykatat e hodhën poshtë ankimin e kërkueses si të papranueshëm. Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë ankimin e kërkueses me arsyetimin se asaj i mungonte interesi personal për të kundërshtuar ligjshmërinë e periudhës së saj të parë të arrestit në burg, për shkak të zëvendësimit të arrestit në burg të kërkueses me një masë më të butë. Megjithatë, vendimi i vitit 2014 për vendosjen e kërkueses në arrest shtëpie nuk përfshinte ndonjë përcaktim të ligjshmërisë së periudhës së parë të arrestit në burg. Një rishikim i plotë nga Gjykata Kushtetuese mund të kishte çuar në gjetjen që kërkuesja ishte ndaluar në kundërshtim me të drejtën e saj për liri, gjithashtu për qëllimin e marrjes së kompensimit për ndalim të paligjshëm sipas N.5(5) KEDNJ. Sidoqoftë, vendimi i papranueshmërisë i Gjykatës Kushtetuese pengoi korigjimin e mangësive në arsyetimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit dhe dëmshpërblimin për cenimin e së drejtës së kërkueses për liri (shihni p.sh. *Margaretić kundër Kroacisë*, Kërkesa nr. 16115/13, 5 qershor 2014).

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N. 5(3) të Konventës për shkak se gjykatat e brendshme nuk dhanë arsye relevante dhe të mjaftueshme në mbështetje të vendimeve të tyre në lidhje me periudhën e parë të arrestit në burg të kërkueses dhe se Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtoi ligjshmërinë e periudhës së dytë të arrestit në burg.

***Muçaj kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 37814/10, Vendimi gjyqësor i datës 11 korrik 2023 [Komiteti]**

Vendimet që urdhërojnë arrestin në burg duhet të japin arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe autoritetet kombëtare duhet të tregojnë “kujdes të veçantë” në zhvillimin e proceseve gjyqësore. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.5(3) KEDNJ (Arsyeshmëria dhe kohëzgjatja e arrestit në burg)*.

Fakte: Në gusht 2009, katër oficerë policie u vranë si pasojë e shkëmbimit të zjarrit me dy persona. Kërkuesi, i cili kishte shërbyer si oficer policie, i kishte bërë thirrje të shpeshta njërit prej vrasësve. Në të njëjtin muaj, kundër kërkuesit u hap procesi penal. Më 22 nëntor 2009, gjykata penale e shkallës së parë urdhëroi arrestin në burg të kërkuesit për shkak të shpërdorimit të detyrës për shkak të kontakteve të tij të dyshuara me vrasësit dhe për shkak

të rrezikut për arratisje. Ditën tjetër, kërkuesi u arrestua dhe tre ditë më vonë, gjykata penale e shkallës së parë konfirmoi arrestin në burg të kërkuesit për shkak të rrezikut për arratisje.

Në dhjetor 2009, gjykata e apelit konfirmoi arrestin në burg me arsyetimin se provat tregonin ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm që kërkuesi kishte kryer krimin e shpërdorimit të detyrës. Në janar 2010 dhe qershor 2010, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese e rrëzuan përkatësisht ankimin e kërkuesit.

Në vitin 2010 dhe 2012, arresti në burg i kërkuesit u konfirmua më tej nga gjykatat e brendshme, pa adresuar referencat e kërkuesit për kohën e kaluar dhe përfundimin e hetimit. Në dhjetor 2012, një gjykatë kombëtare e zgjati arrestin në burg të kërkuesit deri në gjykimin e çështjes, edhe pse arresti në burg zyrtarisht i kishte tejkaluar afatet kohore ligjore. Ky vendim i referohej vonesave të proceseve gjyqësore të shkaktuara nga avokati mbrojtës i të bashkë-pandehurit. Në vitin 2013, kërkuesi u dënua me katër vjet e tetë muaj burgim. Meqenëse koha e kaluar në paraburgim tejkalonte dënimin e tij, gjykata urdhëroi lirimin e menjëhershëm të kërkuesit. Kërkuesit iu ndalua më tej mbajtja e detyrave publike për një periudhë prej tre vjetësh. Kërkuesi nuk e ankimoi dënimin ndaj tij, i cili më pas mori formë të prerë.

Në vitin 2009 dhe 2010, çështja mori mbulim mediatik dhe Kryeministri bëri një deklaratë duke e quajtur kërkuesin kriminel.

Vendosi: Sipas N.5(3) KEDNJ, vazhdimësia e një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, por nuk mjafton më pasi kalon një farë kohe. Në këtë raste, Gjykata duhet të përcaktojë nëse autoritetet kombëtare dhanë arsye “relevante” dhe “të mjaftueshme” për të justifikuar heqjen e lirisë, dhe nëse autoritetet kombëtare kompetente treguan “kujdes të veçantë” në zhvillimin e proceseve.

Në këtë çështje, kërkuesi qëndroi tre vjet, dy muaj dhe trembëdhjetë ditë në paraburgimin. Për një periudhë kaq të gjatë, në parim, do të kërkoheshin arsye të forta për heqjen e lirisë. Gjykatat kombëtare iu referuan vetëm rëndesës së akuzave, pa treguar zbatimin konkret të saj për çështjen e kërkuesit, dhe për rëndesën e akuzave. Rëndesa e veprës penale nuk përbën shkak të pavarur që justifikon paraburgimin (shihni *Hysa kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 52048/16, 21 shkurt 2023 – Pjesa III.B). Gjykatat e brendshme nuk trajtuan argumentet e kërkuesve për kalimin e kohës dhe përfundimin e hetimit dhe nuk morën parasysh ndonjë masë sigurimi alternativ. Kërkuesi u akuzua vetëm për një vepër penale dhe vendimi i vitit 2012 për zgjatjen e afatit të arrestit në

burg të kërkuesit i referohej vonesave në procese të shkaktuara nga avokati mbrojtës i të bashkë-pandehurit. Gjykata e brendshme nuk mori asnjë masë për të adresuar këto vonesa. Prandaj, sistemi i brendshëm i drejtësisë penale nuk e kishte trajtuar çështjen e kërkuesit me “kujdes të veçantë”.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.5(3) KEDNJ për shkak se gjykata kombëtare nuk ofroi shkaqe “relevante” dhe “të mjaftueshme” për të justifikuar arrestin në burg të kërkuesit, së bashku me mungesën e ushtrimit të “kujdesit të veçantë” në zhvillimin e proceseve.

Sipas N.6(2) KEDNJ, të gjithë gëzojnë prezumimin e pafajësisë. Në proceset e brendshme, kërkuesi nuk ka ngritur çështjen se prezumimi i tij i pafajësisë ishte cenuar nga mbulimi mediatik i procesit gjyqësor dhe nga disa deklaratat të Kryeministrit. E drejta për t’u prezumuar i pafajshëm është e garantuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese tregon se ajo e ka trajtuar këtë çështje si aspekt të gjykimit të drejtë. Kërkesa individuale në Gjykatën Kushtetuese është një mjet juridik efektiv (shihni p.sh. *Jakupi kundër Shqipërisë* (vendim), Kërkesa nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009).

Nisur nga sa më sipër, ankesa e kërkuesit sipas N.6(2) KEDNJ (prezumimi i pafajësisë), që rrjedh nga mbulimi mediatik i rastit të tij dhe deklaratat e Kryeministrit, u shpall e papranueshme sipas N.35(1) dhe (4) KEDNJ për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme (përkatësisht një kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese).

Radonjić dhe Romić kundër Serbisë, Kërkesa nr. 43674/16, Vendimi gjyqësor i datës 4 prill 2023

Vendimet që urdhërojnë arrestin në burg duhet të përmbajnë shkaqe relevante dhe të mjaftueshme; me kalimin e kohës, arsyetimi i gjykatave të brendshme duhet të zhvillohet dhe të reflektojë situatën në zhvillim, duke treguar se pse shkaqet fillestare për arrest në burg ishin të vlefshme edhe në fazat e mëvonshme të procesit. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.5(3) KEDNJ (Arsyeshmëria dhe kohëzgjatja e arrestit në burg)*.

Fakte: Kërkuesit ishin dy oficerë të policisë sekrete serbe. Në vitin 1999, u vra një gazetar dhe botues gazete serb me ndikim. Vrasja e tij shkaktoi zemërim ndërkombëtar dhe dënim në shkallë të gjerë, sepse një nga motivet e vrasjes së tij mendohej se ishte kritika publike e tij ndaj politikave të Millosheviçit. Në vitin 2013, Qeveria serbe ngriti një komision për të hetuar

vrasjet e gazetarëve. Në janar 2014, dy kërkuesit u arrestuan me dyshimin se kishin kryer vrasjen në fjalë së bashku me dy të dyshuar të tjerë. Gjykatat e brendshme urdhëruan dhe zgjatën paraburgimin e tyre në pritje të gjykimit. Shkaqet fillestare për ndalimin e tyre ishin: rreziku i arratisjes së tyre; rreziku që ata të ushtronin presion mbi dëshmitarët; dhe nevoja për të ruajtur rendin publik duke pasur parasysh reagimin potencialisht të fortë në Serbi dhe jashtë saj nëse ata liroheshin. Nga qershori 2014, gjykatat e bazuan ndalimin e tyre vetëm në natyrën dhe rëndesën e akuzave, të lidhura me mundësinë e një shqetësimi publik nëse kërkuesit do të liroheshin. Në korrik 2017, gjykata e brendshme vendosi që nuk ishte më i nevojshëm arresti në burg dhe i vendosi ata në arrest shtëpie.

Kërkuesit bënë ankim në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimeve që urdhëronin dhe zgjatnin ndalimin e tyre, gjë që çoi në një sërë vendimesh të ndërmjetme. Në veçanti, në një vendim të miratuar në dhjetor 2017, Gjykata Kushtetuese u shpreh se paraburgimi i kërkuesve ishte justifikuar në periudhën nga arrestimi i tyre në janar 2014 deri në prill 2015. Për sa i përket periudhës së mëvonshme (deri në korrik 2017, kur ankuesit ishte vendosur në arrest shtëpie), Gjykata Kushtetuese konstatoi se juridiksionet kompetente nuk kishin dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar arrestin në burg, gjë që, rrjedhimisht, ishte në kundërshtim me nenin 5(3) të KEDNJ.

Në vitin 2019, kërkuesit u shpallën fajtorë për vrasje të rëndë dhe u dënuan përkatësisht me 30 vite dhe 20 vite burgim. Ankimet janë depozituar dhe ishin ende në pritje që nga gushti 2022.

Vendosi: Sa i përket kohëzgjatjes së tepërt të afatit të paraburgimit të kërkuesve, meqë kërkuesit nuk u ankuan në asnjë fazë të arrestit të tyre në shtëpi (pavarësisht se kjo përbën një lloj heqje lirie në përputhje me nenin 5 të KEDNJ-së), Gjykata u shpreh se periudha që do të merret në konsideratë fillon në janar 2014 (kur u arrestuan kërkuesit) dhe përfundon në korrik 2017 (kur u vendosën në arrest shtëpie). Kështu kjo zgjati gati tre vjet e gjysmë. Gjykata vërejti se gjykatat kombëtare kishin kryer një vlerësim të detajuar të të gjitha rrethanave përkatëse, në intervale të rregullta, dhe kishin rregulluar arsyetimin e tyre për kalimin e kohës për të pasqyruar situatën në zhvillim dhe për të verifikuar nëse ishin më të vlefshme shkaqet për arrestin në burg. Megjithatë, Gjykata u pajtua me Gjykatën Kushtetuese se, pas prillit 2015, gjykata kompetente nuk kishte dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar arrestin në burg të kërkuesve për shkak të rendit publik.

Edhe pse Gjykata Kushtetuese kishte pranuar shprehimisht shkeljen e Konventës, ajo nuk dha asnjë kompensim për dëmin jopasuror. Në mungesë të një rruge tjetër ligjore të qartë dhe të konsoliduar sipas legjislacionit të brendshëm, sipas së cilës mund të kërkohej një shumë e përshtatshme kompensimi, GJEDNJ arriti në përfundimin se kërkuessit nuk morën dëmshpërblim të mjaftueshëm në nivel kombëtar dhe ende mund të pretendonin se ishin viktimat të shkeljes së dyshuar sipas nenit 34 të KEDNJ-së.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Serbia ka shkelur N.5(3) për shkak të arrestit në burg të kërkuessit nga prilli 2015 deri në korrik 2017.

Për sa i përket kohëzgjatjes së tepërt të procesit gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese, Gjykata vuri në dukje se ai ka zgjatur më shumë se dy vjet (nga maji 2015 deri në janar 2018), në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme (siç është gjendja e jashtëzakonshme) që mund të justifikojnë një rishikim të tillë për çështje që ishin relativisht të drejtpërdrejta. Ngarkesa shumë e madhe e punës nuk mund të përdoret si justifikim për proceset tepër të gjata, sepse i takon Shtetit që të organizojë sistemin e tij gjyqësor në atë mënyrë që t'u mundësojë gjykatave të tij të respektojnë Konventën.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Serbia ka shkelur N.5(4) të Konventës për shkak të shkeljes së të drejtës për një vendim të shpejtë gjyqësor në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të kërkuessve.

M.B. kundër Holandës, Kërkesa nr. 71008/16, Vendimi gjyqësor i datës 23 prill 2024

Autoritetet kombëtare mund të ndalojnë azilkërkuessit për shkak të hyrjes së tyre të paautorizuar edhe pas paraqitjes së kërkesës së tyre për azil dhe në pritje të vendimit. Megjithatë, ndalimi për qëllime imigracioni duhet të bazohet në legjislacionin kombëtar dhe nuk duhet të jetë arbitrar, që do të thotë se duhet të ekzistojë një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet ndalimit për qëllime imigracioni dhe parandalimit të hyrjes së paautorizuar. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën shkelje të N.5(1)(f) KEDNJ (E drejta për liri dhe siguri - Ndalimi arbitrar i azilkërkuessve dhe të huajve)

Fakte: Kërkuessi është shtetas sirian i cili ka hyrë në Holandë në tetor 2015 dhe ka aplikuar për azil. Menjëherë pas kësaj, ai u arrestua nën dyshimin për pjesëmarrje në një organizatë terroriste ndërmjet marsit 2013 dhe tetorit 2015

dhe u vendos në paraburgim. Në gusht 2016, gjykata penale kundërshtoi kërkesën e prokurorit dhe e dënoi kërkuesin e akuzuar me dhjetë muaj burg (duke zbritur kohën që ai kishte kaluar tashmë në paraburgim). Vendimi i gjykatës penale u bazua në disa prova (p.sh., deklaratimet e kërkuesit, deklaratim dëshmitari, një mesazh nga kërkuesi në vitin 2013, biseda në WhatsApp e vitit 2015 dhe foto dhe video të gjetura në telefonin e tij celular). Gjykata nuk ka sqaruar pse devijoi nga konkluzioni i prokurorit. Si prokurori ashtu edhe kërkuesi bënë ankim. Në një vendim gjyqësor të vitit 2017, gjykata e apelit e rrëzoi pjesërisht ankimin për shkak të mungesës së kompetencës për njërën nga akuzat dhe, për sa i përket akuzave të tjera, e liroi kërkuesin për mungesë provash të mjaftueshme.

Paraburgimi i kërkuesit u ndërpre më 23 shtator 2016. Në të njëjtën ditë, ai u vendos në paraburgim për qëllime imigracioni në pritje të vlerësimit të kërkesës së tij për azil, për shkak të dyfishtë: i) kërkuesi përfaqësonte kërcënim për sigurinë kombëtare ose rendin publik nisur nga dënimi i tij penal; ii) për t'ju mundësuar autoriteteve shqyrtimin e kërkesës së tij për azil. Ankimi i parë i kërkuesit kundër këtij urdhri paraburgimi u rrëzua ndër të tjera, për shkak të pajtueshmërisë së urdhrit të paraburgimit me N.5(1)(f) KEDNJ nisur nga hyrja e paautorizuar e kërkuesit në Holandë. Një ankim tjetër për arsye procedurale u la në fuqi. Në ditën që kërkuesi doli nga paraburgimi për qëllime imigracioni, ndaj tij u vendos një masë që kufizonte lirinë e tij të lëvizjes: veçanërisht, ai duhej të paraqitej tek autoritetet çdo ditë dhe të kërkonte leje për të dalë nga bashkia ku qëndronte. Kjo masë u hoq në vitin 2018. Në të njëjtin vit, kërkuesit iu dha leja e qëndrimit për arsye azili.

Vendosi: N.5(1)(f) KEDNJ lejon ndalimin e një azilkërkuesi derisa Shteti t'i japë atij autorizimin për të hyrë. Në këtë aspekt, është e rëndësishme hyrja *de jure*, jo *de facto*. Prandaj, është e mundur që një azilkërkues të jetë në territorin e një Shteti, ndërkohë që hyrja e tij nuk është e autorizuar nga ai Shtet. Në këtë rast, ai/ajo mund të ndalohej sipas N.5(1)(f) KEDNJ (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([DHM], Kërkesa nr.13229/03, 29 janar 2008).

Në çështjen në fjalë, në kohën e ndalimit të kërkuesit, autoritetet kombëtare nuk kishin marrë një vendim për kërkesën e tij për azil. Në këtë kontekst, e drejta për të qëndruar në territorin e një Shteti në pritje të rezultatit të një kërkesë për azil nuk mund të barazohet me të drejtën për leje qëndrimi. Prandaj, ndalimi i kërkuesit për shkak të "hyrjes së paautorizuar" ishte në përputhje me N.5(1)(f) KEDNJ.

Në lidhje me arbitraritetin e ndalimit të kërkuarit, Gjykata shqyrtoi nëse ekzistonte një lidhje mjaft e ngushtë ndërmjet ndalimit për qëllime të imigracionit dhe qëllimit të parandalimit të hyrjes së tij të paautorizuar. Në çështjet e mëparshme, Gjykata vendosi se ndalimi për qëllime të imigracionit, i cili justifikohet për arsye të rendit publik, ndërkohë që nuk po vazhdonin në mënyrë aktive procedurat e largimit, ishte arbitrar (p.sh., *Al Husin kundër Bosnjë dhe Hercegovinës* (nr. 2), Kërkesa nr. 10112/16, 25 qershor 2019, dhe për krahasim *N.M kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 43966/19, 18 prill 2023). Shqetësimet për lirimin e një azilkërkuari menjëherë pas dënimit të tij për akuza të lidhura me terrorizmin nuk mund të çojnë në "ndalim parandalues", as nuk mund të zhveshin Shtetin nga detyrimet e tij sipas N.5 KEDNJ. Për më tepër, gjatë paraburgimit të kërkuarit (nëntor 2015 - shtator 2016), autoritetet nuk morën asnjë masë për të vlerësuar kërkesën e tij për azil. Përkundrazi, autoritetet kryen intervista për azil kur kërkuari ndodhej në ndalim për qëllim imigracioni (shtator 2016 - dhjetor 2016). Rrjedhimisht, ky ndalim për qëllim imigracioni duket jo proporcional dhe i panevojshëm, pasi shumë nga hapat e kërkuar për vlerësimin e kërkesës për azil mund të ishin ndërmarrë gjatë paraburgimit sipas legjislacionit penal, pa qenë nevoja për të mbajtur më pas kërkuarin në ndalim për qëllime imigracioni.

Faktet e çështjes në fjalë treguan se gjykata kombëtare mund të mbështetej në rendin publik për të justifikuar ndalimin tepër të gjatë për qëllime imigracioni pas dënimeve penale, në pritje të vendimmarrjes për kërkesën për azil. Kjo solli një zgjerim të shkaqeve të KEDNJ-së për ndalimin e azilkërkuarve. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte një lidhje mjaft të ngushtë ndërmjet ndalimit të tij për qëllime imigracioni dhe qëllimit për të parandaluar hyrjen e tij të paautorizuar. Prandaj, ndalimi i kërkuarit për qëllime imigracioni ishte arbitrar.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Holanda ka shkelur N. 5(1)(f) të Konventës për shkak të ndalimit arbitrar të kërkuarit për qëllime imigracioni në pritje të kërkesës së tij për azil për shkak të rendit publik.

Cviková kundër Sllovakisë, Kërkesat nr. 615/21 dhe 2 të tjera, Vendimi gjyqësor i datës 13 qershor 2024

Një person mund të ndalohet, në kuadër të procesit penal, vetëm për qëllim të sjelljes së tij para autoritetit kompetent ligjor mbi dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një vepre penale. Në rastet e ndalimit të zgjatur, ky dyshim duhet të vazhdojë dhe të mbetet “i arsyeshëm” gjatë gjithë kohës së paraburgimit; në fakt, vazhdimi i ndalimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka të dhëna aktuale për një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale. Gjykatat kombëtare duhet të shqyrtojnë të gjitha faktet që janë pro ose kundër ekzistencës së kërkesës së lartpërmendur të interesit publik ose që justifikojnë një shmangie nga rregulli në nenin 5, dhe duhet t’i paraqesin ato në vendimet e tyre për kërkesat për lirim. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N. 5(1)(c) dhe N. 5(3) KEDNJ*.

E drejta për shqyrtimin e shpejtë të ligjshmërisë së ndalimit nga një gjykatë, e përcaktuar në N.5(4), nënkupton që ky proces duhet të jetë me kundërshti dhe duhet të sigurojë gjithmonë “barazinë e armëve” ndërmjet palëve. Prandaj, nëse një gjykatë i bazon vendimet e saj në ekzistencën e “dyshimit të arsyeshëm” mbi shkaqe që nuk janë ngritur nga prokuroria dhe nuk i jep kërkuetit mundësinë për të komentuar mbi ato, kemi të bëjmë me *shkelje të N.5(4) KEDNJ*.

Fakte: Kërkesja është një shtetase sllovaqe e cili, që nga viti 2012, ka qenë gjyqtare. Në janar 2020, në kuadër të një hetimi më të gjerë për dyshim korrupsioni të organizuar në gjyqësor, Gjykata e Specializuar Penale nxori një urdhër për kontroll në banesën e kërkuetes, me qëllim gjetjen e provave të rëndësishme për procesin penal. Në mars 2020, kërkesja (së bashku me shtatëmbëdhjetë persona të tjerë) u akuzua për vepra të ndryshme, sidomos korrupsion, shpërdorim i pushtetit dhe ndërhyrje në gjyqësor.

Dy ditë më vonë, kërkesja u arrestua dhe u vendos në arrest në burg me dyshimin se kishte marrë ryshfet në këmbim të ndihmës së një gjyqtari tjetër për të vendosur në mënyrë të paligjshme në një çështje në lidhje me një deklaratë premtimi. Dyshimi bazohej kryesisht në komunikimet me shkrim të gjetura në telefonin e një të akuzuari tjetër dhe në deklaratimet fajësuese të një të akuzuari tjetër. Kërkesja paraqiti ankim kundër vendimit të arrestit në burg, duke pretenduar mungesën e shkaqeve specifike për situatën e saj dhe të një analize për domosdoshmërinë e vendosjes së saj në paraburgim (d.m.th, mundësinë e zëvendësimit të paraburgimit me një masë alternative). Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese rrëzuan ankimet e kërkuetes

përkatësisht në mars 2020 dhe në qershor 2020. Me kërkesë të kërkueses, më 5 gusht 2020, Gjykata e Specializuar Penale vendosi që kërkuësja të lirohej. Me kërkesë të prokurorisë, më 24 gusht 2020, Gjykata e Lartë prishi vendimin e datës 5 gusht 2020 dhe rrëzoi kërkesën e kërkueses për lirim. Përveç argumenteve të ngritura nga prokuroria, Gjykata e Lartë i bazoi vendimet e saj në dokumentin që ishte gjetur në apartamentin e kërkueses dhe më pas ishte sekuestruar. Gjykata e Lartë vuri në dukje edhe pasivitetin e prokurorisë. Kërkuësja paraqiti ankim kushtetues, duke argumentuar se Gjykata e Lartë kishte vendosur për çështjen bazuar në arsye të ndryshme nga ato të ngritura nga prokuroria dhe në këtë mënyrë kishte shkelur parimin e barazisë së armëve. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin më 1 dhjetor 2022 sepse vendimi i kontestuar bazohej në elemente që e akuzuara i kishte ditur dhe mbi të cilat kishte mundësi të komentonte.

Kërkuësja u lirua me vendim të Gjykatës së Lartë në tetor 2020, pas mbarimit të afatit ligjor shtatë-mujor të paraburgimit. Vendimi mori gjithashtu parasysh shpjegimin e kërkueses se përse dokumenti i sekuestruar ishte në zotërim të saj dhe arriti në përfundimin se nuk kishte asgjë që tregonte se ajo në fakt kishte bashkëpunuar me dikë.

Vendosi: Gjykata shqyrtoi ankimin sipas N.5(1)(c) KEDNJ dhe N.5(3) KEDNJ në të njëjtën kohë. Gjykata u bind se mbajtja e kërkueses në paraburgim gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij bazohej në një dyshim të arsyeshëm kundër saj. Vendimi për vendosjen e saj në paraburgim dhe për ankimin e saj të ndërmjetëm kishte të bënte me kërkuesen së bashku me disa të pandehur të tjerë dhe arsyet e ndalimit të tyre ishin të ndërthurura. Duke e marrë situatën në tërësi dhe duke marrë parasysh gjithashtu natyrën e ndjeshme të akuzave, kompleksitetin e procesit dhe ndalimin e kërkueses që ishte në një fazë shumë të hershme të hetimit, Gjykata konstatoi se arsyet për vendosjen e saj në arrest në burg ishin “relevante” dhe “të mjaftueshme”.

Situata ndryshoi me vendimin e 5 gushtit për lirimin e kërkueses, i cili u rrëzua nga Gjykata e Lartë më 24 gusht 2024. Ky vendim i fundit bazohej kryesisht në karakterin e veprimeve të ndjekura penalisht dhe në tiparet e personalitetit dhe marrëdhëniet e kërkueses. Këto gjetje, si dhe ato që kanë të bëjnë me pamundësinë e zëvendësimit të paraburgimit të kërkueses me masa alternative, nuk kishin mbështetjen e mëtejshme individuale. Ky vendim bazohej edhe në dokumentet e sekuestruara nga apartamenti i kërkueses dhe në kontaktet me të akuzuarit dhe gjyqtarët e tjerë. Gjykata e Lartë i hodhi poshtë të dyja arsyet në tetor 2020, kur urdhëroi lirimin e kërkueses. Nisur nga sa më sipër,

mbetet për t'u diskutuar nëse arsyet për vazhdimin e ndalimit të kërkueses në fazën e caktuar të procesit ishin "relevante" dhe "të mjaftueshme". Autoritetet kombëtare nuk treguan "kujdes të veçantë" në zhvillimin e proceseve, si rezultat i pasivitetit dhe mosveprimit nga ana e organeve të ndjekjes penale (veprimet e fundit procedurale në lidhje me kërkuesen u kryen më 25 qershor 2020 dhe nuk ishte planifikuar asnjë veprim i mëtejshëm). Nisur nga sa më sipër, me rrëzimin e kërkesës së saj për lirim më 5 gusht 2020, vazhdimi i ndalimit të kërkueses nuk ishte i nevojshëm.

Nga kjo, Gjykata konstaton se Sllovakia ka shkelur N.5(1)(c) dhe (3) të Konventës në lidhje me periudhën pas vendimit të 24 gushtit 2020, i cili rrëzoi kërkesën e kërkueses për lirim.

Për sa i përket shkeljes së parimit të barazisë së armëve, që është e natyrshme në kërkesën e drejtësisë procedurale sipas N.5 (4) KEDNJ, Gjykata shqyrtoi dy aspekte. Së pari, në vendimin e saj të datës 24 gusht 2024, Gjykata e Lartë vuri në dukje mosveprimin e prokurorisë dhe vendosi arrest në burg të kërkueses për arsye që nuk ishin ngritur nga prokuroria, duke cenuar kështu parimin e barazisë së armëve. Së dyti, Gjykata e Lartë u mbështet në faktin që kërkuesja kishte në posedim dokumentin e sekuestruar, të cilin Gjykata e Lartë e mori me iniciativën e saj. Autoritetet e tjera kombëtare nuk ishin mbështetur asnjëherë në atë dokument për të vërtetuar rrezikun e marrëveshjes së fshehtë, kështu që kërkuesja nuk mund të pritej që ta adresonte atë arsye në gusht 2020. Në këtë drejtim, në tetor 2020 shpjegimi i kërkueses se pse e kishte ajo dokumentin e sekuestruar u pranua për të treguar që nuk kishte arsye për bashkëpunim.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Sllovakia ka shkelur N. 5(4) të Konventës për faktin se Gjykata e Lartë e bazoi vendimin e saj në arsye të cilat nuk ishin ngritur nga prokuroria dhe pa i dhënë kërkueses mundësinë për të komentuar mbi to, duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve.

C. PROCESI GJYQËSOR DHE EKZEKUTIMI

Zajmi kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 17/83907, Vendimi gjyqësor i datës 20 qershor 2023 [Komiteti]

Në çështjet ku ka dyshime mbi interpretimin e objektit kohor të një afati kohor më të shkurtër dhe të prezantuar rishtazi, gjykatat kombëtare nuk mund të rrëzojnë një ankim për faktin që është depozituar jashtë këtij afati kohor. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6(1) KEDNJ (E drejta për t'ju drejtuar gjykatës)*

Fakte: Kërkuesja është një shtetase shqiptare, e cila në vitin 2013 u shpall fajtoare për mashtrim në rrethana rënduese dhe u dënua me katërbëdhjetë vjet burgim nga një gjykatë penale e shkallës së parë. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e hodhën poshtë ankimin e kërkueses në vitin 2013 dhe 2015 përkatësisht.

Një ligj kombëtar i vitit 2016 shkurtoi afatin kohor për paraqitjen e një ankimi kushtetues nga dy vjet në katër muaj “nga momenti i marrjes dijeni për ndërhyrjen” në një të drejtë ose liri kushtetuese. Afati i ri kohor u bë i zbatueshëm që nga 1 marsi 2017. Më 27 shkurt 2017, kërkuesja u përpoq të dërgonte një ankim kushtetues me postë, por posta e saj nuk ishte dorëzuar për shkak të pamundësisë për të identifikuar marrësin sepse emri dhe adresa ishin të paplota. Kërkuesja e ridërgoi ankimin e saj kushtetues në adresën përkatëse të Gjykatës Kushtetuese më 22 maj 2017 (brenda afatit kohor dyvjeçar). Më 16 qershor, Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshme si të depozituar jashtë afatit kohor prej katër muajsh, duke filluar nga data e miratimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

Vendosi: Kur ligji i vitit 2016 u miratua, nuk ishte e qartë nëse ai do të zbatohet edhe për vendimin e kundërshtuar të miratuar para datës 1 mars 2017. Gjykata Kushtetuese e sqaroi këtë pikë më 16 qershor 2017, kur vendosi mbi ankimin e kërkuesit. Ky interpretim i afatit të ri kohor prej katër muajsh nuk ishte mjaftueshëm i parashikueshëm për ankuesit e mundshëm kushtetues përpara asaj date. Prandaj, në rastin konkret zbatohet afati dyvjeçar për paraqitjen e ankimit kushtetues. Përfundimi ndryshe do të binte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike (shihni *Çela kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 73274/17, 29 nëntor 2022). Në përfundim, vendimi për rrëzimin e ankimit të kërkuesit përbënte mohim të pajustificuar të së drejtës së kërkuesit për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.6(1) KEDNJ për shkak të mohimit të së drejtës për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

***Yzeiraj kundër Shqipërisë*, Kërkesa nr. 70455/10, Vendimi gjyqësor i datës 11 korrik 2023 [Komiteti]**

Të dyshuarit kanë të drejtë të thërrasin dëshmitarë në favor të tyre. Vendimi i gjykatave të brendshme për refuzimin e thirrjes dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve për t’u mbrojtur duhet të ofrojë arsye të mjaftueshme dhe adekuate për refuzimin e kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve. Më në përgjithësi, gjykatat e brendshme duhet të japin arsyet për vendimet e tyre (duke përfshirë ato që refuzojnë alibinë e një të dyshuari). Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6 (1) KEDNJ (E drejta për seancë dëgjimore të drejtë) dhe N.6(3) KEDNJ (E drejta për pyetjen e dëshmitarëve për t’u mbrojtur)*.

Fakte: Në nëntor 2004, kërkuesi u shpall fajtor nga Gjykata e Rrethit Fier për vrasjen e dy personave, plagosjen e rëndë të dy të tjerëve si dhe për armëmbajtje pa leje; prandaj ai u dënua me burgim të përjetshëm. Vepra penale ka ndodhur më 25 mars 2022. Dënimi u bazua më së shumti në provat e dhëna nga dëshmitarët, dëshmia e të cilëve kishte mospërputhje. Nuk kishte asnjë provë materiale kundër kërkuesit.

Kërkuesi mohoi akuzat kundër tij, duke pretenduar se në kohën e ngjarjeve ai kishte qenë në Greqi. Kjo është konfirmuar nga pasaporta e tij dhe policia e kontrollit kufitar. Kërkuesi kërkoi gjithashtu të thërriste një numër dëshmitarësh (të cilët dhanë deklaratimet e tyre me shkrim) për të konfirmuar alibinë e tij. Kërkesa e tij u refuzua dhe dënimi i tij u la në fuqi nga gjykatat e larta. Ankimi i tij kushtetues u rrëzua.

Vendosi: Sipas N.6(3)(d) KEDNJ, të dyshuarit kanë të drejtë të thërrasin dëshmitarë për t'u mbrojtur dhe gjykatat kanë detyrimin të japin arsytet për vendimet e tyre. Mbrojtja e kërkuesit bazohej në një alibi të fortë. Gjykatat refuzuan kërkesën e kërkuesit për dëshmitarë në këtë drejtim, pa kundërshtuar besueshmërinë e provave nga policia e kontrollit kufitar ose pasaportën e kërkuesit. Gjykatat e brendshme nuk dhanë arsye të përshtatshme për refuzimin e alibisë së kërkuesit. Kërkesa e kërkuesit për të thirrur dëshmitarët ishte mjaftueshëm e arsyetuar dhe e rëndësishme për shkak të vlerës së mundshme provuese të dëshmisë së tyre të drejtpërdrejtë në lidhje me alibinë e tij, e cila mund të kishte forcuar pozitën e mbrojtjes ose madje të çonte në lirimin e kërkuesit. Megjithatë, vendimet e gjykatave vendase nuk përmbanin asnjë shqyrtim të rëndësisë së dëshmisë së tyre të mundshme dhe nuk dhanë arsye të mjaftueshme për rrëzimin e kërkesës së kërkuesit. Deklarimet me shkrim nuk janë të mjaftueshme për të përjashtuar nevojën për dëshmi të drejtpërdrejtë. Kërkuesi duhej të kishte pasur mundësinë të paraqiste prova në mbrojtje të tij, në përputhje me parimin e barazisë së armëve.

Dënimi i kërkuesit bazohej në dëshmi me mospërputhje, të cilat nuk u trajtuan nga gjykatat kombëtare. Kështu, dëgjimi i dëshmitarëve të tjerë, siç kërkohet nga kërkuesi, ishte edhe më vendimtar. Gjykatat e brendshme refuzuan të thërrisnin dëshmitarë të tjerë dhe thjesht pranuan argumentet e prokurorisë, duke i hequr kështu kërkuesit mundësinë për të kundërshtuar akuzat kundër tij dhe duke krijuar një avantazh të padrejtë në favor të prokurorisë.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria ka shkelur N.6(1) dhe 3(d) të Konventës për shkak të refuzimit të gjykatave kombëtare për të

dëgjuar dëshmitarë shtesë për mbrojtjen, duke dëmtuar kështu drejtësinë e përgjithshme të procesit gjyqësor.

Leka kundër Shqipërisë, Kërkesa nr. 60569/09, Vendimi gjyqësor i datës 5 mars 2024

Gjykatat mund t'i ricilësojnë veprat penale nëse kërkuesi ka pasur dijeni për faktet në themel të akuzës së ndryshuar që nga fillimi i gjykimit të tij dhe nëse i akuzuari ka një mundësi të mjaftueshme për t'u mbrojtur - *nuk ka shkelje të N.6 KEDNJ (E drejta për një proces gjyqësor të drejtë)*

Fakte: Në vitin 2005 kërkuesi u arrestua në bazë të regjistrimeve sekrete të bisedave të tij në një komisarjat me vëllanë e tij, për vrasjen e një personi. Para marrjes në pyetje nga prokurorët, kërkuesi u informua për të drejtat e tij (përfshirë të drejtën për të heshtur dhe për t'u ndihmuar nga një avokat). Ai dha një deklaram pa praninë e avokati dhe u shpreh se do të vendoste më vonë nëse do të kishte avokat. Kërkuesi e pranoi vrasjen dhe mori pjesë në paraqitjen për njohje, gjatë së cilës një dëshmitar e njohu atë si autorin e krimit. Kërkuesi nënshkroi procesverbalin e marrjes në pyetje dhe atë të paraqitjes për njohje. Kërkuesi u mor sërish në pyetje nga prokurori, në të njëjtat kushte si herën e parë dhe firmosi procesverbalin.

Në tetor 2005, avokatit të kërkuesit të caktuar nga shteti ju njoftua aktakuza. Kërkuesi u akuzua për vrasjen e dy ose më shumë personave në rrethana të tjera specifike dhe mbajtje pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit. Gjatë procesit, ai ndryshoi versionin e tij të ngjarjeve. Në dhjetor 2005, gjykata e shkallës së parë e shpalli kërkuesin fajtor sipas akuzës.

Gjatë procesit në apel, avokati i caktuar nga shteti (rishtazi) që përfaqësonte kërkuesin pretendoi shkeljen e të drejtës së kërkuesit për t'u marrë në pyetje në prani të një avokati në fazën e hetimit dhe që kërkuesi kishte nënshkruar procesverbalin e marrjes në pyetje nga prokuroria nën presion. Avokati i tij kërkoi edhe ndryshimin e akuzës në veprën penale të vrasjes me dashje. Gjykata e Apelit ndryshoi cilësimin e veprave penale për arsye se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim ligjin për faktet e provuara. Në prill të vitit 2006, kërkuesi u shpall fajtor për vjedhje me armë të mbetur në tentativë që shkaktoi vdekje dhe për vrasje të një personi tjetër të mbetur në tentativë (ai që e identifikoi gjatë paraqitjes për njohje) me qëllim për të kryer një krim tjetër, si dhe për armëmbajtje pa leje. Vendimi nuk përmendte fare paraqitjen për njohje, apo pranimin nga kërkuesi në prokurori.

Gjykata e Lartë rrëzoi ankimin e kërkuessit. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin kushtetues të kërkuessit në maj 2009 me arsytimin se, sipas ligjit të brendshëm, gjykatat e apelit mund të ndryshojnë cilësimin juridik të fakteve. Kërkuessi po vuan dënimin e përjetshëm në një burg të sigurisë së lartë.

Vendosji: Mënyra në të cilën është kryer paraqitja për njohje nuk ka shkelur N.6(1) KEDNJ, pasi – ndër të tjera – personi që kishte identifikuar kërkuessin kishte dhënë tashmë një përshtkrim të detajuar të autorit përpara paraqitjes. Për më tepër, gjykata e apelit nuk u mbështet në paraqitjen për njohje, por më tepër në dëshminë që personi përkatës dha në gjykim, e cila u vërtetua nga prova të tjera (p.sh. regjistrimi i bisedës së kërkuessit në komisariat).

Sa i përket ricolësimit të një veprë penale, N. 6(3)(a) KEDNJ i jep të pandehurit të drejtën për t'u informuar për cilësimin juridik që u bëhet akteve për të cilat ai akuzohet të ketë kryer. Ky është një parakusht thelbësor i një procesi të drejtë penal dhe e lejon të akuzuarin të ushtrojë të drejtën e tij për t'u mbrojtur. Ricolësimi i një veprë penale nuk do të cenojë të drejtat e mbrojtjes nëse i akuzuari ka mundësi të mjaftueshme për të mbrojtur veten.

Në rastin konkret, elementët përbërës të veprës penale të vrasjes (d.m.th, krimi për të cilin u akuzua fillimisht kërkuessi dhe për të cilin u dënua në shkallën e parë) nuk ishin domosdoshmërisht të njëjtë sipas legjislacionit të brendshëm me ato të veprës penale të vjedhjes me dhunë që rezultoi në vdekjen e një personi. . Megjithatë, faktet në themel të akuzës së ndryshuar ishin të njohura për kërkuessit që në fillim të gjykimit të tij, sepse ato ishin pretenduar nga prokurori dhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, avokati i kërkuessit kërkoi ricolësimin e akuzave dhe kërkuessi adresoi rrethanat që lidhen me veprën penale të vjedhjes me dhunë në mbrojtje të tij. Prandaj, kërkuessi mund të kishte parashikuar ricolësimin e akuzave kundër tij dhe ai kishte kohën dhe lehtësitë e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Shqipëria nuk ka shkelur: i) N.6(1) të Konventës, meqenëse kërkuessit nuk iu privua një seancë e drejtë, ii) N.6(3)(a) të Konventës, sepse kërkuessi ishte mjaftueshëm i informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, dhe iii) N. 6(3)(b) të Konventës, për shkak se kërkuessi kishte kohën dhe lehtësitë e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij.

Orhan Şahin kundër Turqisë, Kërkesa nr. 48309/17, Vendimi gjyqësor i datës 12 mars 2024

Gjykatat penale kanë detyrimin të dëgjojnë provat nga personat, deklaratimet e të cilëve përfaqësojnë shkakun kryesor të një dënimi penal (i ashtuquajturit parimi i atypëratyshëmërisë). Nëse gjykata më e ulët penale nuk vepron në këtë mënyrë, gjykatat e larta duhet të korrigjojnë paragjykimin që rrjedh nga shkelja e parimit të atypëratyshëmërisë. Mosveprimi në këtë mënyrë mund të përbëjë *shkelje të N.6(1) KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor të drejtë)*

Fakte: Në dhjetor 2011, gjatë një proteste, një mjet shpërthyes i improvizuar shpërtheu papritur në dorën e personit që kishte planifikuar ta hidhte në drejtim të punonjësve të policisë. Ai person u arrestua dhe, gjatë marrjes në pyetje në prani të avokatit të tij, e identifikoi kërkuesin nga fotografitë që ju treguan dhe deklaroi se ai ishte detyruar të hidhte bombën për shkak të kërcënimeve dhe veprimeve mashtruese nga ana e kërkuesit dhe dy personave të tjerë.

Pas arrestimit të tij në dhjetor 2011, kërkuesi deklaroi se ai nuk e njihte autorin (fotoja e përdorur për ta identifikuar atë në fakt nuk ishte e tij) dhe nuk ishte i përfshirë në sulm ose në aktivitete të tjera në lidhje me PKK-në. Edhe pse më vonë autori e tërhoqi deklarin për përfshirjen e kërkuesit në atë shpërthim bombe, në gusht 2012, Gjykata Assize e Erzurumit e dënoi kërkuesin për anëtarësim në një organizatë të armatosur terroriste dhe e dënoi atë me trembëdhjetë vjet e gjashtë muaj burgim. Gjykata vendosi njëzëri të lirojë kërkuesin nga akuzat e tjera. Pas hapave të mëtejshme procedurale, në mars 2014, Gjykata e Kasacionit anuloi vendimin e gjykatës së faktit për aq sa kishte të bënte me kërkuesin, duke mbajtur mendimin se ai duhej të shpallej fajtor për veprat e tjera dhe e ktheu çështjen në gjykatat më të ulëta.

Për shkak të mbylljes së gjykatave *assize* të autorizuara posaçërisht (përfshirë Gjykatën Assize të Erzurumit), çështja e kërkuesit iu caktua Gjykatës Assize së Doğubayazit, e cila përbëhej nga gjyqtarë që nuk kishin qenë në trupin gjykues të Gjykatës Assize të Erzurumit. Gjyqtarët refuzuan kërkesat e kërkuesit për të pyetur autorin në gjykatë me arsyetimin se kjo nuk do të kishte ndonjë ndikim në themelin e çështjes. Në dhjetor 2014, gjykata konfirmoi dënimin e kërkuesit për të gjitha veprat penale, me përjashtim të anëtarësimit në një organizatë terroriste, pasi ishte një element përbërës i krimeve më të rënda. Arsyetimi i vendimit gjyqësor ishte pothuajse identik me arsyetimin e miratuar nga Gjykata Assize e Erzurumit, duke përfshirë vëzhgimet në lidhje me sjelljen dhe deklarin e autorit gjatë procesit. Kërkuesi u dënua me burgim të përjetshëm për cenim të unitetit të Shtetit

dhe integritetit të tij territorial, dhe, në lidhje me veprat e mbetura, një dënim total me njëzet vjet, dhjetë muaj e pesë ditë burgim dhe gjobë. Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë si të papranueshëm ankimin e kërkuarit për pamundësinë për të marrë në pyetje autorin përpara Gjykatës Assize të Doğubayazit, me arsyetimin se gjykata e faktit ishte mbështetur në prova të tjera përveç deklarimeve të autorit (p.sh. raporti i policisë).

Vendosj: Sipas N. 6(1) KEDNJ, një aspekt i rëndësishëm i procesit të drejtë penal është aftësia e të akuzuarit për t'u ballafaquar me dëshmitarët në prani të gjyqtarit i cili përfundimisht vendos për çështjen. Sipas parimit të atypëratyshmërisë, vendimi në një çështje penale duhet të merret nga gjyqtarët që kanë qenë të pranishëm gjatë gjithë procesit gjyqësor dhe procesit të mbledhjes së provave. Në rastin e një ndryshimi në përbërjen e një gjykate, mund të merren masa të ndryshme për të siguruar që gjyqtarët e sapoemëruar të kuptojnë si duhet provat dhe argumentet (p.sh., duke organizuar një përsëritje të seancës dëgjimore).

Në çështjen në fjalë, Gjykata Assize e Erzurumit është mbështetur kryesisht në deklarimet e bëra nga autori në përcaktimin e bazës faktike të akuzave kundër kërkuarit. Besueshmëria e autorit, deklarimet e të cilit luajtën një rol kyç në ndjekjen penale të kërkuarit dhe i cili më vonë tërhoqi pjesë të deklarimeve të tij në lidhje me kërkuarin, ishte e rëndësishme në proceset përpara Gjykatës Assize të Doğubayazit . Për dënimin e kërkuarit kjo gjykatë është mbështetur më së shumti në deklarimin e autorit, edhe nëse asnjë nga gjyqtarët nuk do të kishte marrë pjesë në fazat e mëparshme të procesit penal kundër kërkuarit ose nuk do të kishte dëgjuar prova nga ai. Gjykata refuzoi gjithashtu kërkesën e kërkuarit për të dëgjuar provat nga autori i krimin. Prandaj, kërkuarit nuk iu dha mundësia për t'u përballur me dëshmitarët në prani të gjyqtarit që vendosi përfundimisht për çështjen, dhe ky është arsyetimi themelor i parimit të atypëratyshmërisë.

Për më tepër, në vendimin e saj gjyqësor, Gjykata Assize e Doğubayazit riprodhoi, pothuajse fjalë për fjalë, linjën e arsytimit të miratuar nga Gjykata Assize e Erzurumit, duke përfshirë vëzhgimet e asaj gjykate mbi besueshmërinë e autorit. Në këtë kontekst, masat mbrojtëse procedurale në zbatim (disponueshmëria e deklarimeve të zbardhura të autorit ose mundësia që i jepet kërkuarit për të ushtruar të drejtat e tij elementare të mbrojtjes) nuk ishin të tilla që të korrigjonin paragjykimet që rrjedhin nga mangësitë nga këndvështrimi i parimit të atypëratyshmërisë, madje as gjykatat e larta nuk e korrigjuan këtë paragjykim. Rëndësia e parimit të atypëratyshmërisë u konfirmua më tej nga dallimi në parashtrimet e bëra dhe konkluzionet

e arritura nga gjyqtarët që kishin dëgjuar drejtpërdrejt autorin dhe ata që nuk e kishin dëgjuar. Gjykata Assize e Erzurumit e dënoi kërkuesin vetëm për veprën penale të anëtarësimit në një organizatë të armatosur terroriste, ndërkohë që Gjykata e Kasacionit mendoi se kërkuesi kishte kryer të gjitha veprat që i atribuoheshin dhe për këtë arsye duhej të shpallej fajtor dhe të dënohej në përputhje me rrethanat.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Turqia ka shkelur N. 6(1) të Konventës për shkak të mosrespektimit të kërkesave të parimit të atypëratyshmërisë nga gjykata e brendshme, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë.

Vučković kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 15798/20, Vendimi gjyqësor i datës 12 dhjetor 2023

Në rast përdhunimi dhe dhune seksuale, gjykatat kombëtare duhet të bëjnë një shqyrtim të kujdesshëm të të gjitha konsideratave përkatëse që lidhen me rastin (duke përfshirë interesat e viktimave dhe pasojat e sulmeve ndaj tyre). Në rast se gjykata e apelit zbut dënimin më të rëndë të vendosur nga një gjykatë e shkallës së parë, ajo duhet të japë arsyet e duhura për zbutjen e dënimit. Dështimi në luftën kundër dhunës ndaj grave në mënyrë efektive mund t'i dekurajojë viktimat nga kallëzimi i krimeve – *Shkelje e N.3 KEDNJ (Ndalimi i trajtimit poshtëruar) dhe N.8 KEDNJ (E drejta për respektimin e jetës private)*

Fakte: Kërkuesja është një shtetase kroat që ka punuar si infermiere. Në vitin 2015, ajo bëri një kallëzim penal kundër kolegut të saj shofer i ambulancës, duke e akuzuar atë për dhunë seksuale (prekje, kapje në pjesë të trupit të saj, përpjekje për të detyruar për të kryer seks oral) gjatë turneve së bashku midis prillit dhe qershorit 2015. Veprimet e tij ishin shoqëruar me gjuhë të papërshtatshme dhe kërcënime se do të pushohej nga puna nëse i tregonte dikujt për atë që kishte ndodhur. Policia ka marrë në pyetje të akuzuarin, i cili në qershor të vitit 2015 u transferua në një post tjetër, për të punuar si shofer ambulance në një qytet tjetër.

Përfundimisht, gjykata e shkallës së parë e shpalli fajtor të akuzuarin për dy akuza për kryerjen e veprimeve të turpshme (çdo veprim me konotacion seksual që nuk arrin në marrëdhënie seksuale pa pëlqim) dhe e dënoi atë me dhjetë muaj burgim. Gjykata vuri në dukje veçanërisht si faktorë rëndësues faktin që veprat seksuale ishin kryer në mënyrë të përsëritur dhe në një interval të shkurtër kohe. Në vitin 2019, gjykata e apelit konfirmoi

dënimin, por zëvendësoi dënimin me burgim me punë në interes publik, e cila u krye në mënyrë të rregullt deri në nëntor 2020. Gjykata e shkallës së dytë konstatoi se puna në interesit publik do t'i kishte shërbyer qëllimit të dënimit, duke pasur parasysh se kishin kaluar katër vjet që nga sulmet dhe autori nuk kishte kryer ndonjë krim tjetër. Vendimi ishte i formës së prerë dhe i pandryshueshëm nga rishikimi kushtetues.

Në vitin 2018, kërkuesja paraqiti një padi civile për dëmshpërblim kundër të akuzuarit dhe punëdhënësit të saj, dhe një tjetër padi civile kundër punëdhënësit të saj për diskriminim. Të dy proceset civile janë ende në pritje në gjykatën e shkallës së parë. Kërkuesja kishte qenë me raport mjekësor për disa periudha si rezultat i dëmtimit në krahun e saj të shkaktuar nga dhuna e M.P ndaj saj (qershor 2015), çrregullim i stresit post-traumatik (korrik - shtator 2015) dhe gjendje akute psikologjike e shkaktuar pas vendimi përfundimtar (tetor 2019-janar 2020).

Vendosi: Përdhunimi dhe dhuna e rëndë seksuale përbën trajtim që përfshihet në N.3 KEDNJ dhe gjithashtu inkurajon vlera themelore dhe aspekte thelbësore të "jetës private" sipas kuptimit të N.8 KEDNJ. Sipas këtyre dispozitave, Shtetet kanë detyrimin pozitiv të miratojnë ligje penale që dënojnë në mënyrë efektive përdhunimin dhe t'i zbatojnë ato në praktikë përmes hetimit dhe ndjekjes penale efektive, në mënyrë që të vërtetohet fakti, të identifikohen dhe, nëse me vend, të ndëshkohen personat përgjegjës. Gjykatat kombëtare penale kanë detyrimin të shqyrtojnë me kujdes të gjitha konsideratat përkatëse në lidhje me çështjen. Masa e dënimit duhet të jetë proporcionale me rëndesën e aktit.

Në çështjen në fjalë, trajtimi që ka pësuar kërkuesja përfshihet në N.3 KEDNJ dhe N.8 KEDNJ. Edhe duke pranuar rëndësinë në rritje të punës në interes publik si një komponent integral dhe të dobishëm të politikës moderne penale, konsensusi i gjerë ndërkombëtar mbi nevojën për të qëndruar të palëkundur ndaj abuzimit seksual dhe dhunës ndaj grave kërkon që gjykatat e brendshme t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kur vendosin të aplikojnë punën në interes publik në vend të dënimit me burg për këto lloj krimesh. Abuzimi seksual i grave është një vepër shumë e rëndë dhe një formë e dhunës me bazë gjinore, në lidhje me të cilën ndjekja penale dhe dënimin luajnë një rol vendimtar.

Gjykatat kombëtare nuk morën kurrë parasysh një sërë faktorësh që ishin të rëndësishëm sipas legjislacionit të brendshëm, të tilla si pasojat për kërkuesen (d.m.th., periudhat e raportit mjekësor), sjelljen e autorit (p.sh., kërcënimet

ndaj kërkueses), mungesën e pendimit të tij dhe/ose çdo përpjekje për të kompensuar dëmin e shkaktuar ndaj kërkueses. Duke e ndryshuar dënimin me burg në punë në interes publik, gjykata e apelit nuk përmendi faktorët rëndues të identifikuar nga gjykata e shkallës së parë, si shkalla e lartë e përgjegjësisë penale të autorit apo qëllimi i tij i fortë në kryerjen e veprave seksuale në fjalë. Për më tepër, gjykata e apelit nuk shpjegoi pse kalimi i kohës peshoi më shumë se këto rrethana rënduese. Prandaj, gjykata e apelit nuk bëri një shqyrtim të kujdesshëm të të gjitha konsideratave përkatëse në lidhje me çështjen.

Gjykata e apelit nuk ka dhënë arsye adekuate, nuk ka marrë në konsideratë në asnjë mënyrë interesat e viktimës, të cilat gjykatat e brendshme janë të detyruara t'i marrin parasysh kur vendosin për dënimin që do të jepet në një rast të caktuar. Kjo qasje mund të jetë tregues i njëfarë zbutjeje në ndëshkimin e dhunës ndaj grave, e cila mund t'i dekurajojë viktimat për të denoncuar krimet (shihni Raporti i vlerësimit bazë të GREVIO-s për Kroacinë (GREVIO /Inf(2023)6), 10 korrik 2023).

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Kroacia ka shkelur N. 3 dhe N. 8 të Konventës për shkak se gjykatat e saj të brendshme nuk i trajtuan siç duhet aktet e përsëritura të dhunës seksuale që kërkuesja kishte pësuar në vendin e saj të punës

Në lidhje me detyrimet procedurale që rrjedhin nga N. 3 dhe 8 KEDNJ në rastin e përdhunimit ose dhunës së rëndë seksuale, shihni edhe *Xkundër Greqisë* – [Pjesa III.B.](#)

Në lidhje me ndikimin e teknologjive të reja në të drejtën për proces gjyqësor të drejtë në procese penale shihni edhe *Yüksel Yalçınkaya kundër Turqisë* – [Pjesa V.](#)

IV. Liria e Shprehjes dhe Informimit

Macate kundër Lituanisë [DHM], Kërkesa nr. 61435/19, Vendimi gjyqësor i datës 23 janar 2023

Librat me përralla për fëmijë që përshkruajnë marrëdhëniet e të njëjtit seks janë mënyra për të shprehur mendimin e dikujt dhe për të dhënë informacion. Autoritetet e brendshme (duke përfshirë gjykatat) nuk mund të pezullojnë shpërndarjen e këtyre librave dhe/ose t'i etiketojnë si të dëmshëm për fëmijët nën 14 vjeç nëse këto vendime bazohen vetëm në arsyen e orientimit seksual (dhe jo sepse, p.sh., librat përshkruajnë shumë informacion të qartë në aspektin seksual). Një sjellje e ndryshme përbën *shkelje të N. 10 KEDNJ (Liria e shprehjes)*.

Fakte: Kërkuesja ishte autore lezbike për fëmijë. Në dhjetor 2013, Universiteti Lituanëz i Shkencave Arsimore botoi një nga librat e saj, me financim të pjesshëm nga Ministria e Kulturës. Libri, i cili u drejtohej fëmijëve nëntë/dhjetë vjeç, përmbante një përshtatje të përrallave tradicionale. Dy nga gjashtë përrallat në libër kishin histori për marrëdhëniet dhe martesat mes personave të të njëjtit seks. Në mars të vitit 2014, Ministria e Kulturës përcolli një ankesë me pretendimin se libri “inkurajonte perversitetet”. Ministria kërkoi nga autoriteti kompetent që të vlerësojë nëse libri mund të jetë i dëmshëm për fëmijët. Në të njëjtën kohë, pas një letre të dërguar nga tetë anëtarë të Parlamentit Lituanëz, Universiteti pezulloi shpërndarjen e librit. Në prill, vlerësimi doli në përfundimin se dy përrallat e kontestuara nuk ishin në përputhje me një dispozitë kombëtare sipas së cilës çdo informacion që “shpreh përbuzje për vlerat familjare” ose “nxit një koncept të ndryshëm të martesës dhe krijimit të familjes nga ai i parashikuar në Kushtetutë ose Kodi Civil” konsiderohet me efekt negativ për të miturit. Autoriteti rekomandoi që libri të etiketohej me një paralajmërim se mund të ishte i dëmshëm për fëmijët nën 14 vjeç. Në vitin 2015 rifilloi shpërndarja, me librin që kishte etiketën paralajmëruese.

Kërkuesja filloi një proces civil kundër Universitetit, duke argumentuar se përshkrimi i marrëdhënieve të të njëjtit seks nuk mund të konsiderohet i dëmshëm për fëmijët e çdo moshe. Në fund, gjykatat lituaneze rrëzuan pretendimin e saj, duke gjetur se libri mund t’u shkaktonte dëm fëmijëve, disa pasazhe ishin shumë të detajuara në aspektin seksual dhe mënyra në të cilën përrallat përshkruanin një model të ri familjar ngriti pyetjen nëse

vetë kërkuesja kishte synuar diskriminimin kundër atyre që mbanin vlera të ndryshme nga ato të sajat.

Ky ishte rasti i parë ku Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kishte vlerësuar kufizimet në literaturë për marrëdhëniet e të njëjtit seks të shkruar posaçërisht për fëmijët. Dhoma së cilës i ishte caktuar çështja hoqi dorë nga kompetenca në favor të Dhomës së Madhe.

Vendosi: Gjykata konstaton se masat e kundërshtuara përbënin një ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes së kërkueses të mbrojtur nga N.10 KEDNJ. Së pari, librat e saj ishin tërhequr nga dyqanet, duke ulur kështu disponueshmërinë për lexuesit. Së dyti, etiketat paralajmëruese kishin gjasa të largonin një numër të konsiderueshëm prindërisht dhe kujdestarësh që të mos lejonin fëmijët nën moshën 14 vjeç të lexonin librin. Prandaj, shënimi i librit ndikoi në aftësinë e kërkueses për t'i ndarë lirisht idetë e saj. Së treti, etiketat ndikuan në reputacionin e kërkueses si një autore e njohur për fëmijë dhe mund ta dekurajonin atë dhe autorë të tjerë që të botonin literaturë të ngjashme.

Gjykata trajtoi nëse ndërhyrja ishte legjitime sipas N.10(2) KEDNJ. Së pari, ajo doli në përfundimin se kufizimi ishte i ligjshëm, pasi kishte një bazë ligjore në të drejtën e brendshme.

Për sa i përket qëllimit, Qeveria parashtroi se qëllimi ishte mbrojtja e fëmijëve nga informacioni tepër i detajuar seksual dhe nga përmbajtja që "promovonte" marrëdhëniet mes të njëjtit seks. Gjykata e hodhi poshtë qëndrimin e Qeverisë. Së pari, nuk mund të kuptonte se si disa pasazhe (veçanërisht, një princeshë dhe vajza e një këpucari që flinin në krahët e njëra-tjetres pas dasmës së tyre) përshkruanin dashurinë trupore shumë hapur për fëmijët, siç kishin konkluduar gjykatat e brendshme. Së dyti, gjykatat kombëtare nuk dhanë arsye adekuate për të justifikuar se përrallat kishin qenë "inkurajuese" ose "promovuese" të disa llojeve të marrëdhënieve në dëm të të tjerave, ose se ato kishin për qëllim të "fyerin", "degradonin" ose "nënçmonin" marrëdhëniet e gjinive të ndryshme, siç pretendohet nga qeveria. Përkundrazi, libri i kërkueses synonte të inkurajonte respektin dhe pranimin e grupeve të ndryshme shoqërore të marginalizuara. Gjithashtu, Gjykata konstaton se historia legjislative e dispozitave kombëtare që mbështesin masat e kundërshtuara, së bashku me shembujt e zbatimit të saj, tregoi se qëllimi themelor legjislativ ishte të kufizonte aksesin e fëmijëve në informacionin që paraqiste marrëdhëniet mes të njëjtit seks si në thelb ekuivalente me marrëdhëniet mes seksit të ndryshëm.

Gjykata e vlerësoi këtë qëllim si të paligjshëm për qëllimin e N. 10(2) KEDNJ. Së pari, Gjykata solli në kujtesë se dallimet e bazuara në orientimin seksual kërkojnë “arsye veçanërisht bindëse dhe me peshë” si formë justifikimi. Për më tepër, siç konfirmohet nga disa organe ndërkombëtare, nuk kishte asnjë provë shkencore ose të dhëna sociologjike në dispozicion që sugjeronin se thjesht përmendja e homoseksualitetit, ose debati i hapur publik rreth statusit social të pakicave seksuale, do të ndikonte negativisht te fëmijët. Gjithashtu, ligjet e një numri të konsiderueshëm të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës ose përfshijnë në kurrikulën shkollore në mënyrë eksplicite mësimin për marrëdhëniet mes të njëjtit seks, ose përmbajnë dispozita për garantimin e respektimit të diversitetit dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të orientimit seksual në mësimdhënie. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se masat e kundërshtuara kufizonin aksesin e fëmijëve në informacion për marrëdhëniet mes të njëjtit seks vetëm në bazë të orientimit seksual. Masat e këtij lloji tregojnë se autoritetet preferojnë disa lloje marrëdhëniesh (marrëdhëniet e sekseve të ndryshme) mbi të tjerat (marrëdhëniet e të njëjtit seks), duke kontribuar kështu në stigmatizimin e vazhdueshëm të këtyre të fundit. Prandaj, këto kufizime janë të papajtueshme me nocionet e barazisë, pluralizmit dhe tolerancës të qenësishme në një shoqëri demokratike.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Lituania ka shkelur N.10 KEDNJ sepse masat e kundërshtuara nuk ndiqnin ndonjë qëllim legjitim për qëllimet e kësaj dispozite.

Sanchez kundër Francës [DHM], Kërkesa nr. 45581/15, Vendimi gjyqësor i datës 15 maj 2023

Kur politikanët vendosin të përdorin një media sociale të hapur për publikun (siç është një “mur” në Facebook) për qëllime politike (p.sh., një fushatë zgjedhore), ata kanë detyra dhe përgjegjësi, sidomos parandalimin dhe goditjen e “gjuhës së urrejtjes” nga palët e treta - veçanërisht nëse politikanin është vënë në dijeni për komentet e urrejtjes. Dënimi penal i politikanëve përbën një ndërhyrje në lirinë e politikanit për të ndarë informacion. Megjithatë, nëse gjuha e komenteve të palës së tretë në mënyrë të qartë nxit urrejtje dhe dhunë kundër një personi për shkak të fesë së tij, kjo ndërhyrje mund të konsiderohet legjitime duke marrë në llogje parasysh dënimin (p.sh. një gjobë e vogël) dhe pasojat e tjera me të cilat përballen politikanët – *Nuk ka shkelje të N.10 KEDNJ (Liria e shprehjes).*

Fakte: Në kohën e ngjarjeve, kërkuesi ishte kryetar bashkie dhe garonte për zgjedhje në Parlament për partinë Fronti Kombëtar (FN) dhe kishte ekspertizë

profesionale në çështjet e strategjisë së komunikimit online. Në tetor 2011, kërkuesi postoi një mesazh për kundërshtarët e tij politikë në “murin” e tij në Facebook të hapur për publikun, të cilin ai e menaxhonte vetë. Dy persona shtuan disa komente nën postimin e tij. Në të njëjtin muaj, partnerja e kundërshtarit politik të kërkuesit u vu në dijeni për ato komente, të cilat ajo i konsideroi “raciste”. Ajo shkoi menjëherë në dyqanin e menaxhuar nga S.B. (njëri nga komentuesit), i cili menjëherë e fshiu komentin e kontestuar. Partnerja e kundërshtarit politik gjithashtu kërkoi nga prokurori që të bënte kallëzim penal kundër kërkuesit dhe dy komentuesve. Ditën tjetër, kërkuesi postoi një mesazh në “murin” e tij ku ftoi përdoruesit të ishin të kujdesshëm me përmbajtjen e komenteve të tyre; megjithatë, ai nuk ndërhyri në lidhje me komentet e postuara tashmë.

Në vitin 2013, kërkuesi dhe komentuesit e sipërpërmendur u dënuan për nxitje të urrejtjes ose dhunës kundër një grupi ose individi (në veçanti, partneres së kundërshtarit) për shkak të origjinës së tyre ose faktit të përkatësisë ose jo në një grup etnik, komb, racë ose fe të caktuar. Në veçanti, nga vendimet rezultoi se komentet përcaktonin qartë grupin në fjalë, përkatësisht personat e besimit mysliman, dhe se lidhja e komunitetit mysliman me krimin dhe pasigurinë kishte gjasa të ngjallte një ndjenjë të fortë refuzimi ose armiqësie ndaj atij grupi. Kërkuesi u shpall fajtor si autori kryesor. Ai kishte krijuar një shërbim online për komunikim (“murin” e Facebook-ut) dhe e bëri atë të hapur për publikun, ndaj kishte marrë përgjegjësinë për përmbajtjen e komenteve ofenduese të postuara. Për më tepër, statusi i tij si politikan kërkonte që ai të ishte edhe më i kujdesshëm. Në këtë çështje, ai nuk kishte vepruar menjëherë për të ndaluar shpërndarjen e këtyre komenteve ofenduese. Dy komentuesit u shpallën fajtorë si bashkëpunëtorë.

Kërkuesit dhe dy komentuesit u urdhëruan të paguanin një gjobë prej 4,000 euro secili (në fund u ul nga gjykata e apelit në 3,000 euro). Kërkuesi dhe një nga komentuesit u urdhëruan gjithashtu, së bashku, t’i paguanin shumë prej 1000 euro partneres së kundërshtarit si kompensim për dëmin e saj jopasuror (që gjykata e apelit e rikualifikoi si kosto).

Vendosj: Dënimi penal i kërkuesit përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes, siç garantohet nga neni 10 i KEDNJ-së.

Ndërhyrja ishte “e parashikuar me ligj”, sepse baza ligjore e brendshme për dënimin e tij ishte mjaft e saktë për çështjen e përgjegjësisë së përbashkët. Veçanërisht, baza ligjore e brendshme përkatëse, siç interpretohet nga gjykatat kombëtare, e përkufizon “prodhuesin” si një person që ka marrë

iniciativën e krijimit të një shërbimi komunikimi elektronik për shkëmbimin e mendimeve për tema të paracaktuara - si “muri” i kërkuesit në Facebook në rastin në fjalë. Gjykata franceze nuk kishte zbatuar kurrë dispozitat përkatëse të brendshme për çështjen e përgjegjësisë së mbajtësit të llogarisë në Facebook (në rastin konkret, një politikan gjatë një fushate zgjedhore) për komentet e postuara në “muri” e tij (veçanërisht në një kontekst politik dhe elektoral). Megjithatë, risia e pyetjeve ligjore nuk ishte në vetvete e papajtueshme me kërkesat e aksesueshmërisë dhe parashikueshmërisë së ligjit dhe interpretimi i gjykatave të brendshme nuk ishte arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm.

Dënimi i kërkuesit ndiqte qëllimet legjitime të mbrojtjes së reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve dhe parandalimin e trazirave dhe krimit.

Gjykata vlerësoi nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Ajo rikujtoi se ka pak hapësirë në bazë të N.10(2) KEDNJ për kufizimet e lirisë së shprehjes në fushën e fjalës politike. Megjithatë, liria e debatit politik mund të kufizohet për të penalizuar apo edhe për të parandaluar të gjitha format e shprehjes që propagandojnë, inkurajojnë, nxisin ose justifikojnë urrejtjen bazuar në intolerancë, me kusht që masat parandaluese dhe represive të jenë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur. Në çështjen në fjalë, Gjykata duhej të vlerësonte proporcionalitetin e kufizimit të vendosur mbi të drejtën e kërkuesit.

Së pari, Gjykata vlerësoi natyrën e komenteve, kontekstin politik dhe përgjegjësinë specifike të kërkuesit në lidhje me komentet e postuara nga palët e treta. Sa i përket natyrës së komenteve, Gjykata vuri në dukje se nuk ekziston një përkufizim universal i “gjuhës së urrejtjes”, prandaj shqyrtimi i përmbajtjes së komenteve të diskutueshme ishte i nevojshëm, veçanërisht nisur nga vendimet e gjykatave të brendshme. Gjykata vërejti se ndikimi i ligjëratis raciste dhe ksenofobike bëhet më i madh dhe më i dëmshëm në kontekstin zgjedhor, veçanërisht kur klima politike dhe sociale, në nivel lokal është e trazuar – si në rastin në fjalë. Nisur nga sa më sipër, komentet e kontestuara përbëjnë gjuhë të urrejtjes.

Në lidhje me kontekstin politik dhe përgjegjësinë specifike të kërkuesit për komentet e postuara nga palët e treta, Gjykata theksoi se tiparet specifike të çështjes nxitën një qasje të bazuar në “detyrat dhe përgjegjësitë”, sipas kuptimit të N. 10(2) KEDNJ, të figurave politike kur vendosin të përdorin mediat sociale për qëllime politike. Prodhuesit dhe përdoruesit e platformave të mediave sociale i nënshtrohen regjimit të përgjegjësisë së përbashkët

i cili lejon caktimin e shkallëzuar të përgjegjësisë sipas situatës specifike në fjalë. Ligji francez ishte në përputhje me këtë pikëpamje. Për më tepër, gjuha e përdorur në komentet në fjalë nxiti qartë urrejtjen dhe dhunën kundër një personi për shkak të fesë së tij dhe kjo nuk mund të maskohet ose minimizohet nga konteksti zgjedhor ose nga dëshira për të diskutuar vështirësitë lokale.

Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se një çështje tjetër kishte të bënte me hapat që kërkuesi duhej të kishte – ose mund të kishte ndërmarrë në mënyrë të arsyeshme në cilësinë e tij si “prodhues”, siç përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm. Së pari, kërkuesi kishte zgjedhur ta mbante “murin” e tij në Facebook të hapur për publikun. Kërkuesi i dinte pasojat potencialisht të rënda të vendimit të tij në funksion të tensioneve lokale dhe të lidhura me zgjedhjet në atë kohë (duke marrë parasysh gjithashtu ekspertizën e tij në fushën digjitale). Për më tepër, edhe nëse kërkuesi u kishte kërkuar përdoruesve të tjerë që të siguroheshin që komentet e tyre të ishin të ligjshme, ai nuk i kishte fshirë komentet e kontestuara. Në lidhje me këtë Gjykata vërejti se kërkuesi ishte dënuar sepse nuk veprroi shpejt për të fshirë të gjitha komentet e paligjshme në fjalë - pra jo për shkak të komenteve të bëra nga dy autorët veçmas. Për më tepër, gjykatat e brendshme kishin nxjerrë vendime të arsyetuara dhe kishin vijuar me një vlerësim të arsyeshëm nëse kërkuesi kishte qenë në dijeni të komenteve të paligjshme të postuara në “murin” e tij në Facebook. Në rastin në fjalë, në përgjigje të postimit të tij kishte vetëm rreth pesëmbëdhjetë komente. Prandaj, nuk u ngrit asnjë dyshim për vështirësitë e shkaktuara nga trafiku potencialisht i tepruar në llogarinë e një politikani dhe burimet e nevojshme për të siguruar monitorimin efektiv të tij.

Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se veprimet për të cilat kërkuesi u akuzua ishin të ndryshme nga ato të kryera nga autorët e komenteve të paligjshme dhe rregulloheshin nga një regjim tjetër përgjegjësie, një regjim që lidhej me statusin specifik dhe autonom të “prodhuesit”. Në këto rrethana, kërkuesi nuk u ndoq penalisht në vend të autorëve të komenteve, të cilët edhe vetë u dënuan.

Në fund, Gjykata pranoi se një dënim penal mund të ketë efekt frenues te përdoruesit e platformave të mediave sociale. Megjithatë, kërkuesi u dënua vetëm me gjobë prej 4.000 eurosh, e cila më vonë u ul në 3.000 euro, së bashku me pagesën prej 1.000 euro palës civile. Nuk kishte pasojë të tjera për kërkuesit në lidhje me gëzimin e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes në mediat sociale ose në arenën politike.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Franca nuk ka shkelur N.10 KEDNJ, duke qenë se dënimi penal ishte një ndërhyrje “e nevojshme në një shoqëri demokratike”: vendimet e gjykatave të brendshme bazoheshin në arsye relevante dhe të mjaftueshme, si për sa i përket përgjegjësisë që i atribuohet kërkuesit, në cilësinë e tij si politikan, për komentet e paligjshme të postuara në prag të zgjedhjeve në “murin” e tij në Facebook nga palë të treta, të cilët vetë u identifikuan dhe u ndoqën penalisht si bashkëpunëtorë, ashtu edhe për dënimin e tij penal.

Hurbain kundër Belgjikës [DHM], Kërkesa nr. 57292/16, Vendimi gjyqësor i datës 4 korrik 2023

Roli i shtypit është të krijojë dhe të mirëmbajë arkivat, sidomos arkivat online, duke mbledhur artikuj të botuar ligjërisht në një format të shtypur vite më parë. Kërkesat për ndryshimin e artikujve në versionin elektronik përbëjnë ndërhyrje në lirinë e shtypit. Si pasojë, autoritetet kombëtare duhet të vendosin një ekuilibër të drejtë ndërmjet lirisë për të ndarë informacion (duke përfshirë disponueshmërinë e vazhdueshme në internet të informacionit për proceset penale), nga njëra anë, dhe të drejtës për t’u harruar në internet (e lidhur me mbrojtjen e reputacionit personal), nga ana tjetër. Autoritetet kombëtare (duke përfshirë gjykatat) mund të urdhërojnë ndryshimin e artikujve në versionin elektronik (p.sh., anonimizimin e tyre) nëse është rreptësisht e nevojshme për mbrojtjen e të drejtës për t’u harruar në internet; në raste të tilla të jashtëzakonshme, nuk do të ketë *shkelje të N.10 KEDNJ (Liria e shprehjes)*

Fakte: Kërkuesi, një shtetas belg, ishte botues i gazetës së përditshme *Le Soir*, një nga gazetat kryesore të përditshme në gjuhën frënge në Belgjikë. Në një botim shtypi të vitit 1994, një artikull raportonte për një aksident automobilistik që kishte shkaktuar vdekjen e dy personave dhe plagosjen e tre të tjerëve. Aty përmendej emri i plotë i shoferit, i cili vuajti dënimin dhe u rehabilitua në vitin 2006. Në vitin 2008, gazeta ngarkoi në faqen e saj të internetit një version elektronik me akses të hapur të arkivave të saj që datojnë që nga viti 1989 (përfshirë artikullin e sipërpërmendur).

Në vitin 2010, shoferi i kërkoi *Le Soir* të hiqte ose të anonimizonte versionin elektronik të artikullit. Në kërkesë përmendej se ai ishte mjek dhe se artikulli shfaqet në rezultate kur në disa motorë kërkimi futet emri i tij. Kërkesa u refuzua, por revista deklaroi se kishte njoftuar drejtorin menaxhues të Google Belgium për të hequr artikullin nga lista. Këto hapa nuk dhanë përgjigje. Në vitin 2012, shoferi nisi një proces civil kundër kërkuesit duke kërkuar një urdhër për anonimizimin e artikullit. Gjykatat e brendshme

lejuan pretendimin e shoferit. Gjykatat e brendshme trajtuan gjithashtu marrëdhënien ndërmjet të drejtës për t'u harruar, sipas N.8 KEDNJ, dhe lirisë së shprehjes së shtypit, sipas N.10 KEDNJ.

Në një vendim të Dhomës së 22 qershorit 2021, Gjykata arriti në përfundimin se Belgjika nuk ka shkelur N.10 KEDNJ. Pas një kërkesë nga kërkuesi, trupi gjykues i Dhomës së Madhe pranoi referimin e çështjes.

Vendosj: Vendimi civil kundër kërkuesit që e urdhëronte atë të anonimizonte artikullin e kundërshtuar, për shkak të “së drejtës për t'u harruar”, përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Vendimet e kundërshtuara të Gjykatës belge kishin një bazë ligjore të parashikueshme dhe ndoqën një qëllim legjitim, përkatësisht mbrojtjen e reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve (në këtë rast, e drejta e shoferit për respektimin e jetës së tij private). Prandaj, çështja përpara Gjykatës ishte nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, sipas kuptimit të N.10(2) KEDNJ.

Gjykata theksoi se çështja kishte të bënte me versionin elektronik të një artikulli, kështu që lidhej vetëm me disponueshmërinë e vazhdueshme të informacionit në internet dhe jo me versionin e tij origjinal të printuar.

Gjykata vërejti se sipas N.10 KEDNJ, shtypi ka – *inter alia* – rolin e mbajtjes së arkivave, duke përfshirë ato online (shihni p.sh., Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave, “GDPR”; Prot.Këshilli i Europës që përfshin një version të modernizuar të Konventës+108). Meqenëse roli i arkivave është të sigurojnë disponueshmërinë e vazhdueshme të informacionit që është publikuar ligjërisht në një moment të caktuar kohor, ato duhet, si rregull i përgjithshëm, të mbeten autentike, të besueshme dhe të plota. Autoritetet kombëtare duhet të jetë veçanërisht vigjilente në shqyrtimin e kërkesave, të bazuara në respektimin e jetës private, për heqjen ose ndryshimin e versionit elektronik të një artikulli të arkivuar.

Gjykata vërejti se arsyetimi i gjykatave kombëtare në çështjen në fjalë përqendrohej në “të drejtën e shoferit për t'u harruar”, e cila lidhej me interesin e një individi për të siguruar fshirjen ose ndryshimin ose kufizimin e aksesit në informacionin e mëparshëm që ndikon në mënyrën se si personi aktualisht perceptohet nga opinioni publik. Ekziston gjithashtu rreziku i tre efekteve të tjera të dëmshme: së pari, grumbullimi i informacionit mund të çojë në krijimin e një profili të personit në fjalë; së dyti, nëse informacioni nuk vendoset në kontekst, kjo mund të bëjë që një individ të marrë një panoramë të fragmentuar dhe të shtrembëruar të realitetit; së treti, pavarësisht nga frekuenca aktuale e kërtimeve të një emri të caktuar, personi në fjalë mund

të ndiejë kërcënim të vazhdueshëm dhe frikë nga përballja në mënyrë të papritur me të kaluarën e përsëri në çdo kohë. Në këtë sfond, çështja përpara Gjykatës ishte nëse (dhe në çfarë mase) N.8 KEDNJ ofron mbrojtje kundër këtyre efekteve negative. Në këtë drejtim, e drejta për t'u harruar nuk ka natyrë autonome, por është e lidhur me të drejtën për respektimin e reputacionit.

Më konkretisht, Gjykata trajtoi nëse vendimet e Gjykatës belge kishin vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet të drejtës për t'u harruar në internet, sipas N. 8 KEDNJ, dhe të drejtës për lirinë e shprehjes, sipas N. 10 KEDNJ. Gjykata solli në kujtesë se kishte zhvilluar një praktikë të gjerë gjyqësore për këtë çështje në lidhje me kërkesat për publikimin fillestar. Megjithatë, çështja në fjalë kishte të bënte me versionin elektronik të një artikulli. Prandaj, Gjykatës iu desh të rregullonte kriteret për të zgjidhur një konflikt mes të drejtave përkatëse në kontekstin specifik të çështjes.

Sa i përket natyrës së informacionit të arkivuar, Gjykatat belge i cilësuan saktë faktet e raportuara në artikull si të tilla që kishin natyrë gjyqësore. Faktet e raportuara për aksidentin automobilistik nuk bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale, rëndësia e të cilave, për shkak të rëndesës të tyre, nuk ndryshon me kalimin e kohës. Për më tepër, ato ngjarje nuk ishin objekt i ndonjë mbulimi mediatik dhe nuk tërhoqën publicitet të gjerë (as në kohën e ngjarjeve dhe as kur artikulli u ngarkua në internet).

Gjykata gjithashtu vërejti se kalimi i një kohe të konsiderueshme ka një ndikim në pyetjen nëse një person duhet të ketë "të drejtën për t'u harruar". Në çështjen në fjalë, Gjykata belge e apelit mori parasysh se kishin kaluar gjashtëmbëdhjetë vjet nga botimi fillestar i artikullit dhe kërkesa e parë për anonimizimin dhe, në total, kishin kaluar rreth njëzet vjet nga koha e dhënies së vendimit të saj. Kështu, kërkuesi, i cili ishte rehabilituar në vitin 2006, kishte një interes legjitim, pas gjithë asaj kohe, të kërkonte të lejohej të riintegrohej në shoqëri pa iu kujtuar përgjithmonë e kaluara e tij.

Sa i përket interesit bashkëkohor të informacionit, gjykatat belge gjetën se njëzet vjet pas ngjarjeve që nuk ishin aktuale dhe qartësisht jo me rëndësi historike, identiteti i një personi që nuk ishte personazh publik nuk i shtohej interesit publik të artikullit, i cili jepte thjesht një kontribut statistikor në një debat publik mbi sigurinë rrugore.

Për profilin publik të personit dhe sjelljen e tij që nga ngjarja, Gjykata kujtoi se fakti i qëndrimit jashtë vëmendjes së medias mund të jetë në favor të

mbrojtjes së reputacionit të një personi. Në çështjen në fjalë, gjykatat belge nënvizuan saktë se kërkuesi ishte individ i panjohur për publikun dhe nuk kishte kërkuar vëmendje.

Për më tepër, është e rëndësishme të vlerësohen pasojat e disponueshmërisë së vazhdueshme të informacionit gjyqësor për riintegrimin e personit në shoqëri duke marrë parasysh edhe faktorë të tjerë (p.sh. nëse ai/ajo ishte rehabilituar). Në çështjen në fjalë, Gjykata belge theksoi me të drejtë se prania e artikullit në arkivat online kishte rrezikuar të stigmatizonte kërkuesin, i cili ishte mjek, dhe të dëmtonte rëndë reputacionin e tij në sytë e pacientëve dhe kolegëve të tij në veçanti dhe ta pengonte atë të riintegrohej normalisht në shoqëri.

Lidhur me shkallën e aksesueshmërisë së informacionit, gjykatat belge vunë re me të drejtë se artikulli ishte i aksesueshëm pa kufizime dhe pa pagesë që kur u vendos në internet. Prania e vazhdueshme e artikullit në fjalë në arkiva pa dyshim që i ka shkaktuar dëm kërkuesit.

Në lidhje me ndikimin e masës për lirinë e shtypit, për shkak të rëndësisë së integritetit të arkivave digjitale të shtypit, gjykata kombëtare duhej t'i jepte përparësi masës që ishte më e përshtatshme për qëllimin legjitim të ndjekur nga ai person dhe më pak kufizuese për lirinë e shtypit. Në çështjen në fjalë, gjykatat belge kishin marrë parasysh këtë objektiv të dyfishtë dhe ishin shprehur se mjeti më i përshtatshëm ishte anonimizimi i artikullit në faqen e internetit të gazetës. Gjykata vuri në dukje se versioni origjinal, jo anonim dhe i shtypur i artikullit ishte ende i disponueshëm dhe mund të konsultohet nga çdo person që ishte i interesuar, duke përbushur kështu rolin e tij të natyrshëm si dokument arkivi. Për më tepër, ajo rikujtoi se anonimizimi është më pak i dëmshëm për lirinë e shprehjes se fshirja e një artikulli të tërë. Në rastin në fjalë, kishte të bënte vetëm me emrin e shoferit.

Në fund, në lidhje me efektin e mundshëm frenues mbi lirinë e shtypit, Gjykata vlerësoi se anonimizimi nga një botues i një artikulli në parim mund të përfshihet brenda "detyrave dhe përgjegjësisë" të shtypit, sipas kuptimit të N.10 KEDNJ dhe kufizimet që mund t'i vendosen. Në rastin në fjalë, urdhri i anonimizimit nuk pati një ndikim real në kryerjen e detyrave gazetareske të gazetës.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Belgjika nuk ka shkelur N.10 KEDNJ, sepse gjykatat e saj kombëtare kishin vepruar brenda kufijve të tyre të vlerësimit dhe kishin arritur një ekuilibër të drejtë: ndërhyrja në të drejtën për lirinë e shtypit (neni 10 KEDNJ) ishte e kufizuar me atë që kishte qenë rreptësisht e nevojshme për mbrojtjen e të drejtës për t'u harruar në internet

(neni 8 i KEDNJ). Prandaj, ndërhyrja ishte e nevojshme dhe proporcionale për qëllimin e N.10(2) KEDNJ.

Kompanie e Transmetimit Radio B92 AD kundër Serbisë, Kërkesa nr. 67369/16, Vendimi gjyqësor i datës 5 shtator 2023

Pagesa e dëmshpërblimit dhe heqja e një artikulli online, i urdhëruar kundër një shoqërie që ka në pronësi një kanal televiziv dhe një portal interneti, përbën ndërhyrje në të drejtën për të ndarë informacion dhe në lirinë e shtypit. Gjykatat kombëtare duhet të vlerësojnë të gjitha faktet relevante përpara se të vendosin këto sanksione, duke përfshirë burimin e informacionit, nëse informacioni ka kontribuar në një debat me interes të përgjithshëm, gjuhën e përdorur në artikullin e kontestuar dhe nëse shoqëria u përpoq të kontaktonte personat e interesuar për t'i ftuar që të japin një deklaratë mbi pretendimet e denoncuar. Një sjellje e ndryshme përbën *shkelje të N.10 KEDNJ (Liria e shprehjes)*.

Fakte: Kërkuesi, Shoqëria e Radio Transmetimit B92 AD, zotëron një kanal televiziv dhe një portal interneti. Në nëntor 2011, lajmet e mbrëmjes raportuan për një polemikë të vazhdueshme mbi prokurimin e vaksinave të gripit AH1N1 në 2009. Veçanërisht, shoqëria raportoi se dymbëdhjetë emra, përfshirë Z.P., një zëvendës ministër e shëndetësisë në atë kohë, ishin hequr nga lista që kishte policia për të dyshuarit për shpërdorim detyrë në lidhje me polemikën, sipas pretendimit për shkak të presionit politik. Në ditët në vijim, në portalin e internetit të shoqërisë u transmetuan lajme dhe u publikuan artikuj të ngjashëm. Raportimi u bazua në një shënim të punonjësve të policisë, të cilët ia dorëzuan atë gazetarëve të shoqërisë. Gjatë raportimit, gazetarët u përpoqën të kontaktojnë persona të interesuar (përfshirë Z.P.).

Pas refuzimit të shoqërisë për të publikuar mohimin, në prill 2012, Z.P. filloi proces civil kundër shoqërisë. Gjykatat e brendshme konstatuan se shoqëria transmetonte dhe artikujt online kishin dëmtuar nderin dhe reputacionin e Z.P-së dhe e urdhëruan atë të paguajë dëmin dhe shpenzimet, krahas heqjes së artikullit të kontestuar nga portali i internetit dhe publikimin e vendimit kundër saj. Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimet në fjalë kishin ndërhyrë në lirinë e shprehjes së shoqërisë, por ndërhyrja kishte qenë e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe reputacionit të ankimesit dhe masat korrigjuese ishin proporcionale.

Vendosj: Vendimi civil i formës së prerë i dhënë kundër shoqërisë kërkuese përbënte “ndërhyrje nga [një] autoritet publik” në të drejtën e saj për lirinë e shprehjes. Ndërhyrja parashikohej me ligj dhe ndiqte interesin legjitim të mbrojtjes së reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, në përputhje me N.10 (2) KEDNJ.

Në vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimit, Gjykata u përqendrua në disa aspekte. Së pari, ajo gjeti se informacioni në fjalë kontribuoi në një debat me interes të përgjithshëm. Së dyti, ajo u shpreh se personi në fjalë ishte një personazh publik dhe, si i tillë, duhej të kishte treguar një shkallë më të madhe tolerance duke pasur parasysh se informacioni lidhej me parregullsi të supozuara në punën e saj dhe jo me jetën e saj private. Së treti, mjetet e përdorura nga kërkuesi për të marrë një kopje të dokumentit në fjalë ishin brenda fushës së lirisë së hetimit të natyrshme në praktikën e gazetarëve me atë profesion, pasi shënimi u dorëzua nga dy oficerë policie (dhe vërtetësia e tij nuk ishte kontestuar kurrë) dhe gjykatat e brendshme nuk kundërshtuan faktin që, duke publikuar informacionin, shoqëria kishte shkëlur ligjin për konfidencialitetin ose kishte ndikuar në administrimin e duhur të drejtësisë.

Së katërti, Gjykata theksoi dallimin mes deklarimeve të fakteve dhe gjykimeve vlerësuese: ekzistenca e të parave mund të tregohet, ndërsa e vërteta e të dytave nuk ndikohet nga provat. Gjykatat e brendshme i konsideruan pretendimet e kontestuara si deklarime të fakteve dhe si të tilla të ndikuara nga provat. Megjithatë, Gjykata konsideroi se pretendimi për presionin politik të ushtruar për fshirjen e emrit të Z.P ishte një gjykim vlerësues dhe, për rrjedhojë, jo i ndikuar nga provat. Ky përfundim bazohet në gjuhën e përdorur në raportimin e shoqërisë për këtë pretendim (p.sh. bëhej fjalë për “një arsye për të dyshuar” dhe “listën që kishte policia për të dyshuarit”), e cila ishte e saktë dhe pa ekzagjerim. Për më tepër, në kuadër të hetimit, shoqëria ka kontaktuar ndër të tjera me Z.P. për ta ftuar të japë një deklaratë. Nisur nga sa më sipër, kërkuesi nuk mund të kritikohej se nuk kishte ndërmarrë hapa të mëtijshëm për të provuar vërtetësinë e pretendimeve të diskutueshme, pasi ai veprroi në mirëbesim dhe me kujdesin që pritej nga një gazetar përgjegjës që raportonte për një çështje me interes publik. Në fund, Gjykata konstaton se sanksioni mund të kishte efekt frenues mbi ushtrimin e së drejtës së ankuesit për lirinë e shprehjes.

Për më tepër, Gjykata theksoi se gjykatat e brendshme nuk zbatuan në mënyrën e duhur standardet që ishin në përputhje me parimet e N.10

KEDNJ, dhe nuk janë bazuar në një vlerësim të pranueshëm të fakteve përkatëse, sepse nuk kishin arritur: i) të shqyrtonin elementet e çështjes që ishin të nevojshme për vlerësimin e pajtueshmërisë së kërkuarit me detyrat dhe përgjegjësitë e tij sipas N.10 KEDNJ; ii) të jepnin arsyet përkatëse dhe të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Serbia ka shkelur N.10 KEDNJ sepse ndërhyrja në të drejtën e kërkuarit nuk ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur.

V. Teknologjitë e reja

L.B. kundër Hungarisë [DHM], Kërkesa nr. 36345/16, Vendimi gjyqësor i datës 9 mars 2023

Vendosja e një detyrimi ligjor për të publikuar të dhënat e debitorëve tatimor (përfshirë emrin dhe adresën e tyre) në faqen e internetit të organit tatimor përbën ndërhyrje në të drejtën e debitorit tatimor për jetën private. Edhe nëse kjo ndërhyrje mund të ndjekë qëllime legjitime (p.sh., mbrojtjen e mirëqenies ekonomike të shtetit), autoritetet kombëtare duhet të kryejnë gjithmonë vlerësimin e proporcionalitetit të individualizuar të pasojave në reputacionin e tatimpaguesve – *shkelje e N.8 KEDNJ (E drejta për jetën private)*.

Fakte: Kërkuesi ishte shtetas hungarez. Dispozita tatimore hungareze kërkon që autoriteti tatimor të publikojë të dhënat personale të tatimpaguesve (përfshirë emrin dhe adresën e shtëpisë) detyrimet e prapambetura të të cilëve tejkalojnë 10 milionë forintë hungareze (HUF – afërsisht 26,000 EUR) në një listë të debitorëve tatimorë në faqen e saj të internetit. Në vitin 2006, “debitorët e mëdhenj tatimorë” (dmth., ata me borxhe tatimore që tejkalojnë 10 milionë HUF për një periudhë prej më shumë se 180 ditësh) u përfshinë në skemën e publikimit. Ndryshimi u konsiderua i nevojshëm për “pastrimin e ekonomisë”, bazuar në vlerësimin që borxhet tatimore të papaguara nuk ishin vetëm çështje e detyrimeve të prapambetura, pasi mund të ishte edhe rezultat i sjelljes në shkelje të detyrimeve të pagesës tatimore.

Pas një inspektimi tatimor në vitin 2013, autoriteti kompetent konstatoi se kërkuesi kishte detyrime tatimore të prapambetura në shumën 227,985,686 HUF (afërsisht 625,000 euro). Ai u gjobit me 170.883.486 HUF (afërsisht 490.000 euro) me kamatë vonesë. Në vitin 2014 dhe 2016 respektivisht, autoriteti tatimor kishte publikuar të dhënat personale të kërkuessit (përfshirë emrin dhe adresën e tij) në listat online të debitorëve tatimorë dhe “debitorëve të mëdhenj tatimorë”. Në vitin 2016, një media online prodhoi një hartë interaktive të debitorëve tatimor të paraqitur me pika të kuqe, ku tregohesh emri dhe adresa e shtëpisë së kërkuessit, duke i bërë të dhënat të disponueshme për të gjithë lexuesit. Të dhënat e tij u hoqën nga lista e “debitorëve të mëdhenj” kur detyrimet e tij tatimore u parashkruan në vitin 2019.

Gjykata nuk ishte vënë më parë në lëvizje të shqyrtonte nëse, dhe në çfarë mase, vendosja e një detyrimi ligjor për të publikuar të dhënat e tatimpaguesve, duke përfshirë adresën e shtëpisë, ishte në përputhje me N.8 KEDNJ.

Vendosj: Nuk mund të përjashtohet që zbulimi e identitetit dhe adresës së shtëpisë së kërkuesit në listë mund të kishte pasur disa pasoja negative. Nisur nga sa më sipër, publikimi i të dhënave personale të kërkuesit përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private sipas kuptimit të N. 8 KEDNJ.

Ndërhyrja ishte e ligjshme dhe ndiqte qëllime legjitime (dmth., mirëqenia ekonomike e vendit dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të tjerëve), në përputhje me N. 8(2) KEDNJ. Megjithatë, Gjykata konstaton se publikimi i të dhënave personale të kërkuesit nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Në këtë drejtim, Gjykata theksoi paraprakisht se publikimi i kontestuar nuk ishte një çështje e vendimit individual nga organi tatimor, por përfshihej në skemën sistematike të publikimit të krijuar nga ligjvënësi. Një Shtet mund të miratojë masa të përgjithshme që zbatohen për situata të paracaktuara pavarësisht nga faktet individuale të secilit rast (duke përfshirë skemat për publikimin e të dhënave të debitorëve tatimor), me kusht që ai të veprojë në përputhje me Konventën dhe të mos e tejkalojë kufirin e tij të gjerë të vlerësimit. Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar. Prandaj, Gjykata duhet të bindet që autoritetet e brendshme kompetente kanë kryer një ushtrim të duhur balancues ndërmjet interesave konkurruese.

Në rastin në fjalë, autoritetet kombëtare nuk peshuan interesat konkurruese individuale dhe publike, as nuk bënë një vlerësim të individualizuar të proporcionalitetit. Edhe nëse publikimi i listës përkatëse korrespondonte me një interes publik legjitim, historia legjislative e ndryshimit të vitit 2006 nuk tregoi ndonjë vlerësim të efekteve të mundshme në sjelljen e tatimpaguesve të skemave të publikimit që ekzistonin që nga viti 2003. Për më tepër, ajo nuk përmbante ndonjë reflektim se si publikimi i adresës së shtëpisë së debitorit tatimor ishte i nevojshëm për të arritur efektin frenues. Më tej, nuk u mor në konsideratë shtrirja e mundshme e faqes së internetit të autoritetit tatimor, e cila ishte e aksesueshme në mbarë botën nga kushdo me akses të pakufizuar në internet. Prandaj, u duk se konsideratat për mbrojtjen e të dhënave duket se janë promovuar pak ose aspak në përparatjen e ndryshimit të vitit 2006, pavarësisht nga tërësia në rritje e

kërkesave detyruese kombëtare dhe të BE-së për mbrojtjen e të dhënave të zbatueshme në legjislacionin e brendshëm (shih p.sh., Konventa+108; Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, “GDPR”).

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Hungaria ka shkelur N.8 KEDNJ (aspekti i “jetës private”), pasi arsyet që mbështesin publikimin sistematik të të dhënave të tatimpaguesve (përfshirë adresat e tyre të shtëpisë) nuk treguan se ndërhyrja për të cilën ishte bërë ankimi ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” dhe se autoritetet e Shtetit të paditur arritën të vendosnin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave konkurruese në rrezik.

Glukhin kundër Rusisë [DHM], Kërkesa nr. 11519/20, Vendimi gjyqësor i datës 4 korrik 2023

Përdorimi i teknologjisë tepër ndërhyrëse të njohjes së fytyrës në proceset e kundërvajtjes administrative (përfshirë përpunimin e të dhënave biometrike të kërkuarit për identifikimin, lokalizimin, arrestimin dhe dënimin e tij) përbën ndërhyrje serioze në të drejtën për jetën private. Autoritetet kombëtare duhet të miratojnë rregulla të detajuara që rregullojnë qëllimin dhe zbatimin e masave të ngjashme (d.m.th., dispozitë ligjore jo e formuluar gjerësisht) dhe të sigurojnë masa mbrojtëse kundër rrezikut të abuzimit dhe arbitraritetit, veçanërisht në rastet e shkeljeve të vogla (siç është mosnjoftimi paraprak për një demonstratë paqësore individuale). Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.8 KEDNJ (Respektimi për jetën private)*.

Gjykatat e brendshme nuk mund të lejojnë arrestimin dhe më pas të dënojnë me sanksion administrativ (p.sh., një gjobë) një demonstrues paqësor për shkak se nuk ka njoftuar paraprakisht për demonstratën e tij, pa dhënë arsye përkatëse ose të mjaftueshme për të justifikuar dënimin. Veprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.10 KEDNJ (Liria e shprehjes)*.

Fakte: Në gusht 2019, kërkuari udhëtoi në nëntokën e Moskës me një figurë kartoni të përmasave të vërteta të Kotovit, një protestues, rasti i të cilit kishte shkaktuar një protestë publike dhe kishte tërhequr vëmendjen e gjerë në media, duke mbajtur një pankartë që lexonte: “Po talleni me mua. Unë jam Konstantin Kotov. Rrezikoj deri në pesë vjet [burg] sipas [nenit] 212.1 për protesta paqësore”.

Gjatë monitorimit rutinë në internet, policia zbuloi fotografi dhe një video të demonstratës së kërkuesit që ishin ngarkuar në një kanal publik Telegram. Sipas kërkuesit, policia kishte përdorur teknologjinë e njohjes së fytyrës për ta identifikuar atë nga pamjet e ekranit të kanalit Telegram, kishte mbledhur pamje nga kamerat e vëzhgimit të instaluar në metronë e Moskës dhe, disa ditë më vonë, kishte përdorur teknologjinë e njohjes së fytyrës drejtpërdrejt për ta gjetur dhe arrestuar atë ndërsa ai po udhëtonte me metro.

Ai u dënua në proces për shkelje administrative për mosnjohim të autoriteteve për demonstratën e tij i vetëm duke përdorur një "send lehtësisht të (ç) montueshëm", siç e kërkon legjislacioni i brendshëm. Ai u gjobit me 20.000 rubla ruse (RUB – rreth 283 euro). Pamjet e ekranit të kanalit Telegram dhe video-regjistrimeve janë përdorur si provë kundër tij. Pas hyrjes në fuqi të një dekreti për sigurinë e transportit, ndërmjet 2017 dhe 2022, më shumë se 220.000 kamera u instaluan në Moskë, përfshirë metronë. Të gjitha kamerat ishin të pajisura me teknologji të drejtpërdrejtë të njohjes së fytyrës.

Vendosi: Gjykata vuri në dukje se Qeveria nuk komentoi pretendimet e kërkuesit se teknologjia e njohjes së fytyrës ishte përdorur për të identifikuar, gjetur dhe arrestuar atë. Për më tepër, legjislacioni i brendshëm nuk kërkon që policia të përpilojë një procesverbal për përdorimin e teknologjisë së njohjes së fytyrës nga ana e saj ose t'i japë personit në fjalë akses në ndonjë regjistrim të tillë. Përveç kësaj, kërkuesi u identifikua më pak se dy ditë pas demonstratës së tij dhe nuk ju dha asnjë shpjegim për një rezultat kaq të shpejtë. Në fund, Gjykata merr parasysh informacionin publik të disponueshëm në lidhje me raste të shumta që përfshijnë përdorimin e teknologjisë së njohjes së fytyrës për të identifikuar pjesëmarrësit në ngjarjet e protestës në Rusi. Në këtë situatë, dhe në rrethanat e veçanta të çështjes, Gjykata pranoi se ishte përdorur teknologjia e njohjes së fytyrës dhe se përpunimi i të dhënave personale të kërkuesit (përfshirë përdorimin e teknologjisë së njohjes së fytyrës për identifikimin, lokalizimin, arrestimin dhe dënimin e tij), përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për respektimin e jetës private sipas kuptimit të N.8 KEDNJ.

Në përcaktimin nëse një kufizim i tillë përputhej me kushtet sipas N.8(2) KEDNJ, Gjykata vërejt se dispozita ligjore përkatëse ishte formular gjerësisht dhe asnjë interpretim autoritar nuk e qartësonte qëllimin e saj. Kështu, duket se lejon përpunimin e të dhënave personale biometrike (përfshirë me ndihmën e teknologjisë së njohjes së fytyrës) në lidhje me çdo proces gjyqësor. Për më tepër, qeveria nuk iu referua asnjë garancie procedurale kundër abuzimeve

apo arbitraritetit në përdorimin e teknologjisë së njohjes së fytyrës. Këto rrethana mund të ngrenë dyshime për “cilësinë e ligjit”. Megjithatë, Gjykata supozoi se ndërhyrja në të drejtën e kërkuarit ndiqte një qëllim legjitim, domethënë parandalimin e krimit.

Në vlerësimin nëse përpunimi i të dhënave personale të kërkuarit ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”, Gjykata vuri në dukje se masat e miratuara nga autoritetet e brendshme ishin veçanërisht ndërhyrëse në të drejtën e kërkuarit për privatësi, veçanërisht për sa i përket teknologjisë së njohjes së fytyrës. Prandaj, kërkohej një nivel i lartë justifikimi që ato të konsideroheshin “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, duke marrë parasysh gjithashtu se të dhënat personale të kërkuarit zbulonin opinionin e tij politik dhe, për rrjedhojë, përfshiheshin në kategoritë e veçanta të të dhënave sensitive që kërkojnë një nivel të lartë të mbrojtjes. Gjykata vuri në dukje më tej se kërkuari u ndoq penalisht për një shkelje të lehtë administrative që lidhej me zhvillimin e një demonstrate i vetëm pa njoftim paraprak. Për më tepër, përdorimi i teknologjisë shumë ndërhyrëse të njohjes së fytyrës për të identifikuar dhe arrestuar pjesëmarrësit e veprimeve paqësore të protestës mund të ketë efekt frenues në lidhje me të drejtat për lirinë e shprehjes dhe tubimit. Në këto rrethana, përdorimi i teknologjisë së njohjes së fytyrës për të identifikuar, lokalizuar, arrestuar dhe dënuar kërkuarin nuk korrespondonte me një «nevoje sociale emergjente”.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Rusia ka shkelur N.8 KEDNJ, sepse përpunimi i të dhënave personale të kërkuarit duke përdorur teknologjinë e njohjes së fytyrës në kuadër të proceseve për shkelje administrative nuk mund të konsiderohet si “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”, por përkundrazi është në pajtim me idealet dhe vlerat e një shoqërie demokratike të qeverisur nga sundimi i ligjit.

Gjykata vendosi se shoqërimi i kërkuarit në komisarjat, arrestimi administrativ dhe dënimi për një shkelje administrative përbënin ndërhyrje në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes për një çështje me interes publik. Gjykata vendosi nëse ky kufizim përputhej me kërkesat sipas N.10(2) KEDNJ. Për sa i përket kriterit “të përcaktuar me ligj”, Gjykata vërejti se dispozita kombëtare nuk përmbushte kriterin e parashikueshmërisë. Edhe nëse supozohet se plotësonte një kusht të tillë dhe ndiqte qëllimet legjitime për të parandaluar çrregullimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, ndërhyrja nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Në veçanti, demonstrata e tij i vetëm kishte qenë pa diskutim paqësore dhe jo shqetësuese për jetën e

zakonshme (ose aktivitete të tjera), dhe as nuk pretendohej se veprimet e tij kishin rrezikuar rendin publik ose sigurinë e transportit. Në fakt, vepra për të cilën ai ishte dënuar ishte thjesht mosnjohimi i autoriteteve. Megjithatë, gjykatat e brendshme nuk i morën parasysh këto elemente. Kështu, gjykatat e brendshme nuk kishin dhënë arsye përkatëse ose të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e kërkuarit për lirinë e shprehjes.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Rusia ka shkelur N.10 KEDNJ, sepse ndërhyrja në të drejtën e kërkuarit për lirinë e shprehjes ishte e pajustificuar.

Wieder dhe Guarnieri kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesat nr. 64371/16 dhe 64407/16, Vendimi gjyqësor i datës 12 shtator 2023

Nëse përgjimi i komunikimeve të njerëzve që jetojnë jashtë kryhet nga agjencitë kombëtare të inteligjencës që veprojnë brenda territorit të shtetit, atëherë ai shtet po ushtron *juridiksionin e tij sipas N.1 KEDNJ* për procesin e përgjimit.

Përgjimi i komunikimeve përbën ndërhyrje në të drejtën për jetë private. Nëse regjimi i përgjimit në masë ndikohet nga mangësi themelore (p.sh., mungesa e një autorizimi nga një autoritet i pavarur), ndërhyrja përbën *shkelje të N.8 KEDNJ (E drejta për jetën private)*.

Fakte: Kërkuarit ishin përkatësisht shtetas amerikanë dhe italianë. I pari ishte një profesionist i IT-së dhe një kërkuar i pavarur që ka punuar me organizata të dhënash dhe lajmesh; i dyti ishte studiues i privatësisë dhe sigurisë dhe ka bërë kërkime dhe botuar gjerësisht mbi privatësinë dhe mbikëqyrjen, duke përfshirë *Der Spiegel* dhe *The Intercept*. Si rezultat i punës dhe kontratave të tyre, kërkuarit dyshuan se komunikimet e tyre mund të ishin përgjuar, nxjerrë, filtruar, ruajtur, analizuar dhe shpërndarë nga agjencitë e inteligjencës në Mbretërinë e Bashkuar në përputhje me regjimin kombëtar. Të dy kërkuarit ndodheshin jashtë territorit britanik.

Vendosi: Gjykata nuk kishte pasur mundësi të shqyrtonte çështjen e kompetencës sipas N.1 KEDNJ në kontekstin e një ankimi në lidhje me një ndërhyrje në komunikimet elektronike të një kërkuari, ku dërguesi ose marrësi i komunikimeve është jashtë territorit të shtetit të paditur. Në çështjen *Big Brother Watch dhe të tjerët* ([DHM], Kërkesat nr. 58170/13 dhe 2 të tjera, 25 maj 2021), Gjykata vlerësoi se ndërhyrja kryesore në N.8 KEDNJ ishte kërkimi, ekzaminimi dhe përdorimi i komunikimeve të përgjuara. Këto faza të procesit të përgjimit u kryen nga agjencitë kombëtare të inteligjencës që

vepronin brenda territorit të Mbretërisë së Bashkuar. Sipas ligjit të Mbretërisë së Bashkuar, ndërhyrja në privatësinë e komunikimeve ka ndodhur në mënyrë të qartë ku ato komunikime janë përgjuar, kontrolluar, ekzaminuar dhe përdorur dhe dëmtimi që rezulton në të drejtat e privatësisë së dërguesit dhe/ose marrësit do të ndodhte gjithashtu atje.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve sipas N.8 KEDNJ ndodhi brenda Mbretërisë së Bashkuar dhe për këtë arsye përfshihej në juridiksionin e saj tokësor për qëllimin e N.1 KEDNJ.

Sa i përket të drejtës së kërkuesve për privatësi, Gjykata konstaton se Mbretëria e Bashkuar ka shkelur N.8 KEDNJ për arsyet e identifikuar në çështjen *Big Brothers Watch*, përkatësisht: i) mungesa e autorizimit të pavarur; ii) mospërfshirja e kategorive të përzgjedhësve në kërkesën për autorizim; iii) dhe fakti që përzgjedhësit e lidhur me një individ nuk i nënshtrohen autorizimit të brendshëm paraprak.

Yüksel Yalçinkaya kundër Turqisë, Kërkesa nr. 15669/20, Vendimi gjyqësor i datës 26 shtator 2023

Nëse një dënim bazohet në mënyrë vendimtare në prova elektronike (domethënë, të dhëna të papërpunuara për përdorimin e një aplikacioni për mesazhe), vendimi i gjykatës për të mos zbuluar provat për mbrojtjen duhet të mbështetet në arsye adekuate. Për më tepër, në rast se ligji i brendshëm nuk parashikon masa mbrojtëse procedurale specifike që synojnë garantimin e integritetit të provave elektronike deri në dorëzimin tek autoritetet gjyqësore, gjykatat e brendshme duhet të trajtojnë plotësisht argumentet në lidhje me besueshmërinë e këtyre provave elektronike. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.6(1) KEDNJ (E drejta për proces gjyqësor të drejtë)*.

Gjykatat e brendshme nuk mund të dënojnë një person për veprën penale të anëtarësimit në një organizatë të paligjshme (p.sh., një grup terrorist) vetëm bazuar në prova elektronike (domethënë, të dhëna të papërpunuara mbi përdorimin e një aplikacioni për mesazhe). Gjykatat kombëtare duhet të vendosin gjithmonë qëllimin e nevojshëm (lidhje mendore, element përbërës subjektiv) në mënyrë të individualizuar. Mosveprimi në këtë mënyrë përbën *shkelje të N.7 KEDNJ. (Nullum crimen sine lege, nulla poena sine lege)*.

Fakte: Që nga viti 2014, autoritetet turke e kanë konsideruar “Organizatën Terroriste Fetullahiste /Strukturën Paralele të Shtetit” (FETÖ / PDY) si një strukturë “kërcënuese të paqes dhe sigurisë publike” dhe, më pas, si një

organizatë terroriste të armatosur. Në fillim të vitit 2016, inteligjenca kombëtare u angazhua në aktivitete të mbledhjes së informacionit në lidhje me FETÖ / PDY duke hyrë në serverin kryesor të aplikacionit të mesazheve të koduara “ByLock”, që ndodhet në Lituani, me supozimin se ky aplikacion po përdorej ekskluzivisht nga anëtarët e asaj organizate për komunikim të brendshëm.

Gjatë natës së 15-16 korrikut 2016, në Turqi ndodhi një tentativë për grusht shteti. Autoritetet vlerësuan se FETÖ/PDY qëndronte pas operacioneve. Mes 20 dhe 21 korrikut, Qeveria shpalli gjendjen e jashtëzakonshme, e cila iu njoftua Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në përputhje me N.15 KEDNJ. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria miratoi disa dekrete legjislativë. Ndërkohë, në dhjetor 2016, mbi bazën e të dhënave të mbledhura nisën mijëra hetime, ku përdoruesit e dyshuar të aplikacionit “ByLock” u akuzuan për anëtarësim në FETÖ/PDY. Gjendja e jashtëzakonshme u hoq më 18 korrik 2018.

Kërkuesi ishte mësues në një shkollë publike në kohën e ngjarjes. Pasi autoritetet turke e kishin identifikuar atë si përdorues të “ByLock”, ai u pezullua nga shërbimi civil, u arrestua dhe u vu në paraburgim për shkak të lidhjes së tij të dyshuar me FETÖ/PDY, në zbatim të dekreteve emergjente të Turqisë. Në janar 2017, ai u akuzua për anëtarësim në organizatën e armatosur terroriste në bazë të provave të mëposhtme: u identifikua si përdorues i “ByLock”; lëvizje të dyshuara në llogarinë e tij bankare; anëtarësimi i tij i mëparshëm në një sindikatë të deklaruar si anëtare ose të lidhur me FETÖ/PDY; shkarkimi e tij nga shërbimi publik; një telefonatë anonime ku thuhej se ishte anëtar i FETÖ/PDY . Gjatë procesit penal, kërkuesi u ankua – *inter alia* – se mbledhja e të dhënave “ByLock” ishte në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm.

Kërkuesi u dënua për veprën penale të anëtarësimit në një organizatë të armatosur terroriste. Dënimi i tij u bazua në mënyrë vendimtare në përdorimin prej tij të “ByLock”, ndërsa provat e mbetura të përfshira në aktakuzë shërbyen vetëm si burim mbështetës.

Vendosi: Sipas Gjykatës, çështja ishte nëse proceset në tërësi ishin të drejta, sidomos mbledhja dhe zbulimi i provave, dhe nëse kërkuesit i ishte dhënë mundësia për të kundërshtuar provat dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre, sepse proces gjyqësor i drejtë sipas N.6(1) KEDNJ presupozon procese gjyqësore kundërshtare dhe barazinë e armëve. Zbulimi i provave nuk është një e drejtë absolute, pasi mund të ketë një sërë arsyesh që mund të kërkojnë që mbrojtjes të mos i tregohen provat, përfshirë shqetësimet për sigurinë kombëtare.

Provat elektronike janë të kudogjendura në proceset penale (për shkak të rritjes së digjitalizimit të të gjitha aspekteve të jetës) dhe ndryshojnë në shumë aspekte nga format tradicionale të provave (përfshirë mbledhjen dhe besueshmërinë e tyre). Gjykata theksoi se juridiksionet e brendshme nuk mund të përdorin këto prova në mënyrë që minon parimet bazë të një procesi gjyqësor të drejtë, sidomos kur proceset kombëtare kanë të bëjnë me vepra të rënda penale (të tilla si ato që lidhen me luftën kundër terrorizmit ose krimeve të tjera të organizuara).

Në çështjen në fjalë, dënimi i kërkuesve mbështetej në mënyrë vendimtare në konstatimin se ai kishte përdorur "ByLock", ndërsa provat e tjera shërbenin vetëm si burim mbështetjeje.

Sa i përket cilësisë së provave, Gjykata nuk kishte elementë të mjaftueshëm për të kundërshtuar saktësinë e të dhënave "ByLock" (të paktën në masën që ato vërtetohnin përdorimin e aplikacionit nga kërkuesi), megjithëse rrethanat në të cilat u morën të dhënat ngritën *prima facie* dyshime për "cilësinë" e tyre në mungesë të masave mbrojtëse procedurale specifike që synonin të garantonin integritetin e tyre deri në dorëzimin tek autoritetet gjyqësore.

Sa i përket aftësisë së kërkuesve për të kundërshtuar provat përkatëse, gjykatat e brendshme nuk dhanë arsye pse të dhënat përkatëse të papërpunuara nuk ju treguan kërkuesit, dhe ato as nuk iu përgjigjën argumenteve të shumta të ngritura nga kërkuesi në lidhje me besueshmërinë e provave "ByLock".

Gjykata vlerësoi se, në parim, pamundësia e mbrojtjes për të pasur akses të drejtpërdrejtë në prova dhe për të testuar integritetin dhe besueshmërinë e tyre drejtpërsëdrejti, vendos një përgjegjësi më të madhe mbi gjykatat e brendshme për t'ia nënshtruar këto çështje shqyrtimit më të rreptë. Gjithashtu, kërkesa për "ekuilibër të drejtë" ndërmjet palëve do të kishte kërkuar që kërkuesit t'i jepej mundësia të komentonte mbi shtrirjen e plotë të materialit të koduar në lidhje me të (përfshirë natyrën dhe përmbajtjen e aktivitetit të tij për "ByLock"). Ky do të përbënte një hap të rëndësishëm në ruajtjen e të drejtave të tij të mbrojtjes, veçanërisht për shkak të peshës mbizotëruese të provave "ByLock" si bazë për dënimin e tij. Për më tepër, paragjykimi i mbajtur nga mbrojtja në bazë të mangësive të mësipërme u shtua nga mangësitë në arsyetimin e gjykatave të brendshme *vis-à-vis* provave "ByLock": në veçanti, gjykatat nuk kishin shpjeguar mjaftueshëm mënyrën se si ishte konstatuar se "ByLock" nuk ishte dhe nuk mund të ishte përdorur nga kushdo që nuk ishte "anëtar" i FETË/PDY (duke marrë parasysh, p.sh., që aplikacioni mund të ishte shkarkuar nga dyqanet e aplikacioneve ose faqet e hapura për publikun

deri në fillim të vitit 2016). Prandaj, Gjykata konstaton se paragjykimi ndaj mbrojtjes së kërkuesit nuk ishte kundërpeshuar nga masat mbrojtëse procedurale të përshtatshme. Gjithashtu, fakti që gjykatat e brendshme nuk trajtuan argumentet e kërkuesit ngriti shqetësime të bazuara për detyrimin për të dhënë arsye që justifikonin vendimet e tyre.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Turqia ka shkelur N.6(1) KEDNJ për shkak se gjykatat e brendshme nuk zbatuan masa mbrojtëse të përshtatshme për të bërë të mundur që kërkuesi të kundërshtojë provat përkatëse në mënyrë efektive, nuk adresuan çështjet kryesore që qëndronin në thelb të çështjes dhe nuk dhanë arsyet e duhura.

Në lidhje me N.15 KEDNJ, Gjykata më tej theksoi se kufizimet mbi të drejtat e kërkuesve për proces gjyqësor të drejtë nuk mund të trajtoheshin sikur të ishin kërkuar rreptësisht nga nevojat e situatës.

Gjykata rikujtoi se asnjë shmangie nga N.7 KEDNJ nuk lejohet sipas N.15 KEDNJ. Kjo dispozitë ndalon zbatimin prapaveprues të legjislacionit penal në disavantazh të një të akuzuari, mishëron parimin *nullum crimen, nulla poena sine lege* dhe parimin që e drejta penale nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të një të akuzuari. Për rrjedhojë, sipas kërkesave të aksesueshmërisë dhe parashikueshmërisë, një vepër penale duhet të përcaktohet qartë në ligj, siç interpretohet nga gjykatat e brendshme.

Gjykata vlerësoi se vepra penale për të cilën kërkuesi u dënua është e kodifikuar dhe e përcaktuar sipas legjislacionit turk, në përputhje me parimin e ligjshmërisë sipas N.7 KEDNJ. Megjithatë, Gjykata rikujtoi se nuk është e mjaftueshme për qëllimet e N.7 KEDNJ që një shkelje të jetë e përcaktuar qartë në legjislacionin e brendshëm. Mosrespektimi i ligjit përkatës nga ana e gjykatave të brendshme, ose një interpretim dhe zbatim i paarsyeshëm i tij në një rast të caktuar, mund të sjellë në vetvete një shkelje të kësaj dispozite.

Në rastin në fjalë, dënimi i kërkuesit buronte nga përdorimi i dyshuar prej tij i "ByLock". Të gjithë elementët përbërës të veprës penale përkatëse (përfshirë lidhjen mendore) ishin konsideruar të manifestoheshin përmes atij përdorimi të dyshuar, pavarësisht nga përmbajtja e mesazheve të shkëmbyera ose identiteti i personave me të cilët ishin bërë shkëmbimet. Gjykata pranoi se "ByLock" nuk ishte thjesht një aplikacion i zakonshëm i mesazheve komerciale dhe se përdorimi i tij mund të sugjeronte *prima facie* një lloj lidhjeje me FETÖ/PDY. Megjithatë, akti që penalizohet sipas ligjit të brendshëm nuk është thjesht një lidhje, por anëtarësim në një organizatë të armatosur terroriste, në masën që ky anëtarësim krijohet mbi bazën

e elementeve përbërës (objektivë dhe subjektivë) të përcaktuar në ligj. Dënimi i kërkuesit bazohej në përdorimin e dyshuar prej tij të "ByLock", i cili u konsiderua i mjaftueshëm në vetvete për të vërtetuar lidhjen e nevojshme mendore, pa vërtetuar rregullisht ekzistencën e të gjitha kërkesave të anëtarësimit në një organizatë të armatosur terroriste (përfshirë qëllimin e nevojshëm) në mënyrë të individualizuar. Gjetja e gjykatave të brendshme se thjesht përdorimi i "ByLock" nënkupton anëtarësimin në një organizatë të armatosur terroriste i bashkëngjiti një përgjegjësi objektive përdorimit të tij, pavarësisht nga qëllimi specifik i kërkuar nga legjislacioni i brendshëm. Kështu, kjo qasje ishte në kontrast me parimin e ligjshmërisë dhe të parashikueshmërisë dhe me të drejtën e individëve për të mos u ndëshkuar pa krijuar një element të përgjegjësisë personale.

Për më tepër, Gjykata theksoi se garancitë themelore të parashikuara në N.7 KEDNJ nuk mund të zbatohen në mënyrë më pak të rreptë kur bëhet fjalë për ndjekjen penale dhe dënimin e veprave terroriste, edhe kur supozohet se janë kryer në rrethana që kërcënojnë jetën e kombit sipas kuptimit të N.15 të Konventës.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Turqia ka shkelur N.7 KEDNJ për shkak të një interpretimi të gjerë dhe të paparashikueshëm të ligjit nga gjykatat e brendshme, i cili ndikoi në lënien mënjane të elementit mendor të veprës penale, duke u larguar kështu nga kërkesat e përcaktuara qartë në legjislacionin e brendshëm.

Që në fillim, GJEDNJ-ja vërejti se dënimi i kërkuesit për anëtarësim në një organizatë të armatosur terroriste bazohej në një masë vendimtare në përdorimin e dyshuar të "ByLock". Megjithatë, anëtarësimet në një sindikatë dhe një organizatë tjetër përfaqësonin ushtrimin nga kërkuesi të së drejtës së tij për lirinë e tubimit, sipas nenit 11 të KEDNJ-së. Pra, fakti që kjo është përdorur, qoftë edhe në një masë të kufizuar, për ta dënuar atë, kërkon shqyrtimin nga Gjykata të kësaj ankese.

Në çështjen në fjalë, mbështetja e autoriteteve gjyqësore në anëtarësimin e kërkuesit në një sindikatë dhe një shoqatë përbënte ndërhyrje në të drejtat e tij sipas Nenit 11 të KEDNJ. Kjo ndërhyrje ishte e paligjshme pasi nuk ishte e parashikuar me ligj në kuptimin e N.11(2) KEDNJ. Gjykatat e brendshme zgjeruan tej mase, në një mënyrë të paparashikueshme, objektin e dispozitës kombëtare që përcakton veprën penale të anëtarësimit në një organizatë të armatosur terroriste: sipas gjykatave të brendshme, anëtarësimi i kërkuesve në një sindikatë dhe një shoqatë (të dyja funksionojnë në mënyrë të ligjshme

në kohën materiale) u konsiderua si provë që vërtetonte anëtarësimin e tij në FETË/PDY. Si pasojë, gjykatat kombëtare nuk ofruan mbrojtjen minimale të nevojshme kundër ndërhyrjeve arbitrare.

Gjykata përjashtoi faktin që ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për lirinë e organizimit ishte e justifikuar duke marrë parasysh derogimin e Qeverisë sipas N.15 KEDNJ. Në këtë drejtim, Qeveria nuk dha shpjegime nëse përdorimi specifik i bërë nga gjykatat e brendshme i anëtarësimin të kërkuesit në sindikatat dhe shoqatat në fjalë ishte kërkuar rreptësisht nga nevojat e situatës që shkaktuan krijimin e gjendjes së jashtëzakonshme.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se Turqia ka shkelur N.11 KEDNJ meqenëse Qeveria nuk kishte arritur të tregonte se ndërhyrja në të drejtat e kërkuesit mund të konsiderohej si e kërkuar rreptësisht nga nevojat e situatës sipas nenit 15.

Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet teknologjive të reja dhe lirisë së informacionit, shihni edhe Hurbain kundër Belgjikës, Sanchez kundër Francës [DHM] dhe Radio Broadcasting Company B92 AD kundër Serbisë – Pjesa IV.

Lista e vendimeve sipas seksioneve

I. MBROJTJA E TË DREJTAVE PRONËSORE DHE TË STREHIMIT

A. Prishje e pronës

<i>Zela kundër Shqipërisë, Aplikimi nr. 33164/11, vendim i datës 11 qershor 2024</i>	9
<i>Simonova kundër Bullgarisë, Aplikimi nr. 30782/16, vendim i datës 11 prill 2023</i>	11
<i>Alif Ahmadov dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit, Apl. nr. 22619/14, vendim i 4 majit 2023</i>	13
<i>Bagirova dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit, Apl. nr. 37706/17 dhe të tjera, vendim i datës 31 gusht 2023</i>	16

B. Dëbimi, konfiskimi dhe sanksione të tjera

<i>S.C. Zorina International S.R.L. k. Rumanisë, Apl. nr. 15553/15, vendim i 27 qershorit 2023</i>	18
<i>Yordanov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, Apl. nr. 265/17 dhe 26473/18, vendim i datës 26 shtator 2023</i>	19
<i>Naforniça k. Republikës së Moldavisë, Apl. nr. 49066/12, vendim i 16 janarit 2024</i>	21
<i>Yaşaroğlu k. Turqisë, Apl. nr. 78661/11, vendim i datës 12 shtator 2023</i> ..	23

C. Kthimi dhe kompensimi

<i>Osmani k. Shqipërisë, Apl. nr. 8706/18, vendim i datës 5 dhjetor 2023 [Komiteti]</i>	25
<i>Jella dhe të tjerë k. Shqipërisë, Apl. nr. 7564/07, vendim i datës 5 mars 2024 [Komiteti]</i>	26
<i>Associations de copropriété forestière Porceni Pleşa et Piciorul Bătrân Banciu (Shoqata e Pyjeve 'Porceni Pleşa dhe Composesorat Piciorul Bătrân Banciu') k. Rumanisë, Apl. nr. 46201/16 dhe të tjera, vendim i 28 nëntorit 2023</i>	28

II. PROCESET CIVILE

A. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore

<i>Kokolari k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 22493/12, vendim i 30 janarit 2024 [Komiteti]	31
<i>Vjola SH.P.K. dhe DE SH.P.K. k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 18076/12, vendim i 30 janarit 2024	33
<i>Zela k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 33164/11, vendim i 11 qershorit 2024	35
<i>Papakostandini k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 7568/08, vendim i 18 korrikut 2024 [Komiteti]	36
<i>Van den Kerkhof k. Belgjikës</i> , Apl. nr. 13630/19, vendim i datës 5 shtator 2023	39
<i>Altius Insurance LTD k. Qipros</i> , Apl. nr. 41151/20, vendim i 24 tetorit 2023	41

B. Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë

<i>Maçi k. Shqipërisë</i> , Apk. nr. 21051/10, vendim i 4 korrikut 2024 [Komiteti]	43
<i>Tona k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 78957/11, vendim i 4 korrikut 2024 [Komiteti]	45
<i>Spahiu k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 79452/17 dhe 2 të tjera, vendim i 18 korrikut 2024 [Komiteti]	47

C. Të drejtat procedurale

<i>Supergrav Albania sh.p.k k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 20702/18, vendim i 9 majit 2023	48
<i>Lazaris k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 48806/06, vendim i 20 qershorit 2023 [Komiteti]	50
<i>Meli and Swinkels Family Brewers N.V. k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 41373/21 dhe 48801/21, vendim i datës 16 korrik 2024	53
<i>Ben Amamou k. Italisë</i> , Apl. nr. 49058/20, vendim i 29 qershorit 2023 ..	56
<i>Poklikayew k. Polonisë</i> , Apl. nr. 1103/16, vendim i datës 22 qershor 2023	58

D. Fokus i veçantë: Proceset që përfshijnë të drejtat e gjyqtarëve

<i>Gashi dhe Gina k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 29943/18, vendim i datës 4 prill 2023 ..	60
<i>Ovcharenko dhe Kolos k. Ukrainës</i> , Apl. nr. 27276/15 dhe 33692/15, vendim i 12 janarit 2023	63

<i>Sarisu Pehlivan k. Turqisë</i> , Apl. nr. 63029/19, vendim i 6 qershorit 2023	66
<i>Pajqk dhe të tjerë k. Polonisë</i> , Apl. nr. 25226/18 dhe 3 të tjera, vendim i 24 tetorit 2023	68

III. PROCESET PENALE

A. Hetimet

<i>Durdaj dhe të tjerë k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 63543/09 dhe 3 të tjera, vendim i 7 nëntorit 2023	73
<i>Çupi k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 27187/08, 14 nëntor 2023	77
<i>Nika k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 1049/17, vendim i 14 nëntorit 2023	80
<i>Repeşco dhe Repeşcu k. Republikës së Moldavisë</i> , Apl. nr. 39272/15, vendim i 3 tetorit 2023	85
<i>Plechlo k. Sllovakisë</i> , Apl. nr. 18593/19, vendim i 26 tetorit 2023	87
<i>X. k. Greqisë</i> , Apl. nr. 38588/21, vendim i 13 shkurtit 2024	88
<i>Matyushonok k. Ukrainës</i> , Apl. nr. 34590/06, vendim i datës 11 korrik 2024	91
<i>Hanovs k. Letonisë</i> , Apl. nr. 40861/22, vendim i 18 korrikut 2024	93

B. Paraburgimi

<i>Hysa k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 52048/16, vendim i datës 21 shkurt 2023	95
<i>Muçaj k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 37814/10, vendim i 11 korrikut 2023 [Komiteti]	97
<i>Radonjić dhe Romić k. Serbisë</i> , Apl. nr. 43674/16, vendim i datës 4 prill 2023	99
<i>M.B. k. Mbretërisë së Vendeve të Ulëta</i> , Apl. nr. 71008/16, vendim i 23 prillit 2024	101
<i>Cviková k. Sllovakisë</i> , Apl. nr. 615/21 dhe 2 të tjera, vendim i 13 qershorit 2024	104

C. Gjykimi dhe Ekzekutimi

<i>Zajmi k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 83907/17, vendim i 20 qershorit 2023 [Komiteti]	
---	--

<i>Yzeiraj k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 70455/10, vendim i 11 korrikut 2023 [Komiteti]	107
<i>Leka k. Shqipërisë</i> , Apl. nr. 60569/09, vendim i 5 marsit 2024	109
<i>Orhan Şahin k. Turqisë</i> , Apl. nr. 48309/17, vendim i 12 marsit 2024	111
<i>Vučković k. Kroacisë</i> , Apl. nr. 15798/20, vendim i datës 12 dhjetor 2023	113

IV. LIRIA E SHPREHJES DHE INFORMIMIT

<i>Macate k. Lituanisë</i> [Dhoma e Madhe / DHM], Apl. nr. 61435/19, vendim i 23 janarit 2023	116
<i>Sanchez k. Francës</i> [DHM], Apl. nr. 45581/15, vendim i 15 majit 2023 ..	118
<i>Hurbain k. Belgjikës</i> [DHM], Apl. nr. 57292/16, vendimi i 4 dhjetorit 2023 ..	122
<i>Kompania Transmetuese e Radio B92 AD. k. Serbisë</i> , Apl. nr. 67369/16, vendim i 5 shtatorit 2023	126

V. TEKNOLOGJITË E REJA

<i>L.B. k. Hungarisë</i> [DHM], Apl. nr. 36345/16, vendim i datës 9 mars 2023	129
<i>Glukhin k. Hungarisë</i> [DHM], Apl. nr. 11519/20, vendim i datës 4 korrikut 2023	131
<i>Wieder dhe Guarnieri k. Mbretërisë së Bashkuar</i> , Apl. nr. 64371/16 dhe 64407/16, vendim i 12 shtatorit 2023	134
<i>Yüksel Yalçınkaya k. Turqisë</i> , Apl. nr. 15669/20, vendim i 26 shtatorit 2023	135

Lista e vendimeve sipas neneve të GJEDNJ-së

Neni 1

Wieder dhe Guarnieri k. Mbretërisë së Bashkuar, Apl. nr. 64371/16 dhe 64407/16, vendim i datës 12 shtator 2023 134

Neni 2

Durdaj dhe të tjerë k. Shqipërisë, Apl. nr. 63543/09 dhe 3 të tjera, vendim i datës 7 nëntor 2023 73

Nika k. Shqipërisë, Apl. nr. 1049/17, vendim i datës 14 nëntor 2023 80

Neni 3

Repeşco dhe Repeşcu k. Republikës së Moldavisë, Apl. nr. 39272/15, vendim i datës 3 tetor 2023 85

Matyushonok k. Ukrainës, Apl. nr. 34590/06, vendim i datës 11 korrik 2024 [Komiteti] 91

X. k. Greqisë, Apl. nr. 38588/21, vendim i datës 13 shkurt 2024 88

Hanovs k. Letuanisë, Apl. nr. 40861/22, vendim i datës 18 korrik 2024 93

Vučković k. Kroacisë, Apl. nr. 15798/20, vendim i datës 12 dhjetor 2023 113

Neni 5

Hysa k. Shqipërisë, Apl. nr. 52048/16, vendim i datës 21 shkurt 2023 95

Muçaj k. Shqipërisë, Apl. nr. 37814/10, vendim i datës 11 korrik 2023 [Komiteti] 97

Radonjić dhe Romić k. Serbisë, Apl. nr. 43674/16, vendim i datës 4 prill 2023 ..99

M.B. k. Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, Apl. nr. 71008/16, vendim i datës 23 prill

2024	101
<i>Cviková k. Sllovakisë, Apl. nr. 615/21 dhe 2 të tjera, vendim i datës 13 qershor 2024</i>	104

Neni 6

<i>Osmani k. Shqipërisë, Apl. nr. 8706/18, vendim i datës 5 dhjetor 2023 [Komiteti]</i>	25
<i>Associations de copropriété forestière Porceni Pleşa et Piciorul Bătrân Banciu (Shoqata e Pyjeve 'Porceni Pleşa dhe Composesorat Piciorul Bătrân Banciu') k. Rumanisë,, Apl. nr. 46201/16 dhe të tjerë, vendim i datës 28 nëntor 2023 ..</i>	28
<i>Kokolari k. Shqipërisë, App. No. 22493/12, vendim i datës 30 janar 2024 [Komiteti]</i>	31
<i>Vjola sh.p.k. dhe DE sh.p.k. k. Shqipërisë, Apl. nr. 18076/12, vendim i datës 30 janar 2024</i>	33
<i>Zela k. Shqipërisë, Apl. nr. 33164/11, vendim i datës 11 qershor 2024</i>	35
<i>Papakostandini k. Shqipërisë, Apl. nr. 7568/08, vendim i datës 18 korrik 2024 [Komiteti]</i>	36
<i>Van den Kerkhof k. Belgjikës, Apl. nr. 13630/19, vendim i 5 shtatorit 2023</i>	39
<i>Altius Insurance l.t.d. k. Qipros, Apl. nr. 41151/20, vendim i datës 24 tetor 2023</i>	41
<i>Maçi k. Shqipërisë, Apl. nr. 21051/10, vendim i datës 4 korrik 2024 [Komiteti]</i>	43
<i>Tona k. Shqipërisë, Apl. nr. 78957/11, vendim i datës 4 korrik 2024 [Komiteti]</i>	45
<i>Spahiu k. Shqipërisë, Apl. nr. 79452/17 dhe 2 të tjerë, vendim i datës 18 korrik 2024 [Komiteti]</i>	47
<i>Supergrav Albania sh.p.k. k. Shqipërisë, Apl. nr. 20702/18, 9 maj 2023</i>	48
<i>Lazaris k. Shqipërisë, Apl. nr. 48806/06, vendim i datës 20 qershor 2023 [Komiteti]</i>	50
<i>Meli dhe Swinkels Family Brewers N.V. k. Shqipërisë, Apl. nr. 41373/21 dhe 48801/21, vendim i datës 16 korrik 2024</i>	53
<i>Ben Amamou k. Italisë, Apl. nr. 49058/20, vendim i datës 29 qershor 2023 ..</i>	56

<i>Pajqk dhe të tjerë k. Polonisë, Apl. nr. 25226/18 dhe 3 të tjera, vendim i datës 24 tetor 2023</i>	68
<i>Ovcharenko dhe Kolos v. Ukrainës, Apl. nr. 27276/15 dhe 33692/15, vendim i datës 12 janar 2023</i>	63
<i>Çupi k. Shqipërisë, Apl. nr. 27187/08, 14 nëntor 2023 [Komiteti]</i>	77
<i>Repeşco dhe Repeşcu k. Republikës së Moldavisë, Apl. nr. 39272/15, vendim i datës 3 tetor 2023</i>	85
<i>Zajmi k. Shqipërisë, Apl. nr. 83907/17, vendim i datës 20 qershor 2023 [Komiteti]</i>	106
<i>Yzeiraj k. Shqipërisë, Apl. nr. 70455/10, vendim i datës 11 korrik 2023 [Komiteti]</i>	107
<i>Leka k. Shqipërisë, Apl. nr. 60569/09, vendim i datës 5 mars 2024</i>	109
<i>Orhan Şahin k. Turqisë, Apl. nr. 48309/17, vendim i datës 12 mars 2024</i>	111
<i>Yüksel Yalçinkaya k. Turqisë, Apl. nr. 15669/20, vendim i datës 26 shtator 2023</i> ...	135

Neni 7

<i>Yüksel Yalçinkaya k. Turqisë, Apl. nr. 15669/20, vendim i datës 26 shtator 2023</i>	135
--	-----

Neni 8

<i>Simonova k. Bullgarisë, Apl. nr. 30782/16, vendim i datës 11 prill 2023</i>	11
<i>Alif Ahmadov dhe të tjerë k.. Azerbajxhanit, Apl. nr. 22619/14, vendim i datës 4 maj 2023</i>	13
<i>Nafornita k. Republikës së Moldavisë, Apl. nr. 49066/12, vendim i datës 16 janar 2024</i>	21
<i>Gashi dhe Gina k. Shqipërisë, Apl. nr. 29943/18, vendim i datës 4 prill 2023</i>	60
<i>Pajqk dhe të tjerë k. Polonisë, Apl. nr. 25226/18 dhe 3 të tjera, vendim i datës 24 tetor 2023</i>	68
<i>Ovcharenko dhe Kolos k. Ukrainës, Apl. nr. 27276/15 dhe 33692/15, vendim i datës 12 janar 2023</i>	63

<i>Plechlo k. Sllovakisë</i> , App. No. 18593/19, vendim i datës 26 tetor 2023	87
<i>X. k. Greqisë</i> , Apl. nr. 38588/21, vendim i datës 13 shkurt 2024	88
<i>Hanovs k. Letonisë</i> , Apl. nr. 40861/22, vendim i datës 18 korrik 2024	93
<i>Vučković k. Kroacisë</i> , Apl. nr. 15798/20, vendim i datës 12 dhjetor 2023	113
<i>Wieder dhe Guarnieri k. Mbretërisë së Bashkuar</i> , Apl. nr. 64371/16 dhe 64407/16, vendim i datës 12 shtator 2023	134
<i>L.B. k. Hungarisë</i> [DHM], Apl. nr. 36345/16, vendim i datës 9 mars 2023	129
<i>Glukhin k. Rusisë</i> [DHM], Apl. nr. 11519/20, vendim i datës 4 korrik 2023 ..	131

Neni 10

<i>Sarsu Pehlivan k. Turqisë</i> , Apl. nr. 63029/19, vendim i datës 6 qershor 2023 ...	66
<i>Macate k. Lituanisë</i> [DHM], Apl. nr. 61435/19, vendim i datës 23 janar 2023	116
<i>Kompania Transmetuese e Radios B92 A.D. k. Serbisë</i> , Apl. nr. 67369/16, vendim i datës 5 shtator 2023	126
<i>Sanchez k. Francës</i> [DHM], Apl. nr. 45581/15, vendim i datës 15 maj 2023	118
<i>Hurbain v. Belgjikës</i> [DHM], Apl. nr. 57292/16, vendim i datës 4 korrik 2023	122

Neni 11

<i>Yüksel Yalçınkaya k. Turqisë</i> , Apl. nr. 15669/20, vendim i datës 26 shtator 2023	135
---	-----

Neni 13 (+ Neni 6)

<i>Altius Insurance l.t.d. k. Qipros</i> , App. nr. 41151/20, vendim i datës 24 tetor 2023.....	41
---	----

Neni 14

<i>Pajqk dhe të tjerë k. Polonisë</i> , Apl. nr. 25226/18 dhe 3 të tjera, vendim i datës 24 tetor 2023 (Neni 14 & Neni 8)	68
---	----

Hanovs k. Letonisë, Apl. nr. 40861/22, vendim i datës 18 korrik (Neni 14 & Neni 3; Neni 14 & Neni 8) 93

Neni 1, Protokolle Nr. 1

Zela k. Shqipërisë, Apl. nr. 33164/11, vendim i datës 11 qershor 2024 35

Alif Ahmadov dhe të tjerë k. Azerbajxhanit, Apl. nr. 22619/14, vendim i datës 4 maj 2023 13

Bagirova dhe të tjerë k. Azerbajxhanit, Apl. nr. 37706/17 dhe të tjera, vendim i datës 31 gusht 2023 16

Yaşaroğlu k. Turqisë, Apl. nr. 78661/11, vendim i datës 12 shtator 2023 23

S.C. Zorina International s.r.l. k. Rumanisë, Apl. nr. 15553/15, vendim i datës 27 qershor 2023 18

Yordanov dhe të tjerët v. Bullgarisë, Apps. Nos. 265/17 dhe 26473/18, vendim i datës 26 shtator 2023 19

Jella dhe të tjerët v. Shqipërisë App. No. 7564/07, vendim i datës 5 mars 2024 [Komiteti] 26

Osmani k. Shqipërisë, Apl. nr. 8706/18, vendim i datës 5 dhjetor 2023 [Komiteti] 25

Maçi k. Shqipërisë, Apl. nr. 21051/10, vendim i datës 4 korrik 2024 [Komiteti] 43

Neni 1, Protokolle Nr. 7

Poklikayew k. Polonisë, Apl. nr. 1103/16, vendim i datës 22 qershor 2023 ... 58

Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore amenduar me protokollin nr. 11

Romë, 4.XI.1950

Teksti i Konventës është ndryshuar sipas dispozitave të Protokollit Nr. 3 (ETS Nr. 45), e cila hyri në fuqi më 21 shtator 1970, të Protokollit Nr. 5 (ETS Nr. 55), e cila hyri në fuqi më 20 dhjetor 1971 dhe të Protokollit Nr. 8 (ETS Nr. 118), e cila hyri në fuqi më 1 janar 1990, dhe përfshiu gjithashtu tekstin e Protokollit Nr. 2 (ETS Nr. 44) e cila, në përputhje me Nenin 5, paragrafin 3 të saj, ka qenë një pjesë përbërëse e Konventës që në datën e hyrjes së saj në fuqi, më 21 shtator 1970. Të gjitha dispozitat që janë ndryshuar dhe shtuar nga këto Protokolle janë zëvendësuar nga Protokollin Nr. 11 (ETS Nr. 155), që nga data e hyrjes së saj në fuqi më 1 nëntor 1998. Që nga kjo datë, Protokollin Nr. 9 (ETS Nr. 140), e cila hyri në fuqi më 1 tetor 1994, është shfuqizuar dhe Protokollin Nr. 10 (ETS Nr. 146) ka humbur qëllimin e vet.

Qeveritë nënshkruese, anëtare të Këshillit të Evropës.

Duke pasur parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor 1948;

Duke pasur parasysh, se kjo Deklaratë ka për qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të shpallura në të;

Duke pasur parasysh, se qëllimi i Këshillit të Evropës është që të re-alizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore;

Duke ripohuar besimin e tyre të thellë në këto liri themelore që përbëjnë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë, ruajtja e të cilave mbështet kryesisht mbi një regjim politik demokratik nga njëra anë, dhe nga ana tjetër mbi një kuptim dhe respektim të përbashkët të të drejtave të njeriut nga të cilat varen;

Të vendosura si qeveri të shteteve evropiane, që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një trashëgimi të përbashkët idealesh, traditash politike, lirie dhe shteti të së drejtës, për të marrë masat fillestare për zbatimin kolektiv të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale, Kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 11

Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre, të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Seksionin I të kësaj Konvente.

Seksioni I

Të drejtat dhe liritë

Neni 22

E drejta për jetën

1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykatë pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashikuar me ligj.

2. Privimi nga jeta nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm:

- a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
- b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht;
- c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

Neni 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet tor-

turës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Neni 4

Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar

1. Askush nuk do të mbahet në skllavëri ose në robëri.

2. Askush nuk do të shtrëngohet të kryejë një punë me dhunë ose të detyruar.

3. Për qëllim të këtij neni, termi "punë e kryer me dhunë ose e detyruar", nuk përfshin:

- a) çdo lloj pune që i kërkohet të kryejë zakonisht një personi të ndaluar në kushtet e parashikuara nga neni 5 i kësaj Konvente ose gjatë liritimit të tij me kusht;
- b) çdo lloj shërbimi i karakterit ushtarak ose, në rastin e kundërshtarëve të ndërgjegjes në vendet ku kundërshtimi i ndërgjegjes është i njohur me ligj, shërbimi që kryhet në vend të shërbimit ushtarak të detyrueshëm;
- c) çdo lloj shërbimi që kërkohet në rast krizash ose fatkeqësish, që kërcënojnë jetën ose mirëqenien e komunitetit;
- d) çdo lloj pune ose shërbimi që është pjesë e detyrimeve normale qytetare.

Neni 5

E drejta për liri dhe siguri

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve

që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

a) kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

b) kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;

c) kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

d) kur një i mitur ndalohet ligjërisht, për qëllim edukimi të mbikqyrrur, ose për ndalimin e tij të ligjshëm, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor;

e) kur individët ndalohen ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

f) kur një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht, me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e paautorizuar në atë vend, ose për një person kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;

2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e

kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

5. Çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Neni 61

E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në

interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishtme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.

Neni 7

Nuk ka dënim pa ligj

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.

Neni 8

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 9

Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, goftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë së tij ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kush-

teve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 11

Liria e tubimit dhe e organizimit

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Neni 12

E drejta për t'u martuar

Burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkëlur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 151

Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme

1. Në rast lufte ose rreziku tjetër publik që i kanoset jetës së kombit, çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë

masa që iu shmangen detyrimeve të parashikuara nga kjo Konventë, veçse në shkallën më të vogël që e kërkon situata, me kusht që këto masa të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare.

2. Dispozita e mësipërme nuk lejon asnjë shmangie nga neni 2, me përjashtim të rastit të vdekjes që vjen si pasojë e akteve të ligjshme të luftës ose nga nenet 3, 4 (paragrafi 1) dhe 7.

3. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, që ushtron këtë të drejtë derogimi, mban plotësisht të informuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për të gjitha masat e marra dhe arsyet pse ato janë marrë. Gjithashtu, ajo duhet të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për datën në të cilën këto masa kanë humbur fuqinë dhe dispozitat e Konventës vihen sërish në zbatim të plotë.

Neni 16

Kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve

Asnjë nga dispozitat e neneve 10, 11 dhe 14 nuk mund të konsiderohet se u ndalon Palëve të Larta Kontraktuese që të vendosin kufizime ndaj veprimtarisë politike të të huajve.

Neni 17

Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një

Shteti, grupimi ose individi, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Neni 18

Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave

Kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.

Seksioni II

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 19

Krijimi i Gjykatës

Për të siguruar respektimin e zotimeve të ndërmarra nga Palët e Larta Kontraktuese të kësaj Konvente dhe nga Protokollet e saj, krijohet Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vijim referuar si "Gjykata". Ajo funksionon në mënyrë të përhershme.

Neni 20

Numri i gjyqtarëve

Gjykata përbëhet nga një numër gjyqtarësh i barabartë me numrin e

Palëve të Larta Kontraktuese.

Neni 21

Kriteret e ushtrimit të funksioneve

1. Gjyqtarët duhet të kenë karakter të lartë moral dhe të kenë kualifikimet e duhura për ushtrimin e funksioneve të larta gjyqësore ose të jenë juristë me aftësi të shquara.
2. Gjyqtarët janë anëtarë të Gjykatës me zotësi individuale.
3. Gjyqtarët, gjatë mandatit të tyre, nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari të papajtueshme me kërkesat e pavarësisë, paanësisë ose angazhimit në veprimtarinë me kohë të plotë; çdo çështje që ka të bëjë me zbatimin e këtij paragrafi zgjidhet nga Gjykata.

Neni 22

Zgjedhja e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja Parlamentare për çdo Palë të Lartë Kontraktuese, me shumicën e votave të shprehura mbi bazën e një liste prej tre kandidatësh të emëruar nga Pala e Lartë Kontraktuese.
2. E njëjta procedurë ndiqet për plotësimin e Gjykatës në rast aderimi të Palëve të reja të Larta Kontraktuese dhe për zëvendësimin e vendeve të mbetura bosh.

Neni 23

Kohëzgjatja e mandatit

1. Gjyqtarët zgjidhen për një mandat gjashtëvjeçar. Ata mund të rizgjidhen. Megjithatë, mandatet e gjysmës së gjyqtarëve që dalin nga zgjedhja e parë mbarojnë pas tre vjetësh.
2. Gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në përfundim të afatit fillestar prej tre vjetësh, caktohen me short nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës menjëherë pas zgjedhjes së tyre.
3. Për të siguruar, sa të jetë e mundur, rinovimin e mandateve të gjysmës së gjyqtarëve çdo tre vjet, Asambleja Parlamentare, para se të zhvillojë zgjedhje të mëpasme, mund të vendosë që mandati ose mandatet e një ose më shumë mandateve të gjyqtarëve që do të zgjidhen të jetë i ndryshëm nga gjashtë vjet, por jo më shumë se nëntë vjet dhe jo më pak se tre vjet.
4. Kur ka më shumë se një mandat dhe kur Asambleja Parlamentare zbaton paragrafin e mësipërm, ndarja e mandateve bëhet me short nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, menjëherë pas zgjedhjes.
5. Gjyqtari i zgjedhur në vendin e një gjyqtari tjetër, të cilit nuk i ka mbaruar mandati, çon deri në fund mandatin e paraardhësit.
6. Mandati i gjyqtarëve mbaron, kur ata mbushin moshën 70 vjeç.
7. Gjyqtarët qëndrojnë në detyrë, deri kur zëvendësohen. Megjithatë, ata vazhdojnë të trajtojnë çështjet e marra

në shqyrtim prej tyre.

Neni 24

Shkarkimi

Gjyqtari mund të hiqet nga detyra vetëm kur gjyqtarët e tjerë vendosin, me shumicë dy të tretash, se ai nuk u përgjigjet më kushteve të kërkuara.

Neni 25

Sekretaria dhe sekretarët ligjorë

Gjykata ka një sekretari, funksionet dhe organizimi i së cilës caktohen në rregulloren e Gjykatës. Gjykata asistohet nga sekretarët ligjorë.

Neni 26

Mbledhja plenare e Gjykatës

Gjykata, në mbledhje plenare:

- a) zgjedh, për një afat prej tre vjetësh, kryetarin e saj dhe një ose dy zëvendëskryetarë, të cilët mund të rizgjidhen;
- b) krijon Dhomat, për një afat të caktuar;
- c) zgjedh Kryetarët e Dhomave të Gjykatës, të cilët mund të rizgjidhen;
- d) miraton rregulloren e Gjykatës, dhe
- e) zgjedh Sekretarin dhe një ose disa zëvendëssekretarë.

Neni 27

Komitetet, Dhomat dhe Dhoma e Madhe

1. Për shqyrtimin e çështjeve që i paraqiten, Gjykata gjykon në komitete prej tre gjyqtarësh, në Dhoma prej shtatë gjyqtarësh dhe në një Dhomë të Madhe prej shtatëmbëdhjetë gjyqtarësh. Dhomat e Gjykatës do të ngrënë komitete për një periudhë kohe të caktuar.

2. Gjyqtari i zgjedhur në emër të një Shteti Palë në gjykim merr pjesë kryesisht në Dhomë dhe në Dhomën e Madhe, dhe në rast se nuk ka një gjyqtar ose ai nuk është në gjendje të marrë pjesë, Shteti Palë cakton një person që merr pjesë në cilësinë e gjyqtarit.

3. Në Dhomën e Madhe përfshihen gjithashtu Kryetari i Gjykatës, zëvendëskryetarët, kryetarët e Dhomave dhe gjyqtarë të tjerë të zgjedhur sipas rregullave të Gjykatës. Kur çështja i është kaluar Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43, asnjë gjyqtar i Dhomës që ka dhënë vendimin nuk mund të marrë pjesë në të, me përjashtim të Kryetarit të Dhomës dhe gjyqtarit, që ka marrë pjesë në lidhje me Shtetin Palë të interesuar.

Neni 28

Deklarimi i papranueshmërisë nga komitetet

Një komitet, me votë unanime, mund ta deklarojë të papranueshme ose mund ta heqë nga lista e çështjeve një kërkesë individuale të paraqitur në bazë të nenit 34, kur një vendim

i tillë mund të merret pa shqyrtim të mëtejshëm. Vendimi është përfundimtar.

Neni 29

Vendimet e Dhomave mbi pranueshmërinë dhe themelin

1. Në qoftë se nuk merret asnjë vendim sipas nenit 28, njëra nga Dhomat vendos mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave individuale të paraqitura në bazë të nenit 34.

2. Dhoma shprehet mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesave ndërshtetërore, të paraqitura në bazë të nenit 33.

3. Vendimet mbi pranueshmërinë do të merren veçan, përveçse kur Gjykata vendos ndryshe në raste përjashtimore.

Neni 30

Heqja dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe

Në qoftë se një çështje në gjykim para një Dhome paraqet një problem serioz në lidhje me interpretimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose kur zgjidhja e një çështjeje mund të ketë një rezultat të papajtueshëm me një vendim të dhënë më parë nga Gjykata, Dhoma, në çdo kohë, para marrjes së vendimit, mund të heqë dorë nga juridiksioni i saj në favor të Dhomës së Madhe, me kusht që njëra nga palët e çështjes të mos ketë kundërshtime.

Neni 31

Kompetencat e Dhomës së Madhe

Dhoma e Madhe:

1. a) shprehet për kërkesat e paraqitura sipas nenit 33 ose nenit 34 kur njëra Dhomë ka hequr dorë nga juridiksioni sipas nenit 30 ose kur çështja i është kaluar asaj sipas nenit 43

b) shqyrton kërkesat për mendimet këshillimore të paraqitura në bazë të nenit 47.

Neni 32

Juridiksioni i Gjykatës

1. Juridiksioni i Gjykatës shtrihet mbi të gjitha çështjet, që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të protokolleve që i referohen asaj siç parashikohen në nenet 33, 34 dhe 47.

2. Në rast mosmarrëveshjeje për juridiksionin, vendos Gjykata.

Neni 33

Çështjet ndërshtetërore

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese mund t'i drejtohet Gjykatës për çdo shkelje të supozuar të dispozitave të Konventës ose të protokolleve të saj, nga një Palë tjetër e Lartë Kontraktuese.

Neni 34

Kërkesat individuale

Gjykatës mund t'i paraqiten kërkesa nga çdo person, organizëm joqeveritar

ose grup individësh që pretendon se është viktimë e një shkeljeje prej njëres nga Palet e Larta Kontraktuese e të drejtave të parashtruara nga Konventa ose protokollat e saj. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

Neni 35

Kushtet e pranueshmërisë

1. Gjykata mund të marrë në shqyrtim çështjen vetëm pasi të jenë shterur mjetet e brendshme, sipas rregullave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së vendimit përfundimtar.

2. Gjykata nuk merr në shqyrtim asnjë kërkesë individuale të paraqitur sipas nenit 34, që:

a) është anonime; ose

b) është në thelb e njëjta me një çështje të shqyrtuar më parë nga Gjykata ose që i është nënshtruar një procedure tjetër për zgjidhje ose investigim ndërkombëtar dhe nuk përmban fakte të reja përkatëse

3. Gjykata deklaron të papranueshme çdo kërkesë individuale të paraqitur në zbatim të nenit 34, të cilën e konsideron të papajtueshme me dispozitat e Konventës ose të protokolleve të saj, haptazi të pabazuar, ose një shpërdorim të së drejtës për kërkesë.

4. Gjykata rrëzon çdo kërkesë që e konsideron të papranueshme në zba-

tim të këtij neni. Ajo mund ta bëjë këtë në çdo fazë të procedimit.

Neni 36

Ndërhyrja e palës së tretë

1. Në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Madhe, një Palë e Lartë Kontraktuese, ku kërkues është një nga shtetasit e tij, ka të drejtë të paraqesë komente me shkrim dhe të marrë pjesë në seanca.

2. Në interes të miradministrimit të drejtësisë, Kryetari i Gjykatës mund të ftojë çdo Palë të Lartë Kontraktuese, që nuk është palë në gjykim ose çdo person të interesuar, që nuk është kërkuesi, të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seanca.

Neni 37

Çregjistrimi i kërkesave

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:

- a) kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose
- b) çështja është zgjidhur; ose
- c) për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.

Megjithatë, Gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës kur këtë e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa dhe protokollat e saj.

2. Gjykata mund të vendosë rifutjen e një kërkesë në listën e çështjeve, kur e konsideron se rrethanat e justifikojnë këtë.

Neni 38

Shqyrtimi i çështjes dhe procedura e zgjidhjes me pajtim

1. Kur Gjykata deklaron të pranueshme një kërkesë, ajo:

a) vazhdon shqyrtimin e çështjes bashkë me përfaqësuesit e palëve dhe, kur është e nevojshme, ndërmerr një hetim, për kryerjen efektive të të cilit Shtetet e interesuara duhet të sigurojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme;

b) vihet në shërbim të të interesuarve me qëllim që të sigurojë një zgjidhje me pajtim të çështjes, mbi bazën e respektit për të drejtat e njeriut, siç përcaktohen nga Konventa dhe protokollat e saj.

2. Procedura e kryer sipas paragrafit 1.b është konfidenciale.

Neni 39

Gjetja e një zgjidhje me pajtim

Në rast se gjendet një zgjidhje me pajtim, Gjykata heq çështjen nga lista nëpërmjet një vendimi, i cili përmban një paraqitje të shkurtër të fakteve dhe zgjidhjen e arritur.

Neni 40

Seancat publike dhe e drejta për t'u njohur me dokumentet

1. Seancat janë publike, përveç rasteve kur Gjykata në rrethana përjashtimore vendos ndryshe

2. Dokumentet e depozituara në sekretari janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur Kryetari i Gjykatës vendos ndryshe.

Neni 41

Shpërblimi i drejtë

Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.

Neni 42

Vendimet e Dhomave

Vendimet e Dhomave bëhen përfundimtare sipas dispozitave të nenit 44, paragrafi 2.

Neni 43

Kalimi i çështjes Dhomës së Madhe

1. Brenda një afati prej tre muajsh nga data e vendimit të një Dhome, çdo palë në çështje, në raste përjashtimore, mund të kërkojë kalimin e saj Dhomës së Madhe.

2. Kërkesa pranohet nga një kolegji prej pesë gjyqtarësh të Dhomës së Madhe, në qoftë se çështja ngre një problem serioz që ka të bëjë me interpretimin

ose zbatimin e Konventës ose të protokolleve të saj, ose një çështje serioze të një rëndësie të përgjithshme.

3. Kur kolegji e pranon kërkesën, Dhome e Madhe shprehet për çështjen me vendim.

Neni 44

Vendimet përfundimtare

1. Vendimi i Dhomës së Madhe është përfundimtar.

2. Vendimi i një Dhome bëhet përfundimtar:

a) kur palët deklarojnë se nuk do të kërkojnë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe; ose

b) tre muaj pas datës së vendimit kur nuk është kërkuar kalimi i çështjes në Dhomën e Madhe; ose

c) kur kolegji i Dhomës së Madhe rrezon kërkesën për kalimin e çështjes, sipas nenit 43.

3. Vendimi përfundimtar botohet.

Neni 45

Arsyetimi i vendimeve

1. Vendimet përfundimtare, si dhe ato që deklarojnë pranueshmërinë ose papranueshmërinë e kërkesave, arsyetohen.

2. Në qoftë se vendimi nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht mendimin unanimit të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të japë një mendim të veçantë.

Neni 46

Fuqia detyruese dhe zbatimi i vendimeve

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës në çdo çështje ku ata janë palë.
2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i dërgohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij.

Neni 47

Mendimet këshillimore

1. Gjykata, me kërkesë të Komitetit të Ministrave, mund të japë mendime këshillimore për çështje ligjore që lidhen me interpretimin e Konventës dhe të protokolleve të saj.
2. Opinione të tilla nuk trajtojnë asnjë çështje që lidhet me përmbajtjen dhe shtrirjen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Seksionin e parë të Konventës dhe në protokollet e saj, ose me ndonjë çështje tjetër të cilën Gjykata ose Komiteti i Ministrave mund t'i duhet ta shqyrtojë si pasojë e ndonjë procedure të tillë, siç mund të përcaktohet në pajtim me Konventën.
3. Vendimi i Komitetit të Ministrave për t'i kërkuar Gjykatës mendime këshillimore merret me votën e shumicës së përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

Neni 48

Juridiksioni këshillimor i Gjykatës

Gjykata vendos nëse kërkesa për mendim këshillimor që paraqitet nga Komiteti i Ministrave është në kompetencën e saj, siç përcaktohet në nenin 47.

Neni 49

Arsyetimi i mendimeve këshillimore

1. Mendimet këshillimore të Gjykatës arsyetohen.
2. Në qoftë se mendimi këshillimor nuk shpreh tërësisht ose pjesërisht opinionin e njëzëshëm të gjyqtarëve, çdo gjyqtar ka të drejtë të japë një mendim të veçantë.
3. Mendimet këshillimore të Gjykatës i komunikohen Komitetit të Ministrave.

Neni 50

Shpenzimet për Gjykatën

Shpenzimet për Gjykatën mbulohen nga Këshilli i Evropës.

Neni 51

Privilegjet dhe imunitetet e gjyqtarëve

Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në Nenin 40 të Statutit të Këshillit të Evropës dhe në marrëveshjet e lidhura në zbatim të këtij neni.

Seksioni III 7/8

Dispozita të ndryshme

Neni 52

Hetimet e Sekretarit të Përgjithshëm

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, jep shpjegim mbi mënyrën se si e drejta e saj e brendshme siguron zbatimin efektiv të të gjitha dispozitave të Konventës.

Neni 53

Mbrojtja e të drejtave ekzistuese të njeriut

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose çënon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo Pale të Lartë Kontraktuese ose nga çdo marrëveshje tjetër në të cilën kjo Palë e Lartë Kontraktuese është palë.

Neni 54

Kompetencat e Komitetit të Ministrave

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk çënon kompetencat që Statuti i Këshillit të Evropës i jep Komitetit të Ministrave.

Neni 55

Përfshirja e mjeteve të tjera të

zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Me përjashtim të ndonjë marrëveshjeje të veçantë, Palët e Larta Kontraktuese heqin dorë reciprokisht nga përfitimi prej traktateve, konventave ose deklaratave në fuqi ndërmjet tyre, për të zgjidhur me anë të ankimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Konvente, në mënyra të ndryshme nga ato që parashikon Konventa në fjalë.

Neni 56

Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet, në momentin e ratifikimit ose në çdo moment tjetër të mëvonshëm, mund të deklarojë me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës se kjo Konventë, në bazë të paragrafit 4 të këtij neni, do të zbatohet mbi të gjitha territoret ose mbi secilin nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve është përgjegjës.
2. Konventa do të zbatohet për territorin ose territoret e caktuara në njoftim, tridhjetë ditë pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të ketë marrë njoftim.
3. Në territoret e lartpërmendura, dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen duke marrë parasysh nevojat vendore.
4. Çdo Shtet, i cili ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, në çdo rast të mëvonshëm, mund të deklarojë në

emër të një ose më shumë territoreve të përmendur në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të individëve, të organizatave joqeveritare ose të grupeve të individëve të parashikuara në nenin 34 të kësaj Konvente.

Neni 57

Rezervat

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit të kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, mund të formulojë ndonjë rezervë në lidhje me një dispozitë të veçantë të Konventës, në shkallën që një ligj në fuqi në atë kohë në territorin e tij nuk është në përputhje me këtë dispozitë. Sipas këtij neni, nuk lejohen rezervat me karakter të përgjithshëm.
2. Çdo rezervë e bërë në përputhje me këtë nen duhet të përmbajë një deklaratë të shkurtër të ligjit në fjalë.

Neni 58

Denoncimi

1. Një Palë e Lartë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Konventë, vetëm pas kalimit të pesë vjetëve nga data e hyrjes së Konventës në fuqi për këtë palë dhe me një njoftim paraprak prej gjashtë muajsh drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili informon Palët e tjera të Larta Kontraktuese.
2. Ky denoncim nuk mund të ketë si pasojë çlirimin e Palës së Lartë Kont-

raktuese në fjalë nga detyrimet e saj sipas kësaj Konvente lidhur me çdo akt që, po të përbëjë shkelje të këtyre detyrimeve, mund të jenë kryer nga ajo përpara datës në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

3. Nën të njëjtat kushte që ndonjëra nga Palët e Larta Kontraktuese pushon së qënuri Anëtare e Këshillit të Evropës, pushon gjithashtu së qënuri Palë në këtë Konventë.
4. Konventa mund të denoncohet në përputhje me dispozitat e paragrafëve të mëparshëm përsa i përket çdo territori për të cilin ajo ka qenë deklaruar të zbatohet në bazë të nenit 56.

Neni 59

Nënshkrimi dhe ratifikimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin e Anëtarëve të Këshillit të Evropës. Ajo duhet të ratifikohet. Ratifikimet depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
2. Kjo Konventë hyn në fuqi pas dorëzimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit.
3. Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Konventa do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Anëtarët e Këshillit të Evropës për hyrjen në fuqi të Konventës, për emrat e Palëve të Larta Kontraktuese që e kanë ratifikuar,

si dhe për depozitimin e mëvonshëm të çdo instrumenti ratifikimi.

PROTOKOLL I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

DHE LIRIVE THEMELORE, AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR 11

Paris, 20. III. 1952

Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998.

Qeveritë nënshkruese, Anëtare të Këshillit të Evropës, Të vendosura që të marrin masa për të siguruar zbatimin kolektiv të disa të drejtave dhe lirive të tjera nga ato të përfshira në Seksionin I të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim e referuar si "Konventa"), Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i

çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera,.

Neni 2

E drejta për arsimim

Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respektton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Neni 3

E drejta për zgjedhje të lira

Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.

Neni 41

Zbatimi territorial

Çdo Palë e Lartë Kontraktuese, në momentin e nënshkrimit ose të ratifikimit të këtij Protokollit ose në çdo moment tjetër të mëvonshëm, mund t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës një deklaratë, ku cakton masën në

të cilën ajo merr përsipër të zbatojë 1 Teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155) dispozitat e këtij Protokollit në territoret e përmendura në deklaratën në fjalë, marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ajo siguron. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që ka komunikuar një deklaratë në bazë të paragrafit të mësipërm, mund të komunikojë herë pas here një deklaratë të mëtejshme që ndryshon përmbajtjen e çdo deklarate të mëparshme ose që i jep fund zbatimit të dispozitave të këtij Protokollit mbi çdo territor. Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen, do të konsiderohet të jetë bërë në përputhje me paragrafin (1) të nenit 56 të Konventës.

Neni 5

Marrëdhënia me Konventën

Palët e Larta Kontraktuese do t'i konsiderojnë nenet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij Protokollit si nene shtesë të Konventës dhe për pasojë do të zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 6

Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim për anëtarët e Këshillit të Evropës, nënshkrues të Konventës; ai do të ratifikohet njëkohësisht me Konventën ose pas ratifikimit të saj. Ai do të hyjë në fuqi pas depozitimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit.

Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë, Protokollit do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, i cili do t'u bëjë të njohur të gjithë Anëtarëve emrat e atyre që e kanë ratifikuar. Bërë në Paris, më 20 mars 1952, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës, i cili do t'u bëjë të njohur të gjithë Anëtarëve emrat e atyre që e kanë ratifikuar.

Bërë në Paris, më 20 mars 1952, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëlloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilës Qeveri nënshkruese.

PROTOKOLLI NR. 7 I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, AMENDUAR ME PROTOKOLLIN NR.11

Strasburg, 22. XI. 1984

Titujt e neneve të shtuar dhe teksti i amenduar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155), që prej hyrjes së tij në fuqi më 1 nëntor 1998 Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij Protokollit, Të

vendosura që të marrin masat e përshtatshme për të siguruar garancinë kolektive të disa të drejtave dhe lirive nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950 (në vijim e referuar si "Konventa"), Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve

1. Një i huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një Shteti nuk mund të dëbohet, veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

- a) të parashtrojë arsyet kundër dëbimit të tij;
- b) të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij;
- c) të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose një ose disa persona të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të renditura në paragrafin 1.a, b dhe c të këtij neni, kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose është bërë për arsye të sigurisë kombëtare.

Neni 2

E drejta e apelit në çështjet penale

1. Çdo person i shpallur fajtor për

një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.

2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij.

Neni 3

Kompensimi për dënimin e padrejtë

Kur një person është dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë dhe kur ky dënim është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar ndëshkimin për arsye të këtij dënimi, zhdëmtohet sipas ligjit ose praktikës në fuqi në Shtetin në fjalë, me përjashtim të rastit kur është provuar se moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej personit në fjalë.

Neni 4

E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të

njëtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.

3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.

Neni 5

Barazia ndërmjet bashkëshortëve

Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisive me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ky nen nuk i pengon Shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.

Neni 6

Zbatimi territorial

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit ose të dorëzimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit, mund të caktojë territorin ose territoret në të cilët do të gjejë zbatim ky Protokoll,

duke përcaktuar masën në të cilën ai merr përsipër të zbatojë dispozitat e këtij Protokoll në këtë ose këto territore.

2. Çdo Shtet, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund ta shtrijë zbatimin e këtij Protokoll në lidhje me çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Protokollin hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason kalimin e një periudhe prej dy muajsh nga data e marrjes së deklaratës nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm mund të tërhiqet ose të ndryshohet, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja ose ndryshimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. 1 Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen do të konsiderohet e bërë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 56 të Konventës.

5. Territori i çdo Shteti për të cilin gjen zbatim ky Protokoll në bazë të ratifikimit, pranimit ose miratimit të tij nga Shteti në fjalë dhe secili nga territoret për të cilin ky Protokoll gjen zbatim në bazë të një deklaratë të nënshkruar nga Shteti në fjalë në përputhje me këtë nen, mund të

konsiderohen si territore më vete duke marrë parasysh referimin që i bëhet territoreve të një Shteti në nenin 1.

6.2 Çdo Shtet që ka bërë deklaratë sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni, në çdo kohë të mëpasme, mund të deklarojë në lidhje me një ose më shumë territore të parashikuara në këtë deklaratë, se pranon kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e kërkesave të personave fizikë, të organizmave joqeveritare ose të grupeve të individëve, siç parashikohet në nenin 34 të Konventës, në lidhje me nenet 1 deri 5 të këtij Protokollit.

Neni 7

Marrëdhënia me Konventën

Shtetet Palë do t'i konsiderojnë nenet 1 deri 6 të këtij Protokollit si nene shtesë të Konventës dhe, për pasojë zbatohen të gjitha dispozitat e Konventës.

Neni 8

Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky Protokoll është i hapur përnënshkrim për Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të Konventës. Ai do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimi ose miratimit. Një Shtet anëtar i Këshillit të Evropës nuk mund ta ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Protokoll pa ratifikuar paraprakisht ose njëkohësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.

2. Për çdo Shtet anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me Protokollin, ky i fundit do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose miratimit.

Neni 10

Funksionet e depozitarit

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton të gjithë Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës:

- a) për çdo nënshkrim;
- b) për depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c) për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokollit në përputhje me nenet 6 dhe 9;
- d) për çdo akt, njoftim ose deklaratë tjetër që ka lidhje me këtë Protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, nënshkruajnë këtë Protokoll. Bërë në Strasburg, më 22 nëntor

1984, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njëloj autentikë, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit Shtet Anëtar të Këshillit të Evropës.

MË SHUMË INFORMACION

Drejtoria e Koordinimit të Programit
Këshilli i Evropës
Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France
Tel. +33 (0)3 88 41 20 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

SQI

Bashkimi Evropian është një bashkim ekonomik dhe politik i 27 vendeve evropiane. Ai bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai vepron globalisht për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive, mjedisit dhe ekonomive, në mënyrë që të gjithë të mund të përfitojnë.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës